

TruthSeekers

Rrënjët e besimit

Mësimet 34 - 66

© 2011 Awana® Clubs International

1 East Bode Road, Streamwood, IL 60107-6658 U.S.A.
internationalprogram@awana.org • (630) 213-2000

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Shtypur në Shqipëri. Asnjë material nga ky publikim nuk mund të riprodhohet apo të përkthehet pa leje të shkruar nga botuesi.

Awana dhe logoja Awana janë marka të regjistruara të Awana Clubs International. Tërë citimet e Shkrimit janë marrë nga Bibla, Diodati i Ri, përkthimi 1991-94. E drejta e autorit Albanian Bible Society. Përdorur me leje. Të gjitha të drejtat të rezervuara

Mësimi kronologjik të Kartat Awana dhe “Ndhimat e mësimdhënies” në Manualin e Mësuesit Rrënjët e besimit të Kërkuesve të së Vërtetës Awana janë përshtatur nga Botimi i fëmijëve, Themelet e qëndrueshme: nga krijimi të Krishti (Librat 2 dhe 3).

Nëse je duke e përdorur për herë të parë një manual mësuesi Rrënjët e Besimit Kërkuesit e së Vërtetës Awana, mund të rishikosh faqet 6-33 në pjesën e parë të Manuali i Mësuesit. Tek ato faqe do të mësosh se si të mësosh bazat e ungjillit, temat doktrimore, parimet e mësimdhënies, se si të drejtosh një fëmijë të Krishti dhe se si të përgatisësh mësimet.

Kur kërkohet për metodën më të qartë, më të thjeshtë e në të njëjtën kohë më të kuptueshme të mësimit të Fjalës së Perëndisë për t'i përgatitur njerëzit për ungjillin dhe për t'u mësuar rrugën e shpëtimit të Perëndisë, Trevor McIlwain-i e gjeti përgjigjen në Fjalën e Perëndisë. Botimi i fëmijëve, Themelet e qëndrueshme: nga krijimi të Krishti u përshtat nga seritë Ndërtimi në themelet e qëndrueshme shkruar nga Trevor McIlwain-i. Duke iu lutur Zotit për drejtim, skuadra e autorëve të këtyre librave zhvilloi parimet e mësimdhënies që hodhën themelet e qëndrueshme për besimin që shpëton duke mësuar një paraqitje të përgjithshme kronologjike të historisë së Biblës, duke filluar me Zanafillën dhe duke mbaruar me ngjitjen e Krishtit.

Awana



TruthSeekers

Rrënjët e besimit

Manuali i mësuesit

Mësimet 34-66



TruthSeekers

Mësimet “Kërkuesit e së Vërtetës”

34. Le ta dëgjojmë prapë!	7
35. Perëndia siguroi për Izraelin	12
36. Premtimi i Perëndisë ndaj Izraelit	15
37. Dhjetë urdhërimet	18
38. Tabernakulli	23
39. Mosbesimi i Izraelit	28
40. Izraeli në tokën e premtuar	31
41. Perëndia përgatit rrugën për Çlirimtarin	34
42. Pyetje, pyetje, pyetje!	37
43. Planet e Perëndisë për Gjonin dhe Jezusin	41
44. Perëndia dërgon Çlirimtarin	44
45. Pagëzimi i Jezusit	47
46. Jezusi qortoi Satanin	50
47. Jezusi fillon punën e Tij	53
48. Duhet të lindësh sërish	56
49. Drejtuesit fetarë refuzojnë Jezusin	59
50. Jezusi zgjodhi dymbëdhjetë dishepuj	62
51. Jezusi shëron një njeri të pushtuar nga demonët	65
52. Jezusi ushqeui pesë mijë njerëz	68
53. Pyetje, pyetje, pyetje!	71
54. Duhet të jetë sipas mënyrës së Perëndisë!	74
55. Shpërftyrimi i Jezusit	77
56. Jezusi është dera për në jetën e përjetshme	80
57. Jezusi ngjalli Llazarin prej së vdekurish	83
58. I riu pasanik	86
59. Qielli apo ferri?	89
60. Jezusi tradhtohet	92
61. Arrestimi i Jezusit	95
62. Kryqëzimi i Jezusit	98
63. Ringjallja dhe ngjitja e Jezusit në qiell	103
64. Domethënia e vdekjes së Krishtit - 1	106
65. Domethënia e vdekjes së Krishtit - 2	109
66. Pyetje, pyetje, pyetje!	112

Mësimi 34

Qëllimi:

Ky mësim do të përmbledhë disa nga të vërtetat e mësuara në 33 mësimet e para.

- Bibla është Fjala e Perëndisë.
- Perëndia është Perëndia i vetëm i vërtetë.
- Perëndia është i shenjtë dhe i drejtë.
- Perëndia krijoi gjithçka.
- Mëkati dhe ndarja nga Perëndia.
- Çlirimtari.
- Pagesa zëvendësuese për mëkatin.

Hyrje

Historitë “Kërkuesit e së Vërtetës” janë shkruar për të ndihmuar fëmijët të kuptojnë të vërtetën biblike që mësohet në “Mësime nga Fjala e Perëndisë”. Disa histori do të kenë një ose më shumë të vërteta biblike të përmendura dhe disa do të ndihmojnë për t’i bërë të qarta të vërtetat e rëndësishme themelore.

Historitë mund të ndryshojnë paksa në bazë të vendndodhjes tënde dhe përkthimit që përdoret, kështu që disa nga idetë e paraqitura mund të mos vlejnjë për fëmijët e klubit tënd. Megjithatë, të vërtetat biblike nuk do të ndryshojnë; ato duhet të paraqiten ashtu siç janë shkruar.

Historia e sotme është një përsëritje e një pjese të materialit të vitit të kaluar. Nëse viti i parë i klubit tënd “Kërkuesit e së Vërtetës” nisi në fillim të vitit shkollor, ky mësim do të mësohet në fillim të vitit të ardhshëm shkollor. Fëmijët e klubit tënd do të kishin pasur një “pushim nga shkolla” prej disa javësh apo muajsh. Prandaj ne mendojmë se është e rëndësishme që fëmijët e klubit të përsërisin disa nga të vërtetat e rëndësishme që janë mësuar gjatë 33 mësimëve të para.

Figurat

- Grafiku 1: Të mësojmë rreth Perëndisë
- Përdor këtë grafik për të përsëritur atributet e Perëndisë.

Le ta dëgjojmë prapë!

Historia

Karola hyri me vrap në shtëpi duke thirrur Xhonin: “Xhon, Xhon! Eja të takojmë xhaxhi Piterin. Kanë kaluar disa javë që nuk kemi folur me të. Më ka marrë malli!”.

“Edhe mua” - tha Xhoni. “Eja të shkojmë!”.

Karola dhe Xhoni, duke iu marrë fryma, vrapuan drejt xhaxhi Piterit, i cili ishte ulur përballë shtëpisë së tij. Së bashku ata thirrën: “Përshëndetje, xhaxhi Piter. Ne u kthëm!”. Xhaxhi Piteri ngriti sytë lart duke qeshur dhe tha: “Mirë se erdhët, Xhoni dhe Karola. Edhe mua më ka marrë malli për ju dhe për diskutimet tona”.

“Edhe ne na ka marrë malli, xhaxhi Piter” - iu përgjigj Xhoni. “Sidomos për diskutimet tona rreth Biblës”. “Kemi qenë të zënë në shtëpinë e gjyshes” - tha Karola. “Neve as që na shkoi në mendje që të lexonim Biblën. Tani nuk e di nëse do të kujtojmë tërë gjërat për të cilat kemi folur”.

“Shiko,” - tha xhaxhi Piteri, - “le të shohim se çfarë mbani mend rreth Perëndisë”. “Ne kemi mësuar shumë gjëra rreth Perëndisë,” - tha Xhoni, - “por mund të të them disa gjëra të rëndësishme që kujtoj për Të. Perëndia është Perëndia i vetëm i vërtetë. Perëndia njih gjithçka. Ai nuk kishte fillim dhe fund. Perëndia është i shenjtë dhe i drejtë. Shtëpia e Perëndisë është në qiell, por Ai ndodhet gjithashtu në çdo vend në të njëjtën kohë”.

“Perëndia na flet përmes Fjalës së Tij, Biblës” - e ndërpreu Karola. “Bibla është historia e Perëndisë”. “Dhe Perëndia krijoi gjithçka” - tha Xhoni. “Ai është më i madhi dhe më i madh nga të gjithë!”.

“Shumë mirë!” - tha xhaxhi Piteri. “Po Luciferi? A e kujtoni atë?”. “Po!” - tha Karola. “Luciferi, që quhet Satan, ishte një engjell i krijuar nga Perëndia. Satani u rebelua ndaj Perëndisë, kështu që Ai e përzuri nga qielli. Satani është armiku i madh i Perëndisë. Ai lufton kundër Perëndisë ditë e natë duke u përpjekur të ndalojë gjërat që bën Perëndia. Satani dëshiron që njeriu të ndjekë atë në vend të Perëndisë”.

“Perëndia krijoi edhe Adamin dhe Evën” - e ndërpreu Xhoni. “Dhe Ai bëri një kopsht shumë të bukur për ta që të jetonin. Ai kopsht quhet Eden. Perëndia mbolli dy pemë shumë të rëndësishme në mes të kopshtit”.

“A kujtoni se si quheshin?” - pyeti xhaxhi Piteri. “Jo? Atëherë, ato quheshin pema e jetës dhe pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes”.

“E di,” - tha Karola, - “që Perëndia i tha Adamit që të mos hante nga pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes. Perëndia tha që nëse Adami hante prej saj, ai do të ndahej përfundimisht nga Perëndia dhe një ditë ai do të vdiste. Perëndia ishte miku i tyre; Ai i donte dhe ata ishin shumë të lumtur”.

“A e kujtoni gjithashtu, - pyeti xhaxhi Piteri, - që Adami dhe Eva ndoqën këshillën e Satanit, duke mos iu bindur Perëndisë dhe hëngrën nga pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes? Ata u ndanë nga Perëndia për shkak të mëkatis të tyre. Perëndia urren mosbindjen ndaj urdhrave të Tij dhe Ai nuk lejon një person të pabindur të jetojë me Të”.

“Dhe,” - shtoi Karola, - “Perëndia dëboi Adamin dhe Evën nga kopshti, në mënyrë që të mos hanin më nga pema e jetës, të takoheshin apo flisnin me Perëndinë, sepse do të vdisnin”. “Po” - tha xhaxhi Piteri. “Edhe pse njerëzit kanë ngjyra të ndryshme lëkure, ne të gjithë e kemi prejardhjen nga të njëjtët prindër: Adami dhe Eva. Prandaj, për shkak se Adami nuk iu bind Perëndisë dhe u nda prej Tij, tërë njerëzit në këtë botë kanë lindur mëkatarë, të ndarë nga Perëndia dhe të kontrolluar nga Satani. Për shkak të mëkatis të Adamit, ai do të vdiste dhe tërë fëmijët e tij do të vdisnin gjithashtu. Kjo të përfshin ty dhe mua!”.

“Por Perëndia e do akoma njeriun, apo jo?” - pyeti Xhoni. “Ke të drejtë, Xhon” - iu përgjigj xhaxhi Piteri. “Ngaqë Perëndia është i dashur, i mëshirshëm dhe i hirshëm, Ai premtoi të dërgonte një çlirimtar: dikë për ta shpëtuar njeriun nga Satani, mëkati dhe vdekja. Perëndia premtoi që Çlirimtari do ta shkatërronte Satanin dhe do ta shpëtonte njeriun nga fuqia e tij. Ju keni kujtesë shumë të mirë, Xhon e Karola. Uluni dhe le të shohim se çfarë gjëje tjetër mbani mend”.

Le të shikojmë në Bibël



Isaia 45:22 – “Kthehuni nga unë dhe do të shpëtoni, ju mbarë skaje të tokës. Sepse unë jam Perëndia dhe nuk ka asnjë tjetër”.

Ndihmoji fëmijët e klubit tënd të gjejnë këtë varg. Shpjegoje vargun dhe ndihmoji që ta mësojnë përmendsh. Shiko pjesën “Si të përgatisësh mësimet e

tua” për të marrë ide se si t’ua mësosh vargun fëmijëve të klubit tënd.

Le të mendohe mi

1. A ka pasur ndonjë kohë kur Perëndia nuk ka ekzistuar? Po/Jo.
2. A do të vdesë Perëndia? Po/Jo.
3. Kush ka krijuar çdo gjë?
a. Satani **b. Perëndia** c. Adami
4. Çfarë është mëkat?
a. Gjërat e mira që bëjmë b. Frytet c. Mosbindja
5. Kush do ta shpëtojë njeriun nga Satani, mëkati dhe vdekja?
a. Një engjëll b. Adam c. Çlirimtari.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Do të hedhësh themelin biblik mbi të cilin do të paraqitet ungjilli. Çdo mësim mbështetet në mësimet e mëparshme, ndaj sigurohu që të trajtosh me kujdes çdo pikë.

Sigurohu dhe diskuto tërë të vërtetat biblike të shkruara në seksionin “Mësime nga Fjala e Perëndisë” që janë me ngjyra. Përdor Biblën kur jep këto mësime. Inkurajo tërë fëmijët e klubit të cilët kanë Bibla që t’i marrin me vete në klub.

Mësimi i sotëm do të jetë një përsëritje e 33 mësimëve të mëparshme. Ti si mësues duhet të dish se sa kohë të duhet të harxhosh për përsëritjen me fëmijët e klubit. Është e rëndësishme që fëmijët e klubit të kenë një kuptim të qartë të pikave më poshtë para se të vazhdojnë me këto mësime: Perëndia; Satani; Adami, Eva dhe mëkati; gjendja e njeriut para Perëndisë: vdekja ndarëse dhe fizike, ndëshkimi i përjetshëm, pagesa për mëkatin, Çlirimtari i premtuar dhe nevoja për flijimin me gjak për mëkatin. Mund të kalosh kohë shtesë duke përsëritur mësimet me disa prej fëmijëve të klubit që nuk kanë një kuptim të qartë të të vërtetave të lartpërmendura. Do t’i zgjedhësh vetë pyetjet e tua për fundin e këtij mësimi.

1. Bibla është Fjala e Perëndisë

- Bibla është libri më i rëndësishëm në tërë botën, sepse është Fjala e Perëndisë. Çdo fjalë e Biblës është e vërtetë!
- Bibla është mesazhi personal i Perëndisë ndaj secilit prej nesh; është mesazhi më i rëndësishëm që na është dhënë ndonjëherë.
- Bibla na flet për Perëndinë.
- Bibla na tregon se çfarë mendon Perëndia për ne dhe çfarë konsideron Ai si nevojën tonë më të madhe.
- Bibla na thotë se si është plotësuar nevoja jonë më e madhe.

2. Perëndia është Perëndia i vetëm i vërtetë. Ai është i shenjtë dhe i drejtë.

- Vetëm Perëndia nuk ka fillim; Perëndia nuk ka fund; Perëndia është i përjetshëm.
- Perëndia është Trini në tre persona.
 - Perëndia Atë (Ati është Perëndi)
 - Perëndia Bir (Biri është Perëndi)
 - Perëndia Fryma e Shenjtë (Fryma e Shenjtë është Perëndi)
- Perëndia njeh gjithçka, është në çdo vend në të njëjtën kohë, është më i madh se të gjithë dhe më i rëndësishëm se të gjithë; Ai është autoriteti më i lartë.

Kujtesë: Shënimet me shkronja të pjerrëta janë vetëm për mësuesin.

Shënim: Nëse do të doje të shikoje më tepër referenca dhe informacion rreth të vërtetave biblike që po përsërisim sot, atëherë shiko “shënimin” që të tregon se ku mund të gjeësh informacion në “Ndihmat për mësimet e mësuesit” të Manualit të Mësuesit, viti i parë. Për shembull: Shënim: Shiko Mësimet Awana 3 dhe 4 për më tepër informacion.

Nëse ke kohë, mund të përdorësh disa nga figurat e sugjeruara në këto mësime.



Lexo: 2 Timoteut 3:16a Tërë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia.

Thuaje fëmijëve të thonë vargun Isaia 45:22.

→ Grafiku 1: Të mësojmë rreth Perëndisë

Shënim: Shiko mësimet 3 e 4.

Shënim: Shiko mësimet 5 dhe 6.
Shënim: Shiko mësimin 7.
Shënim: Shiko mësimin 8.

Shënim: Shiko mësimin 9.

3. Perëndia ka krijuar gjithçka.

- Perëndia ka krijuar tërë frymërat (engjëjt). Frymërat u krijuan të gjithë nga Perëndia për ta adhuruar Atë dhe për t'i shërbyer Atij. Në fillim tërë frymërat jetonin në qiell me Perëndinë.
 - Engjëlli më i madh quhej Lucifer. Luciferit iu dha vendi më i lartë i autoritetit dhe fuqisë mbi tërë engjëjt e tjerë.
 - Luciferi vendosi t'i zinte vendin Perëndisë si sovrani i çdo gjëje. Luciferi u rebelua kundër autoritetit të Perëndisë ndaj Tij.
 - Shumë nga engjëjt e Perëndisë ndoqën Luciferin. Ai u bë drejtuesi i tyre. Ata u bashkuan me Luciferin në rebelimin kundër Perëndisë.
 - Luciferi dhe ndjekësit e tij, të quajtur demonë, nuk mund të jetonin më në qiell. Ata nuk ishin më shërbëtorët e Perëndisë.
 - Luciferi, i quajtur Satan, është armiku më i madh i Perëndisë. Që nga koha kur Perëndia e përzuri atë dhe engjëjt e tij nga qielli, ata kanë luftuar ditë e natë kundër Perëndisë dhe gjithçkaje që Ai do dhe bën.
 - Të rebelohesh është shumë serioze. Një ditë në të ardhmen, Perëndia do të dërgojë Satanin dhe engjëjt e tij në liqenin e zjarrit për t'u ndëshkuar përgjithmonë (Mateu 25:41; Zbulesa 20:10).
 - Perëndia nuk do ta tolerojë mosbindjen ndaj Tij; Perëndia kërkon gjithmonë ndëshkimin për rebelimin kundër Tij.
 - Perëndia krijoi qiejt dhe tokën.
 - Perëndia krijoi njeriun. Perëndia krijoi Adamin.
 - Ngaqë Perëndia e donte shumë Adamin, Perëndia mbolli një kopsht të bukur enkas për Adamin. Perëndia përfshiu në atë kopsht tërë perimet dhe frutorët që Adami kishte nevojë për ta mbajtur atë të shëndetshëm, të fortë dhe të lumtur.
 - Perëndia mbolli dy pemë shumë të rëndësishme në mes të kopshtit: pemën e jetës dhe pemën e njohjes të së mirës dhe të së keqes.
 - Nga të gjitha pemët që Perëndi mbolli për Adamin për ushqim, ishte vetëm një pemë nga e cila Adami nuk duhej të hante, pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes.
 - Nëse Adami do t'i bindej Perëndisë dhe do të hante vetëm atë që kishte thënë Perëndia se ishte e mirë, ai mund të hante nga pema e jetës dhe të jetonte përgjithmonë.
 - Perëndia e paralajmëroi Adamin që, nëse nuk i bindej urdhrit të Tij, ai do të vdiste (Zanafilla 2:7). Perëndia nënkuptonte që atë ditë Adami do të dëbohej nga Perëndia, i cili ishte burimi i jetës së tij. Për shkak të kësaj ai do të vdiste fizikisht një ditë. Në çastin kur nuk do të bindej, ai do të ndahej nga prania dhe miqësia e Perëndisë. Adami do të bëhej armiku i Perëndisë ashtu si Satani.
 - Së fundi, nëse Adami nuk do t'i bindej Perëndisë, atëherë jo vetëm që do të vdiste trupi i tij, por ai do të shkonte në liqenin e zjarrit. Ky është i njëjti vend i ndëshkimit të tmerrshëm, të cilin Perëndia e përgatiti për Satanin dhe ndjekësit e tij.
 - Ndëshkimi i Adamit do të ishte i përhershëm.
 - Perëndia krijoi Evën nga brinja e Adamit.
 - Jeta në kopsht ishte e këndshme për Adamin dhe Evën; gjithçka ishte e përsosur. Ata kishin gjithçka që u nevojitej.
 - Ata kishin miqësi dhe përbashkësi të përsosur me Perëndinë dhe me njëri-tjetrin.

Mësimi 34

(Vazhdim)

Le ta dëgjojmë prapë!

4. Adami dhe Eva nuk i binden Perëndisë

- Satani i njihje paralajmërimet e Perëndisë ndaj Adamit rreth pemës së njohjes të së mirës dhe të së keqes.
 - Ngaqë Satani urren Perëndinë, ai donte të shkatërronte burrin dhe gruan që kishte bërë Perëndia. Satani nuk do që dikush ta njohë Perëndinë apo t'i besojë Atij.
- Satani tundoi dhe mashtrroi Evën.
 - Satani po sugjeronte se Eva duhet të hante frutën nga pema e njohjes të së mirës e të së keqes, në mënyrë që ajo të ishte si Perëndia, të njihje atë që ishte e mirë dhe e keqe.
 - Ajo besoi që Satani po i thoshte të vërtetën. Eva besoi se ajo do të ishte e mençur si Perëndia.
- Eva hëngri për vete dhe ia dha frutën edhe Adamit.
- Edhe pse Adami e dinte se Perëndia kishte thënë që të mos e hante frutën nga pema e njohjes të së mirës e të së keqes, ai nuk iu bind me dashje urdhrat të Perëndisë.

5. Mëkati i Adamit dhe Evës i ndau nga Perëndia.

- Adami dhe Eva u ndanë nga Perëndia menjëherë kur hëngrën frutën.
 - Ngaqë Perëndia është i shenjtë dhe i drejtë, Ai nuk mund të vazhdojë miqësinë me ata që nuk i binden urdhrave të Tij.
 - Ngaqë Adami dhe Eva mëkatuan dhe nuk iu bindën Perëndisë, atyre iu ndërpre miqësia me Perëndinë. Marrëdhënia e tyre me Perëndinë kishte mbaruar.
 - Perëndia urren gjithçka që është e gabuar dhe ndëshkon çdo mosbindje ndaj urdhrave të Tij me anë të vdekjes. Romakëve 6:23a thotë: *Paga e mëkatit është vdekja.*
- Sapo Adami dhe Eva nuk iu bindën Perëndisë dhe ndoqën këshillën e Satanit, ata u ndanë nga Perëndia dhe u futën nën ndikimin e Satanit.
 - Ata nuk ishin më bijtë e Perëndisë.
- Edhe pse njerëzit kanë ngjyra të ndryshme lëkure, ne të gjithë e kemi prejardhjen nga të njëjtët prindër: Adami dhe Eva. Veprat 17:26 thotë se Perëndia “ka bërë nga një gjak i vetëm të gjitha racat e njerëzve.”
 - Për shkak të mëkatit të Adamit, ai vdiq dhe tërë fëmijët e tij do të vdesin gjithashtu. Romakëve 5:12 thotë: *... Prandaj, ashtu si me anë të një njeriu të vetëm mëkati hyri në botë dhe me anë të mëkatit vdekja, po ashtu vdekja u shtri tek të gjithë njerëzit...*
- Satani u bë sundimtari i kësaj bote.
 - Në atë kohë Satani mendonte se e kishte mundur Perëndinë dhe se ai do të kishte kontroll të plotë mbi botën dhe tërë njerëzit.
 - Këtë kishte dashur Satani. Por askush nuk mund të fitojë kundër Perëndisë. Perëndia është Krijuesi i plotfuqishëm.

6. Perëndia, në dashurinë e Tij të madhe, ka premtuar se Ai do të dërgonte një çlirimtar¹ që do të fitonte kundër Satanit dhe që do ta çlironte njerëzimin nga kontrolli i Satanit dhe do ta kthente njerëzimin te Perëndia.

- Perëndia është plot hir dhe i mëshirshëm.
 - “Hiri” është mirësia e Perëndisë ndaj mëkatarëve, të cilët nuk e meritojnë (janë të padenjës).
 - “Mëshira” është rruga që Perëndia u ofron mëkatarëve për t'i shpëtuar ndëshkimit që meritojnë!

7. Perëndia i dëboi Adamin dhe Evën nga kopshti, larg pemës së jetës - Zanafilla 3:22-23.

- Ngaqë Adami dhe Eva u ndanë nga Perëndia, ata duhej të vdisnin fizikisht. Prandaj Perëndia i nxori Adamin dhe Evën, babanë dhe nënën e tërë njerëzve, jashtë kopshtit, larg nga pema e jetës.

Shënim: Shiko mësimin 11.

Shënim: Shiko mësimin 12.

¹Çlirimtar është dikush që na shpëton dhe çliron: një çlirimtar çliron.

Shënim: Shiko mësimin 13.

Shënim: Shiko mësimin 13.

Shënim: Shiko mësimin 14.

Shënim: Shiko mësimin 15.

Shënim: Shiko mësimin 18.

Shënim: Shiko mësimin 22-25.

Shënim: Shiko mësimin 29-32.

Përsëritje



8. Kaini dhe Abeli lindën të dy jashtë kopshtit - Zanafilla 4:2.

- Kaini dhe Abeli lindën mëkatarë, sepse babai i tyre, Adami, ishte mëkatar.
- Adami, jo vetëm ishte babai i Kainit dhe Abelit, por ishte edhe babai i tërë njerëzve të botës. Prandaj, tërë njerëzit në botë lindin mëkatarë, të ndarë nga Perëndia.
 - Për shkak të mëkatit të Adamit, ne kemi lindur me gjendjen e pamundësisë për të njohur, dashur dhe për t'iu bindur Perëndisë. Edhe pse Perëndia na jep jetën, nga lindja ne jemi nën ndikimin e Satanit. Ne, dhe tërë qeniet e tjera njerëzore, kemi lindur mëkatarë, të ndarë nga Perëndia.

9. Perëndia planifikoi një rrugë, në mënyrë që njerëzit të mund të shkonin tek Ai, sepse Ai i donte.

Kjo nuk ishte rruga e njerëzve. Ishte Perëndia që e përcaktoi këtë rrugë.

- Ndëshkimi (paga) për mëkatin është vdekja. Nuk ka asgjë tjetër që mund të bëjnë njerëzit për Perëndinë apo t'i japin Perëndisë për të paguar çmimin (borxhin) për mëkatet e tyre.
- Megjithatë, Perëndia i lejoi njerëzit të përdornin një zëvendësim derisa të gjendej pagesa e pranueshme.
 - Plani i Perëndisë ishte që kur njerëzit t'i afroreshin Atij, ata duhej të çonin një kafshë si ofertë për Të.
 - Kafsha ishte flijimi - ajo që vdiste në vend të mëkatarit.
 - Ata duhej të vrisnin kafshën në mënyrë të tillë që gjaku i saj të rridhte.
 - Kur ata flijonin një kafshë, Ai donte që ata të kujtonin se ata mund të vdisnin dhe të ndëshkoheshin përjetësisht nëse Ai nuk i shpëtonte.
 - Gjaku i kafshëve nuk mund të paguante për mëkatet e njerëzve.
 - Por nëse një person, ndërsa ofrohej gjaku i kafshëve, pranonte para Perëndisë se ishte mëkatar dhe se vetëm Perëndia mund ta shpëtonte nga ndëshkimi i përjetshëm, Perëndia do ta pranonte dhe do të falte (do të mbulonte) mëkatet e tij.
 - Gjaku i flijimit për mëkatin ishte pjesë e planit të lavdishëm të Perëndisë për ta çliruar njerëzimin nga mëkati, Satani dhe vdekja.
- Perëndia është Krijuesi i tërë njerëzve. Ai i dha Adamit jetë dhe Ai i dha jetën secilit prej nesh. Edhe pse kemi lindur të gjithë në këtë botë, të ndarë nga Perëndia, ne i përkasim Atij. Perëndia interesohet rreth asaj që ka ndodhur me ne, edhe pse jemi mëkatarë.

10. Perëndia premtoi se nëse njerëzit do t'i afroreshin me anë të besimit, duke i ofruar Atij gjakun e kafshëve, Ai do t'i pranonte dhe do t'i falte mëkatet e tyre.

- Perëndia fali mëkatin e Abelit dhe e pranoi atë, sepse Abeli iu bind dhe besoi, jo te vetja e tij, por te Perëndia që kishte premtuar të dërgonte Çlirimtarin.
- Noeu besoi dhe iu afrua Perëndisë sipas mënyrës që i kishte thënë Ai.
- Abrahami besoi dhe iu bind Perëndisë.
 - Perëndia i kishte premtuar Abrahamit se një prej pasardhësve të tij do të ishte Shpëtimtari (Çlirimtari) i botës.
- Jozefi besoi në premtimet e Perëndisë ashtu si Abrahami, Isaku dhe Jakobi.
- Moisiu, një izraelit, besoi dhe iu bind Zotit.
 - Perëndia i tha Moisiut që Ai e kishte zgjedhur atë që t'i nxirrte izraelitët nga skllavëria në Egjipt dhe t'i çonte në tokën në të cilën Perëndia i kishte dhënë Abrahamit.
 - Perëndia i çliroi izraelitët nga skllavëria në Egjipt dhe Ai filloi t'i çonte në tokën që Ai i kishte premtuar atit të tyre, Abrahamit.
 - Perëndia nuk i çliroi izraelitët nga skllavëria sepse ishin pa mëkat apo meritonin kujdesin e Tij. Ai i mbrojti për shkak të dashurisë, mëshirës dhe hirit të Tij.
 - Kur Izraeli pa gjërat e mëdha që bëri Zoti, besoi tek Ai - Eksodi 14:31.
 - Përmes Izraelit Perëndia planifikoi t'ia bënte të njohur të vërtetën rreth Tij çdo njeriu në botë.

Mësimi 35

Qëllimi:

Në këtë mësim do të përsëriten disa nga mrekullitë që kreu Perëndia, ndërsa po i çlironte izraelitët nga skllavëria në Egjipt dhe gjatë udhëtimit të tyre për në Kanaan, për në tokën që iu premtoi.

Gjithashtu fëmijët do të mësojnë se:

- Njeriu nuk mund të shpëtojë veten.
- Njeriu nuk meriton gjë nga Perëndia.
- Njeriu ka nevojë për Perëndinë.
- Perëndia është i plotfuqishëm.
- Perëndia është i dashur, i mëshirshëm dhe plot hir.

Hyrje

Historia e sotme do të përfshijë një përsëritje të largimit të izraelitëve nga Egjipti. Mund të kesh disa fëmijë si Xhoni dhe Karola që besojnë se dinë shumë rreth Biblës. Nxti këta fëmijë, së bashku me fëmijët e tjerë që kanë pak njohuri, të dëgjojnë me kujdes atë që po mësohet. Ka gjithmonë gjëra të reja që mund të mësojnë nga fjala e Perëndisë.

Figurat

- Tabela 16: Disa nga premtimet e Perëndisë ndaj Abrahamit
- Figura 25: Gjaku i Pashkës i vënë në shtalkat e dyerve



- Figura 26: Faraoni dhe djali i tij i vdekur



- Figura 28: Mana në shkretëtirë



- Figura 29: Moisiu godet shkëmbin për ujë



Perëndia siguroi për Izraelin

Historia

“Ua, xhaxhi Piter!” - thirri Karola. “Ne kemi mësuar shumë prej teje rreth Perëndisë dhe Fjalës së Tij, Biblës”.

“Po, vërtetë” - iu përgjigj xhaxhi Piteri. “Por ka ende për të mësuar. Edhe izraelitët mendonin se dinin shumë rreth Perëndisë, por kishte akoma gjëra të tjera për të mësuar pas kalimit të Detit të Kuq”.

“Duhet të ketë qenë shumë argëtues kalimi përmes detit për në tokë të thatë pa u lagur!” - tha Xhoni.

“Mendoj se duhet të ketë qenë i frikshëm!” - tha Karola.

“Ishte i frikshëm edhe për izraelitët, Karola” - tha xhaxhi Piteri. “Edhe pse ata kishin parë tërë gjërat e mëdha dhe të fuqishme që kishte bërë Perëndia në Egjipt, ata akoma nuk besonin që Perëndia mund t'i mbronte. Megjithatë Moisiu i besoi Perëndisë dhe u tha izraelitëve që t'i besonin Perëndisë”.

“Perëndia duhet të ketë qenë i trishtuar që njerëzit nuk i besuan pas tërë atyre gjërave që bëri për ta” - tha Xhoni.

“Jam i sigurt që po” - tha xhaxhi Piteri. “Ata me siguri nuk e meritonin ndihmën e Perëndisë, por edhe pse izraelitët mëkatuan dhe nuk i besuan Atij, ai ishte i mëshirshëm dhe i mbrojt”.

“Kujtoj se si ushtria egjiptiane u mbyt nga Perëndia në det” - tha Karola. “Dhe asnjë prej izraelitët nuk u mbyt”.

“Ngaqë Perëndia i donte” - tha xhaxhi Piteri.

“Dhe,” - e ndërpreu Xhoni, - “ngaqë mbajti premtimin e Tij për t'i shpëtuar!”.

“Perëndia tregoi hir ndaj tyre” - tha xhaxhi Piteri. “Ata nuk mund të largoheshin kurrë nga Egjipti pa ndihmën e Perëndisë. Perëndia donte që ata t'i besonin Atij për gjithçka - ashtu siç do prej nesh që t'i besojmë Atij për gjithçka!”.

“Kur mbërritën në anën tjetër të Detit të Kuq,” - tha Karola, - “ata do të kenë qenë shumë të lumtur që u çliruan nga skllavëria dhe tërë problemet që kishin pasur në Egjipt”.

“Shiko,” - tha xhaxhi Piteri, - “ata nuk ishin tërësisht pa probleme. Ata do të ndesheshin akoma me armiq dhe do të kalonin përmes shkretëtirës pa ushqim dhe ujë”.

“Atëherë, si e siguruan ushqimin dhe ujin?” - pyeti Xhoni.

“Shiko, nuk kishte asnjë mënyrë që ata të gjenin vetë në mënyrë të mjaftueshme” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Ata mund të ishin rreth dy milion e gjysmë izraelitë. Ata duhej t'i besonin tërësisht Perëndisë për gjithçka. Le të shohim në Bibël për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, Xhon”.

Le të shohim në Bibël



Isaia 41:10 – “Mos ki frikë, sepse unë jam me ty, mos e humb, sepse unë jam Perëndia yt. Unë të forcoj dhe njëkohësisht të ndihmoj dhe të mbaj me dorën e djathtë të drejtësisë sime.”

Le të mendojmë

1. Kush do të na ndihmojë gjithmonë dhe kush është Ai që i mban premtimet e Tij?
a. Moisiu; **b. Perëndia**; c. Xhaxhi Piteri.
2. Kush harronte të besonte te premtimet e Perëndisë? a. Moisiu; b. Aaroni; **c. Izraelitët**.
3. Kush besoi te Perëndia dhe u tha izraelitëve që të besonin edhe ata?
a. Aaroni; **b. Moisiu**; c. Egjiptianët.
4. Kush e meriton ndihmën e Perëndisë? a. **Askush**; b. Të gjithë; c. Moisiu.
5. Për çfarë duhet t'i besojmë Perëndisë? a. Ushqim; b. Ujë; **c. Gjithçka**.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Ti si mësues do të dish se sa shumë kohë të duhet për të përsëritur mësimin për çlirimin e izraelitëve nga skllavëria në Egjipt. Nëse nuk ke pasur një ndërprerje të gjatë midis 33 mësimeve të para dhe këtij mësimi, nuk do të të duhet shumë përsëritje. Megjithatë, është e rëndësishme që fëmijët të kuptojnë se kush janë izraelitët (pasardhësit e Abrahamit) dhe premtimet e Perëndisë për ta.

Shënim: Pyeti fëmijët nëse mund të kujtojnë premtimet e Perëndisë ndaj Abrahamit para se të tregosh figurën: “Disa nga premtimet e Perëndisë bërë Abrahamit”.

Mësimet rreth çlirimit të izraelitëve nga skllavëria dhe udhëtimit të tyre për në tokën e premtuar kanë përfshirë shumë mrekulli nga Perëndia. Mrekullitë e Perëndisë mund të shpjegohen vetëm duke mësuar se kush është Perëndia. Ai është Krijuesi, Perëndia i plotfuqishëm. Nuk ka asgjë të pamundur për Të. Ai njih gjithçka. Ai ndonjëherë i bën gjërat jashtë ligjeve të Tij fizike, thjesht për të na treguar se sa i madh dhe i fuqishëm është. Ne nuk e dimë se si Ai i kryen mrekullitë; ne thjesht duhet të besojmë se kush është Ai!

1. Perëndia zgjodhi Moisiun për t'i çliruar izraelitët nga skllavëria - Eksodi 3:10.

- Perëndia i tha Moisiut që e kishte zgjedhur atë për t'i nxjerrë izraelitët nga skllavëria në Egjipt dhe për t'i çuar në tokën që Perëndia i kishte dhënë Abrahamit.
- Perëndia zgjedh atë që dëshiron për të bërë vullnetin e Tij. Kur vjen koha që Perëndia të përmbushë planet e Tij, askush nuk mund t'i shpëtojë Atij.
- Moisiu iu bind Perëndisë (Eksodi 4:18-20).
- Izraelitët i besuan Fjalës së Perëndisë të dhënë përmes Moisiut (Eksodi 4:29-31).
- Perëndia i tha Moisiut t'u thoshte izraelitëve që Ai i kishte parë vuajtjet e tyre dhe që kishte dërguar Moisiun për t'i çliruar prej saj (Eksodi 3:13-18).

2. Faraoni refuzoi t'i bindej urdhrat të Perëndisë dhënë përmes Moisiut dhe Aaronit - Eksodi 5:1-2.

Faraoni dhe populli egjiptian nuk e adhuronin Perëndinë; ata adhuronin gjërat që Perëndia kishte krijuar. Egjiptianët adhuronin gjithashtu Faraonin, mbretin e tyre, si perëndi.

3. Përmes rebelimit të Faraonit Perëndia i tregoi Izraelit se Ai ishte Perëndia i tij dhe u tregoi egjiptianëve se vetëm Ai ishte Perëndia i vërtetë e i gjallë - Eksodi 6:1-8; 7:4-5.

4. Perëndia dërgoi nëntë plagë në Egjipt¹.

- Ngaqë mbreti i Egjiptit refuzoi t'i lejonte izraelitët të largoheshin, Perëndia filloi të tregonte fuqinë e Tij të madhe.
- Faraoni dhe populli egjiptian nuk mund ta shpëtonin veten nga këto plagë të tmerrshme të dërguara nga Zoti. As perënditë e tyre të rreme nuk mund t'i shpëtonin.

Shënim: Është e rëndësishme që edhe Shkrimet që shoqërojnë pikat me të zeza në këto mësime të lexohen ndërsa jepet mësimi. Nëse fëmijët mund të lexojnë, ata duhet të inkurajohen të lexojnë vetë. Por ata mund të lexojnë me ngadalë dhe fëmijë të tjerë mund të humbasin interesin kur ka shumë për të lexuar. Kështu, përveçse t'u thuash fëmijëve që të lexojnë, do ta shohësh të dobishme të alternosh leximin e disa prej pjesëve ose nga ti vetë, ose nga disa të rritur të tjerë.

¹Do ta gesh historinë tek Eksodi 7:14-10:29. Mund t'u referohesh mësimeve 30 dhe 31 për hollësi nëse keni pasur një ndërprerje të gjatë midis këtyre mësimeve dhe këtij të fundit. Sigurohu që t'u kujtosh fëmijëve të klubit që kjo është një histori e vërtetë, ashtu siç regjistrohet për ne në Bibël.

Eksodi 13:17-18 na tregon se Perëndia po kujdesej për izraelitët. Ai i drejtoi në shkretëtirën e Sinaït ku nuk kishte armiq, por kishte shumë pak ushqim. Vetëm Perëndia mund t'i shpëtonte izraelitët. Përmes këtyre historive, ne duam të shohim se "...Shpëtimi i përket Zotit" (Jona 2:9b).

Përsëritje

R	X	C	P	E	R	É	N	D	I	A	Y	I
A	C	U	C	X	U	Z	C	U	X	Z	C	Z
N	Y	SH	Y	M	I	R	É	S	I	Z	X	R
A	Z	Q	X	Y	C	Y	X	Z	Z	B	X	A
A	X	I	Y	F	U	Q	I	X	Y	E	Z	E
N	C	M	C	C	X	C	X	U	Z	S	X	L
Z	X	B	X	C	C	X	X	J	X	I	Y	I
K	O	L	O	N	É	Y	C	É	Y	M	C	T
X	Y	C	X	C	Z	C	X	Y	C	X	X	É
M	R	E	K	U	LL	I	C	D	E	T	C	T

Pyetje dhe përgjigje

1. Kë adhuronin Faraoni dhe egjiptianët? **Gjërat që kishte bërë Perëndia.**
2. Kush i mbrojti izraelitët dhe kush i udhëhoqi të sigurt përmes Detit të Kuq? **Perëndia.**
3. Çfarë donte t'u tregonte Perëndia egjiptianëve përmes rebelimit të Faraonit? **Që vetëm Ai është Perëndia i vetëm e i vërtetë.**
4. Pse u ankuan izraelitët? **Ata ishin të uritur e të etur.**
5. Në vend që të ankoheshin, çfarë duhet të kishin bërë izraelitët? **Ata duhet të kishin besuar që Zoti do t'u jepte ushqim**

- Perëndia i mbrojti izraelitët, në mënyrë që asnjë prej këtyre plagëve të mos u ndodhte askujt prej tyre.
- Zoti nuk i mbrojti izraelitët sepse ata ishin pa mëkat apo se e meritonin kujdesin e Tij .
- Ai i mbrojti për shkak të dashurisë, mëshirës dhe hirit të Tij.
- Ai i mbrojti ata sepse Perëndia nuk i kishte harruar premtimet e Tij ndaj Abrahamit, Isakut dhe Jakobit.
- Ai i mbrojti nga plagët, në mënyrë që mbreti i Egjiptit të kuptonte se Perëndia i Izraelit ishte Perëndia i vetëm i vërtetë dhe i gjallë në mbarë tokën.

5. Gjykimi përfundimtar ndaj egjiptianëve - Eksodi 11:1, 4-7.

- Zoti e dinte se pas kësaj plage të fundit Faraoni do t'i lejonte izraelitët që të largoheshin.

6. Faraoni u tha izraelitëve të largoheshin - Eksodi 12:31-36

- Katërqind vjet kishin kaluar dhe tani egjiptianët po u jepnin arin dhe argjendin skllëvërve të tyre, izraelitëve. Dhe egjiptianët po u thoshin atyre të largoheshin menjëherë! Perëndia nuk i harron kurrë premtimet e Tij. Zoti çliroi popullin e Tij ashtu siç u kishte premtuar.

7. Perëndia e çliroi Izraelin në Detin e Kuq.

- Perëndia i drejtoi izraelitët me anë të resë (Eksodi 13:21-22).
- Faraoni vendosi t'i kapte sërish Izraelitët (Eksodi 14:5-7).
- Izraelitët patën frikë dhe fajësuan Moisiun (Eksodi 14:10-14).
- Moisiu besoi te Zoti dhe u tha izraelitëve që të besonin që Perëndia do t'i mbronte.
- Perëndia hapi detin që izraelitët të kalonin në tokë të thatë (Eksodi 14:15-16, 21-20).
- Izraeli pa gjërat e mëdha që bëri Zoti; ai i besoi Atij (Eksodi 14:31).

8. Izraeli u ankua; ata ishin të uritur - Eksodi 16:1-3.

- Edhe pse Zoti i çliroi izraelitët nga egjiptianët duke hapur Detin e Kuq dhe duke i kaluar të sigurt përmes tij, ata vazhduan akoma të dyshonin tek Ai kur ishin në vështirësi?
- Në vend që të ankoheshin, ata duhet të kishin besuar që Zoti do të siguronte ushqim për ta.

9. Perëndia u dha ushqim - Eksodi 16:11-14, 35.

- Izraelitët nuk meritonin asgjë nga Zoti, por në hirin e Tij Ai u dha ushqim.
- => Figura 28: Mana në shkretëtirë.

- Perëndia donte që izraelitët të dinin se vetëm Ai mund t'i ndihmonte. Perëndia ndihmon atë që është i pashpresë; Ai çliron ata që nuk kanë rrugë shpëtimi.

10. Izraeli ankohet përsëri - Eksodi 17:1-4.

- Edhe pse izraelitët ishin mirënjohës për sigurimin e ushqimit, ata e harruan menjëherë fuqinë e Tij të madhe dhe filluan të ankohen përsëri. Ata ishin të etur.

11. Perëndia siguroi ujë për ta - Eksodi 17:5-6.

- Perëndia i tha Moisiut se çfarë duhet të bënte.

=> Figura 29: Moisiu godet shkëmbin për ujë.

- Perëndia i mbrojti izraelitët me besnikëri dhe siguroi gjithçka që kishin nevojë, edhe pse nuk meritonin asgjë nga Perëndia. Këto janë mrekullitë e Perëndisë.
- Ato na tregojnë besnikërinë e Tij për të mbajtur premtimet e Tij.
- Ato na tregojnë dashurinë e Tij për popullin e Tij.
- Ato na tregojnë fuqinë e Tij të madhe ndaj tërë krijimit.

Mësimi 36

Qëllimi

Ky mësim i përgatit fëmijët për paraqitjen e Dhjetë Urdhërimeve. Është e rëndësishme që fëmijët të kuptojnë drejtësinë dhe shenjtërinë e Perëndisë bashkë me zemërimin e Tij kundër mëkatit.

Fëmijët do të shohin, gjithashtu se:


- Njeriu nuk mund të zbatojë Ligjin.
- Njeriu nuk mund të shpëtohet nga diçka që bën.
- Njeriu meriton vdekjen dhe ndëshkimin e përjetshëm për shkak se ai nuk mund të zbatojë Ligjin e Perëndisë.

Hyrje

Në historinë e sotme do të mësojmë se Dhjetë Urdhërimet janë një grup prej dhjetë rregullash apo ligjesh që Perëndia u dha izraelitëve për t'i ndihmuar që të kuptonin se çfarë është mëkati. Ndihmimi të kuptojnë se edhe pse disa mëkate mund t'i lëndojnë ata apo të tjerët më tepër se mëkate të tjera, tërë mëkatet meritojnë gjykimin dhe ndëshkimin e Perëndisë.

Figurat

- Figura 30: Mali i shenjtë i Perëndisë



- Tabela 21: Perëndia dhe njeriu - Përpjekja për të zbatuar urdhërimet e Perëndisë

Premtimi i Perëndisë ndaj Izraelit

Historia

“Çfarë po bën, Karola?” - pyeti Xhoni, ndërsa doli në verandë.

“Po lexoj diçka në Bibël” - iu përgjigj Karola.

“Karola,” - tha Xhoni, - “duhet të ishe duke rregulluar rrëmujën që ke në shtëpi”.

“Mos u shqetëso për të, Xhon” - tha Karola. “Do ta rregulloj. Tani, dua të mbaroj së lexuari historinë”.

“Por Karola,” - tha Xhoni, - “mamaja të tha ta rregulloje para se ajo të kthehet në shtëpi. Ti e di që do të na vijnë mysafirë sonte”.

“Xhon, a do të më lësh rehat?!” - thirri Karola. “Nëse nuk e rregulloj, do t'i them mamasë që nuk ndihesha mirë. Ajo...”.

“Karola!” - e ndërpreu Xhoni. “Kjo është gënjeshtëri!”.

“Çfarë do të ishte gënjeshtëri?” - pyeti xhaxhi Piteri, ndërsa po shkonte drejt Xhonit dhe Karolës. “Duket shumë serioze nga mënyra se si po bërtet”.

“Nuk është aq serioze sa e bën Xhoni” - u përgjigj Karola. “Po lexoj Dhjetë Urdhërimet në Bibël. Dua të mësoj saktësisht se çfarë thonë, në mënyrë që të sigurohem se do t'u bindem të gjithave”.

“Duket gjë e mirë” - tha xhaxhi Piteri. “Por mendoj se duhet të dish se askush veç Perëndisë nuk është në gjendje të zbatojë tërë urdhërimet e Tij”.

“Unë nuk di gjë për Dhjetë Urdhërimet” - tha Xhoni. “Karola, ti po i lexon para nesh”.

“Xhon,” - tha xhaxhi Piteri, - “Perëndia u dha izraelitëve disa rregulla apo ligje që quheshin Dhjetë Urdhërimet. Ai ua dha ato urdhërime, në mënyrë që ata të mund të kuptonin se sa mëkatarë ishin. Ata vazhdonin të harronin se si dyshonin te Perëndia dhe se si ankoheshin kur nuk kishin ushqim dhe ujë. Shumë herë ata mendonin vetëm për vete”.

“Prandaj dua që t'i studioj këto Dhjetë Urdhërime tani, xhaxhi Piter” - tha Karola. “Nëse i njoh si duhet, nuk do t'i harroj dhe nuk do t'i shkel”.

“Kështu mendonin izraelitët për urdhërimet e Perëndisë” - tha xhaxhi Piteri. “Ata ishin të sigurt se do t'u bindeshin atyre”.

“A ishin në gjendje ata t'u bindeshin, xhaxhi Piter?” - pyeti Xhoni.

“Jo” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Ligji kërkon bindje të përsosur. Askush nuk mund t'i bindet gjithmonë Perëndisë në mënyrë të përsosur. Ne kemi lindur mëkatarë dhe të gjithë mëkatojmë”.

“Unë bindem gjithmonë!” - tha Karola.

“Karola! Nuk bindesh!” - tha Xhoni i çuditur. “Ti nuk e rregullove rrëmujën ashtu siç të tha mamaja dhe do të gënjeje duke thënë se ishe sëmurë!”.

“Por kjo është diçka e vogël” - tha Karola.

“Ligji i Perëndisë kërkon bindje të përsosur, Karola” - tha xhaxhi Piteri. “Fjala e Perëndisë thotë se duke mëkatar vetëm një herë, edhe nëse mendon se është një gjë e vogël, si gënjeshtër, je fajtor, sepse ke shkelur tërë urdhërimet e Perëndisë. Le të shohim në Bibël dhe le të lexojmë për një marrëveshje midis Perëndisë dhe Izraelit”.

Le të shohim në Bibël



Jakobi 2:10 – “Sepse kushdo që e zbaton gjithë ligjin, por e shkel në një pikë, është fajtor në të gjitha pikat.”

Ndihmoji fëmijët e klubit tënd që ta gjejnë këtë varg; lexoje dhe pastaj shpjegoje vargun duke përdorur përkufizimin e dhënë. Shpjegoju fëmijëve të klubit se Perëndia na thotë që në mënyrë që të pranohemi prej Tij, ne duhet të zbatojmë tërë urdhërimet: çdonjërin prej tyre! Nëse nuk i bindemi qoftë edhe njërit, vetëm një herë, është njësoj sikur të mos u bindemi të gjithave. Nëse nuk jemi të përsosur, Perëndia nuk mund të na pranohë në praninë e Tij të shenjtë.

Le të mendojmë

1. Çfarë u dha Perëndia izraelitëve, në mënyrë që të kuptonin se sa mëkatarë ishin?
a. Një libër; b. Një mesazh nga Moisiu; **c. Dhjetë Urdhërimet.**
2. Çfarë janë Dhjetë Urdhërimet? a. Histori rreth Perëndisë; **b. Ligji i Perëndisë;** c. Ligji i Moisiut.
3. Kë pranon Perëndia? a. Këdo; b. Njerëzit e mirë; **c. Këdo që është pa mëkat.**
4. Kush mund të zbatojë në mënyrë të përsosur tërë Ligjin e Perëndisë? **Askush.**
5. A është mëkat një gënjeshtër e vogël? **Po / Jo.**

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Ne nuk duhet të mendojmë se tërë fëmijët e klubit tonë i kuptojnë fjalët “i shenjtë” dhe “i drejtë”. Ata mund t’i kenë dëgjuar këto fjalë në ceremonitë fetare pa ditur që Perëndia nuk është vetëm i pastër dhe pa mëkat, por Ai është edhe një Perëndi plot zemërim, që urren dhe ndëshkon çdo mëkat. Ndërsa japim këtë mësim, mund të dimë që Fjala e Perëndisë është e fuqishme për të shkatërruar idetë e rreme të njeriut dhe mashtrimin e Satanit. Fëmijët e klubit tonë, ashtu si njerëzit e Izraelit, duhet të dinë se mëkatarët nuk mund të qëndrojnë në praninë e një Perëndie të shenjtë e të drejtë.

1. Perëndia e çoi Izraelin në malin Sinai - Eksodi 19:1-4.

- Mali Sinai (i quajtur gjithashtu mali Horeb) ishte vendi ku Moisiu pa shkurren që digjej. Në atë kohë Zoti i premtoi Moisiut se Ai do t’i sillte atë dhe izraelitët në këtë mal.
 - Perëndia është besnik - Eksodi 3:12.
 - Ai mbrojt Moisiun, çliroi Izraelin nga skllavëria dhe i çoi në malin Sinai, ashtu siç kishte premtuar.
- Izraelitët nuk vendosën se kur do të udhëtonin apo ku do të shkonin - Perëndia vendosi për ta.
 - Perëndia donte që ata ta pranonin Atë si drejtuesin, mbrojtësin e tyre dhe si Personin që siguronte gjithçka që kishin nevojë.

2. Premtimi i Izraelit - Eksodi 19:5-6.

- Zoti i tregoi Moisiut mesazhin e Tij për Izraelin. Perëndia planifikoi të bënte një marrëveshje me Izraelin.
 - Zoti premtoi t’i bekonte izraelitët nëse ata do t’i bindeshin Atij në mënyrë të përsosur.
 - Nëse ata bënë gjithçka që u thoshte Ai, atëherë Ai do t’i pranonte dhe do t’u jepte gjithçka që kishin nevojë.

3. Premtimi i Izraelit ndaj Zotit - Eksodi 19:7-8.

- Izraeli vendosi t’i bindej Zotit në çdo gjë.
 - Duket se ata e kishin harruar se si kishin dyshuar te Perëndia te Deti i Kuq, kur ushtritë egjiptiane ishin pas tyre.
 - Duket se ata kishin harruar, gjithashtu, se si ishin ankuar kur nuk kishin ushqim apo ujë.
 - Ata kishin besim te vetja.
 - Ata menduan se mund t’i bindeshin Perëndisë aq sa duhej, në mënyrë që Ai t’u jepte gjithçka që kishin nevojë.

→ Figura 30: Mali i shenjtë i Perëndisë

Përsëritje

Shiko vargun përmendsh:

Sepse kushdo që e zbaton gjithë ligjin, por e shkel në një pikë, është fajtor në të gjitha pikat (Jakobi 2:10).

Pyetje dhe përgjigje

1. Kush vendosi se ku do të shkonin izraelitët? Perëndia.
2. Cili ishte premtimi i Perëndisë ndaj Izraelit? Ai do t'i bekonte nëse do t'i bindeshin në mënyrë të përsosur.
3. Çfarë i premtoi Izraeli Perëndisë? Ata premtuan t'i bindeshin Perëndisë në gjithçka.
4. Çfarë nuk kishin kuptuar ende izraelitët? Ata nuk kuptuan se ishin plot me mëkat dhe se ata nuk mund t'i pëlqenin Perëndisë.
5. Cili është ndëshkimi për mëkatet? Vdekja.


- Ata nuk e kishin kuptuar ende që ishin plot me mëkat dhe se nuk mund t'i pëlqenin Perëndisë me diçka që bënin vetë.
- Ata nuk kishin kuptuar që për shkak të mëkatit, sipas kësaj marrëveshjeje, Perëndia nuk do t'i bekonte më apo t'u jepte gjërat e mira për të cilat kishin nevojë.
 - Izraelitët do të mësonin se nëse nuk zbatonin tërë marrëveshjen, atëherë do të mallkoheshin dhe ndëshkoheshin nga Perëndia.
- Zoti e dinte që në një kohë të shkurtër kombi i Izraelit nuk do t'i bindej Atij dhe sipas marrëveshjes së Ligjit, Ai do t'i ndëshkonte për mëkatet e tyre.
 - Atëherë, pse e bëri Zoti marrëveshjen me izraelitët, kur e dinte se ata nuk do të ishin në gjendje ta zbatonin atë?
 - Zoti e bëri këtë, sepse donte t'u tregonte që ishin mëkatarë dhe nuk ishin në gjendje që t'i pëlqenin Atij.
 - Ai donte që të dinin se ata nuk mund të bëheshin miqtë e Tij apo të fitonin pranimin dhe dhuratat e Tij me anë të gjërave që bënin.
- Kur izraelitët u dorëzuan dhe i besuan Perëndisë, atëherë Ai ishte gati t'i shpëtonte nga ndëshkimi i përjetshëm.
 - Kjo është mënyra se si Perëndia vepron me tërë njerëzit. Perëndia do të çlirojë vetëm ata që bien dakord me Të: që janë mëkatarë nën kontrollin e Satanit, mëkatit dhe vdekjes.

4. Përgatitja për praninë e Zotit në mal - Eksodi 19:9-13.

- Perëndia u tha izraelitëve që të caktonin kufij rreth malit.
 - Kjo bëhej ngaqë Perëndia është tërësisht i shenjtë dhe njeriu mëkatar.
 - Perëndia nuk do të pranojë asnjë njeri apo asnjë gjë që nuk është e përsosur. Ai i largon tërë mëkatarët nga vetja.
 - Nëse do të ndodhte që një izraelit ose një kafshë të prekte malin kur Perëndia zbriste në të, ata do të vriteshin.
 - Ndëshkimi për çdo mëkat është vdekja.

5. Perëndia i foli Izraelit nga mali Sinai - Eksodi 19:16-20; 20:1-2.

- Zoti planifikoi të tregonte tërë lavdinë, fuqinë dhe shenjtërinë e Tij para Izraelit, në mënyrë që ata të kuptonin se Ai është një Perëndi shumë i lartë dhe i shenjtë, që urren mëkatin dhe nuk do t'i pranojë ata që nuk i binden Fjalës së Tij.
 - Perëndia e dha Ligjin e Tij, në mënyrë që tërë njerëzit të dinin se sa mëkatarë ishin dhe që është e pamundur që dikush ta bëjë veten të pranueshëm para Perëndisë me anë të gjërave që bën.
- => Grafiku 21: Perëndia dhe njeriu - Përpykja për të zbatuar Urdhërimet e Perëndisë.



Është e pamundur që dikush të zbatojë urdhërimet e Perëndisë në mënyrë të përsosur, sepse të gjithë kemi lindur mëkatarë, të ndarë nga Perëndia (Romakëve 3:10-12).

- Perëndia dha gjithashtu Ligjin e Tij (Dhjetë Urdhërimet), në mënyrë që tërë njerëzit të kishin besim vetëm në mëshirën e Tij për të shpëtuar nga ndëshkimi i Tij për mëkatin.

Mësimi 37

Qëllimi

Studimi i Dhjetë Urdhërimeve kryhet për të arritur bindjen për mëkat dhe për t'i ndihmuar fëmijët që të kuptojnë nevojën e tyre për një Shpëtimtar.

Fëmijët do të shohin gjithashtu:

- Sovranitetin, shenjtërinë dhe drejtësinë e Perëndisë.
- Njerëzit nuk janë në gjendje të zbatojnë Ligjin.
- Vetëm Perëndia në mëshirën e Tij mund të gjejë një rrugë që njerëzit të shpëtohen.
- Bindja ndaj Dhjetë Urdhërimeve nuk është rruga për t'u shpëtuar.
- Ata kanë shkelur ligjet e Perëndisë dhe meritojnë vdekjen.
- Ata nuk mund ta shpëtojnë veten me anë të veprave të tyre të mira.

Hyrje

Ndihmohi fëmijët e klubit të kuptojnë që njerëzit mund të kenë ide të ndryshme rreth mëkatit. Çfarë është mëkat për një fëmijë mund të mos konsiderohet mëkat për një fëmijë tjetër. Prandaj Perëndia vendos se çfarë është mëkat. Perëndia nuk na lë ne që të vendosim se çfarë është mëkat. Mëkati meriton vdekjen. Perëndia na dha Dhjetë Urdhërime, në mënyrë që të mund të shikojmë mëkatin tonë, të pranojmë se jemi mëkatarë dhe të kuptojmë se ne nuk mund ta zbatojmë Ligjin e Perëndisë dhe nuk mund ta shpëtojmë veten nga mëkati dhe vdekja që meritojmë.

Figurat

- Grafiku 1: Të mësuarit rreth Perëndisë
- Grafiku 22 e 23: Veprat e mira, *E vërtetë dhe E gabuar*

Predikuesi 7:20 thotë: *Nuk ka në fakt asnjë njeri të drejtë mbi tokë që bën të mirën dhe të mos mëkatojë.*

Dhjetë Urdhërime

Historia

Xhaxhi Piteri dhe Karola ishin ulur në verandë duke diskutuar për Dhjetë Urdhërime kur Karola tha: "Xhaxhi Piter, akoma nuk e kuptoj se ç'të mirë ka Ligji nëse askush nuk e zbaton".

"Karola," - tha xhaxhi Piteri, - "Perëndia na tregon në Fjalën e Tij, në Letrën drejtuar Romakëve, që Ligji është si mësuesi, që na tregon se sa mëkatarë jemi".

Ndërsa Xhoni po çohet, xhaxhi Piteri tha: "Përshëndetje Xhon! Çfarë po bëje?".

"Po digjia plehurat" - u përgjigj Xhoni.

"Xhon," - tha Karola, - "fytyra jote është shumë pis!".

"Jo, nuk është bërë!" - tha Xhoni. "Sapo e lava!".

"Xhon, dukesh shumë qesharak" - tha Karola duke qeshur. "Ke hi në tërë fytyrën".

"Xhon," - tha xhaxhi Piteri, - "duhet të shihesh në pasqyrë. Karola, a ke një pasqyrë ku mund të shihet Xhoni?".

Karola u kthye me një pasqyrë dhe Xhoni pa veten. "Nuk arrij ta besoj!" - tha Xhoni. "Mendova se isha pastruar!".

"Nuk më besove mua, apo jo Xhon?" - pyeti Karola.

"Jo" - u përgjigj Xhoni. "Por duhet të besoj atë që shikoj në pasqyrë!".

"Ky është një shembull i mirë," - tha xhaxhi Piteri, - "për të na treguar se si e shohim veten në pjesën më të madhe të kohës. Ne mendojmë që jemi mirë derisa e shohim veten në mënyrë të qartë përmes Ligjit të Perëndisë".

"Ashtu siç nuk iu binda mamasë dhe doja ta gënjeja" - tha Karola.

"Mendova se ato ishin gjëra të vogla. Nuk mendoja se ato ishin mëkate".

"Po" - tha xhaxhi Piteri. "Kujtoj se ti madje mendove se po i zbatoje të gjitha Dhjetë Urdhërime".

"Ashtu mendoja derisa ti më tregove se çfarë nënkuptonin me të vërtetë urdhërime" - tha Karola. "Pastaj mësova se i kisha shkelur".

"Akoma nuk kuptoj" - tha Xhoni. "Pse i dha Perëndia Dhjetë Urdhërime nëse nuk mund t'i zbatojmë?".

"Edhe Karola bëri të njëjtën pyetje, Xhon" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Është njësoj si pasqyra ku pe veten. Ti mendoje se ishe i pastër derisa pe se si dukesh në të vërtetë. Edhe ne jemi ashtu. Nga mënyra se si e shikojmë veten ne nuk mendojmë se jemi mëkatarë".

"Por Dhjetë Urdhërime na tregojnë që ne jemi me të vërtetë mëkatarë" - tha Karola.

"A nuk mjaftonte që Perëndia të na thoshte se jemi mëkatarë?" - pyeti Xhoni.

"Po" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Por shumica e njerëzve nuk duan të dëgjojnë apo të lexojnë Fjalën e Perëndisë. Edhe kur e lexojnë, nuk e kuptojnë gjithmonë se ajo u flet edhe atyre. Ne duhet të dimë se jemi mëkatarë dhe mëkatet tona na ndajnë nga Perëndia. Ai dëshiron që ne të shohim se nuk ka asnjë mënyrë se si ne të mund ta ndihmojmë veten. Perëndia dëshiron të pranojmë se jemi mëkatarë dhe të besojmë vetëm në Të dhe në mëshirën e Tij për të na shpëtuar".

"Do të doja të bëja diçka për t'u shpëtuar" - tha Karola. "Nuk është e lehtë të besosh".

"Shiko, Karola," - tha xhaxhi Piteri, - "kjo do të thotë që të besojmë te vetja për të gjetur një mënyrë për t'u pranuar nga Perëndia. Ligji na kujton gjithashtu se Perëndia është i shenjtë; Ai është i përsosur! Mirësia jonë nuk mund të barazohet kurrë me shenjtërinë e Perëndisë dhe Ai nuk lejon kurrë njerëz mëkatarë në praninë e Tij".

"Pse zgjodhi Perëndia të na e tregonte anën tonë mëkatarë në këtë mënyrë?" - pyeti Xhoni.

"Rrugët e Perëndisë janë të përsosura" - tha xhaxhi Piteri. "I takon Atij të vendosë gjithçka. Ai na do dhe vetëm Ai e di se cila është më e mira për ne. Ligji është i përsosur, sepse Perëndia është i përsosur. Ai është sovran - Ai ka fjalën e fundit për gjithçka. Xhon, mendoj se është koha të shohim një prej Dhjetë Urdhërimeve".

Le të shohim në Bibël



Romakëve 3:20 – “Sepse asnjë mish nuk do të shfaqësohet para tij për veprat e ligjit; me anë të ligjit në fakt arrihet njohja e mëkatit.”

Ndihmoji fëmijët e klubit tënd që ta gjejnë këtë varg. Lexoje dhe shpjego se ky varg na thotë që të vërtetat që kemi mësuar në historinë e sotme janë nga

Perëndia. Perëndia dëshiron që ne të pranojmë se kemi bërë gjëra që Ai i urren, se nuk jemi në gjendje t’u bindemi urdhrave të Tij në mënyrë të përsosur dhe se ne nuk mund ta shpëtojmë veten.

Le të mendojmë

- Çfarë janë Dhjetë Urdhërimet? a. Histori; **b. Ligje**; c. Mësime.
- Kush i dha Dhjetë Urdhërimet? a. Moisiu; **b. Perëndia**; c. Izraelitët.
- Kujt i shërbejnë Dhjetë Urdhërimet? **a. Kujtdo**; b. Moisiut; c. Vetëm izraelitëve.
- Cili është qëllimi i Dhjetë Urdhërimeve?
 - Për të na bërë të pranueshëm para Perëndisë; b. Për të na bërë të shenjtë si Perëndia; **c. Për të na treguar që jemi mëkatarë.**
- Sa ligjeve duhet të mos u bindet njeriu dhe sërish të jetë i pranuar nga Perëndia?
 - Një; b. Katër; **c. Asnjë.**

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Izraelitët, ashtu si edhe ne, kemi lindur mëkatarë, duke mos qenë në gjendje t’i pëlqejmë Perëndisë. Izraeli ishte i sigurt se do ta përmbushte pjesën e tij të marrëveshjes (apo besëlidhjes) së Perëndisë me të. Disa njerëz janë po aq të sigurt edhe sot. Ata mendojnë se nëse bëjnë më të mirën e mundshme për t’i zbatuar Dhjetë Urdhërimet, Perëndia do t’i konsiderojë aq të mirë sa t’i pranojë. Sot do të shohim secilin prej Dhjetë Urdhërimeve.



Lexo - Isaia 45:5a thotë: *Unë jam Zoti dhe nuk ka asnjë tjetër; jashtë meje nuk ka Perëndi.*

³Ndihmoji fëmijët e klubit tënd të kuptojnë qartë se të pranosh se Perëndia është Perëndia i vërtetë, do të thotë ta dëgjosh, t’i bindesh, ta nderosh dhe ta adhurosh Atë dhe vetëm Atë në çdo kohë. Megjithatë, asnjë person nuk e ka vendosur Perëndinë të parin në çdo gjë. Nxiti fëmijët të mendojnë për gjërat që njerëzit vendosin para Perëndisë: paratë, ushqimi, lodrat, librat, veshjet, toka, krenaria, etj.. Këto gjëra mund të bëhen perëndi për njeriun.

⁴Ligji i Përtërirë 8:17-20 është një pjesë e mirë e Shkrimit për ata që mendojnë se “janë krijuar vetë”.



Lexo - Isaia 42:8 thotë: *Unë jam Zoti, ky është emri im; nuk do t’i jap lavdinë time asnjë tjetri, as lavdërimet e mia shëmbëlltyrave të gdhendura.*

1. Urdhërimi i parë - Eksodi 20:3

- Në urdhërimin e parë, Perëndia tha se Ai dhe vetëm Ai duhet të jetë Perëndia i të gjithëve.
 - Kjo do të thotë se njerëzit duhet të adhurojnë vetëm Atë. Vetëm Perëndia është i denjë për lavdërimin tonë.
 - Njerëzit duhet t’i japin Perëndisë vendin më të lartë në mendimet e tyre dhe ta lavdërojnë dhe falënderojnë për gjithçka³.
 - Perëndia nuk do të lejojë që dikush apo diçka të zërë vendin e Tij si Perëndi.
 - Çfarëdo lloj gjëje që nderohet, ndaj së cilës tregohet dashuri apo prej së cilës kemi frikë; çfarëdo lloj gjëje që i shërbehet, te e cila mund të gjendet gëzim apo ndaj së cilës krijohet varësi më tepër se sa nga Perëndia, ajo gjë (çfarëdo lloj gjëje qoftë) mund të jetë perëndi për ne.
 - Nëse një person vendos dikë tjetër në vend të Perëndisë, ky është rebelim dhe mëkat.

Mendo:

Sot shumë njerëz po vendosin veten në vend të Perëndisë. Ata mendojnë se janë njerëzit ata që bëjnë që të ndodhë çdo gjë. Ata mendojnë se mund ta kontrollojnë vetë të ardhmen e tyre. Ata nuk mendojnë për Perëndinë në jetën e tyre⁴.

Kjo është pak a shumë si mëkati i Satanit dhe i ndjekësve të tij, kur u rebeluan kundër Perëndisë. Perëndia i dëboi ata përgjithmonë nga pozicioni i tyre i shërbimit para Tij në qiell. Satani dhe tërë ndjekësit e tij do ta kalojnë përjetësinë në liqenin e zjarrit.

2. Urdhërimi i dytë - Eksodi 20:4-6

- Perëndia donte që izraelitët të kujtonin se Ai është më i madh se çdo gjë që ka krijuar (Romakëve 1:18-23). Perëndia është sovran; Ai është autoriteti më i lartë.
 - Asnjë idhull i bërë nga njeriu nuk është i denjë për adhurim.
 - Njerëzit nuk mund të mendojnë se fuqia, autoriteti apo lavdia e Perëndisë i takojnë dikujt tjetër.



Lexo: Romakëve 1:18-23

⁵Disa fëmijë mund të besojnë fort në rëndësinë e së Shtunës dhe ta bëjnë problem. Përpiqu që çështja e së Shtunës të mos kthehet në një argument dhe as të mos jetë tema kryesore. Megjithatë, bëjua të qartë se edhe nëse e zbatojnë të shtunën, por nuk arrijnë të zbatojnë në mënyrë të përsosur nëntë urdhërimet e tjera në çdo moment të jetës së tyre, sërish zbatimi i së shtunës do të jetë i kotë në sytë e Perëndisë (Jakobi 2:9-11).

Më vonë fëmijët do të mësojnë se çfarë na thotë Kolosianëve 2:14, 16-17: urdhërimet ishin vetëm një hije e asaj që do të vinte. Ato u përmbushën tërësisht dhe tërë kërkesat e tyre u plotësuan në personin e Jezu Krishtit (Çlirimtarit).



Lexo: Hebrejve 4:13 thotë: *Dhe nuk ka asnjë krijesë që të jetë e fshehur para tij, por të gjitha janë lakuriq dhe të zbuluara para syve të Atij, të cilit ne do t'i japim llogari.*

Mendo:

Perëndia është frymë, Ai nuk ka trup fizik. Askush nuk e di se si është Perëndia, ndaj Perëndia thotë se ne nuk duhet që të përpiqemi asnjëherë që të bëjmë diçka, për të cilën mendojmë se i ngjan Atij. Mënyra e vetme si mund të njohim se si është Perëndia, është që ta lejojmë Atë të na mësojë përmes librit të Tij, Biblës. Gjithçka tjetër, e cila është ndryshe nga ajo që thotë Bibla, është gënjeshtër nga Satani.

- Të gjithë ata që adhurojnë gjëra të bëra nga njeriu, duke menduar se ato përfaqësojnë Perëndinë, e shkelin këtë urdhërim të Perëndisë dhe janë të dënuar.

3. Urdhërimi i tretë - Eksodi 20:7.

- Perëndia u tha izraelitëve që ata duhet ta respektojnë gjithmonë Atë dhe të mos flasin apo të mos e përdorin emrin e Tij në mënyrë të shkujesur.

Mendo:

Të shash një person tjetër është diçka e keqe, por sa më e tmerrshme është kur nuk tregojmë respekt për Perëndinë apo keqpërdorim Emrin e Tij. Ta përdorësh emrin e Perëndisë ndërsa je duke shprehur zemërim apo pezmatim, do të thotë të shkelësh këtë urdhër.

- Të gjithë ata që nuk i japin Perëndisë respektin që Ai meriton, janë të dënuar.

4. Urdhërimi i katërt - Eksodi 20:8-11.

- Perëndia u tha izraelitëve që ta respektonin ditën e shtatë të javës si ditë të veçantë pushimi për nder të Tij⁵. Ai që i krijoi tërë gjërat në gjashtë ditë.

Kujto:

A e kujton se çfarë bëri Perëndia ditën e shtatë, ditën pasi Ai mbaroi së krijuari botën? Perëndia pushoi, sepse kishte mbaruar gjithçka që kishte planifikuar të bënte.

- Ndërsa Izraeli pushonte çdo shtatë ditë, Perëndia donte që ai të kujtonte se vetëm Ai është Krijuesi i tokës dhe i gjithçkaje në të.

Mendo:

Perëndia i jep jetë çdo gjëje. Ai jep shiun dhe rrezet e diellit në tokë, në mënyrë që gjithçka të rritet. Vetëm Ai është Krijuesi, zotëruesi dhe siguruksi i çdo gjëje. Satani ka nën kontroll pjesën më të madhe të njerëzve në këtë botë, por bota i përket ende Perëndisë.

Psalmi 24:1 thotë: *Zotit i përket toka dhe të gjitha gjërat që janë mbi të, bota dhe banorët e saj.*

5. Urdhërimi i pestë - Eksodi 20:12.

- Perëndia tha se fëmijët duhet t'i nderojnë (respektojnë) dhe t'u binden prindërve të tyre.
 - Asnjë prej nesh nuk i është bindur tërësisht prindërve.
 - T'i injorosh prindërit kur të flasin, t'u kthesh fjalën, të zihesh me fjalë me ta, të mos u bindesh, t'ua kërkosh gjërat duke qarë, të varësh buzët, të refuzosh të flasësh me ta, t'i kritikosh dhe t'i godasësh, të gjitha këto janë mënyra të të qenët të parespektueshëm.
- Kujto, edhe nëse nuk i bindemi qoftë edhe një prej urdhërimeve të Perëndisë, Perëndia do të na dënojë.

6. Urdhërimi i gjashtë - Eksodi 20:13.

- Perëndia u tha izraelitëve që të vrasësh dikë është mëkat.
 - Si Krijues, Perëndia i jep jetë çdo personi.
 - Askush nuk e ka të drejtën që të marrë jetën e një personi tjetër nëse Perëndia nuk e thotë në Fjalën e Tij.
- Perëndia thotë gjithashtu se, nëse një person dëshiron të vrasë dikë, ai tashmë është vrasës dhe është i dënuar nga Perëndia.

Mateu 5:21-22a thotë: *Ju keni dëgjuar se u qe thënë të lashtëve: "Mos vrisni"; dhe: "Kushdo që vret do t'i nënshtrohet gjyqit"; por unë po ju them: "Kushdo që zemërohet pa shkak kundër vëllait të tij, do t'i nënshtrohet gjyqit".*

- Perëndia na gjykon, jo thjesht në bazë të asaj që bëjmë, por edhe në bazë të asaj që duam të bëjmë.
 - Gjërat që duam të bëjmë në mendjet tona - arsyet tona të vërteta për atë që bëjmë - quhen shtysat tona. Perëndia i njeh shtysat tona, sepse Ai njeh mendimet dhe qëllimet tona.

Mësimi 37

(vazhdim)

Veprat 17:25b thotë: Ai u jep të gjithëve jetë, hukatje dhe çdo gjë.



Lexo: Gjoni 8:44 thotë: Ju jeni nga djalli, që është ati juaj, dhe doni të bëni dëshirat e atit tuaj; ai ishte vrasës që nga fillimi dhe nuk qëndroi në të vërtetën, sepse në të nuk ka të vërtetë. Kur thotë të rrema, flet nga vetvetja, sepse është gënjeshtar dhe ati i rrenës.

Dhjetë Urdhërimet

7. Urdhërimi i shtatë - Eksodi 20:14.

- Perëndia thotë se është mëkat të kesh marrëdhënie seksuale me këdo tjetër përveç bashkëshortes apo bashkëshortit.
- Ngaqë Perëndia shikon në zemër, mendimet dhe qëllimet e brendshme të njeriut, Ai e di kur dikush ka mendime mëkatore.

Mateu 5:27-28 thotë: Ju keni dëgjuar se të lashtëve u qe thënë: "Mos shkel kurorën". Por unë po ju them se kushdo që shikon një grua për ta dëshiruar, ka shkelur kurorën me të në zemrën e vet.

- Kur burrat dhe gratë shikojnë dikë, me të cilin nuk janë të martuar, me dëshirën për të pasur marrëdhënie seksuale, atëherë ata e kanë shkelur këtë ligj. Të jesh i shenjtë do të thotë që duhet të jesh i pastër si në mendje ashtu edhe në veprime.

8. Urdhërimi i tetë - Eksodi 20:15.

- Perëndia tha që izraelitët nuk duhet të marrin asgjë që i përket dikujt tjetër.
 - Perëndia është Ai që i jep çdo personi të drejtën për të zotëruar dhe për të ruajtur pronësinë e vet.
- Nëse një person merr diçka që i përket dikujt tjetër, atëherë ai ka mëkatuar kundër Perëndisë.

Mendo:

Të marrësh diçka hua dhe të mos e kthesh, është vjedhje. Edhe nëse një hajdut kthen atë që ka vjedhur apo paguan për atë që ka vjedhur, sërish, kjo nuk kënaq standardin e Perëndisë për mëkatin e vjedhjes.

9. Urdhërimi i nëntë - Eksodi 20:16.

- Perëndia tha që izraelitët duhet të thonë gjithmonë të vërtetën për gjithçka.
 - Perëndia nuk gënjen kurrë dhe Ai na urdhëron të mos gënjejmë.

Titi 1:2 thotë: ...Perëndia, që nuk gënjen...

Mendo:

Satani është gënjeshtari më i madh. Ai i gënjeu Adamin dhe Evën në kopsht. Ai i gënjeu etërit tanë dhe ende vazhdon t'i gënjejë njerëzit në mbarë botën. Satani është ati i tërë atyre që gënjejnë. Disa njerëz bëjnë gjëra të gabuara dhe pastaj gënjejnë për të mbuluar atë që kanë bërë. Disa njerëz gënjejnë në emër të njerëzve të tjerë. Disa njerëz fillojnë thashetheme dhe sajajnë histori. Disa njerëz gënjejnë, madje edhe kur çohen në gjyq. Shumë njerëz i kanë shpëtuar ndëshkimit këtu në tokë, sepse kanë gënjyer pa e ditur njeri. Megjithatë, ne nuk mund t'i fshehim gënjeshttrat nga Perëndia. Perëndia njih gjithçka dhe do të ndëshkojë çdo mëkat. Perëndia flet gjithmonë të vërtetën dhe Ai e di të vërtetën për këdo dhe gjithçka. Disa njerëz mendojnë se "gënjeshttrat e vogla" nuk janë mëkat. Nuk ekzistojnë "gënjeshttra të vogla". Gënjeshttra është gënjeshtër. Perëndia e urren gënjeshtren dhe gënjeshttra është mëkat sipas Ligjit të Tij.

10. Urdhërimi i dhjetë - Eksodi 20:17.

- Perëndia u tha izraelitëve që ata nuk duhet të lakmojnë, pra, të mos duan atë që u takon njerëzve të tjerë.
 - Njeriu nuk duhet t'i ketë zili gjërat e njerëzve të tjerë, aftësitë e tyre, pamjen e tyre apo çfarëdo që ata kanë.

Mendo:

Shumë njerëz janë lakmitarë dhe xhelozë për atë që kanë të tjerët. Ata nuk kënaqen kurrë me atë që kanë. Në mendjet e tyre ata janë të inatosur, sepse nuk kanë atë që ka dikush tjetër.

Disa njerëz mendojnë se të duash të kesh më tepër dhe të duash të kesh gjëra më të mira apo të kesh diçka që e ka dikush tjetër është mënyra se si mendojnë të gjithë. Atyre nuk u intereson se në të vërtetë po lakmojnë. Por Perëndia na ka urdhëruar të mos lakmojmë. Lakmia është mëkat.



Lexo: Romakëve 7:7 thotë: ...Mëkatin unë nuk do ta kisha njohur, veç se me anë të ligjit.



Lexo: Romakëve 3:19 thotë: Por ne e dimë se gjithçka që thotë ligji, e thotë për ata që janë nën ligj, me qëllim që çdo gojë të heshtë dhe gjithë bota t'i jetë nënshtruar gjykimit të Perëndisë.

➤ Thuaju fëmijëve të thonë Romakëve 3:20 që thotë: Sepse asnjë mish nuk do të shfaqësohet para tij për veprat e ligjit; me anë të ligjit në fakt arrihet njohja e mëkatit.

⁶Shënim: Pyet fëmijët për mënyra të tjera sipas të cilave njerëzit mendojnë se janë aq të mirë sa të meritojnë që të pranohen nga Perëndia.

➔ Grafiku 22 dhe 23: Veprat e mira, E vërtetë apo E gabuar

Përsëritje

- Perëndia dhe vetëm Perëndia duhet të jetë G i gjithkujt.
- Njeriu nuk duhet të bëjë, nuk duhet të përkulet para apo të adhurojë E.
- Ti nuk duhet t'Zotit, Perëndisë tënd.
- Kujto ditën e shtunë duke e ruajtur H.
- Ç atin tënd dhe nënën tënde.
- Mos J.
- Mos bëj A.
- Mos D.
- Mos F për komshiu tënd.
- Mos B diçka që i përket komshiut tënd.

- | | |
|---------------------------|--------------------|
| A. Tradhti bashkëshortore | F. Gënje |
| B. Lakmo | G. Perëndia |
| C. Ndero | H. Të shenjtë |
| D. Vidh | I. Të keqpërdorësh |
| E. Idhuj | emrin e |
| | J. Vrit |

⁷Për t'i ndihmuar fëmijët e klubit tënd që ta kuptojnë këtë pikë, merr 11 pjesë të shkurtra spangoje dhe lidhi bashkë nëpër cepa, duke bërë 10 nyje. Në nyjen e fundit lidh një objekt që përfaqëson një person. Mbye këtë spango me objektin e varur në të para fëmijëve. Pyeti se sa nyje të duhet të zgjidhësh dhe sa herë, në mënyrë që ta rrëzosh objektin. Ata duhet të shohin se, kur zgjidh pjesën e parë të spangos kudo përgjatë fijeve që ke bashkuar, ti e shkëput lidhjen e krijuar dhe objekti do të bjerë.

Pyetje dhe përgjigje

- Çfarë thotë urdhërimi i parë? Ka vetëm një Perëndi.
- Çfarë thotë urdhërimi i dytë? Nuk duhet të adhurojmë idhuj.
- Kujt i thotë Perëndia që të nderojë prindërit dhe t'u bindet atyre? Fëmijëve.
- Si quhet veprimi kur dikush merr borxh diçka pa pyetur dhe nuk e kthen? Vjedhje, mëkat.
- Kush vendos se çfarë është mëkat? Perëndia.

11. Përfundim.

- Këto janë Dhjetë Urdhërimet, të cilat Perëndia ua dha izraelitëve.
- Urdhërimet e Perëndisë janë njësoj për të gjithë njerëzit, në çdo vend.
 - Tani njerëzit e dinin se çfarë konsiderohej mëkat.
- Perëndia e dinte se njerëzit nuk mund ta zbatonin këtë listë rregullash në mënyrë të përsosur. Megjithatë Ai kishte një arsye për dhënien e këtyre urdhërimeve.
 - Ligji u mbyll gojën atyre që thonë se janë aq të mirë sa për t'u pranuar nga Perëndia.
 - Dhjetë ligjet shërbejnë që njerëzit të kuptojnë se janë mëkatarë.
 - Askush nga ata që i shikon me syngëritet këto ligje, Ligjin e Perëndisë, nuk duhet të mendojë se është pa mëkat.

Kujto:

Në fillim njeriu, duke mos njohur të keqen, ishte miku i Perëndisë. Por kur Adami dhe Eva nuk iu bindën udhëzimeve të Perëndisë, Perëndia e prishi miqësinë me ta dhe u bë gjykatësi i tyre. Ishte njësoj sikur Perëndia po i thërriste në gjyq. Askush nuk mund t'i mbronte. Perëndia, gjykatësi i përsosur, foli. Njerëzit ishin fajtorë për shkeljen e Ligjit të Perëndisë.

- Pas studimit të Dhjetë Urdhërimeve, shumica e njerëzve do të pranojnë se janë mëkatarë.
- Megjithatë shumë mendojnë se mund të jenë të drejtë para Perëndisë.
 - Këto janë disa nga gjërat me anë të të cilave disa njerëz mendojnë se do të jenë të pranueshëm para Perëndisë⁶.
 - Zbatimi i Dhjetë Urdhërimeve.
 - Të shkruarit në kishë.
 - Të luturit.
 - Të pagëzuarit.
 - Të dhënit të varfërve.
 - Të qenët i mirë me fqinjët.
- Ideja se e mira e një personi mund t'ia kalojë në peshë të këqijave të tij, duke merituar kështu që ai të pranohet nga Perëndia, nuk është shkruar në Bibël.



- Bibla na thotë se, edhe nëse një person do të ishte në gjendje të bënte shumë vepra të mira, edhe sikur t'u bindej tërë urdhrave të Perëndisë pjesën më të madhe të kohës, por do të dështonte vetëm një herë, ai person sërish shkel tërë Ligjin dhe është fajtor për mëkat⁷.



Perëndia dëshiron që njerëzit të bëjnë gjëra të mira, por Ai do që ata të kuptojnë se këto gjëra të mira nuk mund t'i bëjnë ata të pranueshëm para Perëndisë dhe nuk mund të rifitojnë marrëdhënien e prishur me Të. Mirësia jonë nuk plotëson shenjtërinë e Perëndisë. Perëndia donte që njerëzit të kuptonin se për t'u pranuar prej Tij dhe për t'u shpëtuar nga Satani, mëkati dhe vdekja, ata duhet të afroreshin me një mënyrë tjetër. Bibla thotë se vetëm Perëndia në mëshirën e Tij mund të gjejë mënyrën se si njerëzit të shpëtohen nga mëkati i tyre dhe të pranohen prej Tij.

Mësimi 38

Qëllimi

Ky mësim paraqet planin bazë të tabernakullit. Këtu përfshihen vetëm ato gjëra që do t'i ndihmojnë fëmijët të kuptojnë ungjillin kur të paraqitet.

Gjithashtu, fëmijët do të mësojnë:

- Qëllimin e tabernakullit.
- Që Perëndia gjeti një rrugë përmes së cilës mëkatarët t'i afroreshin Atij për të marrë mëshirë.
- Njeriu mund t'i afrohet Perëndisë vetëm sipas vullnetit dhe planit të Perëndisë.
- Nevoja për ndërmjetës midis Perëndisë dhe izraelitëve.


Hyrje

Pyet fëmijët nëse mund të të thonë se çfarë është mëshira. Tregoju afishen "Mëshira" dhe thuaju ta lexojnë. Pyeti se kush ka nevojë për të? Nëse nuk përgjigjen saktë, atëherë shpjego që gjithkush ka nevojë për mëshirë.


Figurat

- Figura 12: Mëshira

- Figura 32: Pjesët e tabernakullit



- Figura 31: Tabernakulli



- Figura 33: Oferta e mëkatit



Tabernakulli

Historia

"Përshëndetje, Xhon dhe Karola" - përshëndeti xhaxhi Piteri. "Ç'i kini këto fytyra të trishtuara".

"Oh, ç'kemi, xhaxhi Piter" - tha Xhoni. "Po mendonim për atë që na the për Perëndinë dhe se si Ai nuk do të pranojë asgjë nga ato që do të bëjmë për të zgjidhur çështjen e mëkateve tona. Kjo do të thotë që të gjithë jemi në telashe!".

"Ke të drejtë, Xhon" - tha xhaxhi Piteri.

"Atëherë, si mund t'i afrohem Perëndisë?" - pyeti Xhoni. "Dua të them, nëse Perëndia është i shenjtë dhe Ai është i përsosur, ne nuk mund t'i afrohem Atij ndonjëherë. Ai nuk do të na pranonte".

"Mendova se po" - tha Karola. "Por tani e di që nuk mundem".

"As izraelitët" - tha xhaxhi Piteri. "Por Perëndia i donte dhe donte që ata t'i afroreshin Atij".

"Por Ai ishte në re!" - tha Xhoni.

"Dhe një kolonë zjarri natën!" - shtoi Karola.

"Po" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Por Perëndia donte të ishte me izraelitët tërë kohën, ndaj Ai siguroi një mënyrë për ta. Megjithatë, ata duhej të dinin se si t'i afroreshin Atij me anë të besimit".

"Çfarë është besimi?" - pyeti Xhoni.

"Të besosh te Perëndia do të thotë të pranosh për të vërtetë atë që thotë Ai" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Do të thotë, gjithashtu, të besosh se Perëndia do të bëjë atë që thotë se do të bëjë. Ai i mban premtimet. Perëndia donte që izraelitët të besonin vetëm në Të dhe në mëshirën e Tij për të gjetur një mënyrë për t'i shpëtuar".

"Pasi u dha atyre urdhërimet e Tij," - tha Karola, - "Ai e dinte se ata kishin nevojë për mëshirë, apo jo, xhaxhi Piter?"

"Po" - u përgjigj xhaxhi Piteri. **"Përmes mëshirës së Tij Ai siguroi një mënyrë për ta, si mëkatarë, që t'i shpëtonin ndëshkimit që meritonin për shkeljen e ligjeve të Tij"**.

"Atëherë çfarë bëri Perëndia për të gjetur një mënyrë që ata t'i shpëtonin ndëshkimit të tyre, xhaxhi Piter?" - pyeti Xhoni.

"Perëndia i tha Moisiut që të ndërtonte një tabernakull" - iu përgjigj xhaxhi Piteri.

"Çfarë?" - pyeti Karola.

"Një tabernakull" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Tabernakull do të thotë thjesht një vendbanim - një vend për të banuar. Perëndia donte një vend të veçantë për të jetuar midis izraelitëve, në mënyrë që Ai mund t'u tregonte mëshirën që kishin nevojë".

"Ai donte ta bënte këtë edhe pse ata mëkatonin?" - pyeti Xhoni.

"Po, Ai e bëri" - iu përgjigj xhaxhi Piteri. "Dhe i tha Moisiut me saktësi si të ndërtonte tabernakullin. Gjithçka duhej të bëhej sipas mënyrës së Perëndisë".

"Në të njëjtën mënyrë si i tha Noeut për të ndërtuar arkën!" - tha Karola me gëzim.

"Pikërisht!" - tha xhaxhi Piteri. "Vetëm Perëndia mund të gjejë një mënyrë që ne t'i afrohem Atij dhe këtë po bënte për izraelitët. Tabernakulli do të ishte vendi ku Perëndia do të takohej me ta dhe do t'u tregonte mëshirë".

"Si mund të futeshin tërë ata njerëz në tabernakull?" - pyeti Xhoni.

"Perëndia caktoi përfaqësues të veçantë midis njerëzve për të dalë para Perëndisë në vend të tyre" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Ai i quajti këta burra priftërinj".

"A mund të jetë kushdo një prift?" - pyeti Xhoni.

"Jo" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Perëndia i zgjodhi ata. Edhe priftërinjtë ishin mëkatarë, ndaj Perëndisë i duhej të gjente një mënyrë që ata t'i afroreshin Atij. Kjo gjë duhej bërë sipas mënyrës së Perëndisë. E tërë kjo është shkruar në Bibël. Le ta shikojmë".

Le të shohim në Bibël



Hebrenjve 9:22b – “Dhe pa derdhur gjak nuk ka ndjesë.”

Ndihmoji fëmijët e klubit tënd që ta gjejnë këtë varg. Lexoje dhe shpjego që ky varg na tregon se nuk do të ketë falje për mëkatin pa derdhje gjaku.

Le të mendojmë

1. Cili është ndëshkimi për mëkatin? a. Flijimi i një kafshe; b. Vdekja; c. Pagesa e një gjobe.
2. Çfarë mund të bëjnë njerëzit për të gjetur zgjidhje për mëkatet e tyre?
 - a. Asgjë; b. T'u binden Dhjetë Urdhërimeve; c. Të adhurojnë Perëndinë.
3. A pagoi gjaku i kafshëve për mëkatet e Izraelit? Po / Jo.
4. Kush jetonte në tabernakull? a. Moisiu; b. Priftërinjtë; c. Perëndia.
5. Çfarë është besimi? a. Të kesh besim te Perëndia dhe te premtimet e Tij; b. Një flijim; c. Një largim nga ndëshkimi i mëkatit.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Tabernakulli është një tablo shumë e bukur e Perëndisë tonë të mëshirshëm. Ja ku po jeton Ai midis njerëzve mëkatarë, duke gjetur një mënyrë që ata t'i afroreshin për të gjetur mëshirën dhe hirin që kishin nevojë. Tabernakulli shihej nga të gjithë. Mëshira ishte në dispozicion të të gjithë atyre që do të afroreshin me anë të besimit. Ndërsa mësojmë historinë e tabernakullit të Perëndisë, Fryma e Tij do t'i përgatisë fëmijët e klubit për të marrë mesazhin më të rëndësishëm: veprën e kryer të Jezu Krishtit!

1. Moisiu u thirr përsëri nga Perëndia në mal - Eksodi 24:12-18.

- Moisiu dhe ndihmësi i tij, Jozueu, shkuan në mal për të takuar Perëndinë.
- Zoti Perëndi nuk donte që izraelitët të harronin urdhrat e Tij, ndaj planifikoi t'i shkruante urdhërimet e Tij në dy pllaka guri.
 - Perëndia donte që Moisiu t'u mësonte izraelitëve urdhërimet e Tij⁸.
 - Dy pllakat do të ishin një kujtesë e përhershme e urdhërimeve të Perëndisë.
- Zoti i shpjegoi Moisiut rregulla dhe zakone të tjera që Ai i kishte urdhëruar izraelitët t'i zbatonin.

2. Perëndia urdhëroi Moisiun të ndërtonte tabernakullin - Eksodi 25:1-9.

- Perëndia u tha të ndërtonin një vend të veçantë ku Ai mund të jetonte me ta - një tabernakull.
 - Perëndia i donte izraelitët; Ai nuk donte t'i shkatërronte.
 - Njerëzit do të mësonin se si t'i afroreshin Perëndisë së tyre të shenjtë pa u shkatërruar.
- Gjithçka në këtë vend duhej të ndërtohej saktësisht siç i tha Zoti Moisiut.
 - Ngaqë izraelitët po ktheheshin në vendin nga kishin ardhur etërit e tyre, tabernakulli duhet të ishte i lëvizshëm.
 - Prandaj Zoti u tha atyre të ndërtonin pjesën më të madhe të tabernakullit me materiale të bëra nga lëkurët e kafshëve dhe leshi i dhive.

Kujto:

A kujton që egjiptianët u dhanë shumë gjëra të vlefshme izraelitëve natën para se të largoheshin nga Egjipti? Atëherë, për të ndërtonur tabernakullin, Perëndia donte që ata që ishin gati, të dhuronin një pjesë të atyre gjërave me vlerë në duart e Moisiut.

3. Perëndia i tha Moisiut që tabernakulli duhet të kishte dy dhoma.

- Dhoma e parë quhej vendi i shenjtë apo vendi i veçuar.
 - Kjo dhomë e kishte hyrjen nga jashtë.
 - Ishte një dhomë e veçuar nga Perëndia për t'u përdorur vetëm për Të.
 - Duhej të përdorej vetëm nga priftërinjtë e zgjedhur nga Perëndia, kur ata t'i shërbenin Atij.

Kujto: Zoti ra dakord me Izraelin që, nëse ata u bindeshin ligjeve të Tij, Ai do të ishte me ta, do t'i mbronte dhe do t'u jepte gjithçka që kishin nevojë. Por, nëse nuk do t'u bindeshin urdhrave të Tij, atëherë ndëshkimi ishte vdekja.

Zoti e dinte se izraelitët ishin mëkatarë dhe nuk do të ishin gjithmonë në gjendje t'u bindeshin urdhrave të Tij. Perëndia e dinte se ata nuk do t'i bindeshin dhe se, nëse nuk do të kishin një rrugë shpëtimi, Atij do t'i duhej t'i ndëshkonte të gjithë.

→ Figura 32: Pjesët e tabernakullit

⁹Kjo nuk do të thoshte se Perëndia nuk do të ishte i pranishëm kudo. Edhe kur erdhi të banonte në tabernakull, Perëndia do të vazhdonte të ishte i pranishëm kudo.

→ Figura 12: Mëshira

Thuaju fëmijëve ta lexojnë përsëri.

¹⁰Kujto: A e kujton kur dëgjuam për herë të fundit rreth kerubinëve? Perëndia i vendosi kerubinët jashtë kopshtit të Edenit, në mënyrë që Adami dhe Eva të mos ishin në gjendje të ktheheshin te pema e jetës. Kerubinët jashtë kopshtit të Edenit ishin kerubinë të gjallë dhe të vërtetë, por këto që Perëndia i tha Moisiut që të ndërtonte, ishin prej ari.

→ Figura 31: Tabernakulli

Trego dhomat dhe perdet e tyre në figurën 32 dhe pastaj trego pozicionin e këtyre dhomave brenda gardhit të figurës 31.

→ Figura 33: Oferta për mëkatin



Lexo: Levitiku 1:1-5.

¹¹Ndërsa personi vriste flinë, ai po pranonte se ishte mëkati i tij që shkaktoi vdekjen e kafshës. Kafsha e pafajshme po vdiste në vend të një mëkatarit, si zëvendësuese për të.

- Dhoma e dytë, **Vendi më i Shenjtë** apo shumë i shenjtë, ishte edhe më e rëndësishme. Prania e Perëndisë do të ishte në këtë dhomë të brendshme.
 - Kjo dhomë ishte caktuar për Perëndinë dhe kryepriifti mund të hynte në të vetëm një herë në vit.
 - Perëndia është i shenjtë, i përsosur dhe i drejtë; i ndarë nga mëkatarët.
 - Kjo ishte dhoma e veçantë në tabernakull, ku Perëndia premtoi të jetonte në qendër të kampit të izraelitëve⁹.
- Tabernakulli me dy dhoma ishte i mbuluar me lëkura të ngjyrosura kafshësh dhe me një mbulesë të sipërme prej gëzofi kafshësh për të formuar çatinë e çadrës (Eksodi 26:14).

4. Arka dhe pajtuesi - Eksodi 25:10-22.

- Perëndia i tha Moisiut të bënte një kuti prej druri të mbuluar me ar, të quajtur arka e besëlidhjes. Ajo duhej të vendosej brenda Vëndit Shumë të Shenjtë, atje ku banonte Perëndia.
- Moisiu duhet të bënte një kapak prej ari të pastër të quajtur pajtues dhe ta vendoste atë sipër arkës së besëlidhjes.
 - Pajtuesi ishte një pjesë e rëndësishme e tabernakullit.
 - Ky ishte vendi ku Perëndia premtoi të jetonte me izraelitët mëkatarë dhe t'u tregonte atyre mëshirë.
 - Zoti i tha Moisiut që ai duhej të bënte dy kerubinë ari, një për secilën anë të pajtuesit¹⁰.
 - Kerubinët duhet të ishin të kthyer me fytyrë nga njëri-tjetri, duke parë poshtë, me krahët e tyre të hapur drejt njëri-tjetrit mbi pajtuesin.
 - Mbi këtë pajtues Perëndia do të takohej me Moisiun dhe do t'i jepte udhëzime për izraelitët.
- Zoti i tha Moisiut të vendoste dy pllakat prej guri, me Dhjetë Urdhërimet të shkruara në to, brenda arkës së besëlidhjes, nën pajtues.

5. Veli - Eksodi 26:31-33.

- Perëndia i tha Moisiut që ai duhej të varte një perde (vel) të bukur si një ndarës midis dy dhomave.
- Perdja do të shërbente si simbol për t'u kujtuar izraelitëve se, për shkak të mëkatit, ata ishin të ndarë nga Perëndia që është i shenjtë dhe i drejtë.

6. Altari prej bronzi - Eksodi 27:1-2.

- Perëndia i tha gjithashtu Moisiut që të bënte një gardh perdesh të vendosura vertikalisht midis shumë kolonave. Ky gardh duhej të bëhej rreth dy dhomave të tabernakullit.
- Brenda hyrjes së gardhit prej perdesh, ata duhej të vendosnin altarin, për të cilin Perëndia tha se duhej të bëhej prej druri të mbuluar me bronz.
- Kur një person donte t'i afrohej Perëndisë dhe të gëzonte bekimet e Tij, ai fillimisht duhej t'i sillte një flijim Zotit. Ai duhej ta sillte te altari prej bronzi, brenda hyrjes.
 - Perëndia lejonte dele, dhi, dema dhe zogj si flijime.
 - Kafshët duhej të ishin meshkuj të përsosur.
 - Gjaku i kafshëve duhej të derdhej.
 - Ai duhej të vendoste duart e tij në kokën e kafshës dhe pastaj ta vriste.
 - Duke bërë këtë ai po pranonte se ishte mëkatar dhe meritonte të vdiste¹¹.
 - Ai po pranonte, gjithashtu, se kjo kafshë do të vdiste si flijim në vend të tij. Ishte njësoj sikur mëkati dhe faji i njeriut të zhvendosej nga njeriu te kafsha. Ai po i kërkonte Perëndisë të pranonte vdekjen e kafshës në vend të vdekjes së tij.
 - Për shkak se kafsha mbartte tani mëkatin e njeriut, ajo duhej të vdiste.
 - Vdekja është ndëshkimi për mëkatin.

Mësimi 38

(vazhdim)



Lexo: Levitiku 17:11 thotë: *Sepse jeta e mishit është në gjak. Prandaj ju kam urdhëruar ta vini mbi altar për të bërë shlyerjen për jetën tuaj, sepse është gjaku që bën shlyerjen e fajit për jetën.*

¹²Kujto: Abeli, Noe, Abrahami, Isaku, Jakobi dhe tërë njerëzit e tjerë të drejtë para izraelitëve duhej t'i afroreshin Perëndisë në këtë mënyrë.

¹³Fëmijët e klubit tënd mund ta kenë të vështirë t'i kuptojnë këto të vërteta. Ne po u mësojmë atyre se Perëndia kërkon pagesë të plotë për mëkatet. Por po themi, gjithashtu, se Perëndia falë mëkatet e izraelitëve që besuan, të cilët u afruan Atij sipas mënyrës që Ai u tha. Kjo mund t'u duket kontradiktore. Ne po mësojmë kështu doktrinën e shlyerjes. Gjatë Dhiatës së Vjetër mëkatari që afrohej sipas mënyrës së Perëndisë falej plotësisht dhe ishte i lirë nga gjykimi për mëkatet e tij. Por Perëndia e bëri këtë vetëm se kishte si qëllim trajtimin e atij mëkati në mënyrë të drejtë e të plotë përmes gjakut dhe vdekjes flijuese të Zotit Jezu Krisht në kryq. Kur Zoti Jezus vdiq, Perëndia hodhi mbi Të mëkatet e besimtarëve të Dhiatës së Vjetër, të cilat për shkak të durimit, dashurisë dhe mëshirës së Tij, kishin mbetur pa u ndëshkuar (Romakëve 3:25; Hebrenjve 9:15). Mos nxito të vazhdosh shpejt përpara, por merr kohë dhe shpjego se si kjo kontradiktë në dukje, u zgjidh në kryq. Por ji vigjilent të flasësh dhe të shpallësh ungjillin me ata që kuptojnë anën e tyre mëkatore dhe pamundësinë e tyre për të shpëtuar veten nga gjykimi i Perëndisë.

Tabernakulli

Shënim: Flijimi ishte një tablo e asaj që ishte e domosdoshme të bëhej, në mënyrë që mëkati i njeriut të falej.

Dhe pa derdhur gjak nuk ka ndjesë (Hebrenjve 9:22b).

Perëndia donte që ata të kujtonin se mënyra e vetme për pranimin ishte të besonin se Ai është Perëndia i drejtë, që mund t'i shpëtonte.

- Perëndia u siguron izraelitëve Ditën e Shlyerjes (Levitiku 16:34).
 - Oferta e Ditës së Shlyerjes përsëritej çdo vit. Duhej të ishte një kujtesë e vazhdueshme e nevojës së njeriut për t'i pasur mëkatet e tij të mbuluara, në mënyrë që Perëndia i shenjtë të mos i shikonte.
 - Nëse izraelitët i afroreshin Perëndisë sipas mënyrës që u kishte thënë, Perëndia premtonte të largonte gjykimin që meritonin dhe të falte mëkatet e tyre për vitin e shkuar.
- Njerëzit, duke ofruar flijimin e kafshës, po tregonin se kishin besim te Perëndia; kjo tregonte se ata i besonin Atij¹².
 - Bibla thotë se Perëndia e pranonte flijimin e kafshës për mëkatarin.
 - Kur Perëndia shikonte vdekjen e kafshës, ai kënaqej që kërkesa e vdekjes për mëkatet ishte plotësuar - kishte pasur një pagesë me vdekje për mëkatet. Perëndia nderonte besimin e njeriut dhe ia llogariste si drejtësi, ashtu siç bëri me Abrahamin.
Por Abrahami i besoi Perëndisë dhe kjo iu numërua për drejtësi (Romakëve 4:3b).
 - Ngaqë ajo drejtësi vinte nga Perëndia, i siguronte tërësisht njeriut përsosmërinë që i duhej për të jetuar në praninë e Perëndisë dhe për të marrë bekimet e Tij¹³.
- A paguante gjaku i kafshëve për mëkatet e tyre?
 - Jo! Gjaku i kafshëve nuk mund të paguante për mëkatet e tyre (Hebrenjve 10:1-4).
 - Ndëshkimi për mëkatet është vdekja dhe kjo përfshin ndarjen e përjetshme të mëkatarit nga Perëndia. Mëkati duhet të paguhet tërësisht.
 - Gjaku i kafshëve ishte vetëm një mbulesë e përkohshme; ai nuk e hiqte borxhin e mëkati.

7. Aaroni dhe bijtë e tij u bënë priftërinj - Eksodi 28:1.

- Zoti caktoi Aaronin të ishte kryeprift. Edhe bijtë e tij të ishin priftërinj.
 - Priftërinjtë i ofronin përditë flijime Zotit në altarin prej bronzi (Eksodi 29:38).
- Vetëm Aaroni, kryepriifti, lejohej të shkonte në dhomën e brendshme, Vendin Shumë të Shenjtë, ku ishte Perëndia.
 - Aaroni dhe çdo njeri që do të shërbente më vonë si kryeprift, mund të futej në Vendin Shumë të Shenjtë një herë në vit, Ditën e Shlyerjes, që do të thotë "dita e mbulimit".
 - Mënyra e vetme se si mund të futej kryepriifti atje ishte me anë të gjakut të një kafshe që ishte flijuar.
 - Nëse dikush tjetër do të futej pas velit dhe do të futej në dhomën e brendshme, ai do të vdiste.
 - Çdo vit, kur kryepriifti futej në Vendin Shumë të Shenjtë, ai spërkaste gjakun e kafshës së flijuar mbi pajtuesin nën kerubinët.
 - Perëndia, në mëshirën e Tij, po e shtynte edhe për një vit ndëshkimin që meritonin kryepriifti dhe izraelitët.
- Perëndia zgjodhi priftërinjtë që të ishin ndërmjetësit midis kombit të Izraelit dhe një Perëndie të shenjtë.
 - Kjo gjë ishte për t'i kujtuar izraelitët se u duhej një ndërmjetës, në mënyrë që t'i afroreshin Perëndisë.

8. Tabernakulli mbaroi dhe u ngrit dhe Perëndia zbriti për të jetuar në të si në shtëpinë e Tij - Eksodi 39:42-43; 40:17, 34-38.

- Izraelitët e ndërtuan tabernakullin për Zotin dhe e bënë saktësisht siç e kishte udhëzuar Perëndia Moisiun.
 - Nëse nuk do ta kishin bërë ashtu siç u kishte thënë Perëndia, Perëndia nuk do të vinte të jetonte me ta.
- Ngaqë Moisiu dhe izraelitët bënë gjithçka që i kishte udhëzuar Perëndia, Ai erdhi të jetonte në qendër të kampit të izraelitëve, në Vendin Shumë të Shenjtë të tabernakullit.
 - Lavdia e Zotit mbushi tabernakullin.
 - Izraelitët mund t'i afroreshin Perëndisë sipas mënyrës që i mësoi Ai.

Përmbledhje:

- Perëndia kishte një qëllim për izraelitët: që të ndërtonin një tabernakull, i cili:
 1. Siguronte një mënyrë që Perëndia të jetonte midis tyre (Eksodi 25:8).
 2. Siguronte një mënyrë që Perëndia të tregonte lavdinë e Tij (Eksodi 40:34-35).
 3. Ishte një kujtesë e ndarjes së një Perëndie të Shenjtë nga një popull mëkatar.
 4. Ngaqë ishte një vend për adhurimin me anë të flijimit, siguronte një mënyrë që populli mëkatar të dilte para një Perëndie të shenjtë.
- Izraelitët, ndërsa bënë këtë adhurim me anë të flijimit, kujtoheshin se kush ishte Perëndia, dhe po ashtu mësonin edhe gjëra të reja rreth Tij.
 1. Perëndia është i shenjtë; Atij nuk mund t'i afroresh pa një ndërmjetës.
 2. Perëndia kujdeset për popullin e Tij dhe banon me ta.
 3. Gjaku është i rëndësishëm në adhurimin e një Perëndie të shenjtë. Pa gjak është e pamundur t'i afroresh Perëndisë.

Shënim: Perëndia nuk na kërkon ne që t'i çojmë flijime kafshësh, por veproi kështu që izraelitët të afroreshin tek Ai. Përmes Çlirimtarit të premtuar, Perëndia do të bënte një mënyrë më të mirë për të trajtuar çështjen e mëkateve.

Përsëritje



Pyetje dhe përgjigje

1. Pse donte Perëndia që izraelitët të ndërtonin tabernakullin? Në mënyrë që Ai të jetonte midis tyre.
2. Sa dhoma kishte tabernakulli? Dy: Vendi i Shenjtë dhe Vendi Shumë i Shenjtë.
3. Kush lejohej të futej në tabernakull? Priftërinjtë.
4. Çfarë bënin priftërinjtë? a. I ofronin flijime përditë Perëndisë; b. Ndërmjetësonin midis njeriut dhe Perëndisë.
5. Çfarë bënte kryepriifti një herë në vit? Ai bënte një fljirim në Vendin Shumë të Shenjtë për mëkatet e tij dhe të izraelitëve për vitin e shkuar.
6. Çfarë është mëshira? Mënyra e Perëndisë që mëkatarët t'i shpëtojnë ndëshkimit që meritojnë për mëkatet e tyre.

Mësimi 39

Qëllimi

Ky mësim u kujton fëmijëve që njeriu është mëkatar; ai ka nevojë për Perëndinë dhe nuk është në gjendje të shpëtojë veten; ai duhet t'i afrohet Perëndisë me anë të besimit. Historia e gjarprit prej bronzi do të përdoret më vonë për të paraqitur ungjillin.

Gjithashtu, ky mësim do t'i ndihmojë fëmijët:

- Të shohin disa pasoja të mëkatit.
- Të shohin mëshirën dhe hirin e Perëndisë.
- Të shohin se sa e rëndësishme është të dëgjojmë Perëndinë dhe t'i besojmë Atij.

Hyrje

Në historinë e sotme mund të shohim se izraelitët nuk janë populli i vetëm që kanë pasur problem me mëkatin. Edhe ne mendojmë shumë për veten tonë, ankohe mi dhe harrojmë të jemi mirënjohës për atë që bëhet për ne. Ne ndonjëherë e trajtojmë Perëndinë në të njëjtën mënyrë si Xhoni trajtoi të ëmën. Perëndia dëshiron që ne t'i pranojmë këto veprime si mëkat. Ai dëshiron që ne të pranojmë mëkatin tonë dhe t'i besojmë Atij, kur thotë se Ai është i vetmi që mund të na shpëtojë nga mëkati ynë. Ne mund të përpiqemi dhe përpiqemi sa më tepër të mundemi për t'i pëlqyer Perëndisë, por ne nuk mund t'i pëlqejmë Atij apo të pranohemi prej Tij sipas mënyrës tonë.

Figurat

- Figura 28: Mana në shkretëtirë



- Figura 34: Gjarpri mbi shtizë



Mosbesimi i Izraelit

Historia

Xhaxhi Piteri dhe Karola po shihnin Xhonin që po dilte nga shtëpia shumë i mërzitur.

“Çfarë problemi ke, Xhon?” - pyeti Karola. “Nuk je zemëruar me mua, apo jo?”.

“Jo!” - u përgjigj Xhoni, ndërsa po ulej. “Jam i mërzitur me mamin!”.

“A je i sigurt se duhet të jesh i mërzitur me mamin, Xhon?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Po!” - u përgjigj Xhoni. “Ajo tha se nuk duhet të dal me miqtë e mi sonte.

Ky është ndëshkim i tepruar thjesht se jam ankuar për diçka”.

“Shiko, Xhon,” - tha xhaxhi Piteri, - “mamaja jote ka autoritetin të vendosë çfarëdo ndëshkimi të dojë. Ajo e di se çfarë është më e mira për ty.

Pastaj ti duhet t'i respektosh prindërit e tu, e kujton?”.

“Xhon, po ia thua tërë historinë xhaxhi Piterit, apo jo?” - pyeti Karola. “E ke pasur këtë ndëshkim për një kohë të gjatë. A e mban mend se si javën e shkuar qëndrova vonë jashtë, më tepër se ç'duhet, ndërsa dje nuk e mbarova punën që të kishte dhënë mamaja? Dhe ke qenë duke u ankuar tërë ditën për...”.

“Në rregull, në rregull!” - tha Xhoni i vënë në siklet. “Nuk ke pse t'ia thuash gjithçka xhaxhi Piterit!”.

“Xhon” - tha xhaxhi Piteri. “Duket se po mendon shumë për veten këto ditë. Mendoja se e doje mamin dhe doje ta kënaqje atë”.

“Dua” - tha Xhoni. “Nuk e di se çfarë nuk shkon me mua! Përpiqem t'i bindem mamin dhe përpiqem të jem mirënjohës për atë që bën për mua. E di që ajo më do dhe dëshiron të më japë atë që kam nevojë. Mendoj se ke të drejtë. Mendoj shumë për veten dhe vazhdoj të harroj se sa shumë kujdeset ajo për mua”.

“Duket pak a shumë si izraelitët, apo jo, xhaxhi Piter?” - pyeti Karola.

“Ke të drejtë për këtë, Karola!” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Kemi lexuar se si nuk iu bindën dhe se si u ankuan për Perëndinë dhe për mënyrën se si u kujdes Ai për ta. Bibla na flet edhe më tepër për izraelitët që vazhdonin të ankoheshin për ushqimin dhe ujin e tyre. Ata thanë se e donin Perëndinë dhe ishin mirënjohës që Ai siguronte për nevojat e tyre. Pastaj, më vonë ata do ta harronin mirësinë e Perëndisë ndaj tyre dhe do të ankoheshin edhe më shumë”.

“Shiko, e di që mamasë i ka ardhur në majë të hundës me ankesat e Xhonit” - tha Karola. “Mendoj se Perëndisë do t'i ketë ardhur në majë të hundës, duke i dëgjuar izraelitët që ankoheshin”.

“Perëndisë nuk i erdhi në majë të hundës” - tha xhaxhi Piteri. “Po kështu edhe Moisiu dhe Aaroni, vëllai i Moisiut. Bibla thotë se edhe Moisiu dhe Aaroni nuk iu bindën njërit prej udhëzimeve të Perëndisë, sepse ishin shumë të mërzitur me izraelitët që ankoheshin”.

“Kjo më çudit” - tha Karola. “Nuk mendoja se Moisiu dhe Aaroni mund të mëkatonin kundër Perëndisë. Ata janë lajmëtarët e Perëndisë për popullin e Tij”.

“Karola,” - tha xhaxhi Piteri, - “a kujton kur mësuam se gjithkush ka lindur me mëkat që nga koha e mëkatit të Adamit?”.

“Po, e kujtoj” - u përgjigj Karola. “Por nuk mendova se Moisiu dhe priftërinjtë, të cilët Perëndia i përdori si ndërmjetës midis popullit të Tij dhe Vetes, të mëkatonin më”.

“Mendoj se mësimi që mund të nxjerrim sot,” - tha xhaxhi Piteri, - “është që askush tjetër përveç Perëndisë, nuk mund të bëjë një jetë të përsosur pa mëkatuar. Perëndia dëshiron që ne të pranojmë se kemi mëkat dhe t'i besojmë Atij për të na shpëtuar nga mëkati. Ne nuk mund të reshtim kurrë së mëkatuari me anë të përpjekjeve tona. Le të shohim një histori tjetër në Bibël, ku Perëndia tregoi mëshirën dhe hirin e Tij ndaj izraelitëve që ankoheshin.

Le të shohim në Bibël



Hebrenjve 11:6 – “Edhe pa besim është e pamundur t’i pëlqesh Atij, sepse ai që i afrohet Perëndisë duhet të besojë se Perëndia është, dhe se është shpërblenjësi i atyre që e kërkojnë atë.”

Ndihmoji fëmijët e klubit tënd të gjejnë këtë varg. Lexoje dhe shpjego se ky varg na thotë se të kesh

besim te Perëndia është mënyra e vetme se si mund t’i pëlqejmë Perëndisë dhe të pranojemi prej Tij.

Le të mendojmë

1. Cili ishte emri i tokës që Perëndia premtoi t’u jepte izraelitëve?
a. Mali Sinai; b. Kanaan; c. Egjipti.
2. Kush siguroi për nevojat e izraelitëve?
a. Moisiu; b. Priftërinjtë; c. Perëndia.
3. Pse nuk donin izraelitët të futeshin në Kanaan?
a. Ata nuk e pëlqenin tokën; b. Kishin frikë; c. Ata nuk mund të futeshin.
4. Kush i shëroi izraelitët, kur panë gjarprin prej bronzi? Perëndia.
5. Çfarë duhet të bëjë një person për t’i pëlqyer Perëndisë dhe për t’u pranuar prej Tij?
a. Vepra të mira; b. Të ketë besim te Perëndia; c. Të përpiqen t’u binden Dhjetë Urdhërimeve.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Perëndia e ngriti renë nga mali Sinai, ku u kishte dhënë izraelitëve Dhjetë Urdhërimet e Tij dhe udhëzimet për tabernakullin. Izraelitët ndiqnin renë kur lëvizte, dhe ajo i drejtoi afër tokës së Kanaanit, të cilën Ai kishte premtuar t’ua jepte atyre.

1. Zbuluesit izraelitë në tokën e premtuar - Numrat 13:1-3.

- Njerëzit që jetonin në tokën e Kanaanit ishin shumë të këqinj dhe adhuronin idhujt. Perëndia planifikoi t’i shkatërronte ata dhe t’ua jepte tokën izraelitëve.

Mendo:

Ne duhet të kujtojmë karakterin e Perëndisë, kur mendojmë për gjykimin e Tij. Ai është i shenjtë, i drejtë dhe gjykon çdo mëkat. Por Ai është edhe i dashur, i mëshirshëm dhe plot hir. Ajo që Perëndia planifikoi t’u bënte kanaanejve ishte e drejtë, sepse Perëndia është i drejtë.

- Kur izraelitët mbërritën në kufijtë e tokës të cilën Perëndia ua kishte premtuar Abrahamit dhe pasardhësve të tij, Zoti i tha Moisiut të zgjidhte një burrë nga secili prej dymbëdhjetë fiseve. Ata do të studionin vendin para se izraelitët të futeshin në të.
 - Më parë Perëndia i tha Moisiut që t’i organizonte izraelitët në bazë të dymbëdhjetë fiseve.
- Moisiu u bind dhe dërgoi dymbëdhjetë burra për të parë vendin dhe njerëzit që jetonin atje.

2. Zbuluesit i raportuan Moisiut dhe izraelitëve - Numrat 13:25-33.

- Dhjetë zbulues nuk i besuan Perëndisë.
 - Toka zotërohej nga njerëz të fortë dhe disa prej tyre ishin gjigantë.
 - Këta zbulues nuk besuan që Perëndia ishte aq i fortë sa t’i mundte njerëzit e Kanaanit dhe t’u jepte tokën izraelitëve.
- Kalebi dhe Jozueu i besuan Perëndisë.
 - Ata kujtuan gjërat e mëdha që kishte bërë tashmë Perëndia. Ata besuan se Ai do t’i dëbonte njerëzit e Kanaanit dhe do t’ua jepte tokën izraelitëve, ashtu siç u kishte premtuar.

→ Figura 35: Jozueu dhe Kalebi

¹⁴Kujto: Satani i tha Evës se ajo nuk do të vdiste nëse hante frutën e pemës së njohjes të së mirës e të së keqes. Satani e quajti Perëndinë gënjeshtar dhe Eva e besoi. Edhe Kaini nuk i besoi Perëndisë dhe iu afrua Atij sipas mënyrës së vet. Perëndia e refuzoi atë dhe ofertën e tij. Kur Noeu u tha njerëzve se një përmytje e madhe do të dërgohej nga Perëndia, ata refuzuan t'i besonin Perëndisë. Ata nuk do të futeshin në arkë dhe do të shkatërroheshin të gjithë. Edhe Egjiptianët nuk besuan që Perëndia i Izraelit ishte Perëndia Shumë i Lartë dhe i vërtetë. Ata besuan te idhujt e tyre për t'u çliruar. Por Perëndia shkatërroi tokën e tyre, vrau të parëlindurit dhe mbyti ushtritë e tyre në det.

¹⁵Kujto: Kur Perëndia vendos të ndëshkojë mëkatarët, nuk ka asnjë vend ku ata të mund të fshihen nga Ai. Në kohët e Noeut, a kishte ndonjë vend ku njerëzit mund t'i shpëtonin gjykimin, pasi Perëndia mbylli derën e arkës dhe dërgoi përmytjen? A mund t'i shpëtonin njerëzit e Sodomës dhe Gomorrës gjykimin të Perëndisë, kur Ai dërgoi zjarr mbi ta? A i shpëtoi gruaja e Lotit gjykimin të Perëndisë, kur nuk iu bind Zotit duke hedhur vështrimin pas? Kur Perëndia vendos që është koha për t'i ndëshkuar njerëzit, nuk ka asnjë vend ku ata mund të shkojnë për t'i shpëtuar.

→ Figura 37: Gjarpri mbi shtizë

Përsëritje

Shiko vargun përmendsh:
Edhe pa besim është e pamundur t'i pëlqesh Atij, sepse ai që i afrohet Perëndisë duhet të besojë se Perëndia është, dhe se është shpërblenjësi i atyre që e kërkojnë atë (Hebrenjve 11:6).

Pyetje dhe përgjigje

1. Si ishin njerëzit në Kanaan? Ata ishin të këqinj dhe adhuronin idhujt.
2. Kush besoi që Perëndia do t'i ndihmonte të pushtonin tokën e Kanaanit? Kalebi dhe Jozueu.
3. Kush nuk do të futej në tokën e premtuar? Tërë izraelitët njëzet vjeç e lart që nuk besuan te Perëndia.
4. Pse i dërgoi Perëndia gjarpërinjtë helmues? a. Sepse izraelitët u ankuan; b. Ngaqë ata nuk i besuan Perëndisë.
5. Çfarë duhej të bënin për të shpëtuar izraelitët që ishin pickuar nga gjarpërinjtë? Ata duhej të kishin besim te Perëndia dhe të besonin se ajo që Ai u tha ishte e vërtetë. Pastaj ata duhej të ngrinin sytë drejt gjarpërit prej bronzi, që Perëndia i tha Moisiut ta ngrinte lart mbi një shtizë.

3. Izraelitët nuk besuan te Perëndia - Numrat 14:1-4, 26-38.

- Perëndia ua kishte premtuar tokën, por ata refuzuan të besonin¹⁴.
- Zoti dëgjoi gjithçka që thanë izraelitët. Ai e dinte që ata nuk do t'i besonin.
- Perëndia do të ndëshkojë këdo që refuzon t'i besojë Atij.
- Perëndia nuk mendonte se izraelitët meritonin të shkonin në tokën që u kishte premtuar. Perëndia u tha izraelitëve që tërë ata që ishin njëzet vjeç e lart, të cilët nuk i besuan Perëndisë, do të vdisnin në shkretëtirë - gjatë dyzet vjet ecejakesh.
 - Kalebi dhe Jozueu i besuan Perëndisë, prandaj ata do të futeshin në tokën e premtuar.

4. Izraelitët u ankuan përsëri - Numrat 20:1-5.

- Ndërkohë që njerëzit endeshin në shkretëtirë, ata fajësuan Moisiun dhe Aaronin, vëllanë e tij, sepse nuk kishin ujë.

5. Perëndia i thotë Moisiut se si t'u jepte izraelitëve ujë - Numrat 20:7-12.

- Perëndia urdhëron Moisiun t'i flasë shkëmbit. Ai nuk duhej ta godiste shkëmbin këtë herë.
- Moisiu nuk iu bind Zotit dhe e goditi shkëmbin në vend që t'i fliste.
 - Moisiut dhe Aaronit u kishte ardhur në majë të hundës me ankesat e izraelitëve. Ata nuk besuan dhe nuk u mbështetën te Zoti në këtë situatë, ashtu siç kishin bërë kur kishin dalë probleme të tjera.
- Moisiu dhe Aaroni nuk do të lejoheshin të futeshin në tokën e premtuar, ngaqë nuk iu bindën Perëndisë.

6. Izraeli u ankua përsëri - Perëndia dërgon gjarpërinj helmues - Numrat 21:4-7.

- Zoti i ndëshkoi izraelitët për shkak të mëkatit të tyre. Shumë prej tyre vdiqën.
- Izraelitët nuk mund t'u shpëtonin gjarpërinjve helmues të dërguar nga Zoti¹⁵.
- Izraelitët pranuan se kishin mëkatuar. Ata kuptuan se vetëm Zoti mund t'i shpëtonte nga vdekja, ndaj i kërkuan Moisiut të kërkonte ndihmën e Tij. Moisiu ishte ndërmjetësi midis izraelitëve dhe Perëndisë.

7. Gjarpri prej bronzi - Numrat 21:8-9.

- Zoti vendosi t'i falte dhe t'i shpëtonte izraelitët, ngaqë është i mëshirshëm.
 - Ata nuk e meritonin ndihmën e Perëndisë, por Ai i shpëton tërë ata që i besojnë Atij.
- Zoti i tha Moisiut se çfarë duhej të bënte dhe se çfarë duhej të bënin izraelitët nëse donin t'i shpëtonin vdekjes. Moisiu duhej të vinte një gjarpër prej bronzi mbi një shtizë.
 - Moisiu duhej të bënte atë që i tha Perëndia dhe njerëzit duhej të shikonin gjarpërin, ashtu siç e kishte udhëzuar Perëndia Moisiun. Duhej të bëhej sipas mënyrës së Perëndisë.

Diskuto:

Çfarë tha Zoti rreth asaj që duhej të bënin për t'u shëruar nga pickimet e gjarpërinjve? Ata duhej të shikonin gjarpërin prej bronzi. A kishte gjarpri mbi shtizë fuqinë për t'i shëruar? Jo! Fuqia e Perëndisë shëroi çdo izraelit që tregoi se i besoi Perëndisë duke parë gjarpërin mbi shtizë.

A mendoni se disa e panë gjarpërin, por Zoti nuk i shëroi? Jo! Perëndia i mban gjithmonë premtimet e Tij. Të gjithë ata që e panë gjarpërin u shëruan menjëherë nga Zoti. Perëndisë mund t'i besojmë se mund të bëjë gjithçka që thotë.

Mendo:

A mendon se njerëzit do të ishin shëruar nëse do të ishin lutur, por nuk do të kishin parë? Jo! Po sikur të mos kishin parë gjarpërin prej bronzi, por t'i kishin bërë Perëndisë një dhuratë, a do të ishin shëruar? Jo! Ata duhej të shikonin gjarpërin prej bronzi, ashtu siç u tha Ai.

- Perëndia dëshiron që ne, ashtu si izraelitët, t'i besojmë Atij.

Mësimi 40

Qëllimi

Ky mësim mbulon kohën nga Jozueu te gjyqtarët dhe deri te mbretërit e Izraelit. Nuk do të hysh në hollësi përveç një vështrimi të shkurtër të Davidit, planit të tij për tempullin dhe ndërtimin e tempullit në kohën e Salomonit.

Ky mësim do të:

- Tregojë mëkatën e tmerrshëm të izraelitëve dhe fqinjëve të tyre paganë.
- Tregojë besnikërinë e Perëndisë për të mbajtur premtimet e Tij ndaj njerëzve që nuk e meritojnë.
- Paraqesë Davidin si pjesë të pasardhjes së Çlirimtarit.
- Tregojë që Perëndia i dërgon profetët për t'u dhënë njerëzve mesazhin e Tij të pendimit, sepse i do dhe kërkon t'i shpëtojë.
- Tregojë pasojat e tmerrshme të refuzimit të të dëgjuarit të Perëndisë dhe të vazhduarit në mëkat dhe rebelim kundër Tij.

Shumë histori nga Dhiata e Vjetër nuk janë përmendur në këto mësim. Ne po paraqesim themelin bazë, mbi të cilin mund të mbështetet ungjilli. Disa kanë thënë se ka një "fije të kuqe" që kalon përmes Biblës. Përgjatë kësaj "fijeje" është historia e Zotit dhe Shpëtimtarit të përjetshëm, që premtoi të gjente një mënyrë për ta çliruar njeriun e rënë nga mëkati, Satani dhe ndëshkimi i përjetshëm.


Hyrje

Pas mbarimit të historisë, ndihmoji fëmijët e klubit tënd të mendojnë për shembuj të idhujve, të atyre gjërave apo njerëzve që adhurohen në kulturën e tyre dhe kulturat rreth nesh.

Figura 36: Adhurimi i idhujve



Figura 37: Tempulli i Salomonit



Grafiku 26: Profetët

Izraeli në tokën e premtuar

Historia

“Hej Xhon” - thirri Karola, ndërsa doli nga dera për ta takuar, - “a e pe ndërtesën e re që po ndërtojnë sipër rrugës?”.

“Po, e pashë” - u përgjigj Xhoni. “Ndala dhe e pashë. Është një kishë e re”.

“Nuk arrij të kuptoj se pse po ndërtojnë një kishë të re?” - pyeti Karola. “Kemi tashmë dy kisha këtu përreth”.

“Mbase kjo është ndryshe nga kishat e tjera” - u përgjigj Xhoni.

“Oh, Xhon,” - qeshi Karola, - “të gjitha kishat janë njësoj. Çfarë mund të ketë ndryshe kjo?”.

“Nuk jam i sigurt,” - tha Xhoni, - “por xhaxhi Piteri ka qenë në kishë dhe ai dukej shumë i lumtur që po ndërtohej kjo kishë. Ai ka ndihmuar për ndërtimin e saj”.

“Ky po që është lajm” - tha Karola. “Nuk e kam parë asnjëherë më parë xhaxhi Piterin të shkojë në kishë. Gjithmonë kam pyetur veten se pse nuk ka shkuar”.

“Mund të të them se pse nuk kam shkuar” - u përgjigj xhaxhi Piteri, ndërsa po shkonte drejt Xhonit dhe Karolës. “Pikë së pari, ke të drejtë Xhon, kjo kishë është ndryshe. Jo të gjitha kishat janë njësoj. Drejtuesit në disa kisha nuk mësojnë të vërtetën rreth Perëndisë dhe atë që Ai na mëson në Bibël; por kjo kishë do ta bëjë. Tani do të shkoj në kishë”.

“Ç’gjë tjetër mësojnë ata, xhaxhi Piter” - pyeti Karola. “A nuk është kjo arsyeja se pse të duhet të ekzistojë një kishë, për të adhurar dhe për të dëgjuar rreth Perëndisë?”.

“Ke të drejtë, Karola” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Perëndia duhet të jetë i vetmi që adhurohet në kishë. Megjithatë, disa njerëz nuk besojnë te një Perëndi i vërtetë”.

“E di” - e ndërpreu Xhoni. “Populli egjiptian adhuronte faraonin dhe idhujt. Por mendoja se ata ishin të vetmit që adhuronin idhujt”.

“Jo, Xhon” - tha xhaxhi Piteri i trishtuar. “Disa izraelitë adhuronin idhujt që u përkisnin popujve që jetonin rreth tyre. Ejani, le të marrim Biblat. Do t’ju tregoj se si Perëndia dërgoi profetë për t’i paralajmëruar izraelitët që të ktheheshin tek Ai ose përndryshe do t’i ndëshkonte, duke lejuar që armiqtë e tyre t’i mundnin. Ata nuk e pëlqyen atë që thanë profetët e Perëndisë, ndaj i vranë disa prej tyre”.

“Perëndia nuk i la të dilnin paq nga kjo, apo jo, xhaxhi Piter?” - pyeti Karola.

“Jo, Karola. Nuk i la” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Ata vazhdonin të mëkatonin, ndaj Perëndia bëri atë që u kishte thënë se do të bënte. Ishte një kohë e vështirë për izraelitët”.

“Nuk e kuptoj se pse donin të adhuronin idhujt” - tha Xhoni. “Ata nuk mund të bëjnë asgjë nga ato që bën Perëndia”.

“Shiko, Xhon,” - tha xhaxhi Piteri, - “nëse mendon mirë, mund të të vijë ndërmend disa nga mënyrat se si njerëzit sot janë njësoj si ata”.

“Me të vërtetë?” - pyeti Karola. “Do të thuash se ka ende njerëz sot që adhurojnë njerëzit dhe gjërat në vend të Perëndisë?”.

“Po” - tha xhaxhi Piteri. “Ndërsa marrim Biblat tona, mund të diskutojmë për mënyrat se si njerëzit sot adhurojnë gjërat që Perëndia ka krijuar, në vend që të adhurojnë Atë”.

Le të shohim në Bibël



2 Pjetrit 3:9 – “Zoti nuk vonon plotësimin e premtimit të tij, siç disa besojnë që ai bën; por është i durueshëm ndaj nesh, sepse nuk do që ndokush të humbasë, por që të gjithë të vijnë në pendim.”

Perëndia nuk është i ngadaltë në mbajtjen e premtimeve të Tij. Koha e Perëndisë nuk është e njëjtë me kohën tonë. Për shkak të dashurisë së Tij ndaj nesh, Ai nuk dëshiron që dikush të vdesë dhe të ndahet nga Ai përgjithmonë. Ai i lë kohë njerëzimit që të pendohet. Megjithatë, Perëndia nuk e ndryshon mendjen. Njerëzit që nuk besojnë në Bibël dhe nuk pendohen në kohën e dhënë prej Tij, do të vuajnë dënimin e Perëndisë.

Le të mendojmë

- Cilët janë ata që Perëndia dëshiron që të humbasin? a. Të këqijtë; **b. Askush**; c. Izraelitët.
- Cila është gjëja më e rëndësishme që duhet të bëjmë në kishë?
a. Të adhurojmë idhuj; b. Të mësojmë se si të jemi të mirë; **c. Të adhurojmë Perëndinë.**
- Çfarë është një idhull?
a. Perëndia i vërtetë; **b. Gjërat që adhurojnë njerëzit**; c. Diçka e fuqishme.
- Pse i ndëshkoi Perëndia izraelitët, duke i lënë në duart e armiqve të tyre?
a. Sepse ata adhuronin idhuj; b. Sepse ata nuk i pëlqenin profetët; c. Perëndia nuk i donte më izraelitët.
- Çfarë dëshiron Perëndia që të bëjë çdo njeri sipas 2 Pjetrit 3:9?
a. Të humbasin; b. Të vuajnë; **c. Të pendohen.**

Mësim nga Fjala e Perëndisë

Izraelitët ishin endur në shkretëtirë për dyzet vjet, sepse kishin refuzuar të besonin se Perëndia do t'u jepte tokën e premtuar. Moisiu dhe Aaroni vdiqën para se Izraeli të futej në tokën e premtuar, ashtu siç tha Perëndia se do të ndodhte. Tërë brezat e rritur vdiqën; ky ishte ndëshkimi i Perëndisë për mosbesimin e tyre. Fëmijët e tyre tashmë ishin të rritur. Zoti tani ishte gati t'i fuste këta izraelitë në Kanaan.

1. Jozueu e drejtoi popullin në Kanaan - Jozueu 1:1-3; 11:23; Gjyqtarët 2:7-15.

- Jozueu, që zuri vendin e Moisiut, i drejtoi izraelitët në Kanaan dhe Perëndia u dha tokën që u kishte premtuar Abrahamit dhe pasardhësve të tij.
- Pasi Jozueu dhe brezi që kishte parë mrekulli në shkretëtirë kishte vdekur, izraelitët e harruan Zotin.

→ Figura 36: Adhurimi i idhujve

- Në vend që t'i besonin Perëndisë në tokën e premtuar, ata adhuruan perënditë e rreme dhe imituan mënyrat e këqija të kombeve përreth tyre, të cilët nuk e njihnin Perëndinë apo Fjalën e Tij.
- Satani i kishte mashtruar këta njerëz, duke i shtyrë të mendonin se ata po adhuronin perënditë e vërteta dhe të gjalla 16.
- Zoti e ndëshkoi Izraelin, sepse ai e harroi dhe adhuroi idhujt.
 - Perëndia i lejoi kombet përreth, të cilët e urrenin Izraelin, ta mundnin dhe t'i bënin izraelitët shërbëtorët e tyre, ashtu siç i kishte paralajmëruar Perëndia.

2. Koha e gjyqtarëve - Gjyqtarët 2:16-19.

- Kur Izraeli u pendua, pra, ra dakord me Perëndinë për mëkatën e vet dhe i kërkoi ndihmë Atij, Perëndia zgjodhi një burrë apo grua për ta drejtuar dhe për ta çliuar nga armiqët e vet. Këta njerëz quheshin gjyqtarë.
- Herë pas herë izraelitët e harronin Zotin.
Zoti lejoi që ata të pushtoheshin disa herë me radhë nga armiqët e tyre.
- Edhe pse izraelitët nuk iu bindën Perëndisë dhe Atij i duhej që t'i ndëshkonte, Ai sërish i donte ata.

Kur njerëzit adhurojnë diçka tjetër në vend të Perëndisë së vërtetë e të gjallë, për të cilin flitet në Bibël, ata po adhurojnë në të vërtetë Satanin. Satani e fsheh veten. Ai fshihet pas idhujve dhe gjërave të tjera, të cilat njerëzit i adhurojnë, ashtu siç e fshehu veten duke përdorur gjarprin kur tundoi Evën.



¹⁷Shumë mbretër sunduan mbi Izrael pasi vdiq Salomoni. Pas vdekjes së Salomonit, kombi i Izraelit diskutoi se kush do të ishte mbret dhe u nda në dy mbretëri. Dhjetë fiset e Izraelit u quajtën Izrael dhe dy fiset jugore u quajtën Juda. Kemi trajtuar shumë vite nga historia e Izraelit - nga Jozueu te Davidi ishin rreth 400 vjet. Nga Davidi së bashku me tërë mbretërit ishin rreth 400 vjet të tjerë.

→ Figura 37: Tempulli i Salomonit

Trego grafikun 26: Profetët.

¹⁸Të pendohesh do të thotë "të ndryshosh mënyrën se si mendon": të biesh dakord me Perëndinë për mëkatin tënd.

¹⁹Satani është i njëjtë edhe sot. Ai flet përmes njerëzve që mund të të thonë se Fjala e Perëndisë nuk është e vërtetë. Ose ata mund të thonë se Perëndia nuk do ta ndëshkojë mëkatin; askush nuk do të shkojë në ferr.

²⁰Si referencë për ju, historitë për këtë periudhë kohe gjenden në librat e Ezdrës dhe Nehemias.

Përsëritje

Zbulimi i mesazhit të fshehtë: "Zoti nuk është i ngadaltë në mbajtjen e premtimit të Tij".

Pyetje dhe përgjigje

1. Pse u endën izraelitët në shkretëtirë derisa të vdisnin të rriturit? **Ata refuzuan të besonin se Perëndia do t'u jepte tokën e premtuar.**
2. Pse lejoi Perëndia që izraelitët të pushtoheshin nga kombet e tjera? **Sepse harruan Perëndinë dhe adhuruan idhujt.**
3. Nga familja e cilit mbret premtoi Perëndia se do të vinte Çlirimtari? **E mbretit David.**
4. Kë dërgoi Perëndia për t'u predikuar izraelitëve dhe për t'i paralajmëruar se do t'i gjykonte? **Profetët.**
5. Çfarë emri të ri morën Izraelitët? **Judenj.**
6. Kush i pushtoi judenjët dhe i detyroi të paguanin taksa? **Romakët.**

3. Koha e mbretërve - 1 Samuelit 8:4-7.

- Nga tërë kombet e botës, Izraeli kishte mbretin më të mirë. Ai kishte vetë Perëndinë, si sovranin dhe mbretin e tij.
- Izraeli e hodhi poshtë Perëndinë dhe kërkoi një mbret si kombet përreth tij.
- Perëndia i dha Izraelit atë që donte; shumë mbretër sunduan mbi të.
 - Disa prej atyre mbretërve besuan te Perëndia dhe i zunë besë Atij, por shumë prej tyre nuk besuan.

4. Davidi ishte mbreti më i madh dhe më i mirë i Izraelit - 2 Samuelit 5:4; 7:12-16.

- Ndryshe nga shumë prej mbretërve të tjerë që sunduan mbi Izraelin, Davidi besoi me të vërtetë te Zoti dhe donte t'i bindej Atij në çdo gjë.
- Mbreti David ishte gjithashtu një prej profetëve të Perëndisë, i frymëzuar nga Perëndia për të regjistruar Shkrimin.
- Davidi donte të ndërtonte një vend të qëndrueshëm, ku njerëzit mund të vinin për të adhuruar dhe për të ofruar flijimet e tyre. Megjithatë, ishte djali i tij, Salomoni, që e ndërtoi tempullin kur u bë mbret pasi vdiq Davidi¹⁷.
- Perëndia i dha Davidit të njëjtin premtim që i dha Abrahamit, Isakut dhe Jakobit.
 - Zoti i premtoi Davidit që Çlirimtari do të rridhte nga familja e tij.

5. Perëndia dërgoi profetë për t'u predikuar izraelitëve dhe për t'i paralajmëruar për gjykimin.

- Perëndia i donte izraelitët dhe donte që ata të shpëtoheshin.
- Profetët (lajmëtarët) u thanë njerëzve se Zoti thoshte se ata duhet të pendoheshin¹⁸, të shkatërronin idhujt dhe t'i besonin vetëm Atij ose përndryshe do të ndëshkoheshin prej Tij.
- Shumica e njerëzve i urrenin mesazhet e profetëve dhe refuzonin të bindeshin. Ata përndiqnin (keqtrajtonin dhe lëndonin) dhe vrisnin lajmëtarët e Perëndisë.
- Përveç profetëve të Perëndisë kishte edhe profetë të rremë, që i tregonin gënjeshtër Izraelit. Ata u thoshin njerëzve se çdo gjë që do të rregullohej dhe se Perëndia nuk do t'i ndëshkonte¹⁹.
- Shumë njerëz shkonin në tempull për të adhuruar Zotin, për të kryer tërë ceremonitë dhe për të ofruar flijime, por ata nuk i bindeshin Perëndisë në jetën e tyre të përditshme.

6. Gjykimi i Perëndisë ndaj Izraelit dhe Judës – 2 Mbretërve 17:1-8; 25:1-12.

- Njerëzit nuk iu bindën Fjalës së Perëndisë, ndaj Atij iu desh t'i ndëshkonte.
- Pas shumë vjetësh njerëzit e Judës u penduan dhe i kërkuan Zotit që t'i kthente në tokën e tyre. Izraelitët që u kthyen në tokën e tyre morën një emër tjetër; ata u quajtën judenj. Deri më sot ata quhen ende judenj²⁰.
- Kur u kthyen në tokën e tyre, ata erdhën dhe i ofruan flijime Perëndisë, por shumë prej tyre nuk besonin se ishin mëkatarë që kishin nevojë për mëshirën e Perëndisë.
- Perëndia lejoi që judenjët të pushtoheshin përsëri - nga grekët, pastaj romakët.
- Romakët sunduan mbi judenjët dhe i detyruan të paguanin taksa. Ata vranë shumë judenj me shpatë, heshtë apo me kryqëzim (vdekje me anë të gozhdimit apo lidhjes së dikujt në kryq).
 - Romakët adhuronin shumë perëndi të rreme dhe Cezarin (perandorin romak).
 - Romakët i lejonin judenjët të adhuronin në tempullin e tyre, në Jerusalem. Judenjët ndërjuan shtëpi për takime, të quajtura sinagoga, ku mund të lexonin dhe mësonin Shkrimet e Dhiatës së Vjetër. Shumë herë mësimet e tyre nuk ishin të sakta.
- Një numër i vogël judenjsh e besonin Fjalën e Perëndisë ashtu siç u ishte dhënë nëpërmjet profetëve. Perëndia u trishtua shumë nga mosbesimi i Izraelit dhe nga refuzimi që ata i bënë premtimeve të Tij. Megjithatë, Perëndia nuk i ndryshoi kurrë planet e Tij apo nuk i harroi premtimet e Tij për Çlirimtarin. Ai po përgatitej për të treguar hirin dhe mëshirën e Tij jo vetëm ndaj Izraelit, por ndaj tërë botës!

Mësimi 41

Qëllimi

Ky mësim shpall lindjen e Gjonit dhe lindjen e Jezusit. Përbushja e profecisë nga Perëndia tregon se Ai është besnik dhe që nuk ndryshon. Sovraniteti, shenjtëria dhe plotfuqishmëria e Tij tregohet në lindjen e Gjonit dhe në dërgimin e Jezu Krishtit, Çlirimtarit të premtuar.

Gjithashtu ky mësim do të tregojë:

- Që Jezusi është Perëndia Bir.
- Që Jezusi është Biri i Perëndisë.
- Që Jezusi është Çlirimtari i premtuar.
- Që nuk ka asgjë të pamundur për Perëndinë.

Hyrje

Në historinë e sotme do të mësojmë se kush është Çlirimtari. Ndihejmi fëmijët të kuptojnë se shumë njerëz sot refuzojnë akoma të mësojnë rreth Perëndisë dhe Çlirimtarit, Perëndisë Bir. Ashtu si në kohën e izraelitëve, edhe sot ka njerëz të cilëve u mësohen gjëra që nuk janë të vërteta rreth Perëndisë dhe Fjalës së Tij, Biblës.

Figurat

- Figura 39: Zakaria në tempull



- Figura 40: Gabrieli i shfaqet Marisë



- Grafiku 24: Jezu Krishti është Perëndi

- Grafiku 25: Adami, mëkatar

Perëndia përgatit rrugën për Çlirimtarin

Historia

Xhoni dhe Karola po shikonin kishën e re afër shtëpisë së tyre, për të cilën xhaxhi Piteri kishte dhënë ndihmën për ta ndërtuar.

“Xhaxhi Piter,” - tha Karola e gëzuar, - “kjo është një kishë shumë e këndshme! A mendon se shumë njerëz do të marrin pjesë në takime këtu?”.

“Ashtu shpresoj” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Megjithatë, ndonjëherë është e vështirë që njerëzit ta ndryshojnë atë që besojnë; ata nuk duan të mësojnë diçka të re”.

“Kjo më kujton izraelitët” - tha Xhoni. “A filluan ndonjëherë ta dëgjonin Perëndinë?”.

“Jo,” - u përgjigj xhaxhi Piteri, - “shumë prej tyre nuk e bënë. Por gjithmonë ka pasur disa njerëz që i besuan Perëndisë. Ata e dinin se Perëndia do të vepronte ashtu siç kishte premtuar. Ata donin Çlirimtarin, për të Cilin Perëndia kishte premtuar se do të vinte shpejt. Ata po shpresonin që Çlirimtari të ishte një mbret që do t'i shpëtonte nga sundimi i romakëve”.

“A u dërgoi Perëndia një mbret?” - pyeti Karola.

“Jo mbretin e mbretërve që prisnin ata” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Asnjë qenie njerëzore nuk mund t'i ndihmonte. Perëndia kishte premtuar një çlirimtar që do t'i çlironte njerëzit nga mëkati, nga Satani dhe nga ndarja e përjetshme nga Perëndia. Të gjithë kishin mëkatar dhe Perëndia nuk mund të pranojë diçka të kryer nga njerëzit mëkatarë”.

“Kë dërgoi Perëndia?” - pyeti Xhoni.

“Perëndia bëri gjënë më të mahnitshme që ishte bërë ndonjëherë” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Ai erdhi vetë për të qenë Çlirimtari!”.

“Perëndia erdhi në tokë?!” - tha Karola e çuditur. “Mendova se njerëzit nuk mund ta shikonin Perëndinë”.

“Ke të drejtë, Karola” - tha xhaxhi Piteri. “Por a kujton kur mësuam nga Bibla se Perëndia është Trini: Perëndia Atë, Perëndia Bir dhe Perëndia Frymë? Perëndia do të dërgonte Birin e Tij për të qenë Çlirimtari”.

“Ua!” - tha Xhoni. “Kjo është e mahnitshme! Po habitem që Perëndia nuk i la tërë njerëzit të humbisnin pa ndonjë ndihmë prej Tij. Njerëzit mëkatonin vazhdimisht duke mos iu bindur Perëndisë”.

“Ai mund t'i linte të humbisnin” - tha xhaxhi Piteri. “Por kishte premtuar të dërgonte një Çlirimtar; dhe kishte gjithmonë disa njerëz që i besonin Perëndisë. Perëndia është plot hir dhe pranon ata njerëz që i afrohen Atij me anë të besimit, duke besuar tek Ai për t'u shpëtuar”.

“Perëndia është shumë i durueshëm, apo jo, xhaxhi Piter?” - tha Karola.

“Po, është” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Dhe Ai e dinte me saktësi se çfarë duhej për të shpëtuar popullin nga mëkatet e tij. Ai e dinte se ishte i vetmi që mund të bënte këtë punë. Ishte e pamundur që njeriu të shpëtonte veten, por për Perëndinë nuk ka asgjë të pamundur”.

“Por si mund të vijë Perëndia këtu si njeri nëse Ai është Perëndi?” - pyeti Xhoni.

“Perëndia kreu mrekulli; Ai është i fuqishëm: nuk ka asgjë të pamundur për Të” - tha xhaxhi Piteri. “Ai bëri që Biri i Tij të lindte përmes një gruaje të zakonshme. Perëndia Bir nuk kishte një atë tokësor. Perëndia Atë ishte Ati i Tij. Çlirimtari duhet të ishte pa mëkat: Ai nuk mund të kishte lidhje me Adamin”.

“Duhet të ketë qenë shumë e vështirë që Ai të linte qiellin dhe të vinte në këtë vend plot mëkat” - tha Karola. “A e di se si e bëri Perëndia këtë?”.

“E di që Perëndia e bëri, sepse na do” - tha xhaxhi Piteri. “Por le të shkojmë të marrim Biblat dhe të lexojmë se si ndodhi kjo gjë”.

Le të shohim në Bibël



Luka 1:37 - “Sepse me Perëndinë asgjë s’është e pamundshme.”

Ndihmoji fëmijët të kuptojnë që, duke qenë se Perëndia është i plotfuqishëm, Ai mund të bëjë atë që dëshiron, edhe kur për njerëzimin është e pamundur.

Le të mendojmë

1. Kush ka mëkatuar? a. Askush; b. Disa njerëz; **c. Të gjithë.**
2. Kë kishte premtuar të dërgonte Perëndia për t’i shpëtuar njerëzit nga mëkati, Satani dhe vdekja? a. Një mbret; **b. Një Çlirimtar;** c. Një kafshë të përsosur.
3. Cili ishte Çlirimtari? a. Mbret; b. Një grua e zakonshme; **c. Perëndia Bir.**
4. Pse mund t’i çlironte Biri i Perëndisë njerëzit nga mëkati, Satani dhe vdekja?
a. Ai ishte i fortë; **b. Ai nuk kishte mëkat;** c. Ai i donte tërë njerëzit.
5. Kë do të çlirojë Perëndia nga mëkati, Satani dhe vdekja?
a. Të gjithë ata që besojnë te Perëndia; b. Të gjithë ata që duan të çlirohen; c. Këdo që është i mirë.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Lindja e Jezu Krishtit nga një e virgjër është një prej të vërtetave qendrore të besimit tonë. Megjithatë shumë mësues në vitet e fundit e refuzojnë atë, sepse nëse besojnë në faktin e lindjes nga një e virgjër, del që ata duhet të besojnë se Perëndia është i shenjtë dhe i plotfuqishëm. Ne dëshirojmë të mësojmë të vërtetën e Perëndisë. Perëndia flet qartë rreth shenjtërisë së Tij nga Zanafilla deri te Zbulesa. Asnjë nga pasardhësit mëkatarë të Adamit nuk mund të ishte Shpëtimtari ynë. Vetëm Biri i shenjtë i Perëndisë së shenjtë mund të vdiste në vendin tonë.

Ne kemi hedhur themelin e së vërtetës përgjatë Dhiatës së Vjetër. Tani do të tregojmë për këtë Çlirimtar të mrekullueshëm, Jezu Krishtin, Birin e Perëndisë: Perëndia Bir.

1. Profeti Malakia i kujton judenjtë se Çlirimtari i premtuar i Perëndisë do të vinte për t’i shpëtuar - Malakia 3:1.

- Gjithashtu, ai u tha judenjve që, para se të vinte Çlirimtari, Perëndia do të dërgonte një profet tjetër.
 - Detyra e këtij profeti do të ishte përgatitja e rrugës për ardhjen e Çlirimtarit apo Shpëtimtarit.
- Pas Malakisë, kaluan katërqind vjet gjatë të cilëve Perëndia nuk foli përmes ndonjë profeti.
 - Megjithatë Perëndia ishte në veprim gjatë kësaj kohe, e cila zakonisht quhet “vitet e heshtjes”²¹. Qetësisht, pa u vënë re nga shumica e njerëzve, Perëndia po përgatitej të përmbushte premtimet e Tij të mëdha për të dërguar një Shpëtimtar për tërë botën.

2. Perëndia premtoi se Zakaria dhe Elizabeta do të kishin një djalë - Luka 1:5-14.

- Zakaria dhe gruaja e tij, Elizabeta, ishin judenj që besonin te Perëndia dhe po prisnin Çlirimtarin e Tij të premtuar.
 - Ata ofronin flijime në tempull, ashtu siç e kishte urdhëruar Perëndia Moisiun.
- Duke qenë se ata besonin te Perëndia dhe i afroreshin Atij sipas mënyrës që kishte kërkuar, Ai i pranoi, ashtu siç kishte pranuar Abelin dhe tërë të tjerët që i kishin besuar Atij, që nga fillimi i botës.
- Edhe pse ishin të moshuar dhe nuk kishin fëmijë²², Perëndia i premtoi Zakarisë se Elizabeta do të kishte një djalë; ata do t’ia vinin emrin Gjon.

3. Vepra e Gjonit ishte të përgatiste rrugën e Çlirimtarit - Luka 1:15-17, 24-25.

- Katërqind vjet para se të lindte Gjoni, Perëndia i tha Malakisë të shkruante këto profeci rreth lajmëtarit të Perëndisë, Gjonit!

²¹Perëndia e bëri gjuhën greke të përbashkët për shumë vende të botës. Ai lidhi qytete të largëta përmes rrugëve romake. Ai e përhapoi popullin e Tij në shumë vende të ndryshme, ku ata ndërtuan sinagoga dhe mësuan Fjalën e Tij.

→ Figura 39: Zakaria në Tempull

²²Në atë kohë judenjtë i përbuznin çiftet që nuk ishin në gjendje të kishin fëmijë. Tani Zakaria dhe Elizabeta do të kishin një djalë në moshën e tyre të thyer!



Lexo: Malakia 3:1.

²³Shpjego: Ishte e pamundur që një virgjëreshë të kishte fëmijë. Megjithatë, asgjë nuk është e pamundur për Perëndinë. Perëndia mund të bëjë gjithçka! Perëndia krijoi njeriun e parë, Adamin, nga pluhuri i tokës dhe Perëndia i jep jetë çdo personi. Nuk ishte e vështirë për Perëndinë t'ia jepte birin e Tij Marisë pa pasur një baba tokësor.


=> Figura 40: Gabrieli i shfaqet Marisë

²⁴Mund të kesh fëmijë në klubin tënd të cilëve u është mësuar se Maria ka qenë pa mëkat. Mos i bëj besimet e tyre çështjen e ditës. Thjesht thuaju që vetë Maria e quajti Perëndinë: "Shpëtimtari im" (Luka 1:47). Kjo tregon se edhe ajo kishte nevojë që Zoti ta shpëtonte nga mëkatet e saj. Bibla thotë se "të gjithë kanë mëkatuar" (Romakëve 3:23).

Trego grafikun 24: Jezu Krishti është Perëndi.

Shënim: Këtë herë mos e lexo "Jezu Krishti është Shpëtimtari i vetëm".

²⁵Engjëlli i tha Marisë që, për shkak se Çlirimtari do të ishte pasardhës i mbretit David, Ai do të ishte përgjithmonë mbret mbi Izraelin. Perëndia do të bënte atë që i kishte premtuar mbretit David kohë më parë.



Pyetje dhe përgjigje

1. Kë zgjodhi Perëndia për të përgatitur rrugën për Çlirimtarin? **Gjonin.**
2. Kë zgjodhi Perëndia për të qenë nëna e Çlirimtarit? **Marinë.**
3. Çfarë kishte të veçantë Çlirimtari? **Ai ishte edhe Perëndi, edhe njeri.**
4. Si quhej Çlirimtari? **Jezus.**
5. Cili ishte Ati i Jezusit? **Perëndia.**
6. Pse nuk lindi Jezusi me mëkat si gjithë të tjerët? **Ai nuk lindi nga një atë njerëzor; prandaj Jezusi ishte Biri i përsosur i Perëndisë, i shenjtë dhe pa mëkat.**

- Perëndia dinte gjithçka për djalin e Zakarisë, para se Elizabeta të mbetej shtatzënë. Perëndia di gjithçka para se të ndodhë. Perëndia dinte gjithçka edhe për ne, para se prindërit tanë ta dinin se do të lindim!
- Gjoni do të ishte profeti që do t'i përgatiste njerëzit për të pranuar Çlirimtarin që do të vinte. Ai do të shkonte para Çlirimtarit për të përgatitur rrugën për Të.
 - Engjëlli e quajti "Zot" Çlirimtarin që do të vinte.
 - Çlirimtari që do të vinte, Shpëtimtari i njerëzve, do të ishte vetë Perëndia!

4. Perëndia i premtoi Marisë një bir - Luka 1:26-31.

Tani ishte koha që Perëndia t'i përmbushte premtimet e Tij rreth Çlirimtarit.

- Perëndia dërgoi një engjell për t'i thënë një virgjëreshë të quajtur Mari, që Perëndia e kishte zgjedhur për të qenë nëna e Çlirimtarit (Isaia 7:14)²³.
- Maria ishte vetëm një grua e thjeshtë, e cila, edhe pse ishte mëkatore, besoi se Perëndia do të dërgonte Çlirimtarin²⁴.
 - Perëndia zgjodhi Marinë për të qenë nëna e Çlirimtarit, sepse Perëndia bën atë që dëshiron. Perëndia është sovran: Ai është autoriteti më i lartë (Psalmi 115:3).
- Djali i Marisë do të ishte Çlirimtari i premtuar: dikush që shpëton apo çliron.
 - Emri i tij do të ishte Jezus, që do të thotë Shpëtimtar apo Çlirimtar. Perëndia nuk e kishte harruar kurrë premtimin e Tij për të dërguar Çlirimtarin. Perëndia e donte tërë botën dhe dëshironte që mëkatarët të çliroheshin nga ndëshkimi që meritonin.

5. Djali i Marisë do të ishte edhe njeri, edhe Biri i Perëndisë - Luka 1:32.

- Engjëlli Gabriel i tha gjithashtu Marisë disa gjëra të mahnitshme për djalin e saj që do të lindte.
 - Në të vërtetë djali i Marisë nuk do të ishte vetëm djali i saj, por Ai do të ishte edhe Biri i Shumë të Lartit, pra, Biri i Perëndisë. Ai do të ishte përgjithmonë Mbret²⁵.
- Jezus ishte emri i Tij si njeri; emri i Tij njerëzor.

Shpjego:

Kur filluam të studiojmë Biblën së bashku, mësuam rreth Trinisë. Mësuam se, edhe pse ka vetëm një Perëndi, Perëndia është tre persona që janë të barabartë në çdo drejtim. Këta të tre janë: Perëndia Atë, Perëndia Bir dhe Perëndia Frymë e Shenjtë. Perëndia është Frymë dhe nuk ka trup njerëzor. Megjithatë Shpëtimtari duhet të ishte një genie njerëzore ashtu si ne; përveçse Ai duhet të ishte pa mëkat. Ndaj, që plani i Perëndisë për Çlirimtarin të mund të përmbushej, Perëndia Bir duhet të lindte si genie njerëzore. Perëndia zgjodhi Marinë për të qenë nëna e Çlirimtarit. Çlirimtari, i Cili ishte Perëndia Bir, duhej të zbriste nga qielli për të lindur në tokë si biri i Marisë, për të marrë trupin e Tij njerëzor. Djali i Marisë do të ishte edhe Perëndi, edhe njeri në të njëjtin trup. Ky djalë, Jezusi, do të ishte tërësisht Perëndi dhe tërësisht njeri.

- Si Biri i Perëndisë, Jezusi kishte shumë tituj (emra). Gjashtë vjet më parë Perëndia ia kishte shpallur këto gjëra profetit të Tij, Isaia (Isaia 9:6).

6. Jezusi, Çlirimtari, nuk do të kishte një atë tokësor - Luka 1:34-35, 37.

- Maria nuk mund të kuptonte se si mund të kishte një fëmijë pa një baba fizik.
 - Engjëlli i tha se Perëndia Frymë e Shenjtë mund të kryente këtë mrekulli.
- Duke qenë se Jezusi do të lindte pa një baba njerëzor, Ai do të lindte pa mëkat.
- Asnjë pasardhës i Adamit nuk është i shenjtë dhe i drejtë.
 - Çdo person në botë ka trashëguar mëkatin e Adamit.
 - Ne të gjithë jemi mëkatarë, sepse mëkati i Adamit është transmetuar te ne (Romakëve 5:12, 19). => Trego grafikun 25: Adami, mëkatar.
- Ati i Jezusit është Perëndi.
 - Perëndia është i përsosur dhe i shenjtë, pa mëkat.
 - Jezusi nuk e trashëgoi natyrën mëkatore të Adamit!
 - Jezusi ishte Biri i përsosur i Perëndisë, i shenjtë dhe pa mëkat!

7. Maria i besoi Zotit dhe pranoi se ishte vullneti i Perëndisë që ajo të ishte nëna e Çlirimtarit - Luka 1:38.

Mësimi 42

Qëllimi

Mësimi i sotëm do të jetë një përsëritje e asaj që është mësuar gjatë tetë seanceve të para. Mund të bësh pyetje të tjera apo të përshtatësh pyetje sipas moshës së fëmijëve të klubit tënd. Referoju faqeve 33-34 të pjesës së parë të Manualit të Mësuesit "Rrënjët e besimit", për të të ndihmuar që të drejtosh mësimet dhe lojërat e përsëritjes.

Hyrje

Sot nuk do të ketë histori. Kjo do të jetë ditë përsëritjeje. Mund të përdorësh pyetjet për t'u bërë fëmijëve një test Awana. Këto pyetje trajtojnë vetëm tetë mësimet e fundit.

Pyetje, pyetje, pyetje!

Historia

Ky mësim nuk ka histori. Kjo do të jetë një ditë përsëritjeje.

Le të shohim në Bibël



Le të shohim se sa vargje kanë mësuar përmendsh fëmijët e klubit tënd dhe sa janë në gjendje t'i thonë. Bëj një pyetje për secilin nga tetë vargjet që kemi përdorur në tetë mësimet e fundit. Shembuj: kush mund të recitojë Isaia 45:22? Kujt i drejtohem për t'u shpëtuar? Përgjigju pyetjes dhe cito vargun

përmendsh që i përgjigjet kësaj pyetjeje. Fëmijët mund të fitojnë pikë shtesë për recitimin e tërë vargjeve.

Isaia 45:22; Jakobi 2:10; Romakëve 3:20; Luka 1:37; Isaia 41:10; Hebrenjve 9:22; Hebrenjve 11:6; 2 Pjetrit 3:9.

Le të mendojmë

Në tetë mësimet e para kemi parë faktet historike të çlirimit të izraelitëve nga skllavëria dhe udhëtimin e tyre drejt tokës së premtuar, siç tregohet në Bibël. Kemi dëgjuar për fuqinë, besnikërinë, hirin, dashurinë dhe mëshirën e Perëndisë siç tregohet me anë të gjithçkaje që Ai siguroi për popullin e Tij shpesh të pabesë: Izraelin. Pamë se si Dhjetë Urdhërimet u dhanë për t'i bindur ata për mëkat, për t'i treguar njerëzimit se ata ishin të pazotë për të shpëtuar veten me anë të veprave të tyre dhe për të parë nevojën që kishin për një Shpëtimtar. Ne studiuam rreth tabernakullit, ku mësuam nevojën e ndërmjetësve midis Perëndisë dhe njerëzimit. Mësuam, gjithashtu, se njeriu mund t'i afrohet Perëndisë vetëm sipas vullnetit dhe planit të Tij. Përmes këtyre mësimëve kemi mësuar se njerëzit janë mëkatarë; ata kanë nevojë për Perëndinë dhe nuk janë në gjendje të shpëtojnë veten; ata duhet t'i afrohen Perëndisë me anë të besimit. Së fundmi, mësuam se Çlirimtari i premtuar, Shpëtimtari i njerëzimit, do të ishte vetë Perëndia!

Moisiu dhe Izraelitët: Izraelitët ishin pasardhësit e Abrahamit, Isakut dhe Jakobit. Kur Jozefi, djali i Jakobit, ishte sundues në Egjipt, familja e tij u zhvendos nga Kanaani në Egjipt për shkak të zisë së bukës në Kanaan. Faraoni i Egjiptit i kishte bërë skllavër për shumë vjet.

1. Kë zgjodhi Perëndia për t'i nxjerrë izraelitët nga skllavëria në Egjipt? **Moisiun.**
2. Kush i çliroi izraelitët në Detin e Kuq? **Perëndia.**
3. Çfarë problemi kishin izraelitët pasi kaluan Detin e Kuq? **Ata nuk kishin ushqim apo ujë.**
4. A i besuan izraelitët Perëndisë për të siguruar ushqim dhe ujë për ta? **Jo, ata u ankuan dhe fajësuan Moisiun dhe Aaronin për situatën e tyre.**
5. A e meritonin izraelitët që t'u jepej ushqim nga Perëndia? **Jo.**
6. A ka ndonjë person që meriton dashurinë e Perëndisë dhe ato që Ai siguron? **Jo.**

Dhjetë urdhërimet: Këto janë dhjetë ligje apo rregulla të cilat Perëndia u dha izraelitëve, në mënyrë që të mund të shikonin se sa mëkatarë ishin.

1. Çfarë u premtoi Perëndia izraelitëve në malin Sinai? **Ai do t'i bekonte nëse ata do t'i bindeshin Atij në mënyrë të përsosur.**
2. Çfarë i premtuan izraelitët Perëndisë? **Ata i premtuan se do t'i bindeshin Atij për gjithçka.**

3. Pse planifikoi Perëndia t'ia jepte urdhërimet e Tij Izraelit? **Perëndia planifikoi t'ua jepte atyre urdhërimet për t'u treguar se ishin mëkatarë dhe se nuk ishin në gjendje t'i pëlqenin Atij apo të pranoheshin prej Tij përmes diçkaje që mund të bënin vetë.**
4. Cili është ndëshkimi i Perëndisë për mosbindjen ndaj njërit prej urdhërimeve të Tij? **Ata do të mallkoheshin dhe ndëshkoheshin nga Perëndia.**
5. A mendoi Perëndia se izraelitët do të ishin në gjendje t'u bindeshin Dhjetë Urdhërimeve të Tij? **Jo, Perëndia e dinte se askush nuk do të ishte në gjendje t'i bindej Atij në mënyrë të përsosur.**
6. Cili është urdhërimi i parë? **Perëndia dhe vetëm Ai është Perëndia i kujtdo.**
7. Cili është urdhërimi i dytë? **Njerëzit nuk duhet të adhurojnë idhuj.**
8. Çfarë tha Perëndia në urdhërimin e pestë për fëmijët në lidhje me prindërit e tyre? **Fëmijët duhet të nderojnë (respektojnë) dhe t'u binden prindërve të tyre.**
9. Çfarë mendon Perëndia për vrasjen sipas urdhërimit të gjashtë? **Ai tha se është mëkat kundër Perëndisë.**
10. A janë Dhjetë Urdhërimet vetëm për izraelitët? **Jo, ato kanë të njëjtin qëllim për të gjithë njerëzit, në çdo vend.**
11. Pse është e pamundur që një person t'u bindet në mënyrë të përsosur Ligjeve të Perëndisë? **Ne jemi të gjithë mëkatarë dhe të ndarë nga Perëndia, ndaj nuk jemi në gjendje t'i pëlqejmë Perëndisë.**

Tabernakulli: Një vend ku Perëndia jetonte midis njerëzve mëkatarë, duke krijuar për ta një mënyrë që të mund të shkonin tek Ai për të gjetur mëshirën dhe hirin që u duhej. Perëndia e dinte se izraelitët nuk do t'u bindeshin Dhjetë Urdhërimeve që u kishte dhënë. Nëse nuk do të kishin një vend ku do të mund të shkonin te Perëndia dhe të merrnin faljen dhe mëshirën e Tij, ata do të vdisnin të gjithë.

1. Kujt u tha Perëndia të ndërtonin tabernakullin? **Perëndia u tha Moisiut dhe izraelitëve që ta ndërtonin.**
2. A do të kishte ardhur Perëndia të jetonte në tabernakull nëse nuk do ta kishin ndërtuan saktësisht siç e kishte udhëzuar Perëndia Moisiu? **Jo.**
3. Ku u ndërtua tabernakulli? **Në qendër të kampit izraelit ku mund ta shikonin të gjithë.**
4. Perëndia është kudo. A do të thotë se Perëndia nuk është kudo në të njëjtën kohë, kur Ai është në tabernakull? **Jo, edhe kur Perëndia erdhi të jetonte në tabernakull, Ai do të vazhdonte të ishte kudo.**
5. Kush ishte i vetmi që mund të futej një herë në vit pas perdes së madhe e të rëndë në Vendin Shumë të Shenjtë? **Kryepriifti.**
6. Çfarë duhet të merrte me vete kryepriifti në Vendin Shumë të Shenjtë? **Gjakun e një kafshe që ishte flijuar (therur).**
7. Çfarë duhet të bënte kryepriifti me gjakun? **Ai duhej të spërkaste pajtuesin me këtë gjak.**
8. Çfarë premtoi se do të bënte Perëndia nëse kryepriifti e bënte këtë? **Perëndia premtoi se do ta mbante larg izraelitëve edhe për një vit tjetër gjykimin e Tij.**
9. A i shlyente gjaku i kafshëve mëkatet e tyre? **Jo, gjaku i kafshëve nuk mund të paguante përgjithmonë për mëkatin; ai ishte vetëm një mbulesë e përkohshme; nuk e hiqte borxhin e mëkatit.**
10. Cila është pagesa e vetme për mëkatin? **Mëkatarët duhet të vdesin dhe kjo përfshin ndarjen e përvetshme të mëkatarit nga Perëndia. Mëkati duhet të shlyhet i gjithi.**
11. Pse i zgjodhi Perëndia priftërinjtë për të qenë ndërmjetësit midis kombit të Izraelit dhe një Perëndie të shenjtë? **Kjo gjë ishte për t'u kujtuar izraelitëve që një ndërmjetës ishte i domosdoshëm, në mënyrë që ata t'i afroreshin Perëndisë.**

Toka e premtuar: Ky është vendi që Perëndia u premtoi Abrahamit dhe pasardhësve të tij. Pasi Perëndia çliroi izraelitët nga skllavëria në Egjipt, Ai i drejtoi te kjo tokë e premtuar.

1. Perëndia dërgoi 12 zbulues izraelitë për të kontrolluar Kanaanin, tokën e premtuar. Çfarë raporti dhanë dhjetë prej tyre për tokën? **Ata nuk mendonin se do të ishin në gjendje të futeshin në tokë, sepse njerëzit ishin të mëdhenj dhe të fortë. Ata nuk besuan se Perëndia do t'ua jepte atyre tokën.**
2. Çfarë raporti dhanë dy zbuluesit e tjerë: Jozueu dhe Kalebi? **Ata besuan se Perëndia do ta mbante premtimin e Tij dhe do t'ua jepte tokën.**
3. Kë besuan izraelitët? **Ata besuan dhjetë zbuluesit.**
4. Cili ishte ndëshkimi i Perëndisë ndaj izraelitëve që nuk besuan në premtimin e Tij për t'u dhënë tokën? **Perëndia tha se tërë ata që nuk besuan tek Ai, do të vdisnin në shkretëtirë. Ata nuk mund të futeshin në Kanaan.**
5. Për kë tha Perëndia se do të futej në tokën e premtuar? **Kalebi dhe Jozueu, sepse ata i besuan Perëndisë dhe bijtë e izraelitëve të rritur.**
6. A ua dha Perëndia pasardhësve të Abrahamit tokën, të cilën ua kishte premtuar? **Po, Perëndia e mbajti premtimin e Tij dhe ua dha tokën.**
7. Pasi Moisiu vdiq, Jozueu mori vendin e tij të drejtimit. Çfarë bënë izraelitët pasi vdiq Jozueu? **Ata harruan Perëndinë, adhuruan perënditë e remë dhe imituan rrugët e këqija të kombeve rreth tyre.**
8. Kush i mashtron njerëzit që ata të adhurojnë idhujt? **Satani.**
9. Nga ndryshonte Davidi nga shumë mbretër që sundonin Izraelin? **Mbreti David besoi dhe donte t'i bindej Perëndisë.**
10. Çfarë premtimi të rëndësishëm i bëri Perëndia Davidit? **Perëndia premtoi se Çlirimtari do të rridhte nga familja e tij.**
11. Si i ndëshkoi Perëndia izraelitët për adhurimin e idhujve? **Perëndia lejoi që të mundeshin nga armiqtë e tyre.**
12. Çfarë i thanë profetët e Perëndisë Izraelit? **Ata u thanë të pendoheshin, të shkatërronin idhujt e tyre dhe të besonin vetëm te Zoti.**
13. Çfarë emri të ri morën izraelitët? **Judenj.**
14. Cili ishte populli i fundit që i pushtoi judenjtë? **Romakët.**
15. Cilin tha Perëndia se do të dërgonte për t'i shpëtuar njerëzit nga Satani, mëkati dhe Vdekja? **Çlirimtarin.**
16. Cila do të ishte puna e Gjonit? **Ai do të ishte profeti që do të përgatiste popullin për Çlirimtarin që do të vinte.**
17. Kush është Çlirimtari i premtuar? **Jezusi.**
18. Çfarë do të thotë emri Jezus? **Jezus do të thotë Shpëtimtar apo Çlirimtar.**

Përsëritje

Përko referencat me vargun e saktë.

1. Isaia 45:22
 2. Jakobi 2:10
 3. Romakëve 3:20
 4. Luka 1:37
 5. Isaia 41:10
 6. Hebrejve 9:22b
 7. Hebrejve 11:6
 8. 2 Pjetrit 3:9
-
- 3 *Sepse asnjë mish nuk do të shfaqësohet para tij për veprat e ligjit; me anë të ligjit në fakt arrihet njohja e mëkatit.*
 - 8 *Zoti nuk vonon plotësimin e premtimit të tij, siç disa besojnë që ai bën; por është i durueshëm ndaj nesh, sepse nuk do që ndokush të humbasë, por që të gjithë të vijnë në pendim.*
 - 5 *Mos ki frikë, sepse unë jam me ty, mos e Humb, sepse unë jam Perëndia yt. Unë të forcoj dhe njëkohësisht të ndihmoj dhe të mbaj me dorën e djathtë të drejtësisë sime.*
 - 7 *Edhe pa besim është e pamundur t'i pëlqesh Atij, sepse ai që i afrohet Perëndisë duhet të besojë se Perëndia është, dhe se është shpërblenjësi i atyre që e kërkojnë atë.*
 - 1 *Kthehuni nga unë dhe do të shpëtoni, ju mbarë skaje të tokës. Sepse unë jam Perëndia dhe nuk ka asnjë tjetër.*
 - 4 *Dhe fryma im ngazëllon në Perëndinë, Shpëtimtarin tim.*
 - 6 *Dhe sipas ligjit, gati të gjitha gjërat pastrohen me anë të gjakut; dhe pa derdhur gjak nuk ka ndjesë.*
 - 2 *Sepse kushdo që e zbaton gjithë ligjin, por e shkel në një pikë, është fajtor në të gjitha pikat.*

Pyetje për diskutim

1. Pse vendosi Perëndia t'i shpëtonte izraelitët nga skllavëria?
 - a. Sepse Perëndia pa vuajtjet e tyre dhe dëgjoji thirrjet e tyre.
 - b. Sepse Perëndia i deshi dhe planifikoi të shfaqte dashurinë dhe mëshirën e Tij ndaj tyre.
 - c. Sepse Perëndia i kishte premtuar Abrahamit që do t'i bënte pasardhësit e Abrahamit një komb të madh dhe se, përmes këtyre pasardhësve, do të vinte Çlirimtari në botë.
2. Çfarë kemi ndër mend kur themi se ata që nuk zbatojnë çdo ligj do të mallkohen dhe do të ndëshkohen nga Perëndia? **Kemi ndër mend ndarjen e përjetshme nga Perëndia dhe ndëshkimin në liqenin e zjarrit, të cilin Perëndia e përgatiti për Satanin, engjëjt e tij dhe mëkatarët.**
3. Pse i shtyn Satani njerëzit të adhurojnë idhujt dhe gjërat e tjera?
 - a. Sepse Satani urren Perëndinë dhe nuk do që dikush ta adhurojë Atë.
 - b. Sepse Satani i urren tërë njerëzit dhe nuk do që ata t'i besojnë Perëndisë dhe të çlirohen nga vdekja.
 - c. Sepse Satani përdor shumë gjëra për t'u fshehur dhe për t'i mashtruar njerëzit.
4. Pse Çlirimtari duhet të lindte nga një virgjëreshë? **Që të mos kishte dyshim se Çlirimtari ishte Biri i Perëndisë: i lindur pa mëkat.**
5. A do të ishte Jezusi më tepër se njeri i thjeshtë? **Po, Jezusi do të ishte Perëndia Bir, të Cilin vetë Perëndia e kishte planifikuar të zbriste nga qielli për të lindur si foshnjë. Jezusi duhej të ishte Perëndi dhe njeri.**
6. Pse Shpëtimtari duhet të lindte si pasardhës i Davidit? **Sepse Perëndia i kishte premtuar Davidit që Çlirimtari do të ishte një prej pasardhësve të tij.**

Mësimi 43

Qëllimi

Përmes profecisë së Zakarisë na thuhet se biri i tij, Gjoni, do të përgatiste rrugën për Çlirimtarin. Gjithashtu, përmes kësaj profecie mësojmë diçka rreth Çlirimtarit, Jezu Krishtit:

- Ai do të ishte personi përmes të cilit Perëndia do të përbushte premtimin e tij ndaj Abrahamit.
- Ai do të ishte vetë Perëndia.
- Ai do të shpjegonte se si do të shpëtoheshin njerëzit.
- Vetëm Ai do të ishte Shpëtimtari për tërë botën; do të kishte vetëm një Shpëtimtar për tërë njerëzit. Jezusi shpallet i Vajosuri i Perëndisë: Profet, Prift dhe Mbret.

Hyrje

Disa fëmijë, ashtu si shumë njerëz, mund të mendojnë se është "krenari" të thuash se Jezu Krishti është rruga e vetme për te Perëndia. Atyre u pëlqen të mendojnë se ka shumë rrugë dhe se nuk ka rëndësi sa kohë që ata janë "fetarë". Nëse nuk mund ta kuptojnë, mos u ha me fjalë me ta. Thjesht thuaju që do të flisni më tepër për këtë në mësimet e mëvonshme.

Figurat

- Grafiku 16: Disa prej premtimeve të Perëndisë ndaj Abrahamit
- Grafiku 27: Profecitë
- *Shënim: Do të përdorim këtë grafik për të regjistruar përbushjen e disa prej këtyre gjërave për të cilat Perëndia tha se do t'i ndodhnin Çlirimtarit. Mënyra më e mirë për ta treguar këtë grafik është duke i mbajtur profecitë të mbuluara, derisa të jepen në mësimet. Duhet të shkruash referencat e Shkrimtave të dhëna për profecitë e përbushura në të djathtë.*

Planet e Perëndisë për Gjonin dhe Jezusin

Historia

Pas shkollë Xhoni dhe Karola u ndalën në shtëpinë e xhaxhi Piterit për t'i bërë një pyetje.

"Xhaxhi Piter, kam një pyetje" - tha Xhoni. "Sot një burrë erdhi në orën e historisë dhe foli për fetë e botës. Ai na tha të njëjtën gjë që kemi dëgjuar nga ti: që jo të gjithë besojnë te i njëjti Perëndi".

"Por ai tha se kjo nuk përbente një problem" - tha Karola. "Ai tha se Perëndia pranon këdo, tërë njerëzit rreth botës, njësoj, në çfarëdo lloj mënyre që të vendosin t'i afrohen".

"Ai tha që të gjithë jemi bijtë e Perëndisë" - shtoi Xhoni. "A është e vërtetë kjo?"

"Bukur fare, apo jo?" - pyeti xhaxhi Piteri.

"Po, pikërisht" - u përgjigj Xhoni. "Disa prej atyre feve dukeshin interesante".

"Por Bibla nuk thotë ashtu, apo jo, xhaxhi Piter?" - pyeti Karola.

"Jo, Karola" - u përgjigj xhaxhi Piteri - "Bibla nuk thotë fare ashtu; thotë të kundërtën. Thotë se të gjithë kanë mëkatuar. Mëkati na ndan nga Perëndia. Ne nuk jemi 'të gjithë' bij të Perëndisë".

"Dhe ka vetëm një rrugë për të shkuar te Perëndia," - ndërpreu Xhoni, - "dhe kjo është rruga e Perëndisë dhe jo e jona".

"Ke të drejtë, Xhon" - tha xhaxhi Piteri i gëzuar.

"Nuk e di pse," - tha Karola, - "por nga mënyra se si e tha, gati i besova. Do t'i kisha besuar po të mos kishim studiuar Biblën!".

"Edhe unë" - tha Xhoni.

"Mendoj se ky njeri ishte i sigurt për atë që tha," - tha xhaxhi Piteri, - "por e kishte gabim. Mbase pa e kuptuar ai po thoshte një prej gënjeshtreve të Satanit".

"Prandaj dukej aq e mirë?" - pyeti Karola.

"Më vjen keq t'ua them këtë, por kjo është e vërtetë" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Kujtoni që Satani shfaqet si një engjëll drite ndonjëherë".

"M'u ngatërruan mendimet vetëm duke e dëgjuar atë" - pranoi Xhoni.

"Prandaj është kaq e rëndësishme të dish saktësisht se çfarë thotë Bibla" - tha xhaxhi Piteri. "Perëndia na thotë në Fjalën e Tij se askush nuk mund t'i afrohet Perëndisë nëse Perëndia nuk hap rrugën që ai t'i afrohet Atij. Vetëm Perëndia mund ta çlirojë njeriun nga Satani, mëkati dhe vdekja".

"Po tërë ata njerëz në vendet e tjera që kanë fe të tjera?" - pyeti Karola.

"Kujto, Karola," - u përgjigj xhaxhi Piteri, - "Perëndia i krijoi tërë njerëzit.

Tërë njerëzit në botë janë pasardhës të një njeriu, Adamit".

"Atëherë Perëndia i njehtë të gjithë" - tha Xhoni. "Ai nuk ka siguruar rrugë të ndryshme për njerëz të ndryshëm".

"Ke të drejtë, Xhon" - tha xhaxhi Piteri. "Ai premtoi të dërgonte një Çlirimtar për tërë botën. Nuk ka rrugë tjetër se si dikush mund të shpëtohet".

"Po pse ka shumë fe?" - pyeti Karola. "E kujton, pasi mëkatuan njerëzit e parë, mëkati filloi të shtohet në tokë" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Pastaj në kullën e Babelit, Perëndia u dha njerëzve gjuhë të ndryshme, për shkak të ideve të tyre rebele. Satani i mashtroi, në mënyrë që të adhuronin gjërat që krijoi Perëndia, në vend që të adhuronin Perëndinë, Krijuesin".

"Xhaxhi Piter!" - bërtiti Xhoni. "Sapo m'u kujtua një varg që flet për Abrahamin! Perëndia tha se tërë kombet do të bekohen përmes tij dhe Çlirimtari do të ishte pasardhës i tij".

"Sërish ke të drejtë, Xhon" - tha xhaxhi Piteri. "Një Shpëtimtar për tërë botën. Perëndia nuk ka harruar askënd. Ai ka misionarë në çdo vend të botës, edhe tani, për t'u treguar popujve për mënyrën e Tij të shpëtimit të njerëzve nga mëkatet e tyre! Ejani, le të marrim Biblat dhe të shohim se çfarë mund të mësojmë ende rreth planit të Perëndisë për Shpëtimtarin".

Le të shohim në Bibël



Isaia 9:6 – “Sepse na ka lindur një fëmijë, një djalë na është dhënë. Mbi supet e tij do të mbështetet perandoria dhe do të quhet Këshilltar i admirueshëm, Perëndi i fuqishëm, Atë i përjetshëm, Princ i paqes.”

Thuaju fëmijëve të klubit që këto emra të shumtë që i janë dhënë Çlirimtarit të Premtuar, Jezu Krishtit, u profetizuan 700 vjet para se të lindte Jezusi.

Le të mendojmë

1. Sa Perëndi ka? a. Shumë; b. Katër; c. Një.
2. Kush i mashtron njerëzit që të mendojnë se ka perëndi të tjerë?
a. Çlirimtari; b. **Satani**; c. Abrahami.
3. Kush i krijoi tërë njerëzit? a. Satani; b. Askush; c. **Perëndia**.
4. Sa rrugë ka për të shkuar te Perëndia? a. Shumë; b. Katër; c. **Një**.
5. Kë do të shpëtojë Perëndia nga mëkati, Satani dhe vdekja?
a. **Këdo që beson te Perëndia**; b. Këdo që dëshiron të çlirohet; c. Këdo që është mjaft i mirë.

Mësim nga Fjala e Perëndisë

Kur Perëndia bën një premtim, Ai do ta përbushë; pavarësisht se sa e vështirë apo se sa e pamundur duket. Edhe nëse do të duhen mijëra vjet për ta realizuar, Perëndia do të përbushë çdo premtim që bën. Mësimi i sotëm do të tregojë se si po e përbush Perëndia premtimin e Tij rreth lindjes së Gjonit. Përmes profesisë së Zakarisë na thuhet se ky djalë do të përgatiste rrugën e Çlirimtarit.

1. Gjoni lindi - Luka 1:57.

- Perëndia bëri atë që i kishte premtuar Zakarisë.
 - Zakaria dhe gruaja e tij, Elizabeta, kishin një djalë dhe ia kishin vënë emrin Gjon, ashtu siç i kishte udhëzuar engjëlli²⁶.

2. Zakaria besoi se premtimet e Perëndisë rreth Çlirimtarit do të përbusheshin shpejt - Luka 1:67-79.

- Zakaria e dinte se shumë shpejt Shpëtimtari i premtuar nga Perëndia do të vinte për të çliruar njerëzimin nga Satani, mëkati dhe vdekja.
 - Zakaria besoi premtimet që Perëndia u kishte dhënë profetëve.

Mendo:

Secili prej nesh duhet të çlirohet nga Satani, nga gjërat mëkatore që kontrollojnë jetët tona dhe nga vdekja e ndarja nga Perëndia. Kjo është arsyeja se përse Perëndia planifikoi të dërgonte Shpëtimtarin në botë.

=> Grafiku 16: Disa nga premtimet e Perëndisë ndaj Abrahamit

Trego këtë premtim në pankartë. Abrahami ishte babai i kombit të Izraelit. A kujton që Perëndia i kishte premtuar atij që njëri nga pasardhësit e tij do të ishte Shpëtimtari? Zanafilla 12:3b: *Te ti do të jenë të bekuara tërë familjet e tokës.*

Edhe pse kishin kaluar mijëra vjet qëkurse Perëndia i bëri atë premtim Abrahamit, Perëndia nuk kishte harruar. Perëndia bën gjithmonë atë që thotë.

3. Gjoni do të përgatiste Izraelin për të besuar te Çlirimtari - Luka 1:76.

- Perëndia Frymë e Shenjtë i dha këtë mesazh Zakarisë dhe Zakaria e besoi.
- Gjoni do të ishte profeti i fundit që do t'i shpallte Izraelit që Shpëtimtari do të vinte së shpejti tek ata.
 - Çlirimtari, Shpëtimtari, për të Cilin Gjoni do të përgatiste rrugën, ishte Zoti, vetë Perëndia.
 - Asnjë njeri i zakonshëm nuk mund të na çlironte nga Satani, mëkati dhe vdekja.

Pyeti fëmijët e klubit tënd, nëse mund të mbajnë mend premtimet e tjera që bëri dhe përbushi Perëndia. Ja disa:

- Paralajmërimet e Tij ndaj Adamit dhe Evës.
- Paralajmërimet e Tij ndaj njerëzve në kohën e Noeut.
- Premtimet e Tij ndaj Abrahamit për t'i dhënë pasardhës.
- Premtimet e Tij ndaj Jozefit përmes ëndrrave që Jozefi do të ishte sundimtar.
- Premtimet e Tij ndaj Moisiut për t'i nxjerrë izraelitët jashtë Egjiptit dhe për t'i kthyer në malin Sinai.
- Premtimi i Tij ndaj izraelitëve për t'i ruajtur nga plaga e fundit nëse do të zbatonin udhëzimet e Tij rreth Pashkës.
- Premtimi i Tij për t'i kthyer izraelitët në tokën e premtuar.
- Paralajmërimet e Tij ndaj Izraelit dhe Judës që ata do të ziheshin robër nëse nuk pendoheshin nga mëkatet e tyre.



Lexo: Isaia 43:11 thotë: *Unë, unë jam Zoti dhe përveç meje nuk ka Shpëtimtar tjetër.*

²⁷Kujto: Kush i çlironi Noeun dhe familjen e tij nga përmbytja? Kush e çlironi Isakun nga vdekja dhe siguroi një dash që të vdiste në vend të tij? Kush e çlironi Lotin nga shkatërrimi i Sodomës dhe Gomorrës? Kush e çlironi Jozefin nga burgu në Egjipt? Kush i shpëtoi izraelitët nga ushtria e Faraonit në Detin e Kuq? Kush i çlironi izraelitët nga vdekja duke u siguruar atyre ujë dhe ushqim në shkretëtirë? Vetëm Zoti është Çlirimtari i madh.

Shënim: Përsëritje si këto janë të rëndësishme. Fëmijët e klubit duhet të kenë parasysh vazhdimësinë e temave biblike: ata duhet të kujtohen se Perëndia nuk ndryshon. Ai është ende i njëjti Perëndi sot siç ka qenë në Dhiatën e Vjetër dhe kështu do të jetë gjithmonë.

²⁸Mendo: Sa diej i japin dritë tokës? Vetëm një. I njëjti diell i jep dritë mbarë botës. Sa çlirimtarë pretmoi Perëndia të dërgonte në botë? Vetëm një.

→ Figurë e sugjeruar: Grafiku 27: Profecitë

Trego vetëm titullin

Përsëritje

Vendosi shkronjat në rendin e duhur për të formuar fjalën që përshkruan personin.

1. Ai bën një punë të veçantë.
IRFTP (Prift)
2. Dikush që sundon mbi popullin e tij.
RTEBM Mbret)
3. Ai u flet njerëzve fjalët e Perëndisë.
FORTEP (Profet)

Pyetje e përgjigje

1. Kë zgjodhi Perëndia për të përgatitur rrugën për Çlirimtarin? **Gjonin**.
2. Kush ia dha babait të Gjonit, Zakarisë, mesazhin për Gjonin dhe Çlirimtarin?
Fryma e Shenjtë.
3. Kush do t'u sillte dritë njerëzve në çdo anë?
Çlirimtari, Jezu Krishti.
4. Çfarë do të thotë "Krisht"?
a. Mesi; b. I Vajosur.
5. Për çfarë detyrash të veçanta apo të larta ishte veçuar Jezusi, Çlirimtari, nga Perëndia?
a. Profet i Perëndisë; b. Kryepriift i Perëndisë; c. Mbret

- Zoti është Çlirimtari i madh i tërë atyre që besojnë tek Ai.
- Nuk ka Shpëtimtar tjetër, veç Zotit²⁷.
- Zakaria tha se kur të vinte Shpëtimtari, Ai do t'u tregonte njerëzve të Tij se si mund të faleshin mëkatet e tyre (Luka 1:77).
 - Perëndia nuk mund dhe nuk do t'i falë mëkatet nëse nuk është paguar çmimi i plotë për to.
- Çlirimtari do të vinte si dielli që lind në mëngjes.

Mendo:

Si do të ndiheshë nëse do të dilje për të bërë një xhiro në pyll dhe do të humbisje? Kur të perëndonte dielli, ti jo vetëm do të ishte i humbur, por as nuk do të shihje se ku ishte. Mezi do të prisje që të lindte dielli në mëngjes që të gjeje rrugën e kthimit. Në mënyrë të ngjashme, mëkati i Adamit dhe Evës na futi të gjithëve në errësirë. Ata kishin qenë shumë të sigurt në kopshtin e Edenit, sepse vareshin nga Perëndia për çdo gjë dhe Ai u dha atyre atë që kishin nevojë. Por kur mëkatuan, mëkati i tyre i ndau nga Perëndia. Ata u dëbuan nga kopshti. Ne mund të themi që ata ishin në errësirë: në rrezik të vazhdueshëm nga sulmet e Satanit. Tërë fëmijët dhe pasardhësit e tyre, duke na përfshirë mua dhe ty, kemi lindur në errësirë dhe mëkati! Por Perëndia po gjente një rrugë në mes të asaj errësire!

- Zakaria tha që Çlirimtari do të vinte në këtë botë për të qenë drita e tërë njerëzve.
 - Çlirimtari do të vinte ashtu si dielli lind pas një nate të errët dhe u jep dritë tërë njerëzve në çdo vend²⁸.
 - Perëndia nuk pretmoi se do të dërgonte çlirimtarë të ndryshëm, një për ne dhe një tjetër për njerëzit në vende të ndryshme të botës.
 - Perëndia pretmoi vetëm një Çlirimtar, i Cili do ta bënte të mundur që ne t'i afroshim Perëndisë.
- Gjoni jetoi në shkretëtirë derisa u përmbush koha e Perëndisë që ai të fillonte t'ia jepte mesazhin e Perëndisë Izraelit, për ta përgatitur që të besonte në Çlirimtarin që do të vinte (Luka 1:80).
 - Gjoni i besoi Perëndisë; Ai i besoi Perëndisë që ta shpëtonte nga ndëshkimi i përjetshëm.

4. Perëndia përmbush premtimet e Tij rreth Jezusit, Çlirimtarit - Mateu 1:1-2.

- Jezusi, Çlirimtari që do të vinte, do të ishte pasardhës i Abrahamit, Isakut, Jakobit dhe Davidit.
- Për katërqind vjet Perëndia u kishte dhënë profetëve të Tij mesazhe rreth këtij Shpëtimtari që do të vinte.
- Perëndia planifikoi gjithçka që do t'i ndodhte Shpëtimtarit edhe para se Ai të vinte në botë.

=> Figurë e sugjeruar: Grafiku 27: Profecitë

Zbuloi profecinë e parë: "Do të jetë pasardhës i Davidit". Lexo tekstin e profecisë, Isaia 9:7, në të majtë dhe përmbushjen e profecisë, Mateu 1:1, në të djathtë.

- Jezusi do të quhej edhe Krisht.
 - "Krisht" do të thotë "Mesi".
 - "Krisht" do të thotë gjithashtu "i Vajosur" - i veçuar nga Perëndia për detyra të veçanta.
- Jezusi ishte i Vajosuri i Perëndisë, i veçuar për tri detyra të veçanta.
 - Ai duhet të ishte Profeti i Perëndisë, Prift dhe Mbret.
 - Si Profet i Perëndisë, Jezusi do të dërgohej në botë për t'u treguar rrugën e Perëndisë tërë njerëzve për t'u çliruar nga Satani, mëkati dhe ndëshkimi i përjetshëm.
 - Perëndia do të dërgonte edhe Jezusin për të qenë Kryepriifti i madh dhe i fundit. Kujto që kryepriifti çonte gjakun e kafshëve në dhomën e brendshme të tempullit një herë në vit, në mënyrë që mëkatet e popullit të mund të faleshin.
 - Jezusi do të bëhej Mbreti, pasardhësi i mbretit David.

Vetëm Jezusi ishte i premtuar nga Perëndia për të qenë Krishti, i Vajosuri. Askush tjetër nuk mund ta pretendojë me të drejtë këtë pozicion. Jezu Krishti u premtua nga Perëndia për të qenë Çlirimtari i vetëm për tërë mëkatarët. Perëndia i mban gjithmonë premtimet e Tij.

Mësimi 44

Qëllimi

Ky mësim paraqet lindjen e Jezu Krishtit, sidomos duke qartësuar përmbushjen e profecisë dhe Hyjnisë së Krishtit: Biri i Perëndisë dhe Perëndia Bir. Sigurohu që të gjes kohën për të treguar profecitë dhe përmbushjen e tyre dhe të theksosh se Jezusi është Biri i Perëndisë, njeriu i vetëm pa mëkat. Tërë të tjerët janë pasardhës të Adamit dhe prandaj janë mëkatarë. Vetëm Jezusi është i shenjtë dhe i pamëkat.

Hyrje

Izraelitët, që tani quhen judenj, kishin shumë kohë që prisnin Çlirimtarin që të vinte e t'i shpëtonte nga Satani, mëkati dhe ndëshkimi i përjetshëm. Perëndia nuk donte që atyre t'u shpëtonte ardhja e Tij, ndaj u dha atyre shumë profeci për t'i ndihmuar që ta identifikonin.

Figurat

Figura 41: Një engjëll i flet Jozefit



Figura 42: Jezusi lindi



Figura 43: Dijetarët



Figura 44: Udhëtimi për në Egjipt



Grafiku 27: Profecitë

Grafiku 24: Jezu Krishti është Perëndi

Grafiku 25: Adami, mëkatar

Grafiku 28: Perëndia, i Shenjtë

Perëndia dërgon Çlirimtarin

Historia

Gjoni dhe Karola ishin ulur në tavolinë me xhaxhi Piterin. Karola mbaroi së ngjëri zemër dhe pastaj i bëri një pyetje xhaxhit të saj.

“Xhaxhi Piter, një prej katër shoqeve tona në shkollë na pyeti se nga e dimë që ka vetëm një Perëndi të vërtetë. I thashë asaj që Bibla e thotë shumë e qartë, por më bëri të pyes veten se si e dinin njerëzit se kush ishte Çlirimtari i premtuar”.

“Edhe unë kam pyetur veten për këtë, xhaxhi Piter” - tha Xhoni. “Si e njohën?”.

“Këto janë pyetje me vend” - tha xhaxhi Piteri. “Perëndia donte që të gjithë të dinin se kush ishte Çlirimtari, ndaj Ai u tha profetëve të Tij të shkruanin saktësisht se si do të vinte Çlirimtari. Perëndia ua dha njerëzve këto profeci rreth Shpëtimtarit që do të vinte, qindra e ndonjëherë mijëra vjet para se të ndodhnin”.

“Mijëra vjet! - tha Karola e çuditur. “Kjo është e mahnitshme!”.

“Dhe ajo që është më e mahnitshme,” - tha xhaxhi Piteri, - “është se secila prej këtyre profecive ose është përmbushur ose do të përmbushet. Dhe gjithçka do të përmbushet ashtu siç ka thënë Perëndia”.

“Këtë e kam të vështirë që ta kuptoj” - tha Xhoni. “Çfarë gjërash shkruan ata për Çlirimtarin?”.

“Bibla i ka regjistruar këto profeci” - tha xhaxhi Piteri. “Disa profeci flasin për vendin se ku do të lindte, disa japin fakte për prindërit dhe paraardhësit e Tij, disa flasin për vendin se ku do të shpërnguleshin prindërit e Tij dhe për vendin se ku do të ktheheshin për të jetuar kur Jezusi të ishte duke u rritur”.

“Nga e dinin profetët se çfarë të shkruanin” - pyeti Karola.

“Kjo gjë e bën profecinë kaq të veçantë” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Ato janë fjalët e Perëndisë, të komunikuara në mendjen e profetit, i cili shkroi më pas mesazhet e sakta të Perëndisë”.

“Atëherë profetët po shkruanin saktësisht atë që u tha Perëndia të shkruanin,” - tha Xhoni, - “dhe prandaj u realizuan profecitë”.

“E drejtë, Xhon” - tha xhaxhi Piteri. “Perëndia u tha profetëve të shkruanin qindra profeci rreth Çlirimtarit që do të vinte”.

“Ua!” - tha Karola. “Këto janë shumë profeci, në mënyrë që të ishte e sigurt që judenjtë ta njihnin Çlirimtarin. Perëndia paska treguar kujdes të veçantë për ta!”.

“Po, ashtu është” - tha xhaxhi Piteri. “Por këto fjalë janë edhe për ne sot, që edhe ne të mund të dimë që Jezusi është Çlirimtari i premtuar”.

“A e kuptuan njerëzit se kush ishte Jezusi kur ai erdhi?” - pyeti Xhoni.

“Vetëm disa njerëz” - tha xhaxhi Piteri.

“A e kuptuan prindërit e tij se kush ishte ai?” - pyeti Karola.

“Perëndia ua tha përmes engjëllit të Tij,” - u përgjigj xhaxhi Piteri, - “por do të ketë qenë e vështirë edhe për ata për të kuptuar se kjo foshnjë ishte me të vërtetë Perëndi!”.

“Oh, xhaxhi Piter, kjo është e mahnitshme!” - tha Xhoni. “Nuk mund ta imagjinoj që Perëndia të vijë në tokë si foshnjë. Mendohem se si duhet të ketë qenë”.

“Shiko, Xhon” - tha xhaxhi Piteri. “Ka edhe më shumë gjëra të mahnitshme për të mësuar rreth Çlirimtarit, ndaj le të hapim Biblat dhe të shikojmë se çfarë thotë për Të”.

Le të shohim në Bibël



Mateu 1:23 – “Ja, virgjëresha do të mbetet shtatzënë dhe do të lindë një djalë, të cilit do t’i vënë emrin Emanuel, që do të thotë: ‘Zoti me ne’.”

Kjo do të thotë se fëmija, Jezusi, do të ishte vetë Perëndia, do të vinte në tokë për të lindur si fëmijë dhe do të jetonte me njerëzit këtu në botë.

Le të mendojmë

1. Kush shkroi saktësisht se si do të vinte Çlirimtari? **a. Profetët**; b. Perëndia; c. Jezusi.
2. Kush u tha profetëve saktësisht se çfarë të shkruanin?
a. Adami; b. Abrahami; **c. Perëndia**.
3. Kush ishte Çlirimtari? a. Gjoni; **b. Perëndia**; c. Moisiu.
4. Cili ishte emri i Çlirimtarit? a. Gjoni; b. Zakaria; **c. Jezusi**.
5. Sa prej profecive të Perëndisë rreth Çlirimtarit ishin përmbushur apo do të përmbusheshin? a. Shumica; **b. Të gjitha**; c. Disa.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Historia e lindjes së Jezu Krishtit, shpesh e quajtur “Historia e Krishtlindjes”, mund të jetë e njohur nga shumë njerëz rreth nesh. Skena e dashur e foshnjës së vogël në grazhd është gjithçka që dinë disa njerëz për këtë ndodhi.

Ne po paraqesim më tepër se thjesht një histori të një foshnjeje të ëmbël në një grazhd; ne po paraqesim gjithashtu ardhjen e ve të Zotit, Perëndisë së fuqishëm, Çlirimtarit të premtuar, Shpëtimtarit të mëkatarëve! Nuk është historia e foshnjës Jezus, por e personit Jezus dhe e asaj që Ai bëri për njerëzimin, duke u ofruar falje dhe jetë të përjetshme të gjithë atyre që besojnë.

Megjithatë sot ne do të mësojmë se si erdhi Çlirimtari në tokë.

1. Problemi i Jozefit - Mateu 1:18-19.

- Maria, e cila do të ishte nëna e Jezusit, i ishte premtuar për martesë një burri që quhej Jozef.
- Jozefi zbuloi që Maria ishte shtatzënë dhe ai e dinte që nuk ishte babai i foshnjës.
 - Sipas ligjit judaik, Jozefi mund të bënte një padi publike dhe Maria mund të ishte vrarë, se ishte shtatzënë me një fëmijë që nuk ishte i tij.
 - Por Jozefi e donte Marinë, kështu që vendosi të prishte fejesën në heshtje.

2. Engjëlli i Perëndisë ia shpjegoi të vërtetën Jozefit - Mateu 1:20-25.

- Perëndia donte që Jozefi të merrte Marinë si gruan e tij, në mënyrë që Çlirimtari të kishte një baba të mirë tokësor.
 - Jozefi ishte një njeri që i besonte Perëndisë, ndaj Ai dërgoi engjëllin e tij që t’i tregonte Jozefit të vërtetën rreth Marisë.
 - Maria nuk kishte shkuar me askënd.
 - Foshnja brenda saj i ishte dhënë nga Perëndia Frymë e Shenjtë.
 - Foshnja ishte Biri i Perëndisë që kishte zbritur nga Qielli për t’u bërë një qenie njerëzore, në mënyrë që të ishte Çlirimtari i mëkatarëve.
 - Profetët kishin thënë se Shpëtimtari i premtuar do të lindte nga një virgjëreshë.
 - Duke qenë se Jezusi do të ishte edhe Perëndi, edhe njeri, Ai do të kishte shumë emra.
 - Një prej emrave të Tij do të ishte Emanuel, që do të thotë “Perëndia me ne”.
 - Vetë Perëndia do të vinte në tokë si foshnjë!

→ Figura 41: Një engjëll i flet Jozefit

→ Trego grafikun 27: Profecitë.

Zbulo profecinë e dytë: “Lindur nga një virgjëreshë”. Lexo tekstin e profecisë, Isaia 7:14, në të majtë dhe përmbushjen e Shkrimit, Mateu 1:18-25, në të djathtë.

²⁸Shumë nga kultet nuk besojnë se Jezusi është Perëndia. Mos e lejo veten që të përfshihesh në një diskutim me një nga fëmijët e klubit. Thuaj vetëm që kjo është ajo që na mëson Bibla dhe që ne do ta kufizojmë diskutimin tani me atë që është shkruar në Fjalën e Perëndisë.

→ Figura 42: Jezusi lindi

→ Trego grafikun 27: Profecitë.

³⁰Zbulo profecinë e tretë: "Lindur në Bethlehem". Lexo tekstin e profecisë, Mikea 5:2, në të majtë, dhe Shkrimin e përbushjes së saj, Mateu 2:1, në të djathtë.

Mendo: A ishte e drejtë që dijetarët të adhuronin Jezusin? Perëndia kishte shkruar në Ligjin që ia dha Moisiut, që vetëm Perëndia duhet të adhurohej. Po, Jezusi është Perëndi, ndaj ishte e drejtë që ata ta adhuronin. Jezusi është edhe Perëndi, edhe njeri.


→ Figura 43: Dijetarët

→ Figura 44: Udhëtimi për në Egjipt

→ Trego grafikun 27: Profecitë.

Zbulo profecinë e katërt: "Udhëtimi për në Egjipt". Lexo tekstin e profecisë, Osea 11:1, në të majtë dhe tekstin e përbushjes së saj, Mateu 2:14, në të djathtë.

Përsëritje



Pyetje dhe përgjigje

1. Kush e vendosi foshnjën në barkun e Marisë? Perëndia Frymë e Shenjtë.
2. Kush ishte babai tokësor i Jezusit? **Jozefi**.
3. Ku lindi Jezusi? **Në Bethlehem**.
4. Pse nuk mëkatoi asnjëherë Jezusi? **a. Ai nuk ishte pasardhës i Adamit; b. Ai ishte Perëndi.**
5. Çfarë emrash kemi përdorur për Çlirimtarin në mësimin e sotëm? **a. Jezu Krisht; b. Emanuel; c. Perëndia Bir.**

- Jezu Krishti është Perëndia Bir - një prej tre personave të Trinisë²⁹.
- Perëndia Atë, Bir dhe Frymë e Shenjtë janë të përbërshëm.
- Jozefi i besoi Perëndisë dhe e mori Marinë në shtëpi si gruan e tij.

3. Jezusi lindi në Bethlehem - Mateu 2:1.

- Jezusi lindi në Bethlehem ashtu siç kishin thënë profetët e Perëndisë shumë vjet më parë.
- Perëndia i përbërshëm kishte ardhur në një trup njerëzor për të jetuar me njerëzit.
- Trego grafikun 24: Jezu Krishti është Perëndi.

4. Mbreti Herod dhe dijetarët - Mateu 2:2-15.

- Dijetarët erdhën në Jerusalem për të kërkuar atë që kishte lindur, "Mbretin e judenjve". Ata donin ta adhuronin³⁰.
- Herodi kishte frikë se do të humbiste pozitën e tij si mbret, kur kjo foshnjë të rritej.
 - Ai u shtir sikur donte ta adhuronte fëmijën, kështu që u kërkoi dijetarëve ta njoftonin, kur ta gjenin.
- Dijetarët ndoqën yllin që i drejtoi te vendi ku jetonte Jezusi. Ata e adhuruan.
- Perëndia e drejtoi Jozefin që ta çonte Jezusin në Egjipt, ku do të ishte i sigurt nga plani i keq i Herodit për ta shkatërruar. Perëndia e dinte se çfarë do të planifikonte Herodi.
 - As Herodi, as ndonjë fuqi tjetër në qiell apo në tokë nuk mund të ndalonte Perëndinë që të zbatonte planin e Tij për t'i shpëtuar njerëzit nga mëkatet e tyre.

5. Jozefi, Maria dhe Jezusi kthehen në Nazaret - Mateu 2:19-23.

- Kur Herodi vdiq, Zoti dërgoi një prej engjëjve të Tij që t'i thoshte Jozefit t'i nxirrte Marinë dhe Jezusin nga Egjipti dhe të ktheheshin në tokën e Izraelit.
 - Fjalët e Perëndisë dhënë përmes profetëve të Tij u përbushën - Çlirimtari jetoi në qytetin e Nazaretit.

6. Jezusi, një djalë në Nazaret - Luka 2:40.

- Jezusi u rrit dhe nga foshnjë u bë një djalë të fortë.
 - Ati, Perëndia e mbrojtë dhe drejtoi në gjithçka që mendonte, thoshte dhe bënte.
 - Ai iu bind çdo urdhri të Perëndisë.
 - Ai nuk mëkatoi kurrë. Ai nuk lindi si mëkatar.
 - Ai nuk ishte i ndarë nga Perëndia, si tërë pasardhësit e Adamit.
- Trego grafikun 25 dhe 28: "Adami, mëkatar" dhe "Perëndia, i Shenjtë".

7. Jezusi u bë burrë - Luka 2:52.

- Edhe pse Jezusi ishte Perëndi, Ai ishte edhe një qenie e vërtetë njerëzore. Ai u rrit në një trup njerëzor.
- Jezusi lindi në këtë botë si njeri, në trup njerëzor, në mënyrë që Ai të mund të ishte Çlirimtari, Shpëtimtari, për qeniet njerëzore!
- Jezusi u rrit e u bë i mençur. Perëndia ishte i kënaqur me Të dhe njerëzit e pëlqenin.
 - => Trego grafikun 27: Profecitë.
- Zbulo profecinë e pestë: "Disa nga karakteristikat e Tij". Lexo tekstin e profecisë, Isaia 11:2, në të majtë dhe Shkrimin e përbushjes së saj, Luka 2:52, në të djathtë.
- Karakteri i Jezusit si njeri ishte karakteri i Perëndisë:
 - Ai ishte pa mëkat dhe i shenjtë; Ai ishte plotësisht i drejtë.
 - Ai e mbante gjithmonë fjalën e Tij.
 - Ai ishte besnik në gjithçka që bënte.
 - Njohuria e Tij ishte e përsosur.
 - Ai ishte i mëshirshëm dhe plot hir, tërësisht i dashur dhe i mirë.

Profeti i Perëndisë, Isaia, tha se Çlirimtari do të ishte i mençur dhe do të kishte njohuri të madhe, sepse Ai do të ishte njësh me Perëndinë Frymë e Shenjtë. Kjo profeci, dhënë nga Perëndia, u realizua dhe u përbush në mënyrë të mrekullueshme në Jezu Krishtin. Perëndia i mban premtimet e Tij!

Mësimi 45

Qëllimi

Përmes shërbesës së Gjon Pagëzorit na tregohet nevoja për të pasur një qëndrim pendese. Drejtuesit judenj ishin shembuj tipik të njerëzve krenarë e jo të penduar.

Gjithashtu do të mësohet:

- Shpjegimin e pendimit: një ndryshim qëndrimi ndaj Perëndisë dhe ndaj mëkatit të personit.
- Shpjegim të pagëzimit të Gjonit: një pagëzim pendimi.
- Që Jezu Krishti është Biri i Perëndisë, siç është thënë nga vetë Perëndia.

Hyrje

Ndihmoji fëmijët të kuptojnë që njerëzit nuk mund të sajojnë me ndonjë mënyrë tjetër për t'u pranuar nga Perëndia veçse të besojnë në Perëndinë. Thuaju fëmijëve të mendojnë për mënyra të tjera përveç atyre që kemi përmendur në historinë e sotme, me anë të të cilave njerëzit mund të mendojnë se mund të pranohen nga Perëndia.

Figurat

- Figura 45: Gjon Pagëzori u thotë njerëzve që Jezusi është Qengji i Perëndisë



- Grafiku 29: Perëndia dhe njeriu: besimi i prindërve dhe kisha
- Grafiku 24: Jezu Krishti është Perëndi
- Grafiku 30: Skribët, farisenjtë dhe saducenjtë

Pagëzimi i Jezusit

Historia

Xhoni dhe Karola po prisnin xhaxhi Piterin në sallonin e tij, kur e panë që po vinte rrugës. Xhoni thirri:

“Xhaxhi Piter, ku ke qenë? Nuk menduam se kisha punë të shtunën”.

“Përshëndetje, Xhon e Karola” - tha xhaxhi Piter. “Keni të drejtë, nuk kisha punë të shtunën. Po punoja te kisha. Është pothuajse gati për të filluar takimet”.

“Ua, xhaxhi Piter!” - tha Karola. “Perëndia duhet të jetë vërtetë i kënaqur me ty! Ti kalon shumë kohë në kishë. Tani nuk duhet të merakosesh për Satanin, mëkatin dhe vdekjen. Ti tashmë po i pëlqen Perëndisë”.

“Po, Karola, jam i sigurt se Perëndia është i kënaqur me punën që po bëj në kishë,” - tha xhaxhi Piteri, - “por çfarë të shtyn të mendosh se nuk duhet të merakosesh për Satanin, mëkatin dhe vdekjen si gjithë të tjerët?”.

“Shiko,” - tha Karola - “shoqja ime më tha se e ëma e saj e ka thënë këtë gjë duke qenë se ato shkojnë në kishë çdo javë, Perëndia është i kënaqur me to dhe i ka pranuar”.

“Kjo nuk është e vërtetë, apo jo, xhaxhi Piter?” - pyeti Xhoni. “Sepse miku im më tha se ai nuk ka pse të shkojë në kishë tërë kohën, sepse prindërit e tij shkojnë në kishë dhe besojnë në Perëndinë e vërtetë. Ai tha se meqë ata besojnë, Perëndia do ta pranojë edhe atë”.

“Xhon dhe Karola,” - tha xhaxhi Piteri i trishtuar, - “dua që të mendoni për tërë ato gjëra që kemi mësuar nga Bibla. Çfarë mësuar për gjendjen e tërë njerëzimit?”.

“Të gjithë janë mëkatarë,” - u përgjigj Karola, - “duke përfshirë këtu edhe veten tonë”.

“Dhe paga për ato mëkate është vdekja” - shtoi Xhoni. “Dhe nuk ka asnjë mënyrë që ne të mund të pranohemi nga Perëndia me anë të diçkaje që mund të bëjmë vetë”.

“Si të shkuarit në kishë!” - e ndërpreu Karola.

“Hëm! E kisha harruar këtë” - tha Xhoni. “Atëherë, mendoj se edhe ne nuk mund të pranohemi ngaqë prindërit tanë besojnë te Perëndia”.

“Ke të drejtë” - tha xhaxhi Piteri. “Fillova të mendoj se ju kishit harruar disa gjëra të rëndësishme për të cilat kemi folur. Fatkeqësisht, ka njerëz sot që mendojnë si njerëzit në kohën kur lindi Jezusi. Kujtoni se si folëm për Gjonin, i cili i përgatiti njerëzit për ardhjen e Çlirimtarit? Shiko, ai pati një punë të vështirë me disa njerëz. Gjoni u tha atyre se edhe ata duhet të pendoheshin, ashtu siç ishte penduar ai. Por ata nuk mendonin se duhet të pendoheshin”.

“Harrova se çfarë do të thotë pendim” - tha Karola.

“Do të thotë të ndryshosh mënyrën e të menduarit rreth Perëndisë, vetes dhe mëkatit” - tha xhaxhi Piteri. “Drejtuesit fetarë judenj gjatë asaj kohe ishin shumë krenarë për veten e tyre. Ata mendonin se ishin aq të mirë sa t'i pëlqenin Perëndisë, sepse e njihnin shumë Fjalën e Perëndisë dhe kryenin shumë detyra fetare. Megjithatë, ata, si shumë njerëz sot, nuk besonin gjithçka që thoshte Perëndia në Fjalën e Tij: disa prej tyre madje kishin shtuar ligjet e tyre”.

“Perëndia nuk mund të kishte qenë i kënaqur për këtë!” - tha Karola.

“Jo, Karola, nuk ishte” - tha xhaxhi Piteri. “Do të mësojmë se çfarë mendon Perëndia për këta njerëz, ndërsa do të studiojmë pjesën e Dhiatës së Re në Biblat tona. Sot do të shohim atë që po mësonte Gjoni dhe se si e takoi Çlirimtarin për herë të parë!”.

Le të shohim në Bibël



Gjoni 1:29 – “Të nesërmen, Gjoni e pa Jezusin që po vinte drejt tij dhe tha: ‘Ja, Qengji i Perëndisë, që heq mëkatën e botës!’.”

Jezusi ishte Qengji që u dha dhe u dërgua nga Perëndia. Në një mësim të ardhshëm do të shohim se çfarë donte të thoshte Gjoni, kur e quajti Jezusin

Qengjin e Perëndisë.

Le të mendojmë

1. Kush ka mëkatuar? **a. Të gjithë;** b. Disa njerëz; c. Asnjë.
2. Si mund të pranohemi nga Perëndia? a. Duke shkuar në kishë; b. Duke pasur prindër që besojnë te Perëndia; **c. Duke besuar te Perëndia.**
3. Çfarë do të thotë të ndryshojmë mënyrën se si mendojmë rreth Perëndisë, vetes dhe mëkatit? **a. Të pendohemi;** b. Të na vijë keq; c. Të jemi krenarë.
4. Kush u tha njerëzve se duhet të pendoheshin? a. Çlirimtari; b. Drejtuesit fetarë; **c. Gjoni.**
5. Kush nuk duhet të pendohet, sepse është mjaft i mirë për t'i pëlqyer Perëndisë?
a. Drejtuesit fetarë; **b. Askush nuk është mjaft i mirë;** c. Gjoni.

Mësim nga Fjala e Perëndisë

Ky mësim e shpjegon pendimin si ndryshim qëndrimi apo mendimi ndaj Perëndisë, rreth vetes dhe mëkatit. Sot, shumica e njerëzve në kulturën tonë mendojnë vetëm për veten dhe harrojnë Perëndinë dhe atë që Ai thotë rreth mëkatit. Ky mësim duhet të bëjë lidhjen me shumë të vërteta të Dhiatës së Vjetër, që ata kanë dëgjuar rreth flijimit dhe Çlirimtarit që do të vinte.

1. Gjoni ishte lajmëtari i Perëndisë për Izraelin - Mateu 3:1-4.

- Gjoni ishte profeti i Perëndisë, por ishte i varfër. Ai thjesht hante gjërat që gjente në shkretëtirë dhe veshja e tij ishte si e një njeriu të varfër³¹.
- Ishte koha që Gjoni, i cili ishte zgjedhur nga Perëndia për të qenë profet dhe për t'i përgatitur judenjtë për të pranuar Çlirimtarin, të fillonte t'i mësonte njerëzit.
- Gjoni u mësoi njerëzve që ata duhet të pendoheshin.
 - Pendimi nuk i shpëton njerëzit. Gjoni e dinte se ata duhet të ndryshonin mënyrën e të menduarit të tyre rreth Perëndisë, rreth vetes dhe mëkatit.
 - Ata duhet të binin dakord me Perëndinë³²:
 - Që Ai ishte Perëndia i vetëm i vërtetë, Krijuesi.
 - Që ata kishin lindur në mëkat dhe vazhdonin të mëkatonin kundër Perëndisë duke mos iu bindur ligjeve të Tij dhe që ata vetë nuk ishin në gjendje që të bëheshin të pranueshëm prej Tij.
 - Që tërë mëkati është kundër Perëndisë dhe se Perëndia e urren mëkatën dhe do ta ndëshkojë gjithmonë, duke e ndarë mëkatarin nga vetja në zjarrin e përjetshëm.

2. Shumë njerëz i besuan mesazhit të Perëndisë përmes Gjoni - Mateu 3:5-6.

- Shumë nga judenjtë i besuan Fjalës së Perëndisë, të cilën Gjoni ua predikoi atyre, dhe shkuan tek ai për t'u pagëzuar.
 - Kur një person pagëzohet, kjo gjë është një shenjë për këdo, që ai person bie dakord me Perëndinë se meriton vdekjen për mëkatet e tij, por i beson Çlirimtarit për ta shpëtuar³³.

3. Fjalët e Gjoni ndaj krenarëve dhe të papenduarve - Mateu 3:7-9.

- Shumica e drejtuesve të tempullit ishin krenarë. Le t'i shikojmë këta drejtues dhe të marrim në konsideratë atë që na thotë Bibla rreth qëndrimit të tyre.

³¹Disa njerëz thonë se nëse vendos besimin te Perëndia, atëherë Ai do të të japë para dhe tërë gjërat që do. Por Perëndia nuk premtonte që një person do të bëhet i pasur nëse i beson Atij dhe i bindet Fjalës së Tij. Shumë nga profetët më të mëdhenj të Perëndisë dhe njerëz të tjerë që besuan ishin shumë të varfër. Më vonë do të shohësh se edhe Jezusi, Biri i Perëndisë, ishte shumë i varfër kur ishte këtu në tokë.

³²Këto janë të njëjtat gjëra të cilat Perëndia dëshiron që secili të kuptojë për vetveten dhe të bjerë dakord.

³³Pagëzimi nuk do të na bëjë të pranueshëm para Perëndisë. Pagëzimi nga jashtë nuk do të na pastrojë nga mëkatet tona para syve të Perëndisë. Pagëzimi nuk mund të paguajë për mëkatet tona. Paga për mëkatet është vdekja. Pagëzimi është thjesht një shenjë për t'u treguar të tjerëve që një person bie dakord me mesazhin e Perëndisë dhe se ai po i beson vetëm Perëndisë për ta shpëtuar.


=> Trego grafikun 30: Skribët, farisenjtë dhe saducenjtë.

³⁴Kur flasim për krenarinë tonë, ne flasim për një qëndrim që thotë: "Mendoj se mënyra ime është më e mira, pavarësisht se çfarë thotë Perëndia". Krenari do të thotë egoizëm dhe mburrje. Shumë njerëz mendojnë se kanë gjithmonë të drejtë. Edhe kur e dinë se e kanë gabim, nuk u pëlqen ta pranojnë. Ata duan që të gjithë të mendojnë se ata janë aq të mirë kur në fakt janë mëkatarë, si gjithë të tjerët. Nëse nuk jemi dakord me atë që thotë Perëndia në Fjalën e Tij ose mendojnë: "Kjo nuk vlen për mua", mbase jemi duke menduar ashtu sepse jemi krenarë!

³⁵Disa njerëz mendojnë se ata janë pranuar nga Perëndia, sepse prindërit e tyre besojnë te Perëndia. Disa mund të mendojnë se për shkak se kanë shkuar në kishë që të vegjëll dhe kanë marrë pjesë në tërë ceremonitë e kishës, Perëndia do t'i pranojë. Askush nuk pranohet nga Perëndia për shkak të prindërve apo duke shkuar në kishë. Perëndia gjykon këdo në mënyrë individuale. Çdo person duhet ta vendosë besimin e tij te Perëndia.

=> Trego figurën 29: Perëndia dhe njeriu: Besimi i prindërve dhe kisha.

- Skribët kopjonin dhe kujdeseshin për rrotullat, shkrimet e Moisiut dhe profetëve në tempull. Shumë skribë ishin krenarë, sepse ata e njihnin më tepër Fjalën e Perëndisë se të tjerët. Ata nuk e dinin se për Perëndinë ishte më e rëndësishme që ata t'i besonin Fjalës së Tij dhe t'i bindeshin.
- Farisenjtë ishin drejtues fetarë judaikë, të cilët kishin sajuar rregullat e tyre dhe i kishin bërë shtesa ligjit të Perëndisë. Ata nuk mendonin se ishin mëkatarë si njerëzit e tjerë. Ata ishin krenarë dhe mendonin se ishin aq të mirë sa të pranoheshin nga Perëndia për shkak të gjërave që po bënin.
- Edhe saducenjtë ishin drejtues fetarë. Megjithatë, ata nuk i besonin shumë nga gjërat që Perëndia kishte shkruar në Fjalën e Tij.
- Shumë nga këta drejtues fetarë refuzonin të pranonin se ishin mëkatarë - ata nuk do të pendoheshin dhe nuk binin dakord me Perëndinë.
- Duke qenë se farisenjtë dhe saducenjtë ishin aq krenarë, fjalët e Gjonit ndaj tyre ishin shumë të forta³⁴.
 - Perëndia i gjykon njerëzit që janë krenarë dhe që nuk bien dakord me Të, por Ai premton të ndihmojë dhe të çlirojë ata që bien dakord që janë mëkatarë dhe që pranojnë se vetëm Ai mund t'i ndihmojë.
 - Nëse do të kishin besuar me të vërtetë atë që tha Gjoni rreth tyre, veprimet e tyre do të kishin ndryshuar.
- Shumë judenj mendonin se Perëndia do t'i pranonte, sepse ishin pasardhës të Abrahamit.
- Gjoni u tha farisenjve dhe saducenjve të mos ishin krenarë apo të mos i zinin besë faktit se ishin bij të Abrahamit³⁵.



Përsëritje

J X C (P E R Ë N D I) A Y O Y O
 E C U C X U Z C U X Z C N C N
 Z Y S H Y (N J E R I U I) Z X R X R
 U Z Q X Y C Y X Z Z B X A X A
 S H (S H P Ë T I M T A R I) V Z V
 I U H L J K S F N B O X L X L
 Q E N G J I I P E R Ë N D I S Ë
 T O V O N Ë Y C Ë Y M C T C T
 P E R Ë N D I A B I R X K X K
 A V L K U O I C D O T C T C T

Pyetje dhe përgjigje

1. Çfarë është pendimi? Të ndryshosh mënyrën se si mendon rreth Perëndisë, rreth vetes dhe rreth mëkatit.
2. Kush duhet të pendohet? Tërë mëkatarët.
3. Ku e gjeti Jezusi fuqinë e Tij për të bërë punën e Perëndisë këtu në tokë? Nga Perëndia Frymë e Shenjtë.
4. Si e quajti Perëndia Jezusin? Birin e Tij.
5. Si e quajti Gjoni Jezusin kur e pa të vinte drejt Tij? Qengji i Perëndisë.

4. Gjoni pagëzoi Jezusin - Mateu 3:13-16.

- Edhe pse Jezusi erdhi të pagëzohej, nuk erdhi ngaqë ishte mëkatar dhe kishte nevojë të pendohet si gjithë të tjerët që u pagëzuan.
- Jezusi erdhi të pagëzohej për të treguar se mesazhi i Gjonit ishte i vërtetë.
- Jezusi ishte Perëndia Shumë i Lartë, por kur u bë njeri, Ai zgjodhi të varej nga Perëndia Frymë e Shenjë për të marrë fuqi për të bërë punën e Perëndisë këtu në tokë.

5. Çfarë tha Perëndia për Jezusin - Mateu 3:17.

- Perëndia Atë e quajti Jezusin Birin e Tij.
 - Jezusi ishte njeri, por ishte edhe Perëndia Bir që kishte zbritur nga qielli.
- Figura 24: Jezu Krishti është Perëndi
- Perëndia u kënaq tërësisht me Jezusin; Ai ishte tërësisht i shenjtë dhe i drejtë; i përsosur në sytë e Perëndisë.

6. Jezusi, Qengji i Perëndisë - Gjoni 1:29.

Kur Gjoni pa Jezusin, ai tha që Jezusi ishte Qengji që ishte dhënë dhe dërguar nga Perëndia. Gjoni nuk e dinte se kush do të ishte Çlirimtari, por kur pa shenjën nga Perëndia, ai ishte i sigurt se Jezusi ishte Biri i Perëndisë, Shpëtimtari i botës.

Mësimi 46

Qëllimi

Përmes historisë së tundimit të Jezusit nga Satani në shkretëtirë, ky mësim paraqet Jezusin si Birin e pamëkatë të Perëndisë që iu bind plotësisht Perëndisë dhe i bëri ballë Satanit. Gjithashtu paraqet Jezusin si Perëndia Bir që një ditë do të hedhë Satanin dhe demonët e tij në liqenin e zjarrit.

Fëmijët e tu do të mësojnë edhe që:

- Satani është gënjeshtar dhe mashtrues.
- Jezu Krishti është Perëndia; prandaj Jezusi është më i fortë sesa Satani.
- Jezu Krishti si njeri u përbal me tundimin e Satanit, por nuk u dorëzua.
- Është e rëndësishme të njohim Fjalën e Perëndisë.

Hyrje

Pyeti fëmijët nëse janë tunduar më parë për të bërë diçka të gabuar. Sigurohu që ata e kuptojnë se çfarë është tundimi. Tundim mund të nënkuptojë që dikush ka dëshirat e veta për të bërë diçka të gabuar apo të ndaluar, ose mund të jetë dikush tjetër që përpiqet të shtyjë një person të bëjë diçka të gabuar apo të ndaluar. Sot do të shohim se si u tundua edhe Jezusi, si njeri.

Figurat

- Figura 46: Jezusi në shkretëtirë



- Grafiku 24: Jezu Krishti është Perëndi
- Grafiku 31: Fuqia e Perëndisë mbi Satanin

Jezusi qortoi Satanin

Historia

Xhoni dhe Karola po diskutonin, kur xhaxhi Piteri eci drejt tyre.

“Oh, xhaxhi Piter,” - tha Karola e gëzuar, - “mbase mund të na ndihmosh të zgjidhim këtë argument. Xhoni dëgjoji disa nga miqtë e tij që po tregonin një histori ku forcat e këqija po luftonin kundër forcave të mira. Ai mendon se këto histori mund të jenë të vërteta; por unë mendoj se nuk ka forca të tilla! Xhaxhi Piter, çfarë mendon?”

“Karola ka të drejtë, Xhon” - tha xhaxhi Piteri. “Këto histori janë gënjeshtër. Por ka një armik të vërtetë dhe ne duhet të dimë të vërtetën rreth tij”.

“Mos do të thuash Satani, apo jo, xhaxhi Piter?” - pyeti Xhoni. “Por këto histori nuk janë për Satanin; ata thjesht janë të interesuar për histori rreth forcave të mira dhe të këqija”.

“Po, unë po flas për Satanin” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Satani dëshiron që të mendojmë se e keqja mund të fitojë ndaj të mirës. Ai dëshiron të mendojmë se është qejf t'i dëgjojmë dhe të veprojmë sipas asaj që thuhet në këto lloj historish”.

“Kujtoj kur studiuam më parë për Satanin” - tha Karola. “Ai ishte një prej engjëjve të krijuar nga Perëndia, por u rebelua kundër Perëndisë”.

“Dhe humbi vendin e tij të shërbimit në qiell” - shtoi Xhoni. “Dhe një ditë Perëndia do të hedhë atë dhe ndjekësit e tij në liqenin e zjarrit”.

“Ju të dy mbani mend shumë gjëra” - tha xhaxhi Piteri. “Është e rëndësishme të dimë rreth këtij armiku të tmerrshëm të Perëndisë dhe njeriut, dhe Bibla është libri që na jep të vërtetën, jo këto histori të sajura”.

“Çfarë bëri Satani kur erdhi Jezusi në tokë” - pyeti Karola.

“Satani u përpoq të bënte të njëjtën gjë që bëri me Adamin dhe Evën në kopsht,” - u përgjigj xhaxhi Piteri; Ai u përpoq të shtynte Jezusin të mëkatonte”.

“A iu afrua Jezusit si gjarpër?” - pyeti Xhoni.

“Jo,” - u përgjigj xhaxhi Piteri, - “nuk kishte se si të fshihej Satani para Jezusit. Jezusi di gjithçka!”

“Atëherë çfarë ndodhi?” - pyeti Xhoni. “Bibla na thotë që Perëndia Frymë e Shenjtë e çoi Jezusin në shkretëtirë për t'u tunduar nga Satani,” - u përgjigj xhaxhi Piteri, - “dhe kur ishte atje Jezusi kaloi dyzet ditë pa ngrënë”.

“Dyzet ditë! Kjo është një kohë e gjatë pa ushqim!” - thirri Karola.

“Po, është” - tha xhaxhi Piteri. “Por duke iu bindur Atit të Tij, Jezusi u tundua në të njëjtën mënyrë se si tundohen njerëzit e zakonshëm. Pas dyzet ditëve pa ushqim, Jezusi ishte i uritur dhe i lodhur. Duke u bërë njeri, Jezusi i la privilegjet që kishte në qiell dhe përjetoi dobësinë dhe nevojën, ashtu si ne”.

“Nuk më ka shkuar kurrë mendja për këtë!” - tha Karola. “Pse e bëri këtë?”

“Shiko, duke qenë se Ai kaloi përmes gjithë vështirësive që kalojmë edhe ne, ne e dimë që Ai na kupton” - tha xhaxhi Piteri. “Dhe Ai hoqi gjithçka që heqim edhe ne, por duke iu bindur tërësisht Perëndisë. Satani madje u përpoq ta shtynte Jezusin të bënte mrekulli dhe t'i kthente në bukë gurët në shkretëtirë”.

“Jezusi mund ta kishte bërë këtë po të donte!” - tha Karola. “Ai është Perëndi!”

“Ke të drejtë, Karola!” - tha xhaxhi Piteri. “Por refuzoi, sepse Perëndia nuk i tha kurrë që ta bënte. Jezusi bëri vetëm atë që i pëlqente Perëndisë. Jezusi bëri diçka që asnjë njeri tjetër nuk ka qenë në gjendje ta bëjë. Ai i bëri ballë tërësisht Satanit dhe iu bind plotësisht Perëndisë. Jezusi është më i madh se Satani në çdo mënyrë. Edhe si njeri shumë i uritur dhe i lodhur, Jezusi e mundi Satanin. Dhe kur shikojmë në Biblat tona, do të vërejmë që Ai e bëri duke përdorur Fjalën e Perëndisë për ta mposhtur atë”.

Le të shohim në Bibël

Mateu 4:4 - «Por ai, duke iu përgjigjur, tha: “Është shkruar: ‘Njeriu nuk rron vetëm me bukë, por me çdo fjalë që del nga goja e Perëndisë’”»

Ndihmoji fëmijët të kuptojnë që ushqimi nuk është gjëja e vetme e rëndësishme në jetët tona. Ne kemi nevojë për Fjalën e Perëndisë për të na treguar të vërtetën dhe rrugën për në jetën e përjetshme.

Le të mendojmë

1. Cili engjëll u rebelua kundër Perëndisë? a. Jezusi; **b. Satani**; c. Adami.
2. Kush i ysht dhe mashtron njerëzit? a. Perëndia; b. Jezusi; **c. Satani**.
3. Kush dëshiron t'i pëlqejë vetëm Perëndisë? a. Satani; **b. Jezusi**; c. Eva.
4. Kush nuk ka mëkatuar asnjëherë? **a. Jezusi**; b. Adami; c. Satani.
5. Si e mundi Jezusi Satanin kur ky e tundoi? a. U ndesh me të; b. E hodhi në liqenin e zjarrit; **c. Përdori Fjalën e Perëndisë kundër tij**.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Ne duam që fëmijët e klubit tonë të dinë se Satani është një armik i vërtetë që i mban robër burrat, gratë dhe fëmijët. Ai është gënjeshtar dhe mashtrues që i shtrembëron fjalët e Perëndisë. Gjithashtu, ne duam që fëmijët e klubit të mësojnë se Jezusi është i vetmi që mund t'i çlirojë njerëzit nga fuqia e Satanit. Ne duam që ata të shikojmë se Jezusi mposhti armikun duke përdorur në mënyrë të saktë Fjalën e Perëndisë!

1. Satani tundoi Jezusin - Mateu 4:1.

- Perëndia e krijoi Luciferin (tani njihet si Satan) të përsosur.
 - Por Satani bëri një zgjedhje për t'u rebeluar kundër Perëndisë që në fillim.
 - Qysh atëherë Satani, i quajtur edhe djall, ka qenë vazhdimisht i keq.
- Satani e tundoi Adamin për t'u rebeluar kundër Perëndisë.
 - Satani donte që të kishte Jezusin nën kontrollin e tij. Nëse Jezusi mëkatonte, Ai nuk do të ishte në gjendje të ishte Çlirimtari ynë.

2. Tundimi i parë - Mateu 4:2-4.

- Edhe pse Jezusi është Perëndi, Ai ishte edhe njeri i vërtetë.
 - Atë e mori uria ashtu si ne.
- Satani po përpiqej të shtynte Jezusin të vërtetonte se ishte Biri i Perëndisë.
 - Satani i kërkoi Jezusit të bënte diçka që Perëndia Atë nuk i kishte thënë të bënte.
 - Jezusi zbriti në tokë nga qielli për të bërë vetëm atë që donte Ati i Tij.
- Jezusi ishte Biri i Perëndisë; Ai mund të kishte kthyer gurët në bukë, por Jezusi nuk do t'i bindej Satanit.
- Jezusi iu përgjigj Satanit duke cituar Biblën, Fjalën e Perëndisë.
 - Ne na duhet ushqimi për të jetuar, por Perëndia thotë se ka diçka më të rëndësishme sesa ushqimi³⁶.

3. Tundimi i dytë - Mateu 4:5-7.

- Satani po citonte pjesë nga Psalmi 91.
 - Satani i njeht fjalët e Perëndisë në Bibël, por i përdor ato në mënyrë të gabuar.
 - Satani nuk po e citonte Fjalën e Perëndisë në mënyrë të saktë: kjo është mënyra që përdor Satani për të mashtruar njerëzit.
 - Ai mashtroi Evën në kopshtin e Edenit: tani po e provonte me Jezusin.

Ezekieli 28:15; Isaia 14:12-14; Gjoni 8:44

→ Trego grafikun 24: Jezu Krishti është Perëndi.

→ Figura 46: Jezusi në shkretëtirë

Gjoni 8:28-29; Hebrejve 10:7

³⁶Ne do të vdisnim pa ushqim, por çfarë dobie ka nëse kemi trupa të shëndetshëm dhe vdesim pa Perëndinë dhe vuajmë ndëshkimin e përjetshëm? Ne duhet të dëgjojmë dhe besojmë Fjalën e Perëndisë, në mënyrë që të jemi në gjendje të jetojmë përherë me Perëndinë.



Lexo: Gjoni 8:44.

³⁷Përgjatë viteve Perëndia ka treguar veten se është besnik. Edhe ne mund t'i besojmë Atij tërësisht. Ne duhet të varem nga Zoti për të bërë gjithçka që ka shkruar në Bibël.

³⁸Në fillim Satani u përpoq të merrte pozitën e Perëndisë si sovran i tërë gjithësisë. Satani dështoi, por shumë engjëj e ndoqën. Pastaj Satani mori kontrollin e racës njerëzore, në mënyrë që ata ta adhuronin dhe t'i shërbenin. Satani e dinte se Jezusi ishte Biri i Perëndisë, ndaj Satani u përpoq të zinte vendin e Perëndisë duke i kërkuar Jezusit ta adhuronte.

³⁹Mund të kesh dëgjuar histori që flasin për betejën midis të ashtuquajturave "forca" të së mirës e të së keqes. Shpesh për këtë betejë thuhet sikur të ketë dy forca të barabarta që ndeshen me njëra-tjetrën. Megjithatë Perëndia nuk është "forcë"; Ai është frymë. Fjala e Perëndisë na thotë se Perëndia është më i larti; Ai është Krijuesi. Meqë Jezusi është Perëndia Bir, Ai është zotëruesi më i lartë dhe Krijuesi i çdo gjëje. Kur erdhi në tokë, Ai ishte Perëndia në trup njerëzor. Perëndia është më i madh sesa Satani në çdo drejtim!

→ Grafiku 31: Fuqia e Perëndisë ndaj Satanit

Përsëritje

Shiko vargun përmendsh:

Është shkruar: *Njeriu nuk rron vetëm me bukë, por me çdo fjalë që del nga goja e Perëndisë.* (Mateu 4:4)

Pyetje dhe përgjigje

- Pse e tundoi Satani Jezusin?
 - Ngaqë Satani donte që Jezusi të mëkatonte, në mënyrë që Jezusi të mos ishte në gjendje të na çlironte;
 - Ngaqë Satani donte që Jezusi të ishte nën kontrollin e tij;
 - Ngaqë Satani dëshiron të marrë pozitën e Perëndisë.
- Kush e mashtrroi Evën? **Satani.**
- Si iu përgjigj Jezusi tundimeve të Satanit? **Ai citoi Fjalën e Perëndisë, Biblën.**
- Kujt iu bind Jezusi? **Perëndisë, Atit të Tij.**
- Kush është i vetmi që i është bindur tërësisht Perëndisë dhe i bëri ballë djallit? **Jezusi.**


- Satani është gënjeshtar dhe mashtrues.
- Satani i tha Jezusit të hidhej nga tempulli për të vënë në provë Perëndinë që kishte premtuar se do të kujdesej për Birin e Tij.
 - Jezusi nuk kishte pse të tundonte Atin e Tij për të parë nëse Ai do të kujdesej për të. Ai i besoi Perëndisë për të mbajtur Fjalën e Tij³⁷.
 - Përsëri, Jezusi iu përgjigj tundimit të Satanit duke cituar Biblën.

4. Tundimi i tretë - Mateu 4:8-10.

- Satani mund t'i ofronte Jezusit të kishte kontroll mbi këtë botë, sepse, kur Adami u rebelua kundër Perëndisë dhe ndoqi Satanin, ky u bë perëndia i kësaj bote.
 - Satani kishte fituar ndikim mbi mendjet e njerëzve të botës, kështu që mund t'i drejtonte të bënin gjërat e këqija që kishte planifikuar.
- Satani u përpoq të shtynte Jezusin që ta adhuronte³⁸.
 - Satani ende dëshiron të marrë pozitën e Perëndisë si sunduesi më i lartë.
- Jezusi mposhti Satanin duke i thënë atij atë që thotë me të vërtetë Perëndia në Bibël. Jezusi nuk i ndryshoi fjalët e Perëndisë siç bëri Satani.
 - Jezusi nuk iu bind Satanit siç bëri Adami në kopshtin e Edenit.
 - Jezusi e njihte, e donte dhe i bindej Perëndisë, Atit të Tij.

5. Jezusi është Perëndia.

- Jezusi, Perëndia Krijues është shumë më i madh se Satani, një qenie e krijuar³⁹.
 - Në fillim Ai krijoi Satanin si Lucifer, një engjëll të rëndësishëm dhe të bukur që do t'i shërbente Perëndisë.
 - Jezusi do ta hedhë një ditë Satanin në liqenin e zjarrit, që Perëndia e përgatiti për të dhe ndjekësit e tij.
- Beteja midis të mirës dhe të keqes nuk është e barabartë.
 - Në këtë trup fizik, Jezusi vuajti, ashtu si ne, por Ai nuk mëkatoi kurrë. Satani nuk mund të bënte që Jezusi të mëkatonte. Satani është i fortë, por nuk mund të fitonte asnjëherë kundër Perëndisë Shumë të lartë.



6. Satani e la Jezusin për një kohë të shkurtër - Mateu 4:11.

- Satani e dinte se ishte i mundur, kështu që e la Jezusin për pak kohë.
 - Ai e tundoi Jezusin me çdo tundim që janë ndeshur ndonjëherë njerëzit (Hebrenjve 4:15).
 - Por Jezusi nuk bëri asgjë nga ato që tha Satani; Ai gjithmonë bëri atë që i pëlqente Perëndisë, Atit të Tij (Gjoni 8:29).
- Perëndia dërgoi engjëjt për t'u kujdesur për Jezusin, pasi Satani e kishte lënë. Jezusi është i vetmi që i është bindur plotësisht Perëndisë dhe i bëri ballë Djallit. Ai është i vetmi që mund të na çlirojë nga mëkati, Satani dhe vdekja.

Mësimi 47

Qëllimi

Ky mësim paraqet Jezu Krishtin si Perëndia që erdhi në tokë:

- me autoritet për të folur dhe interpretuar Fjalën e Perëndisë.
- me fuqinë për të çliruar njerëzimin nga Satani, mëkati dhe vdekja.
- për të shëruar me dashuri dhe dhembshuri.

Hyrje

Kujtoju fëmijëve që drejtuesit fetarë gjatë kësaj kohe kishin sajuar shumë rregulla. Satani kishte errësuar mendjet e këtyre drejtuesve. Judenjët po vuanin nën drejtimin e tyre. Shumica e njerëzve kishin harruar apo nuk kishin dëgjuar kurrë për Çlirimtarin e premtuar që do të dërgonte Perëndia. Kjo është arsyeja se përse mësimi i Jezusit ishte ngazëllyes për njerëzit.

Figurat

- Figura 47: Jezusi mëson në sinagogë



- Marku 6:14-29

Jezusi fillon punën e Tij

Historia

Xhoni dhe Karola po shikonin figurat në Biblën e xhaxhi Piterit.

“Xhaxhi Piter,” - tha Xhoni – “e kam të vështirë ta kuptoj se si Jezusi mund të jetë Perëndi dhe njeri i vërtetë. Jezusi duket shumë i fuqishëm për të qenë njeri, por Bibla thotë se Ai u lodh dhe kishte uri njësoj si njerëzit”.

“Por kështu ka qenë: Perëndi i vërtetë dhe njeri i vërtetë” - tha xhaxhi Piteri.

“Sigurisht që do të doja të mund të kisha qenë atje e ta shikoja vetë Atë!” - tha Karola.

“Edhe unë, Karola” - tha xhaxhi Piteri. “Shumë njerëz erdhën nga çdo vend për ta dëgjuar tek jepte mësim. Ai i çuditi, sepse mësoi qartë dhe me autoritet Fjalën e Perëndisë. Fatkeqësisht, mësuesit fetarë të judenjve nuk po mësonin në mënyrë të qartë Fjalën e Perëndisë, ndaj mesazhet e Jezusit ishin gjë e re për njerëzit”.

“Mendoj se të gjithë e pëlqenin” - tha Xhoni.

“Po” - tha xhaxhi Piteri. “Jezusi ishte shumë popullor me njerëzit. Dhe Ai i çuditi, sepse kishte fuqinë të dëbonte demonët. Lajmi përhapej shpejt dhe njerëzit flisnin për Jezusin”.

“Çfarë janë demonët, xhaxhi Piter?” - pyeti Karola.

“Demonët janë frymëra që u rebeluan bashkë me Satanin kundër Perëndisë” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Demonët ndjekin Satanin. Ata e urrejnë Perëndinë dhe u pëlqen të jetojnë tek ata që nuk besojnë te Perëndia, dhe t'i kontrollojnë”.

“Si i dëboi?” - pyeti Xhoni.

“Ai thjesht foli,” - u përgjigj xhaxhi Piteri, - “dhe ata u larguan nga personi që torturonin. Jezusi është më i fortë sesa Satani dhe të gjithë demonët e tij. Demonët duhej t'i besonin Jezusit”.

“Jezusi është me të vërtetë i fuqishëm!” - tha Karola. “Nuk ka asnjë si Jezusi!”.

“Ke të drejtë, Karola” - tha xhaxhi Piteri. “Shumë njerëz menduan njësoj, kështu që e ndoqën. Jezusi po predikonte lajmin e mirë kudo ku shkonte”.

“Çfarë lajmi të mirë?” - pyeti Xhoni.

“Lajmin e mirë që mbretëria e Perëndisë ishte afër” - tha xhaxhi Piteri. “Jezusi ishte vetë Perëndia. Ai kishte ardhur t'i çlironte njerëzit nga Satani, mëkati dhe vdekja”.

“Mund të imagjinoj që njerëzit ishin të gëzuar për këtë!” - tha Karola.

“Ata nuk e kuptuan plotësisht se kush ishte,” - tha xhaxhi Piteri, - “por panë mrekullitë që bëri”.

“Ç’lloj mrekullish bëri Jezusi?” - pyeti Xhoni.

“Ai shëroi shumë njerëz” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Ai madje shëroi një njeri që ishte i sëmurë nga lebra”.

“Çfarë është lebra?” - pyeti Karola.

“Lebra është një sëmundje që vret nervat dhe mund të shkaktojë që një person të humbasë dorën, këmbën apo madje hundën” - tha xhaxhi Piteri. Askush nuk donte të prekte apo t'i afrohej një lebrozi”.

“Kjo duket e tmerrshme!” - tha Xhoni. “Si e shëroi Jezusi?”.

“Është në Bibël,” - tha xhaxhi Piteri, - “kështu le të shohim se çfarë është shkruar rreth këtyre mrekullive që kreu Jezusi”.

Kujto: Pse u pranua Abeli nga Perëndia? Ngaqë Abeli nuk ishte mëkatar? Jo, ngaqë Abeli i besoi Fjalës së Perëndisë dhe i besoi Atij. Kur Zoti Perëndia i tha Noeut të ndërtonte arkën sepse Ai do të shkatërronte tokën, Noeu i besoi Perëndisë dhe Zoti e shpëtoi atë dhe familjen e tij. Perëndia i tha Abrahamit të largohej nga vendi i tij dhe të shkonte në një vend që Zoti premtoi t'ia tregonte. Abrahami besoi te Zoti dhe Zoti e çoi në tokën e Kanaanit. Moisiu i besoi Zotit dhe u tha izraelitëve që të vendosnin gjakun në shtalkat e shtëpive të tyre. Zoti i mbrojti ata nga Engjëlli i Vdekjes. Jozueu dhe Kalebi besuan se Perëndia do t'ua jepte tokën, edhe pse kishte gjigantë në tokë. Ata ishin të vetmit nga ai brez i izraelitëve që u futën në tokën e premtuar. Nëse duam që Perëndia të na pranojë, ne duhet t'i besojmë Atij dhe të besojmë atë që na ka thënë në Bibël.

Le të shohim në Bibël



Gjoni 1:17 – “Sepse Ligji u dha nëpërmjet Moisiut, por hiri dhe e vërteta erdhën nëpërmjet Jezu Krishtit.”

Kujtoji fëmijët e klubit tënd që ligji kërkon bindje të përsosur, por hiri është mirësia e Perëndisë ndaj mëkatarëve që nuk e meritojnë.

Le të mendojmë

1. Kush ishte me të vërtetë Perëndi dhe njeri?
a. Jezusi; b. Satani; c. Demonët.
2. Cilat janë frymërat që u rebeluan bashkë me Satanin kundër Perëndisë?
a. Perëndia; b. Jezusi; c. **Demonët.**
3. Brenda kujt duan të jetojnë dhe të kontrollojnë demonët?
a. Jezusit; b. Njerëzve që besojnë te Perëndia; c. **Njerëzve që nuk besojnë te Perëndia.**
4. Kujt duhet t'i binden demonët, edhe pse nuk duan?
a. Njerëzve; b. **Jezusit**; c. Satanit.
5. Kush mund të kryejë mrekulli që nuk mund t'i bëjë askush?
a. Demonët; b. Satani; c. **Jezusi.**

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Ndërsa Jezusi ishte në shkretëtirë, Gjon Pagëzori vazhdoi të mësonte mesazhin e Perëndisë për t'i përgatitur njerëzit që të besonin te Jezusi, Çlirimtari. Disa njerëz ndryshuan mënyrën se si mendonin rreth vetes dhe mëkatit. Të tjerët, si farisenjtë, besonin tek vetja dhe mendonin se ata ishin të mirë para Perëndisë. Mbreti Herod, i cili po bënte një jetë shumë mëkatarë, nuk i pëlqente disa nga gjërat që thoshte Gjoni, ndaj e futi Gjonin në burg dhe më vonë e vrau. Para se të vritej, Gjoni e kishte mbaruar punën e tij për të përgatitur rrugën për Zotin Jezus.

1. Mesazhi i Jezusit - Marku 1:14-15.

- Kur Jezusi ishte tridhjetë vjeç, filloi të mësonte njerëzit:
 - Për të ndryshuar qëndrimin e tyre.
 - Për të rënë dakord me Perëndinë: që ishin mëkatarë të pashpresë.
 - Për t'i besuar ungjillit (“lajmit të mirë”) që Ai kishte ardhur t'u tregonte.
 - Pushteti i Perëndisë (Mbretëria e Perëndisë) në tokë do të fillonte së shpejti.
 - Satani ishte bërë sundimtari i kësaj bote, kur Adami nuk iu bind Perëndisë dhe ndoqi Satanin.
 - Të gjithë ne, kur lindim në këtë botë, lindim nën kontrollin e Satanit (në mbretërinë e Satanit) (2 Mbretërve 4:4; Efesianëve 2:2).
 - Duke qenë se Perëndia është i dashur, i mëshirshëm dhe plot hir ndaj mëkatarëve, Ai dërgoi Jezusin, Shpëtimtarin në botë për të mposhtur Satanin.
- Lajmi i mirë i Perëndisë ndaj secilit prej nesh është: duke besuar te Perëndia **dhe te Shpëtimtari, ne mund t'i shpëtojmë kontrollit të Satanit dhe hyjmë në miqësi me Perëndinë.**
 - Nëse nuk i besojmë Perëndisë, ne nuk mund t'i pëlqejmë Atij dhe ne nuk do të pranohemi nga Ai. Hebrejve 11:6 thotë se “pa besim është e pamundur t'i pëlqesh Atij”⁴⁰.

2. Jezusi thirri burra për ta ndihmuar në veprën e Tij - Marku 1:16-20.

- Jezusi filloi të thërriste njerëz për ta ndjekur.
 - Ai do t'i mësonte ata.
 - Ai do t'i dërgonte ata që t'u tregonin të tjerëve për mesazhin e lajmit të mirë të Perëndisë.
 - Kur Jezusi u tha atyre se do t'i bënte peshkatarë njerëzish, Ai po thoshte që do t'i mësonte ata se si t'i afronin njerëzit te Perëndia, duke u treguar atyre lajmin e mirë!

→ Figura 47: Jezusi duke mësuar në sinagogë

⁴¹A i kujton skribët që kopionin Shkrimet e Dhiatës së Vjetër? Ata ishin edhe mësues të Fjalës së Perëndisë. Por shumica prej tyre nuk kishte besim te Perëndia dhe nuk i besonte Fjalës së Tij. Ata ishin krenarë, duke besuar në veprat e tyre të mira dhe te njohuria që kishin për Fjalën e Perëndisë për t'u shpëtuar. Prandaj ata nuk e njihnin me të vërtetë Perëndinë; ata nuk e kuptonin qartë Fjalën e Tij, kështu që ata mund t'u thoshin njerëzve vetëm atë që mendonin se nënkuptonte Fjala e Perëndisë.

Luka 10:24-26



Lexo: Zbulesa 20:10.

Dhembshuria është interesimi me gjithë zemër për problemet e tjetrit dhe një dëshirë për të ndihmuar.

Përsëritje

Përko këta njerëz me përshkrimin e tyre më poshtë:
1. Jezusi; 2. Gjon Pagëzori; 3. Satani.

1. Ai shëroi të sëmurët.

1. Ai mësoi Fjalën e Perëndisë në mënyrë të qartë.

2. Ai i përgatiti njerëzit për të besuar te Çlirimtari që do të vinte.

1. U dërgua për të mposhtur Satanin.

3. Tërë njerëzimi ka lindur në mbretërinë e tij.

1. Shpëtimtari.

1. Ai dëboi demonët.

2. Atë e futën në burg dhe u vra për shkak të asaj që mësoi.

Pyetje e përgjigje

1. Si quhej mesazhi që mësoi Jezusi? **Ungjill apo lajm i mirë.**

2. Çfarë përbante ky ungjill apo lajm i mirë? **Duke besuar te Perëndia dhe duke besuar te Shpëtimtari, ne mund t'i shpëtojmë kontrollit të Satanit dhe të krijojmë miqësi me Perëndinë.**

3. Pse u kërkoi Jezusi njerëzve që ta ndihmonin? **Ai donte t'i mësonte ata, në mënyrë që t'i dërgonte t'u tregonin të tjerëve lajmin e mirë.**

4. Pse mësoi Jezusi ndryshe nga skribët? **Sepse Jezusi është Perëndi; Ai e njihje Atin e Tij. Ai kuptoi në mënyrë të qartë Fjalën e Perëndisë. Skribët mësonin atë që mendonin se nënkuptonte Shkrimi.**

5. Pse i dëbonte Jezusi demonët dhe shëronte të sëmurët? **Sepse kishte dhembshuri dhe dashuri për ta.**

3. Jezusi mësoi me autoritet - Marku 1:21-22.

- Judenjtë takoheshin nëpër shtëpi, të cilat quheshin sinagoga, në qytete anembanë Izraelit dhe madje në vendet përreth.
 - Në sinagoga lexoheshin dhe u mësoheshin njerëzve shkrimet e Moisiut dhe profetëve.
 - Judenjtë që jetonin jashtë Jerusalemit shkonin në tempull atje vetëm për festat e rëndësishme, ashtu siç kishte udhëzuar Perëndia përmes Moisiut.
- Njerëzit që e dëgjuan Jezusin të fliste ishin të çuditur nga autoriteti që tregoi Ai në shpjegimin e domethënies së Fjalës së Perëndisë.
 - Jezusi mësonte shumë ndryshe nga mënyra se si mësonin skribët⁴¹.
 - Jezusi është Perëndia; Ai e njihje Atin e Tij dhe mësonte në mënyrë të qartë Fjalën e Perëndisë.
 - Ai u tha njerëzve saktësisht atë që Perëndia po u thoshte atyre përmes shkrimeve të Moisiut dhe profetëve.

4. Jezusi dëboi frymërat e liga - Marku 1:23-28.

- Frymërat e papastra (apo të liga), të quajtur demonë, janë engjëj që kohë më parë u rebeluan kundër Perëndisë dhe ndoqën Satanin.
 - Atyre u pëlqen të kontrollojnë dhe të jetojnë te njerëzit që nuk i besojnë Perëndisë.
 - Satani dhe demonët e dinë se Jezusi është Perëndia i shenjtë, Krijuesi i tyre.
 - Demonët e dinë se një ditë do të hidhen në liqenin e zjarrit.
- Jezusi urdhëroi demonin të heshte dhe e dëboi.
 - Jezusi nuk donte që të ishin demonët ata që t'u tregonin njerëzve për Të.
 - Vetë Jezusi do t'u tregonte njerëzve të vërtetën e Perëndisë dhe do t'u tregonte atyre fuqinë e Tij me anë të mrekullive që bëri.
- Njerëzit po shikonin sërish që Jezusi kishte fuqi dhe autoritet të madh.

5. Jezusi shëroi shumë të sëmurë dhe dëboi demonë - Marku 1:29-34.

- Jezusi është Perëndia; tërë gjërat janë nën pushtetin e Tij.
- Jezusi ndjeu dashuri dhe dhembshuri⁴² për këta njerëz të sëmurë dhe të pushtuar nga demonët.
- Jezusi e dinte se tërë këto gjëra të trishtuara janë në botë për shkak të mëkatit të njeriut dhe sundimit të Satanit.

6. Jezusi shëroi një lebroz - Marku 1:40-42.

- Ky njeri e dinte se nuk mund ta shëronte veten nga kjo sëmundje e tmerrshme lëkure. Ai e dinte, gjithashtu, se asnjë prej njerëzve nuk mund ta ndihmonte të shërohej.
- Megjithatë ai që kishte lebrë besoi se Jezusi mund ta ndihmonte, edhe pse askush tjetër nuk mundej. Ai shkoi te Jezusi duke i kërkuar mëshirë dhe ndihmë.
- Lebrozët ishin të dëbuar nga shoqëria në atë kohë dhe askush nuk u afrohej.
 - Megjithatë, Jezusi e preku këtë njeri dhe e shëroi, sepse e donte.

Njerëzit janë të ngjashëm me këtë lebroz.

- Për shkak të mëkateve tona, ne jemi “të papastër” në sytë e Perëndisë.
- Nuk ka asgjë që mund të bëjmë vetë për të hequr fajin dhe ndëshkimin e mëkatit.
- Askush tjetër nuk mund të na ndihmojë me të vërtetë.
- Ne mund të ndihemi të refuzuar, ashtu si lebrozi.
- Ne mund të kemi ndjesinë që të tjerët nuk do të na donin kurrë, nëse do ta dinin se si jemi me të vërtetë brenda vetes.
- Ne mund të mendojmë se edhe Perëndia na shikon në atë mënyrë.

Megjithatë Perëndia di gjithçka rreth nesh dhe sërish të jetë Shpëtimtari ynë. Ai jo vetëm që kujdeset për ne dhe është gati të na ndihmojë, por Ai është i vetmi që ka fuqinë për të na shpëtuar.

Mësimi 48

Qëllimi

Ky mësim na flet për bisedën e Jezusit me Nikodemin rreth lindjes së re: që një person të shpëtohet, ai duhet të lindë sërish. Ne do të flasim për veprën e Frymës së Shenjtë përmes Fjalës së Perëndisë. Jezusi shfaqet si rruga e vetme për shpëtimin e njerëzve. Ai është udha e shpëtimit për tërë njerëzit anëmbanë. Ata nuk mund të bëjnë asgjë për të shpëtuar veten.

Hyrje

Ndihmohi fëmijët e klubit tënd të kuptojnë që askush, as predikuesit, ungjilltarët, apo ndonjë drejtues fetar sot, nuk mund ta bëjë veten të pranueshëm para Perëndisë. Perëndia nuk do të pranojë asnjë nga gjërat që bëjmë. Të gjithë ne jemi mëkatarë, duke merituar vdekjen, por Perëndia është plot hir. Ai dërgoi Birin e Tij, Jezu Krishtin, për të qenë Shpëtimtari i atyre që i besojnë Atij.

Figurat

- Figura 34: Gjarpri mbi shtizë



- Figura 48: Vizita e Nikodemit gjatë natës



- Grafiku 32: Dy lloj njerëzish

Duhet të lindësh sërish

Historia

“Më pëlqen ky keku!” - tha Xhoni, ndërsa po mbaronte së ngrëni kafshatën e fundit.

“Ty gjithmonë të pëlqejnë kekët, Xhon!” - tha Karola.

“Ishte një datëlindje e këndshme, Xhon” - tha xhaxhi Piteri.

“Ashtu mendoj edhe unë” - tha Xhoni. “Xhaxhi Piter, kur e ke datëlindjen?”.

“Cilën datëlindje?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Çfarë do të thuash me: ‘cilën datëlindje?’” - pyeti Xhoni.

“Shiko, Xhon,” - tha xhaxhi Piteri, - “unë kam dy datëlindje. E para është kur kam lindur si foshnjë. Të gjithë e kanë atë datëlindje”.

“Por çfarë është datëlindja e dytë?” - e ndërpreu Karola.

“Karola, a e kujton se si Adami dhe Eva mëkatuan në kopshtin e Edenit?” - pyeti xhaxhi Piteri. “Dhe që nga ajo kohë çdo njeri, çdo pasardhës i Adamit, ka lindur mëkatar!”.

“Por ne nuk mund të bëjmë gjë për mënyrën se si lindim!” - tha Karola e trishtuar.

“Ke të drejtë,” - tha xhaxhi Piteri, - “nuk mund të bëjmë, por Perëndia ka gjetur një mënyrë që ne të lindim për herë të dytë; jo në lidhje me Adamin, por në lidhje me Perëndinë”.

“Vërtetë?” - tha Xhoni.

“Po” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Perëndia e di që ne nuk mund të bëjmë diçka për të ndryshuar gjendjen në të cilën jemi. Ne kemi trashëguar natyrën mëkatore të Adamit, ndaj, pavarësisht se sa shumë të përiqemi, ne nuk jemi në gjendje ta ndryshojmë veten që t’i bindemi Perëndisë dhe t’i pëlqejmë Atij”.

“Po ata predikues që vijnë në qytet për të predikuar rreth Perëndisë?” - pyeti Karola. “A nuk mund t’i binden dhe t’i pëlqejnë Perëndisë?”.

“Jo nëse varen nga mënyrat e tyre dhe nuk kanë lindur sërish” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Askush nuk mund të jetojë dhe t’i pëlqejë Perëndisë nëse nuk ka lindur sërish, duke besuar te Jezu Krishti si Shpëtimtari i tij”.

“Të ketë lindur sërish?!” - tha Xhoni i çuditur. “Mendova se mund të lindësh vetëm një herë!”.

“Xhon, sipas Biblës ishte vetë Jezusi që foli për lindjen sërish” - tha xhaxhi Piteri. “Ai po i fliste Nikodemit, njërit prej drejtuesve fetarë”.

“Por kjo duket e çuditshme” - tha Karola. “Si mund të lindë sërish një person?”.

“Në të njëjtën mënyrë që linda unë: besova te Jezu Krishti si Shpëtimtari im” - tha xhaxhi Piteri. “Kur besova, linda në familjen e Perëndisë”.

“Çfarë do të thuash me: ‘në familjen e Perëndisë?’” - pyeti Xhoni.

“Adami dhe Eva u ndanë nga Perëndia,” - kujtoi xhaxhi Piteri, - “dhe mosbindja e tyre i nxori ata dhe pasardhësit e tyre jashtë familjes së Perëndisë dhe i vendosi nën sundimin e Satanit. Një person mund të lindë në familjen e Perëndisë duke besuar te Jezu Krishti. Kjo është mënyra e vetme për t’u lindur për herë të dytë”.

“Ua!” - tha Karola, - “kush mund të lindë sërish?”.

“Njerëzit e vetëm që mund të lindin sërish janë mëkatarët!” - tha xhaxhi Piteri. “Çdokush është mëkatar nga lindja. Ajo që kërkon Perëndia është që një person të pranojë që është mëkatar, i pushpresë dhe që nuk mund të shpëtojë veten. Në çastin që ai person i beson Jezu Krishtit si Shpëtimtarit të tij, ai lind sërish”.

“Xhaxhi Piter, kështu lindi sërish edhe ti?” - pyeti Xhoni.

“Po” - tha xhaxhi Piteri. “Thjesht pranova para Perëndisë se isha mëkatar dhe se nuk mund të bëja asgjë për mëkatet e mia. Besova se Jezusi ishte Shpëtimtari i vetëm, i vetmi që mund të më çlironte nga mëkati, Satani dhe vdekja”.

“Atëherë ke dy datëlindje!” - tha Karola.

“Po, Karola, i kam,” - tha xhaxhi Piteri, - “dhe e dyta është më e mira. Bibla thotë se kushdo që beson te Jezu Krishti do të ketë jetë të përjetshme! E shikoni se çfarë dhurate për datëlindje?”.

Le të shohim në Bibël



Gjoni 3:16 – “Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.”

Ngaqë Perëndia nuk do që dikush të shkojë me Satanin në ndëshkim të përjetshëm, Ai dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, në botë për t'i shpëtuar.

Le të mendojmë

- Cilët kanë lindur mëkatarë? a. Njerëzit e këqinj; **b. Të gjithë**; c. Demonët.
- Çfarë ndodh kur një person beson te Jezu Krishti si te Shpëtimtari i tij?
 - Ai është nën sundimin e Satanit; b. Ka datëlindjen e parë; **c. Lind sërish.**
- Cilët njerëz mund të lindin sërish?
 - Mëkatarët që besojnë te Jezu Krishti**; b. Engjëjt; c. Demonët.
- Cili është i vetmi që mund t'i çlirojë njerëzit nga mëkati dhe vdekja?
 - Abrahami; **b. Jezusi**; c. Satani.
- Çfarë u premtonte Perëndia atyre që besojnë te Biri i Tij, Jezusi?
 - Para; b. Festë; **c. Jetë të përjetshme.**

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Kujtoji fëmijët që judenjtë, dhe sidomos farisenjtë, ishin shumë krenarë që ishin pasardhës të Abrahamit. Ata mendonin se ishin në familjen e Perëndisë për shkak se ishin bijtë e Abrahamit. Farisenjtë nuk e kuptonin që çdo person i lindur në këtë botë ka lindur nën sundimin e Satanit (në mbretërinë e Satanit). Ne do të lexojmë një prej pjesëve më të njohura dhe të dashura të Shkrimit.

1. Nikodemi shkoi te Jezusi - Gjoni 3:1-2.

- Nikodemi ishte i sigurt se Jezusi ishte dërguar nga Perëndia.
- Ai e dinte se mrekullitë e mëdha që kishte bërë Jezusi mund të bëheshin vetëm me anë të fuqisë së Perëndisë.
 - Shumica e farisenjve të tjerë e urrenin Jezusin dhe thoshin se Ai i bënte mrekullitë e Tij me anë të fuqisë së Satanit.
- Nikodemi erdhi t'i fliste Jezusit natën mbase që drejtuesit e tjerë judenj të mos e shikonin.

2. Lindja e re - Gjoni 3:3-7.

- Jezusi i tha Nikodemit që rruga e vetme se si një person mund t'i shpëtojë fuqisë dhe sundimit të Satanit dhe të jetë në gjendje ta njohë, ta dojë dhe t'i bindet Perëndisë, është duke lindur sërish.
 - Jezusi po i thoshte Nikodemit, një drejtuesi fetar, që ai duhet të kishte një mendje dhe jetë të re, të cilat do të bënin të mundur që ai të njihje dhe të kuptonte Perëndinë, ashtu siç mundeshin Adami dhe Eva kur i krijoi Perëndia⁴³.
 - Edhe ne duhet të kemi një mendje dhe jetë të re, në mënyrë që ta duam Perëndinë dhe t'i bindemi Atij.
- Nikodemi ishte shumë i çuditur kur Jezusi i tha që një person duhet të lindë sërish para se të kuptojë apo të jetë nën udhëheqjen e Perëndisë (të hyjë në mbretërinë e Perëndisë). Mbase ai mendonte se lindja e tij e parë si pasardhës i Abrahamit do ta fuste në familjen (mbretërinë) e Perëndisë.
- Nikodemi mendonte se Jezusi nënkuptonte që trupat e njerëzve duhet të lindin për herë të dytë, si foshnja.
- Jezusi tha se çdo person që futet nën udhëheqjen e Perëndisë (në mbretërinë e Tij) duhet të lindë nga uji dhe Fryma.
 - Uji për të cilin foli Jezusi nuk është uji i pagëzimit⁴⁴.
- Neve do të na jepet një jetë e re **duke besuar atë që thotë Fjala e Perëndisë rreth Jezusit** (1 Pjetrit 1:23).

→ Figura 48: Vizita e Nikodemit gjatë natës

⁴³Kur Perëndia krijoi Adamin dhe Evën, Ai i bëri sipas shëmbëlltyrës së Tij. Perëndia i bëri ashtu, që ata të mund ta njihnin, ta donin dhe t'i bindeshin Atij. Ata ishin miqtë e Tij. Por, kur mëkatuan, ata vdiqën frymërisht. Ata u ndanë prej Tij. Ata nuk ishin më në përbashkësi me Perëndinë. Ata nuk ishin më miqtë e Tij. Ata i kishin akoma mendjet, por, për shkak të mëkatis të tyre, ata nuk ishin në gjendje ta njihnin Perëndinë dhe t'i kuptonin fjalët e Tij. Gjithashtu, nuk ishin në gjendje ta donin apo t'i bindeshin Atij. Prandaj, ata nuk ishin më në gjendje t'i pëlqenin Perëndisë. Mendjet dhe vullnetet e tyre ishin tashmë nën dikimin e Satanit. Tërë njerëzit e lindur në botë që nga ajo kohë, kanë lindur me gjendjen e pamundësisë për të njohur, për të kuptuar, për të dashur apo për t'u bindur Perëndisë. Asnjë person që ka lindur në këtë botë nuk mund t'i pëlqejë Perëndisë. Çdo person në çdo vend, pavarësisht nga kombësia, ngjyra apo gjuha, ka lindur nën autoritetin e Satanit.

⁴⁴Pagëzimi nuk mund të na bëjë bij të Perëndisë; nuk mund të na i lajë mëkatet. Disa fëmijë mund të mendojnë apo u është mësuar më parë që pagëzimi e shpëton një person, ose që besimi me pagëzimin e shpëton një person. Disa pjesë të Shkrimit, të nxjerra nga konteksti i pjesës tjetër të Fjalës, mund të interpretohen në atë mënyrë. Inkurajoji fëmijët të lexojnë Fjalën. Efesianëve 5:26; Gjoni 15:3; Psalmi 119:9 dhe Titit 3:5 do t'i ndihmojnë ata të kuptojnë rëndësinë e Fjalës së Perëndisë në jetët e tyre. Kujto që një person i pashpëtuar nuk mund ta kuptojë Fjalën, por Fryma e Perëndisë do ta përdorë Fjalën për të sjellë bindje dhe shpëtim. Mos u ha me fjalë me ta, por lër Fjalën që të veprojë. Ata mund të mos bien dakord me atë që dëgjojnë apo lexojnë në fillim, por vazhdo me mësimin, duke besuar se Fryma e Shenjtë do të veprojë tek ata.

→ Figura 34: Gjarpri mbi shtizë

⁴⁵Kujto: Satani, i cili quhet gjarpri i lashtë, e largoi Adamin nga Perëndia. Kur Adami mëkatoi kundër Perëndisë, ai vdiq. Atëherë tërë pasardhësit e Adami janë të ndarë nga Perëndia dhe po vdesin se janë mëkatarë. Paga e mëkatit është vdekja. Izraelitët nuk mund ta shpëtonin veten nga gjarpërinjtë, edhe ne po ashtu nuk mund ta shpëtojmë veten nga vdekja. Perëndia i çliroi izraelitët dhe vetëm Ai mund të na çlirojë edhe ne.

Përsëritje

Vendos përshkrimet e ngjyrosura nën titujt e saktë më poshtë:

1. Mbretëria e Perëndisë; 2. Mbretëria e Satanit; 3. Lindur një herë; 4. Lindur sërish.

A. Ata që kanë lindur vetëm një herë dhe janë nën sundimin e Satanit: (2, 3)

B. Ata që kanë lindur për herë të dytë dhe janë nën autoritetin e Perëndisë: (1, 4).

Pyetje dhe përgjigje

- Cilët janë dy llojet e njerëzve?
a. Njerëz të lindur një herë;
b. Njerëz të lindur sërish.
- Në cilën mbretëri ndodhen ata që kanë lindur vetëm një herë? **Në mbretërinë e Satanit.**
- Në cilën mbretëri janë ata që kanë lindur dy herë? **Në mbretërinë e Perëndisë.**
- Pse e dërgoi Perëndia Birin e Tij, Jezusin, Shpëtimtarin në botë? **Ai nuk do që ndokush të shkojë me Satanin në shkatërrim të përgjeshëm.**
- Çfarë tha Jezusi rreth asaj që duhet të bëjë një mëkatar për t'u çliuar nga pushteti i Satanit? **Të besojë te Jezu Krishti.**
- Çfarë marrin njerëzit që besojnë te Jezusi si Shpëtimtari i tyre? **Jetë të përgjeshme.**

- Kur njerëzit dëgjojnë dhe i besojnë Fjalës së Perëndisë, Fryma e Shenjtë i ndryshon ata, në mënyrë që:

- Të mund të njohin Perëndinë dhe t'i kuptojnë fjalët e Tij.
- Të mund të jenë në gjendje ta duan Atë dhe të jetojnë nën autoritetin e Tij.
- Të mund të hyjnë në mbretërinë e Perëndisë.

- Jezusi i tha Nikodemit të mos çuditej që ai duhet të lindte sërish.
- Perëndia thotë se ka dy lloj njerëzish në botë:

→ Trego grafikun 32: Dy lloj njerëzish.

Dy lloje njerëzish	
Lindur një herë	Lindur dy herë
Ata që kanë lindur vetëm një herë dhe janë nën sundimin (mbretërinë) e Satanit	Ata që kanë lindur për herë të dytë dhe janë nën sundimin (mbretërinë) e Perëndisë

- Të gjithë ata që kanë lindur për herë të dytë janë në familjen (mbretërinë) e Perëndisë.

3. Jezusi duhet të ngrihet lart - Gjoni 3:14-16.

- Nikodemi nuk mund të kuptonte ende se si mund të lindte në familjen e Perëndisë.
- Jezusi ia shpjegoi Nikodemit duke e kujtuar se çfarë u ndodhi paraardhësve të tij fetarë në shkretëtirë.

Kujto: Izraelitët kishin mëkatur kundër Perëndisë, ndaj Ai u dërgoi gjarpërinj helmues për t'i kafshuar dhe njerëzit filluan të vdisnin. Kur u penduan, pra, ndryshuan mendjen dhe pranuan mëkatin e tyre, Perëndia i tha Moisiut të bënte një gjarpër bronzi dhe ta vinte mbi shtizë. Perëndia premtoi se kushdo që ishte kafshuar dhe shikonte gjarpërin prej bronzi do të shërohej. Ai e mbajti premtimin!

Mendo: Nikodemi ishte përpjekur t'u bindej ligjeve të Perëndisë. Ai nuk e kuptonte që, me forcat e tij, ishte tërësisht i papranueshëm para Perëndisë. Ai duhej të bënte atë që izraelitët kishin bërë dhe vetëm t'i besonte Zotit⁴⁵.

- Jezusi tha që ka vetëm një rrugë që të mund të çlirohemi nga Satani, mëkati dhe vdekja dhe të mund të lindim në mbretërinë e Perëndisë.
 - Jezusi tha se Ai duhet të ngrihet lart, ashtu si gjarpri prej bronzi u ngrit në shkretëtirë, që kushdo që beson në Të të marrë jetën e përgjeshme nga Perëndia.
- Ngaqë Perëndia nuk do që ndokush të shkojë me Satanin në shkatërrim e përgjeshëm dhe të ndahet nga Ai, Perëndia e dërgoi Birin e Tij, Jezusin, Shpëtimtarin, në botë.
 - Jezusi tha: *Sepse Perëndia e deshi aq botën, saqë tha Birin e Tij të vetëmlindur...* Pyeti fëmijët: "Çfarë tha Jezusi rreth asaj që duhet të bëjë një mëkatar për t'u çliuar nga fuqia e Satanit?"
Te Gjoni 3:16 Jezusi tha: *Që kushdo që beson në Të.*
- Kur një burrë, grua apo fëmijë i beson fjalët e Perëndisë dhe i beson Jezusit si Shpëtimtarit të tij, Perëndia i jep atij personi jetë të re.

4. Udhë e jetës dhe vdekjes - Gjoni 3:17-20.

- Jezusi tha që kushdo që beson në Të "nuk do të humbasë".
 - Ata që besojnë te Shpëtimtari nuk do të shkojnë në ndëshkim të përgjeshëm për mëkatet e tyre.
- Ata që e refuzojnë Shpëtimtarin janë të dënuar dhe të refuzuar nga Perëndia që tani.
 - Askush nuk ka pse të presë derisa të vdesë për të ditur nëse do të pranohet apo do të refuzohet nga Perëndia.
- Shumë njerëz nuk bien dakord me Fjalën e Perëndisë dhe t'i besojnë Atij, sepse janë krenarë dhe mendojnë se janë të mirë apo pëlqejnë jetën e tyre mëkatore.
 - Ata nuk duan të pranojnë se e kanë gabim.
 - Ata nuk duan që Perëndia t'i ndryshojë. Secili duhet të mendojë se çfarë personi është. Bibla na thotë se Perëndia dëshiron që çdo person të jetë pjesë e familjes së Tij. Prandaj Ai dërgoi Birin e Tij, Jezu Krishtin.

Mësimi 49

Qëllimi

Ky mësim flet për mrekullitë e shërimeve fizike që kreu Jezusi, një shenjë e Hyjnisë së Tij.

Gjithashtu, flet për faktin se shumë nga drejtuesit fetarë e refuzojnë Jezusin.

Fëmijët e klubit tënd do të mësojnë:

- Jezusi ka pushtet të falë mëkatet.
- Jezusi erdhi për të shpëtuar mëkatarët.
- Njerëzit janë të pashpresë për të shpëtuar veten.
- Perëndia shikon dhe trajton hipokrizinë.

Hyrje

Ndihmoji fëmijët e klubit të kuptojnë se sa e rëndësishme është që të studiojmë Biblën. Në këtë mënyrë do të mund të dimë kur dikush nuk po na thotë të vërtetën rreth Perëndisë apo Fjalës së Tij. Tregoj se si ata që largojnë njerëzit nga Perëndia mund të njihen shpesh nga fakti se ata shtrembërojnë, keqpërdorin, injorojnë, refuzojnë apo i shtojnë Fjalës së Tij. Kujtoju atyre kur Satani e bëri këtë gjë në kopsht ndaj Evës, në shkretëtirë ndaj Jezusit dhe ai akoma po përpiqet ta bëjë këtë me ne sot. Jezusi mposhti Satanin duke përdorur në mënyrë të saktë Fjalën e perëndisë; ne duhet të mësojmë të bëjmë të njëjtën gjë.

Figurat

- Figura 49: Jezusi shëron të paralizuarin



- Grafiku 24: Jezu Krishti është Perëndi

- Figura 38: Sundimi romak



Drejtuesit fetarë refuzojnë Jezusin

Historia

“Përshëndetje, Xhon e Karola” - tha xhaxhi Piteri. “Si jeni sot?”.

“Mirë!” - tha Karola. “A e di që Tomi do të vijë në shtëpinë tonë dhe do të studiojmë Biblën së bashku?”.

“Oh, do të ishte fantastike!” - tha xhaxhi Piteri. “Kur do të vijë?”.

“Shiko, nuk e dimë nëse mund të vijë” - tha Xhoni i trishtuar. “Babi i tij nuk ishte shumë dakord për këtë”.

“Pse jo?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Ai tha se njerëzit fetarë janë hipo... diçka e tillë” - tha Karola.

“Mos tha gjë ‘hipokritë’?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Po!” - tha Xhoni. “Xhaxhi Piter, çfarë do të thotë kjo?”.

“Hipokrit është një person që nga ana e jashtme shtiret sikur është shumë fetar,” - tha xhaxhi Piteri, - “por nga brenda nuk beson me të vërtetë te Perëndia. Ai nuk e konsideron veten mëkatar, ashtu siç e shikon Perëndia”.

“Të gjithë kanë mëkatuar” - tha Karola.

“Ke të drejtë, Karola” - tha xhaxhi Piteri. “Babai i Tomit mbase do të jetë zhgënjyer nga mënyra se si sillet dikush. Ai mund të ketë parë dikë që ka qenë shumë ‘fetar’ në sytë e tij; ai ka menduar që ai njeri nuk do të mëkatonte kurrë. Pastaj kur personi ka mëkatuar, babai i Tomit mund të jetë zemëruar kundër Perëndisë për shkak të asaj që ka bërë apo ka thënë ai njeri”.

“Nuk mendoj se babait të Tomit duhet t’i interesojë se si veprojnë njerëzit e tjerë” - tha Xhoni. “Ai bën shumë gjëra të këqija! Ta kishe parë duke...”.

“Xhon, Jezusi erdhi për të shpëtuar mëkatarët!” - e ndërpreu xhaxhi Piteri. Ne të gjithë jemi mëkatarë. Mëkat nuk janë vetëm gjërat e jashtme. Janë gjërat brenda nesh (ndjenjat dhe mendimet tona), si zemërimi, krenaria dhe xhelozia. Babai i Tomit duhet të dijë se Perëndia nuk është si ata njerëz që e quajnë veten fetarë. Prandaj disa nga mëkatarët që Jezusi takonte e donin shumë”.

“Mendoj se të gjithë do ta donin Jezusin” - tha Karola. “Ai bëri shumë gjëra të mrekullueshme”.

“Po,” - tha Xhoni, - “mendoj se babai i Tomit do ta pëlqente Jezusin nëse do ta takonte”.

“Shpresoj se do ta pëlqente” - tha xhaxhi Piteri. “Në kohën kur Jezusi ishte këtu në tokë, shumë njerëz si babai i Tomit i besuan Jezusit, por njerëz të tjerë e refuzuan”.

“E refuzuan?!” - tha Karola. “Pse e bënë këtë?”.

“Për të njëjtën arsye që po flisnim” - tha xhaxhi Piteri. “Disa njerëz ishin hipokritë, pra, ata nuk donin t’ia dinin aq shumë për Perëndinë, sa për veten e tyre dhe që të linin përshtypje të mira te njerëzit e tjerë. Farisenjtë ishin të tillë”.

“Ua,” - tha Xhoni, - “duket sikur njerëzit, kur Jezusi ishte në tokë janë të ngjashëm me njerëzit që mërzitën babanë e Tomit”.

“Mendoj se ke të drejtë, Xhon” - pranoi xhaxhi Piteri. “Jezusi foli ashpër kundër farisenjve. Perëndia shikon brenda njeriut dhe nuk mashtrohet nga ajo që thonë apo bëjnë njerëzit. Ai e njeh secilin prej nesh, ashtu siç jemi. Do të flas me babin e Tomit dhe do të shoh nëse do ta lejojë Tomin të vijë të studiojë Biblën me ne”.

Le të shikojmë në Bibël



Gjoni 20:31 – “Por këto gjëra janë shkruar që ju të besoni se Jezusi është Krishti, Biri i Perëndisë dhe që, duke besuar, ta keni jetën në emër të tij.”

Perëndia i shkroi fjalët e Tij, në mënyrë që ne të ishim në gjendje të njohim dhe të besojmë atë që thotë Ai për mëkatin, gjykimin dhe sigurimin e Tij.

Fjala e Perëndisë është e vërtetë!

Le të mendojmë

1. Kush është një hipokrit? a. Dikush që beson te Perëndia; b. Tërë drejtuesit fetarë; **c. Dikush që shtiret sikur është fetar.**
2. Çfarë mendojnë hipokritët për Perëndinë apo mëkatin? **a. Ata nuk i besojnë Perëndisë;** b. Ata besojnë se Jezusi është Perëndi; c. Ata besojnë se janë mëkatarë.
3. Kë erdhi të shpëtonte Jezusi? a. Njerëzit që ishin të mirë; **b. Mëkatarët;** c. Njerëzit fetarë.
4. Çfarë shikon Perëndia kur shikon njerëzit?
a. Se si veprojnë njerëzit; b. Sa fetarë janë; **c. Gjërat e brendshme dhe të jashtme të njerëzve.**
5. Kush mund t'ia hedhë Perëndisë? **a. Askush;** b. Satani; c. Drejtuesit fetarë.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Shumica e drejtuesve fetarë të kohës së Jezusit nuk donin t'ia dinin për Perëndinë; ata e përdornin Fjalën e Perëndisë dhe emrin e Tij vetëm si mënyrë për të siguruar ndjekës. Edhe pse vepronin në mënyrë fetare, në “zemrat” e tyre ata nuk i bindeshin Perëndisë, as nuk i besonin Atij. Ata refuzonin Atë që mund t'i shpëtonte nga mëkatet e tyre.

1. Jezusi mësoi Fjalën e Perëndisë - Marku 2:1-2.

- Shumë njerëz donin të dëgjonin atë që mësonte Jezusi. Ata erdhën për të parë Jezusin për arsye të ndryshme:
 - Disa ishin kureshtarë.
 - Disa mendonin se Ai do të bëhej mbreti që do t'i çlirointe nga romakët.
 - Disa donin ta dëgjonin, sepse Ai e fliste Fjalën e Perëndisë me autoritet.
 - Disa ishin xhelozë për Të dhe donin ta padisnin për krim.
 - Disa shpresonin që Ai të thoshte apo të bënte diçka që ta fajësonin.
 - Disa donin që të shëroheshin.

2. I sëmuri që gjeti Jezusin - Marku 2:3-4.

- Ky burrë nuk mund të bënte gjë për të shëruar veten; ai ishte i paralizuar. Asnjë doktor apo mik nuk mund ta shëronte⁴⁶.
- Këta burra e çuan mikun e tyre tek i vetmi që mund ta ndihmonte.
 - Shtëpia ishte e mbushur plot, kështu që e ngjiten në çati, hapën një vrimë dhe e ulën në rrogozin e tij përballë Jezusit.

3. Jezusi fali mëkatet e të sëmurit dhe e shëroi - Marku 2:5-12.

- Jezusi pa që ata besuan me të vërtetë tek Ai dhe ia fali mëkatet atij njeriu.
- Këta skribë kishin të drejtë, kur thanë se vetëm Perëndia mund të falë mëkatet, por e kishin gabim, kur thanë se Jezusi mëkatoi kur fali mëkatet e burrit të sëmurë.
 - Jezusi është Perëndia; Ai kishte autoritet për të falur mëkatet e njerëzve⁴⁷.
 - Skribët nuk besonin se Jezusi ishte Perëndia Bir që kishte zbritur nga qielli për të qenë Çlirimtari. Ata mendonin se Ai ishte thjesht një person normal.
- Edhe pse ata burra nuk thanë gjë, Jezusi i njihte mendimet e tyre.

→ Figura 49: Jezusi shëron të paralizuarin

⁴⁶Mendo: Kjo na kujton gjendjen e pashpresë të tërë njerëzve. Askush nuk është në gjendje ta çlirojë veten nga Satani, mëkati dhe vdekja. Veprat e mira apo jeta e mirë nuk mund të na shpëtojnë. Ne nuk mund ta shpëtojmë veten. Madje as pastori, as mësuesi i Biblës apo ndonjë mik nuk mund të na çlirojnë. Asnjë fe apo kishë nuk mund të na shpëtojnë. Pagëzimi nuk mund të na shpëtojë.

→ Trego grafikun 24: Jezusi Krishti është Perëndi.

⁴⁷A mundet një pastor, një prift apo ndonjë njeri tjetër që të ketë autoritetin e Perëndisë të dëgjojë dhe të na falë mëkatet tona? Jo! Vetëm Perëndia mund të falë mëkatet (1 Timoteut 2:5; 1 Gjonit 1:9; 2:1-2).

⁴⁸Kur Jezusi thirri Mateun që ta ndiqte, Mateu po punonte për romakët, duke mbledhur taksa për popullin e tij, judenjët. Mbledhësit e taksave zakonisht urreheshin nga judenjët; ata kishin namin që kërkonin taksa shtesë nga njerëzit dhe që i mbanin paratë për vete.

⁴⁹Sigurohu që fëmijët të kuptojnë se Jezusi erdhi në mënyrë që tërë njerëzimi të shpëtohej nga Satani, mëkati dhe vdekja. Megjithatë, ardhja e Tij do të ishte e dobishme vetëm për ata që binin dakord se ata ishin mëkatarë, që nuk mund të shpëtonin veten dhe se kishin nevojë për një shpëtimtar.

Mateu 6:2, 5, 16; 23:1-39

Përsëritje

Veprimtari për të zbuluar mesazhin e fshehtë: “Jezusi erdhi për të shpëtuar mëkatarët”.

Pyetje dhe përgjigje

1. Kush refuzoi Jezusin dhe Fjalën e Perëndisë?
a. Skribët dhe farisenjtë; b. Drejtuesit fetarë.
2. Kush mund të falë mëkatet? **Perëndia (ose Jezusi).**
3. Pse i fali Jezusi mëkatet e njeriut të sëmurë?
Sepse ai besoi te Jezusi.
4. Kush i tha Mateut se çfarë duhej të shkruante në librin e parë të Dhiatës së Re? **Fryma e Shenjtë.**
5. Kë erdhi të shpëtonte Jezusi? Tërë **njerëzimin.**
6. Pse drejtuesit judenj e urrenin Jezusin dhe e donin të vdekur? **a. Sepse Jezusi tha se ishte Biri i Perëndisë, Çlirimtari i premtuar; b. Sepse Jezusi u tha atyre që ishin mëkatarë; c. Sepse ata ishin xhelozë ndaj Jezusit; Atë e ndiqnin shumë njerëz.**

- Jezusi e tregoi fuqinë e Tij si Perëndi duke e shëruar tërësisht njeriun e sëmurë.
 - Njerëzit u çuditën dhe lavdëruan Perëndinë. Ata nuk kishin parë kurrë diçka të tillë.

4. Jezusi thirri Levin - Marku 2:13-14.

- Jezusi thirri Levin, të quajtur gjithashtu Mate, që ta ndiqte menjëherë si një prej dishepujve apo nxënësve të Tij⁴⁸.
 - Mateu e ndoqi menjëherë Jezusin, i Cili ishte Shpëtimtari që Perëndia e kishte dërguar në botë.
 - Shumë vite më vonë Zoti përdori Mateun për të shkruar një prej librave të Biblës.
 - Fryma e Shenjtë i tha Mateut se çfarë duhet të shkruante.
 - Mateu është libri i parë i Dhiatës së Re. Është plot citime nga Dhiata e Vjetër, e cila ishte shumë e njohur për popullin jude.

5. Jezusi erdhi të thërriste mëkatarët - Marku 2:15-17.

- Skribët dhe farisenjtë ishin krenarë. Ata besonin se ishin më të mirë se të tjerët, sepse agjëronin, luteshin dhe bënë shumë gjëra për t'i pëlqyer Perëndisë.
- Shpëtimi që Jezusi erdhi të siguronte nuk do të ndihmonte ata lloj njerëzish që mendojnë se janë pa mëkat apo që mendojnë se janë aq të mirë sa të pranohen nga Perëndia⁴⁹.
- Jezusi erdhi të shpëtonte ata që do të pranonin se janë mëkatarë të pashpresë.

6. Plani i keq i farisenjve - Marku 3:1-2.

- Farisenjtë dhe drejtuesit e tjerë judenj e refuzuan mesazhin e Perëndisë që u dha përmes Gjonit, ata refuzuan gjithashtu mësimin e Jezusit, Shpëtimtarit.
- Ata po e vëzhgonin vazhdimisht Jezusin, duke shpresuar që Ai të bënte diçka kundër rregullave të tyre, në mënyrë që ta arrestonin dhe ta dënonin me vdekje.
 - Jezusi iu bind tërë ligjeve të Perëndisë, por Ai refuzoi të ndiqte rregullat që kishin sajuar dhe që ia kishin shtuar Fjalës së Perëndisë drejtuesit fetarë.
- Drejtuesit judenj e urrenin Jezusin, sepse Ai thoshte se ishte Biri i Perëndisë, Çlirimtari i premtuar.
- Gjithashtu ata e urrenin Jezusin, sepse Ai u tha që ishin mëkatarë.
 - Jezusi e dinte se drejtuesit nuk donin ta adhuronin Perëndinë me sinjeritet.
 - Ata vepronin si fetarë sa për t'u dukur, por brenda ishin egoistë dhe të këqinj.
 - Bibla e quan hipokrit dikë që vepron kështu. Nëse një person përpiket të duket shumë fetar kur në të vërtetë nuk do t'ia dijë për Perëndinë, kjo quhet hipokrizi.
 - Jezusi i njihte mendimet e njerëzve dhe ia bëri të qartë popullit jude se drejtuesit e tij ishin hipokritë.

Mendo: Disa njerëz sot janë si drejtuesit judenj në kohën e Jezusit. Ata shtireshin se ishin shumë fetarë, por brenda vetes nuk donin t'ia dinin shumë për Perëndinë.

- Drejtuesit judenj e urrenin Jezusin, sepse turmat e njerëzve e ndiqnin.
 - Ata ishin xhelozë për Jezusin.

Edhe sot kemi njerëz si këta: njerëz që ndiqen nga shumë të tjerë, por që e kanë refuzuar Perëndinë. Edhe pse mesazhi i tyre mund të duket shumë fetar dhe interesant, nuk është i vërtetë; është gënjeshtër. Disa, ashtu si farisenjtë, u thonë njerëzve që do të shkojnë në qiell nëse bëjnë gjërat e duhura. Të tjerë u thonë njerëzve që të gjithë do të shkojnë në qiell ose thonë se Perëndia është dashuri dhe thjesht duhet të duam njëri-tjetrin për të shkuar në qiell. Edhe këto janë gënjeshtër! Fjala e Perëndisë thotë në mënyrë të qartë se vetëm Jezusi mund ta shpëtojë njerëzimin; njerëzit nuk mund të bëjnë gjë për të shpëtuar veten.

Mësimi 50

Qëllimi

Sot do të shohim se zgjedhja e dymbëdhjetë dishepujve nga Jezusi na tregon se Ai zgjodhi njerëz të zakonshëm. Gjithashtu do ta shohim Jezusin si Perëndia Shumë i Lartë, i Cili është në gjendje të qetësojë stuhitë me një fjalë të vetme.

Gjithashtu, fëmijët e klubit tënd do të mësojnë:


- që, për shkak se Jezusi është Perëndia, Ai ka pushtet mbi çdo gjë.
- që Jezusi kujdeset për njerëzit në situata të pashpresa.
- që Jezusi e di atë që mendojnë njerëzit.

Hyrje

Mbase disa prej fëmijëve të klubit tënd njohin njerëz që e urrejnë Perëndinë ose dikë që beson te Perëndia. Disa njerëz thonë se besojnë te Perëndia, por ata nuk besojnë se Jezusi është Perëndi. Ata mendojnë se Ai është thjesht një njeri i mirë në histori. Kjo është edhe një prej gënjeshtreve të Satanit. Ai nuk do që njerëzit të besojnë se Jezusi mund të jetë Shpëtimtari i tyre nga mëkati, Satani dhe vdekja.

Figura

→ Figura 50: Jezusi dhe dymbëdhjetë dishepujt



→ Figura 51: Jezusi qetëson detin



Jezusi zgjodhi dymbëdhjetë dishepuj

Historia

“Xhaxhi Piter, nuk e kuptoj se pse duhet ta urrejë dikush Jezusin” - tha Karola. “Ai po ndihmonte shumë njerëz. Gjithçka që kam dëgjuar për Të ka qenë e mirë”.

“Po” - tha xhaxhi Piteri. “Është e vështirë të kuptosh se përse duhet ta urrejë dikush Jezusin. Ai ishte gjithmonë i perëndishëm. Ai nuk mbante fshehur ndonjë mëkat brenda Tij. Ai ishte tërësisht i mirë: Ai nuk mëkatoi kurrë!”.

“Do të thuash që njerëzit nuk e panë të bëjë diçka të keqe?” - pyeti Xhoni.

“Ke të drejtë, Xhon” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Jezusi bëri vetëm ato gjëra që i pëlqenin Perëndisë. Atij nuk iu desh kurrë të shqetësohej se mos ishte hipokrit. Ai ishte nga jashtë krejtësisht siç ishte brenda vetes.”

“Mendoj se duhet të jetë e vështirë që kjo gjë të bëhet gjatë gjithë kohës!” - tha Karola.

“Jezusi është Perëndi” - tha xhaxhi Piteri. “Kur njerëzit shkonin tek Ai, Ai gjithmonë bënte dhe thoshte gjërat që i kishte thënë Perëndia”.

“Po sikur Jezusi ta dinte se drejtuesit fetarë po planifikonin ta vrisnin” - pyeti Xhoni. “A do të kishte mëkatuar atëherë?”

“Kjo është pyetje me vend, Xhon” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Ngaqë Jezusi është edhe njeri, Ai mund të kishte vepruar ashtu siç mund të kishim vepruar ne nëse do ta dinim që dikush do të na bënte keq”.

“E di se çfarë do të kisha bërë” - e ndërpreu Xhoni. “Do të isha shumë i zemëruar, saqë do të doja t’i vrisja unë i pari”.

“Kështu mendon shumica e njerëzve, Xhon,” - tha xhaxhi Piteri, - “por ne duhet të kujtojmë se Jezusi është edhe Perëndi. Dhe ngaqë Ai është Perëndia, Ai e dinte saktësisht se çfarë po planifikonin drejtuesit fetarë, megjithatë...”.

“Atëherë pse nuk përdori fuqinë e Tij për t’i ndalur?” - e ndërpreu Karola.

“Nëse nuk donte t’i vriste, mund t’i kishte frikësuar aq shumë, saqë të largoheshin prej tij”.

“Po, Karola, Jezusi mund ta kishte bërë këtë” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Por Perëndia kishte plane të tjera. Dhe kujtoni atë që thashë për Jezusin; Ai bën vetëm gjërat që i pëlqejnë Perëndisë. Perëndia ka një qëllim për çdo gjë që bën. Ne jo gjithmonë e kuptojmë se përse Ai i bën gjërat sipas mënyrës së vet, por ne mund të besojmë që Ai do të bëjë gjënë më të mirë. Jezusi është shembulli ynë se si t’i besojmë Perëndisë”.

“Ka diçka tjetër që nuk e kuptoj” - tha Xhoni. “Kur drejtuesit fetarë panë tërë mrekullitë që bëri Jezusi, pse nuk besuan në ato që tha Ai?”

“Po” - e ndërpreu Karola. “Edhe unë po bëja të njëjtën pyetje, sepse mbaj mend që na the se edhe Satani dhe demonët e tij besojnë te Perëndia dhe e dinë që Jezusi është Perëndi. Demoni tha që Jezusi ishte Perëndi përpara njerëzve”.

“Ke të drejtë, Karola” - tha xhaxhi Piteri. “Por Satani nuk do që njerëzit të besojnë te Perëndia, kështu që ai përpiqet që ata t’i besojnë gënjeshtres së tij rreth Jezusit. Ai nuk do që ata të besojnë se Jezusi është Shpëtimtari i premtuar. Ai dëshiron që ata të vazhdojnë të kërkojnë Çlirimtarin që ka premtuar Perëndia. Edhe pse kemi Biblën për të lexuar tërë këto histori të vërteta, kemi akoma njerëz që nuk u besojnë gjërave që janë shkruar këtu. Për shkak të mëkati të njeriut dhe sundimit të Satanit në tokë, do të ketë gjithmonë njerëz që nuk i besojnë Fjalës së Perëndisë.”

Le të shohim në Bibël



1 Gjonit 1:8 – “Po të themi se jemi pa mëkat, gënjejmë vetveten dhe e vërteta nuk është në ne.”

Nuk ka se si t'i pëlqejmë Perëndisë dhe t'u bindemi tërë rregullave të Tij. Të gjithë kemi mëkatuar!

Le të mendojmë

1. Kush nuk ka mëkatuar kurrë? a. Njerëzit; b. Drejtuesit fetarë; **c. Jezusi.**
2. Kush i thoshte Jezusit se duhet çfarë të bënte? a. Satani; **b. Perëndia;** c. Drejtuesit fetarë.
3. Kush nuk beson se Jezusi është Perëndi? **a. Disa drejtues fetarë;** b. Satani; c. Demonët.
4. Kush nuk do që njerëzit të besojnë te Jezusi si Shpëtimtari i tyre?
a. Abrahami; **b. Satani;** c. Gjon Pagëzori.
5. Kur njerëzit thonë se nuk kanë mëkat, çfarë po bëjnë? **a. Gënjejnë veten;**
b. Thonë të vërtetën; c. Tregojnë që nuk e kuptojnë se çfarë është mëkati.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Jezusi ishte i zemëruar me drejtuesit fetarë, sepse e kishin ndarë mendjen që të mos i besonin gjërave që Perëndia po përpiqej t'u mësonte. Kështu bëri edhe faraoni i Egjiptit kur Perëndia dërgoi Moisiun për t'i thënë që t'i linte izraelitët të largoheshin nga Egjipti. Faraoni e kishte ndarë mendjen kundër Perëndisë dhe ishte i vendosur në atë që donte të bënte. Perëndia e shkatërroi atë njeri të lig dhe shkatërroi vendin e tij. Është shumë e rrezikshme kur njerëzit e ndajnë mendjen që të mos i besojnë Perëndisë dhe mesazhit të Tij. Një ditë Perëndia do të shkatërrojë çdokënd që refuzon t'i bindet Atij. Askush nuk mund të ndeshet kundër Perëndisë dhe të fitojë.

1. Jezusi shëroi dorën e një njeriu - Marku 3:1-5.

- Jezusi shëroi tërësisht dorën e një njeriu.
 - Jezusi thjesht foli dhe dora e njeriut u shërua⁵⁰.
 - Askush nuk mund ta bënte këtë përveç Perëndisë. Ai është i plotfuqishëm.

2. Farisenjtë dhe herodianët komplotuan për vdekjen e Jezusit - Marku 3:6.

- Herodianët ishin ndjekësit e Mbretit Herod.
 - Ata nuk donin një mbret tjetër.
 - Ky mbret ishte djali i Herodit që u përpoq të vriste Zotin Jezus, kur ishte foshnjë.
- Jezusi kishte shëruar dorën e atij burri dhe tani këta njerëz të këqinj po përpiqeshin ta vrisnin!

3. Jezusi i mësoi turmat dhe shëroi të sëmurët - Marku 3:7-10.

- Turma të mëdha njerëzish nga zonat pranë erdhën për të dëgjuar mësimet e Jezusit dhe për t'u shëruar nga sëmundjet e tyre.
- Jezusi i mësoi njerëzit në breg të liqenit të quajtur Deti i Galilesë.
- Kishte kaq shumë njerëz që donin t'i afroreshin Jezusit, sa që Ai u tha dishepujve t'i bënin gati një varkë për t'u larguar nëse njerëzit fillonin të shtyheshin dhe t'i shtypnin ata.
- Edhe ata që e preknin, duke besuar se do të shëroheshin, shëroheshin menjëherë.

4. Frymërat e ndyra e njihnin Jezusin - Marku 3:11-12.

- Drejtuesit judenj nuk besonin se Jezusi ishte Biri i vërtetë i Perëndisë, por frymërat e ndyra e dinin se kush ishte.
 - Ata e kishin njohur dhe i kishin shërbyer në qiell para se të ndiqnin Satanin.

⁵⁰Kujto: Në fillim kur Perëndia krijoi botën (Kolozianëve 1:16), Ai e bëri gjithçka vetëm duke folur. Jezusi është Perëndi. Ai krijoi çdo gjë vetëm duke u dhënë urdhër që të ndodhnin. Në të njëjtën mënyrë, Ai urdhëroi që dora e atij njeriu të shërohej dhe u shërua tërësisht.

⁵¹Perëndia nuk ka pse të na tregojë mrekulli që të besojmë tek Ai. Ai pret që ne të besojmë për shkak të asaj që Ai ka shkruar në Bibël.

→ Figura 50: Jezusi dhe dymbëdhjetë dishepujt

⁵²Kujto: Jezusi thirri Levin (Mateun) nga tavolina e mbledhjes së taksave dhe Levi e ndoqi.

⁵³Pyeti fëmijët nëse kanë qenë ndonjëherë në varkë kur ka pasur stuhi. Nëse kanë qenë, pyeti se si janë ndier. A kishin frikë?

Përsëritje

Përko këta njerëz me përshkrimet e tyre më poshtë:

1. Herodianët; 2. Jezusi; 3. Juda Iskarioti;
4. Dishepujt; 5. Farisenjtë; 6. Demonët.

4. Kush ishin ndjekësit e veçantë të Jezusit?

6. Kush i shërbente Jezusit në qiell?

1. Kush ishin ndjekësit e mbretit Herod që donin të vrisnin Jezusin?

3. Kush e tradhtoi Jezusin tek armiqtë e tij?

2. Kush mund të qetësojë erërat dhe detet?

5. Kush ishin xhelozë për Jezusin?

Pyetje dhe përgjigje

1. Pse mund t'i shëronte Jezusi të sëmurët?
Sepse Ai është Perëndia.

2. Pse donin herodianët të vrisnin Jezusin?
Si ndjekës të mbretit Herod ata ishin të shqetësuar që Jezusi do të zinte vendin e mbretit. Ata nuk donin një mbret tjetër.

3. Kush i shërbente Jezusit në qiell, por tani ndiqte Satanin? **Frymërat e ndyra ose demonët.**

4. Kë zgjodhi Jezusi për ta ndihmuar që të mësonin, shëronte dhe dëbonte demonët?
Dishepujt (12).

5. Cili ishte dishepulli të cilin Jezusi e dinte që do ta tradhtonte një ditë? **Juda Iskarioti.**

- Jezusi u tha frymërave të ndyra të heshtnin.
 - Ai nuk donte që njerëzit t'i besonin Atij për shkak të asaj që thoshin demonët.
 - Jezusi donte që njerëzit të kuptonin, përmes mësimi të Tij, që ata ishin mëkatarë dhe që kishin nevojë për Të si Shpëtimtarin e tyre⁵¹.

5. Jezusi zgjodhi dymbëdhjetë dishepujt - Marku 3:13-19.

- Jezusi kishte shumë dishepuj që e ndiqnin për të mësuar mesazhin e Perëndisë.
- Nga grupi i madh i ndjekësve të Tij, Jezusi zgjodhi dymbëdhjetë burra që të bëheshin dishepujt e Tij të veçantë për ta ndihmuar në veprën e Tij të mësimi, shërimit dhe dëbimit të demonëve⁵².
 - Jezusi planifikoi t'i trajnonte ata njerëz për t'u bërë apostujt e Tij apo përfaqësuesit e veçantë.
 - Shumë nga dymbëdhjetë dishepujt që zgjodhi Jezusi nuk ishin shumë të shkolluar.
 - Asnjë prej tyre nuk ishte i pasur.
 - Disa prej tyre ishin peshkatarë para se të fillonin të ndiqnin Jezusin si dishepujt e Tij.
 - Megjithatë, ata panë rëndësinë e besimit dhe mësimi nga Jezu Krishti, të Cilin Perëndia e kishte dërguar në botë.
- Të gjithë i besuan, përveç njërit - Juda Iskariotit.
 - Juda tha që ishte dakord me Perëndinë dhe me të vërtetë besoi te Jezusi, por foli vetëm me buzë.
 - Ai ishte hipokrit; mendja e tij nuk ishte dakord me Perëndinë.
 - Ai nuk besoi me të vërtetë te Jezusi si te Çlirimtari i tij nga kontrolli i Satanit, mëkatit dhe vdekjes.
- Njëmbëdhjetë dishepujt e tjerë nuk e dinin se Juda nuk ishte besimtar i vërtetë.
- Jezusi e dinte se çfarë mendonte Juda.
 - Jezusi e dinte se Juda do ta tradhtonte një ditë në duart e armiqtë të Tij.

6. Stuhia - Marku 4:35-37.

- Ishte mbrëmje. Jezusi u tha turmave të ktheheshin në shtëpi. Ai dhe dymbëdhjetë dishepujt e Tij hipën në barkë dhe u nisën për të shkuar në anën tjetër të liqenit (Detit të Galileesë).
- U bë një stuhi e madhe.
 - Erërat po frynin dhe valët e mëdha po përplaseshin në barkë, aq sa ajo po mbushej me ujë⁵³.

7. Dishepujt e zgjuan Jezusin - Marku 4:38.

- Jezusi po flinte në fund të barkës.
 - Edhe pse Jezusi ishte Perëndia, Ai ishte njeri i vërtetë.
 - Ai u lodh dhe donte të flinte, ashtu si ne.
- Dishepujt nuk mund të kuptonin se si mund të vazhdonte të flinte Jezusi dhe të mos shqetësohej, kështu që e zgjuan.
 - Dishepujt duhet ta dinin se Jezusi kujdesej për atë që po u ndodhte.

8. Jezusi qetësoi stuhinë - Marku 4:39-41.

→ Figura 51: Jezusi qetëson detin

- Jezusi, duke qenë Perëndi, krijoi detin dhe erën.
- Stuhia duhej të ndalej kur Jezusi e urdhëroi të ndalej, sepse Ai është krijuesi dhe zotëruesi i vërtetë i çdo gjëje.
- Jezusi i pyeti dishepujt se përse nuk besonin tek Ai.
 - Dishepujt kishin harruar se Perëndia shikon gjithçka, tërë kohën, qoftë e mirë, qoftë e keqe.

Ne do të mësojmë shumë gjëra rreth Jezusit nga ajo që Perëndia ka shkruar në Fjalën e Tij, rreth kohës që ai kaloi me dishepujt e Tij. Perëndia dëshiron që të gjithë ta njohin!

Mësimi 51

Qëllimi

Ky mësim e tregon sërish Jezusin si Perëndia Shumë i Lartë, i Cili është në gjendje të shërojë plotësisht një njeri që ka qenë i pushtuar në mënyrë të pashpresë nga demonët. Gjithashtu tregon se njerëzit nuk janë në gjendje të çlirohen vetë nga Satani dhe mëkati.

Gjithashtu, fëmijët do të shohin:

- Që Jezu Krishti është më i fortë se Satani dhe mund t'i çlirojë njerëzit nga pushteti i Satanit.
- Që Jezusi kujdeset për njerëzit në situata të pashpresa.
- Që vetëm Jezusi mund t'i shpëtojë.

Hyrje

Disa prej fëmijëve të klubit tënd mund të kenë anëtarë familjeje apo miq që janë të përfshirë thellë në droga apo madje flasin për vetëvrasjen. Shoqëria nuk ka një ndihmë të përhershme apo përgjigje për njerëz në këto kushte. Gjëja e vetme që mund të bëjnë njerëzit është të përqipen të rregullojnë problemet e njëri-tjetrit. Megjithatë, Jezu Krishti ofron jetë të re dhe fuqi për ta jetuar në një mënyrë që i pëlqen Perëndisë!

Figurat

- Figura 52: Jezusi shëron një njeri të pushtuar nga demonët



Jezusi shëron një njeri të pushtuar nga demonët

Historia

“Xhaxhi Piter, a e mban mend atë shokun që kisha, të cilin e kapën duke vjedhur?” - pyeti Xhoni.

“Po, e mbaj mend, Xhon” - tha xhaxhi Piteri. “E ke takuar prapë?”.

“Shiko, e pashë dje në qytet” - tha Xhoni. “Ai dëshiron të më takojë ndonjë ditë. Ai thotë që po i shkojnë mirë gjërat tani”.

“Dëgjova që po përdorte dhe shiste drogë” - tha Karola.

“Po,” - tha Xhoni, - “edhe unë e dëgjova. Ai nuk dukej mirë”.

“Ke ndërmend ta takosh prapë, Xhon?” - e pyeti xhaxhi Piteri.

“Jo,” - u përgjigj Xhoni, - “nuk jam i interesuar të shoqërohem më me atë lloj tipi. Kam frikë se mos futem në telashe”.

“Do të doja që dikush ta ndihmonte me problemin e tij” - tha Karola. “Ai ka qenë një mik i mirë”.

“Oh, njerëzit janë përpjekur ta ndihmojnë” - tha Xhoni. “Por ai vazhdon të refuzojë ndihmën e tyre. Fqinjët e tij mendojnë se nuk ka shpresë për të. Ata thonë që është bërë i papërmbajtshëm.”

“E di se çfarë duan të thonë,” - tha xhaxhi Piteri, - “dhe kanë të drejtë nëse po flasin rreth një personi apo programi për ta ndihmuar. Por ai mund të ndryshojë!”.

“Si?” - pyeti Karola.

“Në të njëjtën mënyrë që Perëndia e ka bërë të mundur për ty dhe mua, për të na falur dhe për të na pastruar nga mëkatet tona” - tha xhaxhi Piteri. “A e mbani mend se çfarë i tha Jezusi Nikodemit?”.

“Ai i tha atij se duhet të lindte sërish” - tha Xhoni.

“Por problemi i këtij miku të vjetër është pak më madh se i Nikodemit” - tha Karola. “A nuk ka nevojë për diçka më tepër?”.

“Karola, mëkati është mëkat” - tha xhaxhi Piteri. “Meriton të njëjtin ndëshkim: vdekjen. Jezu Krishti është i vetmi që mund t'i ndihmojë mëkatarët. Nuk ka përgjigje tjetër për ju, mua apo ndonjë njeri tjetër në botë”.

“Por pyes nëse Jezusi ka qenë në gjendje të shërojë dikë në gjendje kaq të keqe” - tha Karola.

“Sigurisht!” - tha xhaxhi Piteri. “Jezusi është Perëndi. Nuk ka asgjë të vështirë për Të. Bibla paraqet disa histori të mrekullueshme e të vërteta të njerëzve me probleme tepër të vështira, që u ndryshuan tërësisht nga Jezusi”.

“Por kjo ndodhi kur Jezusi ishte në tokë si njeri” - tha Xhoni. “Po sot?”.

“Jezusi nuk ka ndryshuar” - tha xhaxhi Piteri. “Ai u jep akoma jetë të re njerëzve që i besojnë Atij. A e mbani mend atë predikuesin që takuam javën që shkoj? Një herë e një kohë edhe ai merrte drogë”.

“Ua! E vështirë për ta besuar” - tha Xhoni. “Nuk ta jep përshtypjen fare. Edhe ai e njuh Biblën, apo jo, xhaxhi Piteri?”. “Po,” - tha xhaxhi Piteri, - “dhe ka shumë njerëz si ai: nën ndikimin e Satanit, por të çliruar nga Jezusi. Sot mund të shohim një histori në Bibël rreth një njeriu nga Gadara që ishte i pushtuar nga demonët. Edhe ky ishte një njeri për të cilin askush nuk mendonte se mund të ndryshonte. Por nuk ka asgjë të pamundur për Perëndinë. Merrni Biblën dhe ne mund ta lexojmë tani”.

Le të shohim në Bibël



Gjoni 8:36 – “Pra, nëse Biri do t’ju bëjë të lirë, do të jeni me të vërtetë të lirë.”

Perëndia është i vetmi që mund t’i çlirojë njerëzit nga pushteti i Satanit. Sapo një person çlirohet nga Perëndia, Satani nuk mund ta kontrollojë përsëri.

Le të mendojmë

1. Si mund të pastrohemi nga mëkatet?
a. Të jemi të mirë; **b. Të lindim sërish**; c. Të pagëzohemi.
2. Sa lloj ndëshkimesh ka për mëkatet? **a. Një**; b. Dy; c. Katër.
3. Cili është ndëshkimi për tërë mëkatet?
a. Pagesa e një gjobe; b. Bërja e shumë veprave të mira; **c. Vdekja**.
4. Kush mund ta ndryshojë një person që të mos jetojë një jetë mëkatore?
a. Një predikues; **b. Perëndia**; c. Miqtë.
5. Kush nuk ndryshon kurrë? **a. Jezusi**; b. Satani; c. Predikuesit.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Dishepujt sapo kishin kaluar një përvojë shumë të frikshme në detin e Galilesë. Ata e kishin parë Jezusin të shëronte sëmundjet dhe të dëbonte demonët, por ata nuk e kishin parë kurrë të bënte diçka të tillë. Ai kishte urdhëruar stuhinë të ndalej dhe ajo u ndal! Nëse do t’i kishin mbajtur mend Shkrimet, ata do ta kishin ditur se në fillim Perëndia u kishte thënë ujërave të tërhiqeshin që të dilte toka e thatë dhe Ai kishte hapur Detin e Kuq, në mënyrë që izraelitët të mund të shpëtonin nga egjiptianët. Jezu Krishti është Perëndia Bir. Deti, në të cilin po lundronin Jezusi dhe dishepujt e Tij, i përkiste Atij. Ai bëri çdo gjë në fillim. Jezusi krijoi detin, erën, vetëtimat dhe retë. Ai ka fuqi për të ndryshuar çdo gjë.

Tani dishepujt do të mësonin edhe më tepër për fuqinë e Jezusit.

1. I demonizuari - Marku 5:1-5.

- Ky njeri nuk mund ta shpëtonte veten nga pushteti dhe kontrolli i këtyre frymërave të këqija.
- Njerëzit ishin përpjekur që ta mbanin brenda që të mos lëndohej, por demonët brenda tij ishin aq të fortë, sa që kishin këputur edhe zinxhirët.
- Ky njeri jetonte nëpër shpella që përdoreshin si varreza.
 - Ai nuk mund ta ndihmonte veten.
 - Nuk kishte shpresë për të⁵⁴.
- Satani dhe demonët e tij duan vetëm të shkatërrojnë njerëzit.
 - Edhe kur duket sikur Satani dhe demonët e tij po i trajtojnë njerëzit mirë, ata po presin akoma për një rast për t’i shkatërruar.
- Satani dhe demonët e tij e kishin torturuar këtë njeri aq shumë, sa që ai i bënte vazhdimisht dëme vetes.

Mendo:

Shumë njerëz sot përpiqen të vrasin veten. Satani dhe demonët e tij mund ta fusin këtë mendim në mendjet e tyre. Satani është gënjeshtar dhe vrasës. Ai e urren Perëndinë dhe urren njerëzit. Satani mund t’i shtyjë njerëzit të mendojnë se ata nuk mund të dalin nga problemet në të cilat janë futur. Edhe nëse duan të reshtin së vepruari në atë mënyrë, ata shtyhen të besojnë se nuk munden. Disa njerëz janë shumë të ngjashëm me njeriun nga Gadara; ata nuk kanë më një jetë normale dhe askush nuk di se si t’i ndihmojë.

⁵⁴Mund të na vijë keq për një njeri si ky dhe të mendojmë se sa mirë është që nuk jemi si ai, por çdo person i lindur në këtë botë është nën ndikimin e Satanit, është i pashpresë dhe pa ndihmë, siç ishte ky njeri. Satani nuk i shtyn shpesh njerëzit të bëjnë gjërat që bënte ky njeri, por Satani i mban njerëzit nën ndikimin e tij derisa t’i çlirojë Jezusi.





Lexo - Gjoni 3:16.

⁵⁵Mendo: Ti mund të thuash: “Shiko, në rregull për Nikodemin; por çfarë mund të themi për një njeri si ky nga Gadara apo një të droguar sot? A nuk janë ata të pashpresë?”. Nëse po përpiqen të ndihmojnë veten apo nëse po kërkojnë ndihmën e të tjerëve, përgjigjija është: “Po, ata janë të pashpresë”.

→ Figura 52: Jezusi shëron një njeri të demonizuar

⁵⁶A të kujtohet se çfarë ndodhi kur Satani erdhi të tundonte Jezusin në shkretëtirë? A fitoi Satani? Jo! Jezusi refuzoi të bënte diçka, të cilën Ati i tij nuk i kishte thënë ta bënte. Kush është më i fortë: Satani dhe demonët e tij apo Jezu Krishti?

Mateu 25:41; Zbulesa 20:10

Përsëritje

Shiko vargun përmendsh:

Pra, nëse Biri do t'ju bëjë të lirë, do të jeni me të vërtetë të lirë.

Pyetje dhe përgjigje

- Kush dëshiron t'i shkatërrojë njerëzit?
a. **Satani**; b. **Demonët apo frymërat e ndyra.**
- Kush mund ta çlirojë veten nga ndikimi i Satanit? **Askush.**
- Kush mund t'i çlirojë njerëzit nga ndikimi i Satanit? **Jezusi, Perëndia.**
- Kush është autoriteti më i lartë mbi Satanin dhe demonët e tij? **Perëndia.**
- Ku do t'i dërgojë Perëndia një ditë Satanin, demonët e tij dhe tërë njerëzit që e ndjekin? **Në liqenin e zjarrit.**
- Kush e ndryshoi njeriun e pushtuar nga demonët? **Jezusi.**

A mos vallë nuk ka shpresë për këto probleme? Satanit do t'i pëlqente që ata njerëz dhe pjesa tjetër e botës të mendonte kështu.

- Satani do të bënte çfarëdo që të mundte për t'i mbajtur njerëzit larg nga të besuarit e të vërtetës së Perëndisë.
 - Perëndia dëshiron të japë jetë të re; jetë të re nga lart, ashtu siç ia shpjegoi Jezusi Nikodemit⁵⁵.
 - Njerëzit nuk mund të çlirohen vetë nga ndikimi i Satanit.
 - Megjithatë Jezusi mund t'i çlirojë.

2. Demonët e njhnin Jezusin - Marku 5:6-7.

- Demonët e dinin se Jezusi ishte Krijuesi i tyre, Biri i Perëndisë.
 - Demonët kishin frikë se Jezusi mund t'i ndëshkonte menjëherë.
- Perëndia është autoriteti më i lartë mbi Satanin dhe tërë frymërat.
 - Ai mund të bëjë me ta atë që i pëlqen.

3. Jezusi i urdhëroi demonët të dilnin - Marku 5:8-10.

- Ka shumë, shumë frymëra apo demonë në botë.
 - Satani është drejtuesi i tyre.
- Demonët e dinin se ata nuk mund të dilnin kundër Jezusit që është Perëndia⁵⁶.
 - Ata e dinin se një ditë ata do viheshin nën autoritetin e Perëndisë.

4. Demonët u futën te derrat - Marku 5:11-14.

- Jezusi nuk i dërgoi këto frymëra të ndyra në ndëshkim të përjetshëm në atë kohë.
 - Ai u dha leje të futeshin te derrat.
 - Nuk ishte koha e Perëndisë që ata të ndëshkoheshin përfundimisht për rebelimin dhe mëkatën e tyre.
- Megjithatë Perëndia ka caktuar një kohë të ardhshme, kur Satani dhe tërë frymërat e ndyra do të ndëshkohen përgjithmonë në liqenin e zjarrit.

5. Një njeri i lirë - Marku 5:15.

- Ky njeri u çlirua nga kontrolli i Satanit dhe demonëve të tij me anë të fuqisë së Zotit Jezus.
 - Ai nuk kishte se përse të bënte gjërat që i thoshin demonët.
 - Ai ishte tani nën autoritetin e Perëndisë.

6. Njerëzit e marrë - Marku 5:16-17.

- Këta njerëz ishin të marrë, sepse donin më shumë që Jezusi të largohej, sesa të dëgjonin mësimet e Tij.

Ka akoma njerëz sot si këta, që jetojnë vetëm për të tashmen. Ata refuzojnë t'i dëgjojnë fjalët e Perëndisë, sepse u interesojnë më tepër gjërat e kësaj bote. Ata nuk janë të interesuar për atë që do t'u ndodhë pas vdekjes (Luka 12:13-34).

Kur vdesim, nuk mund të marrim asgjë me vete. Megjithatë, gjërat që Perëndia na mëson në Bibël na tregojnë se si mund të marrim jetën e përjetshme.

7. Një njeri me një mesazh - Marku 5:18-20.

- Ai kishte një histori të vërtetë, të mrekullueshme për t'u treguar të tjerëve.
- Ai nuk e ruajti këtë përvojë për vete. Ai i foli kujtdo që e dëgjonte për gjërat e mëdha që bëri Jezusi për të.

Nuk ka asgjë tepër të vështirë për Perëndinë. Ai çliroi njeriun nga Gadara; Ai mund të çlirojë këdo.

☞ *Thuaju fëmijëve të klubit të thonë Gjonin 8:36.*

Mësimi 52

Qëllimi

Ky mësim tregon që jeta ka të bëjë më tepër sesa thjesht me ushqimin dhe gjërat që zotërojnë njerëzit. Jezu Krishti shfaqet si Buka e Jetës që plotëson nevojat tona për shpëtimin nga mëkati dhe na jep jetën e përjetshme. Gjithashtu tregon që njerëzit nuk mund të shpëtojnë veten, si dhe nevojën e tyre për të besuar vetëm në veprën e Jezu Krishtit si Shpëtimtari i tyre.

Hyrje

Ndihmoji fëmijët e klubit tënd të kuptojnë se ushqimi që hamë do të na ndihmojë vetëm në këtë jetë. Të gjithë njerëzit kur të vdesin, do të jetojnë ose në qiell me Perëndinë, ose në ferr me Satanin dhe demonët e tij. Për të jetuar në qiell, ne duhet të pranojmë “ushqimin” frymëror që na jep Zoti. Vetëm Perëndia mund të na e sigurojë dhe e ka bërë këtë në Jezu Krishtin.

Figurat

- Figura 53: Jezusi ushqen 5 000 njerëz



Jezusi ushqeu pesë mijë njerëz

Historia

“Ua, ky ushqim është fantastik!” - tha Xhoni. “Mund të ha ushqim të tillë tërë ditën”.

“Është shumë i mirë” - tha Tomi. “Jam i gëzuar që më ftove të vij!”.

“Tom, jemi të gëzuar që je me ne” - tha xhaxhi Piteri.

“Po, jemi, Tom,” - tha Karola, – “por ti nuk po ha shumë; duhet të më ndihmosh ta mbaroj këtë ushqim përndryshe Xhoni duhet ta hajë vetë të gjithin!”.

“Kam ngrënë shumë” - tha Tomi. “Kam gjëra të tjera ndërmend tani”.

“A do të na flasësh për to?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Shiko,” - tha Tomi, - “po mendoja për babin tim dhe tim vëlla, Xhimin. Ata nuk e dinë se sa qejf është e tërë kjo”.

“Cila, Tom?” - pyeti Xhoni. “Do të thuash tërë ushqimi?”.

“Oh, jo ai” - u përgjigj Tomi. “Dua të them, ushqimi është fantastik dhe po kënaqem me ju të gjithë. Por po flisja për studimin tonë të Biblës”.

“Studimin e Biblës?” - e pyeti Xhoni. “Ti do të studioje më tepër Biblën, sesa të hajë?”.

“Po, Xhon” - u përgjigj Tomi. “Nuk kam ditur gjë më parë rreth Jezu Krishtit. Mendoj se edhe im atë dhe Xhimi do ta pëlqenin Jezusin nëse do të dëgjonin për Të”.

“Shiko, Tom, mund ta bëjnë këtë gjë një ditë” - tha xhaxhi Piteri. “Ata mund të shikojnë gëzimin tënd rreth asaj që po mëson dhe mund të të pyesin se për çfarë bëhet fjalë”.

“Tom, a do më ushqim?” - pyeti Karola. “Unë jam shumë e ngopur dhe nuk ha dot asnjë kafshatë tjetër. Mendoj se hëngra shumë!”.

“Jo, faleminderit, Karola” - tha Tomi. “Kur mund ta fillojmë studimin e Biblës? Dua të mësoj sa më tepër që të jetë e mundur sot!”.

“Në rregull,” - tha Karola, – “ju të dy më ndihmoni të pastroj tavolinën dhe mund të fillojmë”.

“A e dini,” - tha xhaxhi Piteri, - “ka diçka që mund ta hani vazhdimisht dhe ta shijoni gjithnjë e më tepër dhe asnjëherë të mos ngopeni! Problemi është se shumë njerëz nuk duket se mendojnë që kanë oreks për të”.

“Për çfarë po flet?” - e pyeti Xhoni.

“Po flas për Fjalën e Perëndisë” - tha xhaxhi Piteri. “Mendoj se Tomi është një prej atyre njerëzve që ka oreks për të. Shumica e njerëzve në kohën e Jezusit ishin si shumica e njerëzve sot. Do të preferonin më tepër ushqim për stomakun e tyre, sesa diçka për të kënaqur nevojat e tyre frymërore. Tom, sa mirë që ke etje dhe uri për të ditur më tepër rreth Perëndisë!”.

“Si mund të jetë dikush i uritur dhe i etur për Fjalën e Perëndisë?” - e pyeti Karola. “Nuk e kuptoj se si mund të na ndihmojë kjo të rritemi”.

“A e mban mend që, kur Adami dhe Eva mëkatuan, ata u ndanë menjëherë nga Perëndia?” - e pyeti xhaxhi Piteri. “Edhe pse ishin krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, me aftësinë për të njohur, për të dashur dhe për t’iu bindur Atij, ata nuk ishin më në gjendje të komunikonin me Perëndinë si miq. Ata ishin mëkatarë nën sundimin e Satanit. Dhe, si pasardhës të Adamit, të gjithë ne kemi lindur mëkatarë, të ndarë nga Perëndia”.

“Ua, nuk i dija tërë këto!” - tha Tomi. “Dhe si mund të rrijë dikush pa i dëgjuar tërë këto?”.

“Shiko, Tom, të gjithë ne mendojmë për ushqimin e trupave tanë; ai na duhet për t’u rritur” - tha xhaxhi Piteri. “Një ushqim i mirë do të na kënaqë për pak orë, por pastaj do të na marrë përsëri uria. Megjithatë, vetëm Jezusi mund t’i plotësojë nevojat tona, të cilat janë shumë të rëndësishme. Ai mund të na kënaqë, sepse vetëm Ai mund të na ndihmojë të kemi përsëri një marrëdhënie me Perëndinë. Ai erdhi për të na dhënë jetë të re: jetë që është e përjetshme, jetë që na kënaq përgjithmonë, jo thjesht për disa orë. Le t’i marrim Biblat dhe do t’ju tregoj se ku thotë Jezusi se është Buka e Jetës.”

⁵⁷Mendo: Nuk do të jetë ndihmë për dikë nëse ndjek mësimet e Biblës për të marrë para apo gjëra materiale. Jezusi nuk erdhi në botë për të dhënë pasuri tokësore. Besimi i Biblës, besimi te Jezusi si Shpëtimtar nuk na premtim kushte më të mira.

⁵⁸Mendo: Mbase kishin kaluar 1 400 vjet që kur izraelitët ishin larguar nga Egjipti atë natë Pashke. Pse kishte aq shumë judenj që festonin akoma Pashkën? A ishin të gjithë besimtarë të vërtetë në Perëndinë, duke pritur Çlirimtarin e Tij? Jo. Disa po e bënin, sepse ishte zakoni; të tjerë e festonin Pashkën, sepse donin t'i bindeshin Ligjit të Perëndisë nga ana e jashtme, edhe pse brenda vetes nuk u interesonte Perëndia, dhe as t'i besonin Atij. Por kishte disa prej tyre që e zbatonin Pashkën, sepse Perëndia i kishte urdhëruar ta bënin këtë; ata besonin te Perëndia dhe besonin se Ai do të dërgonte Çlirimtarin.

⁵⁹Jepu fëmijëve kohë të përgjigjen. Disa shembuj të mrekullive të Jezusit tashmë të mësuara: - Shëroi të sëmurët: një lebroz, një të paralizuar dhe dorën e një njeriu; - Qetësoi stuhinë; - Shëroi njeriun nga Gadara, të pushtuar nga demonët; - Dëboi demonët.

Le të shohim në Bibël



Gjoni 6:35 – “Dhe Jezusi u tha atyre: ‘Unë jam buka e jetës; kush vjen tek unë nuk do të ketë më kurrë uri dhe kush beson në mua, nuk do të ketë më kurrë etje.’”

Ushqimi për të cilin po flet Jezusi këtu, nuk është ushqimi për trupin për t'u rritur; është ushqimi për jetën tonë frymërore. Ne nuk mund të punojmë për të; ne mund ta marrim vetëm duke i besuar Perëndisë për të na dhënë atë që kemi nevojë.

Le të mendojmë

- Për çfarë nevojë mendojnë tërë njerëzit sot?
 - Ushqim dhe ujë;** b. Gjëra frymërore; c. Edukim.
- Çfarë nevojash të tjera të rëndësishme kanë njerëzit sot?
 - Argëtim; b. Punë; **c. Nevoja frymërore.**
- Pse kanë njerëzit nevoja frymërore?
 - Ata nuk e lexojmë Biblën; **b. Ata janë mëkatarë;** c. Ata parapëlqejnë më shumë ushqimin.
- Kush është i vetmi që mund të sigurojë për nevojat tona frymërore?
 - Satani; **b. Jezu Krishti;** c. Prindërit.
- Kur Jezusi plotëson nevojat tona frymërore, për sa kohë do të zgjasë?
 - Derisa të vdesim; b. Një vit; **c. Përgjithmonë.**

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Sot do të lexojmë për kohën kur Jezusi tha se Ai ishte Buka e Jetës. Ai i përdori këto fjalë, sepse buka ishte ushqimi që shumica e njerëzve hanë sot. Ata hanin edhe gjëra të tjera, por ata vareshin nga buka si burimi i tyre kryesor i energjisë dhe i ushqimit. Jezusi e dinte se njerëzit, përveç ushqimit, kishin nevojë për diçka tjetër. Energjia që marrim nga të ngrënit, zgjat vetëm për pak dhe pastaj na merr uria sërish. Ne na duhet jeta e përrjetshme që rrjedh nga Perëndia, për të cilën Ai na flet në Fjalën e Tij. Ne kemi lindur në mbretërinë e Satanit, pa jetën e përrjetshme me Perëndinë. Megjithatë, Jezusi na ofron jetën e përrjetshme, një jetë që i kënaq plotësisht të gjithë ata që besojnë vetëm tek Ai si Shpëtimtari i tyre. Mësimi i sotëm do të tregojë se si Perëndia kujdeset për nevojat fizike dhe frymërore të njerëzve.

1. Turmat ndjekin Jezusin - Gjoni 6:1-4.

- Pyeti fëmijët e klubit nëse ata e dinë se përse këta njerëz po e ndiqnin Jezusin nga pas. A mendojnë ata se këta njerëz e konsideronin veten mëkatarë?
 - Përgjigjia është jo; ata e ndiqnin sepse donin të merrnin diçka prej Tij⁵⁷. Atyre nuk u interesonin gjërat frymërore.
- Arsyeja se përse erdhi Jezusi ishte për t'i çliruar njerëzit nga Satani, mëkati dhe vdekja e përrjetshme: ndarja nga Perëndia.
- Pyeti fëmijët nëse mbajnë mend se çfarë ndodhi te Pashka shumë vjet më parë.

Kujtoni: Te Pashka judenjtë kujtuan natën e fundit që paraardhësit e tyre kaluan në Egjipt. A e kujtoni se si Engjëlli i Vdekjes kaloi tutje shtëpive të tyre, sepse çdo familje kishte therur një qengj dhe kishte vendosur gjakun në shtalkat e shtëpisë? Perëndia u tha atyre se çdo vit ata duhet të therrnin dhe të hanin një qengj, si kujtesë e çlirimit të paraardhësve të tyre nga Ai. Populli jude udhëtonte në distanca të largëta për të festuar Pashkën, e cila zhvillohej në Jerusalemin çdo vit (Eksodi 12:1-28; Ligji i Përtërirë 16:1-8)⁵⁸.

2. Pesë bukë dhe dy peshq të vegjël - Gjoni 6:5-9.

- Tashmë Jezusi kishte vendosur se çfarë do të bënte.
 - Ai ia bëri pyetjen dishepullit të tij, Filipit, thjesht për të dëgjuar përgjigjen e tij.
 - Filipi kishte parë mrekulli të tjera që kishte bërë Jezusi.
 - Pyeti fëmijët nëse i mbajnë mend disa prej mrekullive të Jezusit⁵⁹.
 - Filipi duhet të kishte besuar se Jezusi ishte në gjendje t'i ushqente njerëzit.

⁶⁰Nëse një fëmijë flet për rastin kur Pjetri eci mbi ujë, thuajti që ndodhi, ngaqë Jezusi kreu një mrekulli për ta bërë Pjetrin të ecte. Ishte fuqia e Jezusit, jo aftësia e Pjetrit.

⁶¹Jezusi po u thoshte njerëzve se ata nuk duhet të shqetësohen vetëm për nevojat fizike; ata gjithashtu duhet të bëjnë të pamundurën për t'u siguruar se do të jetojnë përgjithmonë me Perëndinë kur të largohen nga kjo botë (Luka 12:15-23). Jezusi po u thoshte atyre që të mendonin për të marrë ushqimin e përjetshëm dhe frymëror. Ky ushqim frymëror është e vërteta që Jezusi po u mësonte atyre. A do të jetojmë përherë në qiell apo në vendin e ndëshkimit të përjetshëm, të quajtur ferr. Çfarë dobie do të kenë një trup i shëndetshëm apo pasuritë nëse kur vdesim, nuk do të shkojmë në qiell (Mateu 25:46)?

Përsëritje

J	X	C	P	E	U	R	SH	O	N	L	K	O	A
E	C	U	C	X	SH	U	P	A	R	A	J	S	A
Z	Y	V	Y	N	Q	E	E	I	U	I	Z	X	F
U	Z	D	X	Y	I	C	T	X	Z	Z	B	X	E
S	H	E	Y	F	M	U	I	I	X	U	J	E	RR
I	SH	K	E	T	O	I	M	T	A	R	I	X	L
Z	X	J	X	C	D	C	T	X	J	X	I	Y	I
E	N	E	F	G	P	N	A	C	E	Y	M	C	T
J	E	T	A	E	P	E	R	J	E	T	SH	M	E
B	U	K	A	E	J	E	T	E	S	S	T	C	T

Pyetje dhe përgjigje

1. Pse e ndiqnin njerëzit Jezusin? **Për të marrë diçka prej tij.**
2. Pse e la Jezusi qiellin për të ardhur në tokë? **Për t'i çliuar njerëzit nga pushteti i Satanit, mëkatit dhe vdekjes së përjetshme larg Perëndisë.**
3. Për çfarë kanë nevojë njerëzit që t'u japin jetë trupave të tyre? **Ushqim.**
4. Për çfarë kanë nevojë njerëzit për të marrë jetë të përjetshme në qiell me Perëndinë? **Bukën e Jetës - Jezu Krishtin si Shpëtimtari i tyre.**
5. Kush na e dha Bukën e Jetës? **Perëndia Atë.**

3. Jezusi ushqe pesë mijë njerëz - Gjoni 6:10-12.

- Ndërsa Jezusi ndante bukët dhe peshqit, ato shumoheshin e shumoheshin.

→ Figura 53: Jezusi ushqen 5 000 njerëz.

Mendo: A mundet që tërë familja jote dhe tërë kushërinjtë e tu të ngopen nga një simite e vogël? Jo! Askush veç Perëndisë, i Cili është Shumë i Larti, nuk mund ta bëjë këtë gjë.

4. Plani i njerëzve - Gjoni 6:14-15.

- Dukej se njerëzit ishin gati të binin dakord që Jezusi duhet të ishte Shpëtimtari, të Cilin Perëndia kishte premtuar për ta dërguar në botë.
 - Megjithatë, ata akoma nuk e shikonin nevojën që të ishte Ai Shpëtimtari i tyre nga pushteti i Satanit, mëkatit dhe vdekjes.
- Ata donin që Jezusi të ishte mbreti i tyre, në mënyrë që Ai t'i shëronte sëmundjet e tyre, t'u jepte ushqim dhe t'i çlirohte nga kontrolli i romakëve.

5. Jezusi ecën mbi ujë - Gjoni 6:16-21.

- Njeriu ka arritur të bëjë shumë gjëra, por nuk ka arritur të ecë mbi ujë⁶⁰.
- Jezusi krijoi detin, ndaj nuk ishte e vështirë që Ai të ecte mbi të (Kolozianëve 1:16).

6. Njerëzit e kërkuan Jezusin - Gjoni 6:22-26.

- Jezusi i njihte mendjet e këtyre njerëzve. Ai i njihte arsyet e vërteta se përse po e kërkonin.

7. Jezusi, Buka e Jetës - Gjoni 6:27-35.

- Jezusi nuk po thoshte që ishte e gabuar të punoje për të fituar ushqimin⁶¹.
- Ne nuk mund të bëjmë diçka për t'i pëlqyer Perëndisë apo për t'u pranuar prej Tij.
 - Perëndia kërkon prej nesh që të besojmë vetëm te Jezusi si Shpëtimtari ynë.

Kujtoni: Çfarë duhej të bënin njerëzit që u kafshuan nga gjarpërinjtë në shkretëtirë për t'u shpëtuar nga vdekja? Atyre u duhej vetëm të shikonin gjarprin prej bronzi që Moisiu vendosi mbi shtizë. Ata nuk mund të bënin asgjë për të shpëtuar veten. I tillë duhet të jetë besimi që dëshiron Perëndia të kemi te Shpëtimtari Jezu Krisht. Vetëm Ai mund të na çlirojë nga vdekja dhe të na bëjë të pranueshëm te Perëndia.

- Njerëzit akoma nuk besonin te Jezusi; ata donin të shikonin një mrekulli tjetër.
- Ata po shikonin gjërat e mëdha që bëri Jezusi, në vend të dëgjimit të së vërtetës që po mësonte.
 - Ata i kujtuan Jezusit manën, që hëngrën paraardhësit e tyre në shkretëtirë për dyzet vjet. Ata menduan se ishte Moisiu, dhe jo Perëndia, që u dha manën.
 - Ata thanë që nëse Jezusi ishte me të vërtetë Biri i Perëndisë, Ai duhet të jepte një shenjë, ashtu siç u dha Moisiu.
- Jezusi u tha atyre që ishte Ati i Tij, jo Moisiu, që ua dha manën paraardhësve të tyre, në mënyrë që ata të mos vdisnin në shkretëtirë.
- Tani Perëndia u kishte dhënë bukën e vërtetë nga qielli.
 - Jezusi po fliste për veten. Jezusi është buka që Perëndia dha, në mënyrë që bota të mos vdiste dhe të ndahej nga Ai përgjithmonë.
- Por njerëzit ishin akoma duke menduar për ushqimin për trupat e tyre.
 - Ata donin që Jezusi të vazhdonte t'u jepte ushqim, ashtu siç i kishte ushqyer me bukë dhe peshq.

Perëndia u dha izraelitëve **manën** nga qielli dhe **ujin** nga shkëmbi **për t'i shpëtuar nga vdekja fizike** në shkretëtirë. Perëndia dërgoi **Jezusin** nga qielli në botë **për t'i shpëtuar mëkatarët nga vdekja e përjetshme.**

Nëse një person refuzon të hajë ushqim, trupi i tij do të vdesë dhe kushdo që refuzon të besojë te Jezusi si Shpëtimtari i tij, do të mbetet i vdekur para Perëndisë, i ndarë përgjithmonë prej Tij. Jezu Krishti është i vetmi që mund të na bëjë të pranueshëm para Perëndisë dhe të na japë jetë të përjetshme me Të!

Mësimi 53

Qëllimi

Mësimi i sotëm do të jetë një përsëritje e atyre që kemi mësuar gjatë dhjetë mësimeve të fundit. Mund të bësh pyetje të tjera apo t'i përshtatësh pyetjet me moshën e fëmijëve të klubit tënd. Të lutem referoju faqeve 33-34 të Manuali i Mësuesit "Rrënjët e besimit", pjesa e parë, për ndihmë se si t'i zhvillosh mësimet dhe lojërat e përsëritjes.

Hyrje

Kjo do të jetë një ditë përsëritjeje. Mund të përdorësh pyetjet për të zhvilluar një Test Awana me fëmijët. Këto pyetje mbulojnë vetëm dhjetë mësime të fundit.

Pyetje, pyetje, pyetje!

Historia

Sot nuk do të kemi histori për të treguar.

Le të shohim në Bibël



Le të shohim se sa vargje kanë mësuar fëmijët përmendsh dhe nëse janë akoma në gjendje t'i thonë. Bëj nga një pyetje për secilin nga 10 vargjet që kemi përdorur në dhjetë mësime të fundit. Shembull: Kush mund të thotë Gjonin 1:29? Si e quan Gjoni Jezusin në këtë varg? Përgjigju pyetjes

dhe cito vargun përmendsh që i përgjigjet kësaj pyetjeje. Fëmijët mund të fitojnë pikë shtesë për recitimin e tërë vargjeve.

Gjoni 8:36; Mateu 1:23; 1 Gjonit 1:8; Gjoni 1:17; Gjoni 3:16; Gjoni 6:35; Isaia 9:6; Gjoni 20:31; Gjoni 1:29; Mateu 4:4.

Le të mendojmë

Gjatë dhjetë mësimeve të fundit kemi studiuar nga pjesa e Dhiatës së Re në Bibël. Mësuam se si Gjon Pagëzori përgatiti popullin për ardhjen e Çlirimtarit, Jezu Krishtit; Ai përmes të Cilit Perëndia do të përmbushte premtimin e Tij ndaj Abrahamit. Mësuam rreth lindjes së Jezu Krishtit, sidomos duke e bërë të qartë përmbushjen e profecisë dhe Hyjnisë së Krishtit: Biri i Perëndisë dhe Perëndia Bir. Thekso faktin që Jezusi është njeriu i vetëm pa mëkat. Përmes shërbesës së Gjon Pagëzorit na tregohet nevoja për një qëndrim pendese. Drejtuesit fetarë ishin shembuj të atyre që ishin krenarë dhe të papenduar; ata e refuzuan Jezusin. Ne pamë Jezusin të tunduar nga Satani dhe se si Jezusi i bëri ballë atij dhe se si një ditë do t'i hedhë Satanin dhe demonët e tij në liqenin e zjarrit. Jezusi shfaqet si rruga e vetme e shpëtimit për njerëzit. Ata nuk mund të bëjnë asgjë për të shpëtuar veten. Mësuam për mrekullitë e Jezusit të shërimit fizik, një shenjë tjetër e Hyjnisë së Tij. Gjithashtu, Jezu Krishti shfaqet si Buka e Jetës, që plotëson nevojat tona për shpëtim nga mëkati dhe na jep jetë të përjetshme.

Gjon Pagëzori: Zakaria, një prift i tempullit në Jerusalem dhe gruaja e tij, Elizabeta, i besuan Perëndisë dhe Fjalës së Tij. Perëndia u premtoi atyre që do të kishin një djalë; ata do ta quanin Gjon. Djali i Zakarisë do të ishte profeti që do të përgatiste popullin për të pranuar Çlirimtarin që do të vinte.

1. Çfarë u tha Gjoni njerëzve? **Ata duhej të pendoheshin dhe të pagëzoheshin.**
2. Çfarë do të thotë të pendohesh? **Pendimi është një ndryshim i mënyrës se si mendojmë rreth vetes, mëkatit tonë dhe Perëndisë. Do të thotë që biem dakord me Perëndinë që ne jemi mëkatarë, se nuk i jemi bindur ligjeve të Tij dhe se nuk jemi në gjendje të jemi të pranueshëm nga Perëndia.**
3. A duhet të pagëzohemi për t'u shpëtuar nga Satani, mëkati dhe vdekja? **Jo, pagëzimi nuk mund të bëjë gjë për të na çliruar nga kontrolli i mëkatit apo për të na bërë të pranueshëm para Perëndisë.**
4. Pse u tha Gjoni njerëzve që të pagëzoheshin? **Perëndia tha që me anë të pagëzimit njerëzit duhet të tregonin se binin me të vërtetë dakord me Të.**
5. Kë pagëzoi Gjoni një ditë, i Cili ishte më i madh se ai? **Jezusin.**
6. Si e quajti Gjoni Jezusin një ditë, kur e pa duke shkuar drejt tij? **Qengji i Perëndisë, i Cili heq mëkatin e botës.**

Drejtuesit fetarë, judenjtë dhe frymërat e ndyra: Skribët, farisenjtë dhe saducenjtë ishin drejtues fetarë judenj gjatë kohës të Gjon Pagëzorit dhe Jezu Krishtit. Edhe njerëzit, të cilët u mësuan nga Gjoni dhe Jezusi ishin judenj.

1. Pse priftërinjtë dhe drejtuesit fetarë nuk e pranuan mësimin e Gjonit?
 - a. **Ata mendonin se tashmë ishin të pranuar nga Perëndia për shkak të gjërave që bënin: veprat e tyre të mira.**
 - b. **Ata mendonin se Perëndia do t'i pranonte për shkak se ata ishin pasardhës të Abrahamit.**
2. Çfarë u tha Jezusi njerëzve se duhet të bënin? **Jezusi tha se ata duhej të ndryshonin mënyrën e tyre të menduarit, të binin dakord me Perëndinë që ata ishin mëkatarë të pashpresë dhe të besonin “ungjillin” apo lajmin e mirë, të cilin Jezusi erdhi t'u shpallte.**
3. Cili ishte lajmi i mirë që Jezusi erdhi t'u shpallte? **Duke besuar te Perëndia dhe te Shpëtimtari, ne mund t'i shpëtojmë kontrollit të Satanit dhe të kemi miqësi me Perëndinë.**
4. Cili ishte ndryshimi midis mënyrës se si mësonin skribët dhe Jezusi? **Ngaqë Jezusi është Perëndi; Ai e njihnte Atin e Tij. Ai e kuptonte në mënyrë të qartë Fjalën e Perëndisë. Skribët mësonin atë që mendonin se nënkuptonin Shkrimet; ata nuk e njihnin me të vërtetë.**
5. Kush ishin demonët në fillim? **Ata ishin engjëj të Perëndisë, derisa ndoqën Satanin në rebelim kundër Perëndisë.**
6. Pse kishin frikë demonët nga Jezusi? **Ata e dinin se Ai ishte Krijuesi i tyre dhe gjykatësi i tyre dhe se një ditë, Ai do t'i hidhte në zjarrin e përjetshëm për t'i ndëshkuar.**
7. Pse drejtuesit fetarë e shikonin nga afër Jezusin? **Sepse ata e urrenin Atë dhe donin të gjenin ndonjë arsye për të cilën të mund ta akuzonin dhe ta vrisnin.**
8. Pse drejtuesit fetarë e urrejnë Jezusin aq shumë?
 - a. **Sepse Jezusi tha se Ai ishte Biri i Perëndisë: Çlirimtari i premtuar.**
 - b. **Sepse Jezusi u tha atyre se sa të këqinj ishin; ata ishin mëkatarë.**
 - c. **Sepse ata ishin xhelozë që turmat ndiqnin Jezusin.**
9. Kush është drejtuesi i tërë demonëve që jetojnë këtu në tokë? **Satani.**
10. Pse donin herodianët ta vrisnin Jezusin? **Si ndjekës të mbretit Herod, ata ishin të shqetësuar që Jezusi do të zinte vendin e mbretit. Ata nuk donin një mbret tjetër.**
11. Kush dëshiron që t'i shkatërrojë njerëzit? **Satani dhe ndjekësit e tij, demonët.**
12. Kush mund ta çlirojë veten nga kontrolli i Satanit? **Askush.**
13. Kush mund t'i çlirojë njerëzit nga kontrolli i Satanit? **Jezusi, Perëndia.**
14. Kush është sovrani më i lartë mbi Satanin dhe demonët e tij? **Perëndia.**
15. Çfarë tha Jezusi se duhet të bëjë një mëkatar për t'u çliuar nga pushteti i Satanit? **Të besojë te Jezu Krishti.**

Jezusi: Jezu Krishti është Perëndi dhe Njeri. Ai është Biri i Perëndisë, Perëndia Bir.

1. Kush është Çlirimtari? **Jezusi.**
2. Çfarë do të thotë emri Jezus? Çlirimtar apo **Shpëtimtar.**
3. A ka shpëtimtarë të ndryshëm për njerëz në pjesë të ndryshme të botës? **Jo, ka vetëm një Shpëtimtar për tërë botën.**
4. Nga erdhi Jezusi, Shpëtimtari? **Jezusi është Biri i Perëndisë; Perëndia e dërgoi nga qielli.**
5. Cila ishte mamaja e Jezusit? **Maria.**
6. Jozefi dhe Maria janë pasardhës të Adamit. Çfarë trashëguan pasardhësit e Adamit prej tij? **Mëkatin, të gjithë kanë lindur në mëkat.**
7. A lindi Jezusi në mëkat? **Jo, sepse Perëndia ishte Ati i Tij. Perëndia është pa mëkat.**
8. Ku lindi Jezusi? **Në Bethlehëm.**
9. Kush ishin tre burrat që ndoqën yllin për të gjetur Jezusin dhe për ta adhuruar? **Dijetarët.**
10. Kush u përpoq ta vriste Jezusin kur ishte foshnjë, sepse ishte xheloz për të? **Mbreti Herod.**
11. Në cilin qytet u rrit Jezusi? **Në Nazaret.**
12. Jezusi dukej si fëmijët e tjerë ndërsa rritej, por nga ndryshonte nga ata? **Jezusi ishte edhe Perëndi, edhe genie njerëzore.**

Përsëritje

Aktivitet: Përko referencën me vargun e saktë.

1. Gjoni 8:36;
2. Mateu 1:23;
3. 1 Gjoni 1:8;
4. Gjoni 1:17;
5. Gjoni 3:16;
6. Gjoni 6:35;
7. Isaia 9:6;
8. Gjoni 20:31;
9. Gjoni 1:29;
10. Mateu 4:4

7 Sepse na ka lindur një fëmijë, një djalë na është dhënë. Mbi supet e tij do të mbështetet perandoria dhe do të quhet Këshilltar i admirueshëm, Perëndi i fuqishëm, Atë i përjetshëm, Princ i paqes.

2 Ja, virgjëresha do të mbetet shtatzënë dhe do të lindë një djalë, të cilit do t'i vënë emrin Emanuel, që do të thotë: "Zoti me ne".

9 Të nesërmen, Gjoni e pa Jezusin që po vinte drejt tij dhe tha: "Ja, Qengji i Perëndisë, që heq mëkatet e botës!".

10 Por ai, duke iu përgjigjur, tha: "Është shkruar: 'Njeriu nuk rron vetëm me bukë, por me çdo fjalë që del nga goja e Perëndisë'".

4 Sepse Ligji u dha nëpërmjet Moisiut, por hiri dhe e vërteta erdhën nëpërmjet Jezu Krishtit.

5 Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.

8 Por këto gjëra janë shkruar që ju të besoni se Jezusi është Krishti, Biri i Perëndisë dhe që, duke besuar, ta keni jetën në emër të tij.

3 Po të themi se jemi pa mëkat, gënjejmë vetveten dhe e vërteta nuk është në ne.

1 Pra, nëse Biri do t'ju bëjë të lirë, do të jeni me të vërtetë të lirë.

6 Dhe Jezusi u tha atyre: "Unë jam buka e jetës; kush vjen tek unë nuk do të ketë më kurrë uri dhe kush beson në mua, nuk do të ketë më kurrë etje".

13. A bëri Jezusi ndonjë gjë të gabuar? **Jo, Jezusi lindi pa mëkat dhe kurrë nuk mendoi, tha apo bëri diçka që nuk i pëlqeu Atit të Tij, Perëndisë.**

14. A ka pasur një person tjetër pa mëkat si Jezusi? **Jo, gjithë të tjerët trashëguan mëkatet e Adamit dhe nuk iu bindën ligjit të Perëndisë.**

15. Pse Jezusi u kërkoi njerëzve që ta ndihmonin? **Ai donte t'i mësonte ata, në mënyrë që t'i dërgonte për t'u shpallur të tjerëve lajmin e mirë.**

16. Jezusi kishte shumë ndjekës, por sa dishepuj të veçantë zgjodhi Ai për ta ndihmuar që të mësonte, shëronte dhe dëbonte demonët? **Dymbëdhjetë.**

17. Cili ishte dishepulli që Jezusi e dinte që do ta tradhtonte? **Judë Iskarioti.**

18. Pse e ndiqnin njerëzit Jezusin? **Për të marrë diçka prej Tij.**

19. Pse i dëboi demonët dhe i shëroi të sëmurët Jezusi? **Ai pati dhembshuri dhe i donte.**

20. Në cilën mbretëri ndodhen ata që kanë lindur vetëm një herë? **Në mbretërinë e Satanit.**

21. Në cilën mbretëri ndodhen ata që kanë lindur dy herë? **Në mbretërinë e Perëndisë.**

22. Pse e dërgoi Perëndia Birin e Tij, Jezusin, Shpëtimtarin në botë? **Sepse Ai nuk do që ndokush të shkojë me Satanin në shkatërrim të përjetshëm.**

23. Çfarë lloj njerëzish do të shpëtojë Jezusi? **Ata që besojnë se janë mëkatarë dhe që kanë nevojë për një shpëtimtar.**

24. Kush mund t'i falë mëkatet? **Perëndia (apo Jezusi).**

25. Pse i fali Jezusi mëkatet e të sëmurit? **Sepse ai besoi te Jezusi.**

26. Çfarë marrin njerëzit që besojnë te Jezusi si Shpëtimtari i tyre? **Jetë të përjetshme.**

27. Kush i tha Mateut se çfarë duhej të shkruante në librin e parë të Dhiatës së Re? **Fryma e Shenjtë.**

28. Për çfarë kanë nevojë njerëzit për trupat e tyre për jetën në tokë? **Për ushqim.**

29. Për çfarë kanë nevojë njerëzit për jetën e përjetshme në qiell me Perëndinë? **Për Bukën e Jetës: Jezu Krishtin si Shpëtimtarin e tyre.**

30. Kush është i vetmi që mund të na bëjë të pranueshëm para Perëndisë dhe të na japë jetën e përjetshme me Të? **Jezu Krishti.**

Pyetje për diskutim

1. Kush e ndihmoi gjithmonë Jezusin në gjithçka që bëri këtu në tokë? **Perëndia Frymë e Shenjtë e drejtoi dhe ndihmoi Jezusin në gjithçka që bëri.**
2. Çfarë tha Perëndia Atë kur u pagëzua Jezusi?
 - a. **Perëndia Atë tha se Ai ishte tërësisht i kënaqur me Jezusin.**
 - b. **Ai e quajti Jezusin Birin e Tij.**
3. Pse e tundoj Satani Jezusin?
 - a. **Ai donte që Jezusi të mëkatonte, në mënyrë që ai të mund ta vinte Atë nën kontrollin e tij.**
 - b. **Ai donte që Jezusi të mëkatonte, në mënyrë që Jezusi të mos ishte në gjendje të na çlironte prej tij.**
 - c. **Ai donte që të merrte pozicionin e Perëndisë.**
4. Pse nuk i ktheu Jezusi gurët në bukë, edhe pse ishte i uritur? **Ati i Tij nuk i kishte thënë; Jezusi bëri vetëm atë që i kishte urdhëruar Ati i tij.**
5. A e di Satani dhe a e përdor Fjalën e Perëndisë? **Po, por Satani shtrembëron (ndryshon) fjalët e Perëndisë për t'ia përshtatur qëllimeve të tij.**
6. Pse nuk i la Jezusi njerëzit që ta bënë mbretin e tyre? **Sepse Ai i njihje mendimet e njerëzve. Ata nuk e donin Jezusin, që Ai të mund t'i çlironte nga Satani, mëkati dhe vdekja. Ata e donin që thjesht të ishte mbreti i tyre, në mënyrë që Ai t'u jepte gjëra dhe t'i çlironte nga romakët, që kontrollonin vendin e tyre.**

Mësimi 54

Qëllimi

Ky mësim, i cili paraqet hipokrizinë e farisenjve, tregon pafuqinë e çdo feje pa pranuar mëkatën dhe pa pasur besim të Perëndia. Gjithashtu do të paraqesë:

- Veprat e mira nuk mund t'i shpëtojnë njerëzit.
- Njerëzit nuk mund t'ia fshehin Perëndisë mëkatet e tyre.
- Njerëzit duhet t'i afrohen Perëndisë me anë të besimit, duke besuar te Jezu Krishti si Shpëtimtari i tyre.

Hyrje

Pyeti fëmijët nëse mendojnë se janë më të mirë se dikush që ata njohin, i cili pi, vjedh, gënjen, etj.. Pastaj pyeti nëse kanë mbajtur ndonjëherë ndonjë qëndrim të keq (mendime apo ndjenja) brenda vetes, por që janë përpjekur të mos e marrë vesh njeri. Shpjegoju se të gjithë sillemi kështu ndonjëherë; ne mund të jemi në gjendje t'ia hedhim prindërve, por nuk mund t'ia hedhim Perëndisë. Ai shikon gjithçka.

Figurat

→ Figurat 54: Traditat e farisenjve



→ Grafiku 33: Perëndia dhe njeriu: Veprat e mira dhe ndjekja e rregullave

→ Grafiku 34: Perëndia dhe njeriu: Përpjekjet e njeriut

Duhet të jetë sipas mënyrës së Perëndisë!

Historia

“Xhon, a i dëgjoje ata djemtë që po flisnin te rruga?” - e pyeti Karola.

“Po, i dëgjoja!” - u përgjigj Xhoni. “Ishte e tmerrshme!”.

“Prindërit tanë nuk do të na lejonin kurrë të flisnim ashtu” - tha Karola. “Jam e gëzuar që nuk flas si ata. A e dije që unë po mësoj vargje biblike?”.

“Po, mendoj se ma ke thënë të paktën disa herë” - u përgjigj Xhoni.

“Oh, ashtu?” - tha Karola. “Shiko, atëherë, nëse mund të mësoj edhe 10 vargje të tjera, do të kem mësuar gjithsej 50 vargje përmendsh!”.

“Edhe?” - e pyeti Xhoni.

“Edhe mendoj që kjo është gjë shumë e mirë” - tha Karola.

“Ashtu mendoj edhe unë” - tha Xhoni.

“Ashtu mendon?!” - thirri Karola.

“Shiko, duket sikur je shumë krenare për veten” - tha Xhoni.

“Duhet të jem krenare për veten” - thirri Karola. “M'u desh shumë kohë për t'i mësuar vargjet”.

“Një herë unë mësova emrat e tërë lojtarëve të skuadrës kombëtare së futbollit,” - tha Xhoni, - “por nuk i kujtoj tani”.

“Nuk është ndonjë krenari e madhe të mësosh emrat e lojtarëve të një skuadre futbollit,” - tha Karola, - “ndërsa mësimi i vargjeve, është diçka me të cilën Perëndia kënaqet shumë”.

“Përshëndetje Karola! Ç'kemi Xhon?” - tha xhaxhi Piteri, ndërsa u fut te dera.

“A nuk është ashtu, xhaxhi Piter?” - pyeti Karola. “Mësimi i vargjeve biblike i pëlqen Perëndisë më tepër sesa mësimi i emrave të lojtarëve të një skuadre futbollit!”.

“Duket një bisedë shumë interesante” - tha xhaxhi Piteri. “Mendoj që ti je ajo që po mëson vargjet, Karola. Çfarë vargjesh po mëson tani?”.

“Po mësoj 1 Samuelit 16:7: ...sepse Zoti nuk shikon si shikon njeriu, njeriu shikon pamjen, kurse Zoti shikon zemrën.” - tha Karola.”

“Shumë mirë!” - tha xhaxhi Piteri. “A e di se çfarë do të thotë ai varg?”.

“Jo, mendoj që jo” - u përgjigj Karola.

“Karola, a ke menduar ndonjëherë keq për dikë për diçka që ka thënë apo bërë?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Po!” - u përgjigj Karola. “Unë dhe Xhoni dëgjuam disa çuna që po flisnin te rruga. Ata ishin të tmerrshëm. Nuk do të flisja kurrë si ata”.

“A u ndale për të menduar se përse sillen ashtu njerëzit?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Si Karola” - tha Xhoni. “Ajo po mburret. Ajo mendon se është shumë e rëndësishme, sepse ka mësuar përmendsh disa vargje”.

“Xhon!” - thirri Karola - “Ti...”.

“Mirë, mirë!” - i ndërpreu xhaxhi Piteri. “Le të mendojmë për këtë. Të mësosh vargje përmend është shumë mirë. Perëndia dëshiron që ne ta njohim Fjalën e Tij. Por të mburresh për veten nuk është gjë e mirë. Kujto, Fjala e Perëndisë na thotë se ne jemi mëkatarë, ashtu si ata djem. Ti i di mëkatet e tyre për shkak të asaj që kanë thënë; por a mendon se je më e mirë se ata? Edhe sikur një person të mëson tërë Biblën, kjo gjë nuk do ta shpëtonte nga mëkatet e tij. Ashtu siç thotë vargu, Perëndia shikon anën e brendshme, shikon “zemrën”: mendimet, ndjenjat dhe besimet tona, jo thjesht ato gjëra që njerëzit na shikojnë duke i bërë. Karola, a e dije që krenaria është mëkat?”.

“Xhaxhi Piter, ke të drejtë!” - tha Karola. “Kur Perëndia më shikon, Ai shikon një mëkatarë, edhe nëse mësoj vargje përmendsh”.

“Shumë e vërtetë” - tha xhaxhi Piteri. “Jezusi foli shumë për këtë gjë: njerëzit në kohën e Dhiatës së Re kishin të njëjtin problem. Xhon, edhe ne të dy kemi nevojë për këtë. Le të marrim Biblat tona”.

Hir: Një dhuratë që nuk e meritohet nga Perëndia

Shpëtuar: Çliruar nga pushteti i Satanit dhe ndëshkimi i mëkatit

Besim: Besoj në atë që ka bërë Krishti për të më çliruar nga mëkatit im.

Vepra: Gjëra të mira për të cilat mburret

Mburret: Krenohet

Le të shohim në Bibël



Efesianëve 2:8-9 - “Ju në fakt, jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit, dhe kjo nuk vjen nga ju, po është dhurata e Perëndisë, jo nga vepra, që të mos mburret askush.”

Edhe pse Ligji nuk mund t'i çlirojë njerëzit nga mëkatit, shumica e tyre përpiqen të zbatojnë Ligjin. Njerëzit duan ta “fitojnë” dhe ta “meritojnë” pranimin e Perëndisë, në vend që ta marrin me anë të hirit nëpërmjet besimit, e cila është rruga e vetme. Edhe fëmijët e vegjël mësojnë shpejt t'i ndjekin “rregullat” e dikujt pa pasur një ndryshim të vërtetë në mendjet e tyre rreth vetes, mëkatit dhe Perëndisë.

Le të mendojmë

1. Cili ishte problemi i vërtetë i Karolës?
 - a. Ajo nuk mësonte shpejt përmendsh; **b. Krenaria;** c. Ajo ishte më e mirë se Xhoni.
2. Çfarë mendon Perëndia për krenarinë?
 - a. Është mëkat;** b. Është një qëndrim i mirë; c. Diçka që njerëzve të mirë u lejohet ta kenë.
3. A të bën të pranueshëm para Perëndisë mësimi i vargjeve përmendsh? **Po/Jo.**
4. A i intereson Perëndisë ajo që mendojmë apo besojmë? **Po/Jo.**
5. Kush janë mëkatarët në historinë e sotme?
 - a. Vetëm djemtë në rrugë; b. Vetëm Karola; **c. Të gjithë.**

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Jezu Krishti erdhi t'i çlirojë njerëzit, për t'u dhënë atë liri që Ligji nuk mund ta jepte. Ligji u dha për t'u treguar njerëzve anën e tyre mëkatore. Krishti përmbushi tërë Ligjin. Perëndia Frymë e Shenjtë do t'i ndihmojë besimtarët, duke u dhënë atyre lirinë dhe fuqinë për të bërë atë që është e drejtë, jo ngaqë e thotë ligji, por sepse ata e bëjnë me gëzim si për Zotin. Ndërsa mëson, kërkoji vazhdimisht Perëndisë të të ndihmojë që ta paraqesësh mesazhin e hirit të Tij, atë hir të mrekullueshëm dhe të pamërituar që Ai u jep mëkatarëve që nuk e meritojnë. Ne jemi shpëtuar me anë të hirit dhe rritemi me anë të hirit!

1. Rregullat e farisenjve - Marku 7:1-5.

- Farisenjtë nuk i miratonin dishepujt e Jezusit, sepse ata nuk bënin gjërat për të cilat farisenjtë thoshin se ishin të domosdoshme që një person të pranohej nga Perëndia⁶².

Farisenjtë u kishin shtuar qindra ligje të tjera ligjeve origjinale që Perëndia i kishte dhënë Moisiut. Askush nuk ishte në gjendje t'i zbatonte tërë këto ligje, por farisenjtë prisnin që njerëzit t'i zbatonin. Njerëzit dënoheshin nëse nuk i bindeshin ligjit, edhe pse farisenjtë nuk po u bindeshin vetë ligjeve. Kjo ishte një prej arsyeve se përse Perëndia i quante hipokritë!


- Ata ishin krenarë për veten, ngaqë e bënin çdo gjë, si p.sh.: larjen e duarve, kupave dhe tryezave para se të hanin, për t'u dukur përpara njerëzve.
- Por ata nuk e dinin apo nuk u interesonte që Perëndia e shikonte tërë të keqen në ta. Njerëz si këta ka edhe sot, që e shpallin me të madhe fenë e tyre, duke kritikuar njerëzit që nuk janë si ata, e megjithatë, ata vetë janë akoma nën sundimin e Satanit.

2. Dënimi i farisenjve nga Jezusi - Marku 7:6-9.

- Jezusi citoi atë që profeti Isaia kishte thënë për judenjtë (Isaia 29:13).
 - Ata thoshin shumë gjëra të mira për Perëndinë me buzët e tyre, por në “zemrat” e tyre (në Bibël “zemrat” do të thotë mendimet tona më të thella, ndjenjat dhe besimet), ata nuk e donin Perëndinë apo nuk i besonin dhe nuk i bindeshin Fjalës së Tij.
- Perëndia nuk e pranoi adhurimin e judenjve, sepse ata nuk e kishin me zemër.
- Ata nuk iu afruan Perëndisë duke rënë dakord me Të se ata ishin mëkatarë dhe duke besuar në premtimet e Tij rreth Çlirimtarit.
- Ka akoma njerëz që u mësojnë të tjerëve idetë e tyre në vend të Fjalës së Perëndisë. Shumë fe sot mësojnë rregulla që nuk gjenden në Bibël. Njerëzve u mësohet që nëse i ndjekin këto rregulla dhe bëjnë gjërat që mësojnë këto fe, ata do të pranohen nga Perëndia.

⁶²Shumica e farisenjve mbanin në ballë një kuti të vogël lëkure që mbante vargje nga Shkrimi. Ata kishin një kuti tjetër të lidhur në krahun e tyre me anë të një shiriti lëkure. Perëndia u kishte dhënë izraelitëve udhëzime që t'i lidhnin ligjet e Tij në duart e tyre dhe t'i vendosnin ato midis syve, si një shembull që tregonte se sa e rëndësishme ishte t'i njihje dhe t'u bindeshe urdhërimeve të Tij (Ligji i Përtërirë 6:8). Megjithatë, farisenjtë mendonin se nëse e bënin këtë gjë me të vërtetë, atëherë të gjithë do të shikonin se sa mirë i bindeshin ata Ligjit të Perëndisë. Kur këta farisenj u jepnin para të varfërve, ata siguroheshin që të gjithë ta dinin kur i hidhnin paratë e tyre në kutinë e ofertave. Atyre u pëlqente të luteshin në publik, në mënyrë që të gjithë t'i shihnin. Gjërat që po bënin, duke u përpjekur t'i bindeshin Ligjit, si dhënia, lutja, nuk ishin gjëra të këqija në vetvete. Qëndrimi i tyre (mendimet rreth Tij) ishte i gabuar. Ata nuk po i besonin Perëndisë për t'i shpëtuar nga mëkatet e tyre. Ata mendonin se po bënin atë që ishte e mirë për t'i pëlqyer Perëndisë dhe donin që njerëzit të shikonin se sa të mirë ishin (Mateu 6:2, 5; 23:1-28).

→ Grafiku 33: Perëndia dhe njeriu - veprat e mira dhe zbatimi i rregullave



Perëndia thotë që një mësim i tillë është i kotë. Është shumë e gabuar (mëkatore) të shtosh apo të heqësh diçka nga Fjala e Perëndisë.

3. Jo ajo që hamë, por ajo që jemi - Marku 7:14-23.


- Skribët dhe farisenjtë theksonin shumë mos ngrënie e disa ushqimeve.
 - Ata mendonin se kjo, gjithashtu, do t'i ndihmonte të pranoheshin nga Perëndia.
- Jezusi e bëri të qartë se nuk është ajo që hamë që na bën të papranueshëm te Perëndia, por gjërat mëkatore që Perëndia i shikon në “zemrat” tona.
 - Edhe nëse nuk i bëjmë gjërat që përmend Jezusi, Perëndia thotë se shumë gjëra të liga, të cilat Ai i urren, janë akoma në “zemrat tona”; dhe për këtë arsye Ai nuk mund të na pranojë⁶³.

4. Fariseu krenar - Luka 18:9-12.

- Jezusi po tregonte një shëmbëlltë.
 - Një shëmbëlltë është një histori që na mëson diçka rreth Perëndisë dhe marrëdhënies tonë me Të.
- Fariseu shkoi në tempull për të folur me Perëndinë.
 - Ai ishte krenar. Ai mendoi se ishte aq i mirë sa t'i pëlqente Perëndisë⁶⁴.
- Perëndia thotë se tërë njerëzit kanë mëkatuar dhe janë ndarë prej Tij.
 - Askush nuk mund të bëjë diçka me anë të forcave të veta për t'iu afruar Perëndisë.
 - Isaia 64:4a thotë se çfarë mendon Perëndia për drejtësinë e njeriut:

Jemi të gjithë si një gjë e papastër, dhe të gjitha veprat tona të drejtësisë janë si një rrobe e ndotur.

→ Grafiku 34: Perëndia dhe Njeriu - Përpjekjet e njeriut.



5. Tagrambledhësi i penduar - Luka 18:13.

- Ky njeri nuk u përpoq t'ia fshihte Perëndisë anën e tij mëkatore.
 - A kujtoni se si njerëzit i urrenin tagrambledhësit, sepse ata vidhnin prej tyre?
- Ai besoi te Zoti si Shpëtimtari i tij.
 - Perëndia pati mëshirë për të, e fali dhe e pranoi.

6. Vendimi i Jezusit - Luka 18:14.


- Fariseu nuk mund të pranonte se ishte një fajtor dhe një mëkatar i pashpresë që kishte nevojë për një Shpëtimtar (mëshirën e Perëndisë), ndaj mëkatet e tij nuk u falën nga Perëndia.

Nuk ka asgjë që mund të bëjmë për të shpëtuar veten. Nuk ka rëndësi se sa të rëndësishëm apo të mirë mendojmë se jemi; Perëndia do të pranojë vetëm ata që kanë besim te Jezu Krishti si Shpëtimtari i tyre.

⁶³Kujtoni Jakobin 2:10, i cili thotë se edhe nëse kemi shkelur vetëm një prej urdhërimeve të Perëndisë, ne jemi fajtorë për shkeljen e tërë ligjit.

⁶⁴Ky farise ishte si Kaini. Kaini iu afrua Perëndisë sipas mënyrës së tij, jo sipas mënyrës së Perëndisë, duke besuar në gjërat që kishte rritur vetë nga toka. Perëndia e refuzoi këtë farise, ashtu siç refuzoi Kainin.

Përsëritje



Pyetje dhe përgjigje

1. Kush kishte sajuar ligjet e veta? **Farisenjtë.**
2. Çfarë mendon Perëndia për njerëzit që shtojnë apo heqin nga Fjala e Tij? **Ata e kanë gabim; ata po mëkatojnë.**
3. Mos ngrënie e cilit ushqim do të na bëjë të pranueshëm para Perëndisë? **Asnjë.**
4. Mëkatet e kujt fali Perëndia, të tagrambledhësit apo fariseut? **Të tagrambledhësit.**
5. Pse nuk e pranoi Perëndia fariseun? **Fariseu nuk mund të pranonte që, si fajtor dhe si mëkatar i pashpresë, kishte nevojë për një Shpëtimtar.**

Mësimi 55

Qëllimi

- Ky mësim paraqet Hyjinë e Krishtit me anë të rrëfimit të Pjetrit, shpërftyrimin dhe fjalëve të Perëndisë nga reja.
- Gjithashtu paraqet vdekjen e Jezusit, e cila do të ndodhte së shpejti, si përmbushje e profecisë.

Hyrje

Pyeti fëmijët e klubit tënd nëse u pëlqejnë historitë imagjinare. Disa prej tyre janë të këndshme, por kur flasim se ku do ta kalojmë përjetësinë, ne duhet të jemi të sigurt se njohim të vërtetën, dhe jo diçka imagjinare. Në mbarë botën njerëzit ndjekin besime, histori dhe ide, të cilat nuk filluan si të vërteta, por si gënjeshtër të Satanit, të bëra për të larguar vëmendjen e njerëzve nga e vërteta e Perëndisë. Megjithatë, kur lexojmë Biblën, ne lexojmë të vërtetën, të dhënë nga vetë Perëndia, i Cili është i përjetshëm dhe që nuk gënjen.

Figurat

→ Figura 57: Shpërftyrimi



Shpërftyrimi i Jezusit

Historia

“A e di çfarë, xhaxhi Piter?” - tha Karola. “Emi është kthyer nga qyteti!”.

“Fantastike!” - tha xhaxhi Piteri. “A po ia kalon mirë me motrën?”.

“Oh, po kënaqemi!” - tha Karola. “Ne...”.

“Po!” - e ndërpreu Xhoni. “Ato flasin vetëm për ‘muhabete vajzash’. Unë madje nuk kam mundësi t’i flas!”.

“Oh, Xhon, ne nuk flasim thjesht për ‘muhabete vajzash’” - tha Karola.

“Pastaj ti nuk duhet t’i kishe dëgjuar bisedat tona!”.

“Atëherë, a ka ndryshuar Emi që kur është larguar nga shtëpia?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Po, disi” - u përgjigj Karola. “Jam pak e shqetësuar për të”.

“Çfarë do të thuash?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Nuk e di se si ta them: a e kujton se çfarë lexuam për fariseun?” - e pyeti Karola. “Shiko, nuk është njësoj, por Emi mendon se di gjithçka tani”.

“Ajo mbase di më shumë se ty Karola” - tha Xhoni. “Ajo po studion në universitet”.

“Po, por kjo është ndryshe” - tha Karola. “Ajo ka disa ide që mua nuk më duken të drejta”.

“Çfarë idesh?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Unë e di njërën” - i ndërpreu Xhoni. “E dëgjova që i thoshte mamasë se Jezusi ishte thjesht një mësues i mirë: Ai nuk ishte me të vërtetë Perëndi”.

“Po, Emi ma tha edhe mua këtë” - tha Karola. “Por ajo tha gjithashtu se nuk është e shqetësuar për kohën kur do të vdesë, sepse ajo ka zbuluar se mund të kthehet më pas si një person tjetër”.

“Ky është budallallëk!” - tha Xhoni i çuditur.

“Duket budallallëk, në rregull,” - tha xhaxhi Piteri, - “por Satani i ka mashtruar njerëzit që t’i besojnë gjëra si kjo si për të vërteta. Ata mendojnë se po të jenë aq të mirë sa duhet, ata do të jenë në gjendje të kthehen në tokë si një person me një jetë më të mirë”.

“Çfarë mendojnë ata se mendon Perëndia për këtë?” - pyeti Xhoni.

“Njerëzve që besojnë në fetë e rreme nuk u intereson se çfarë mendon Perëndia” - tha xhaxhi Piteri. “A e kujtoni se si farisenjtë ia shtonin ligjet e tyre Fjalës së Perëndisë? Atyre nuk u interesonte se çfarë mendonte Perëndia”.

“Xhaxhi Piter, mendoj se ke të drejtë,” - tha Karola, - “sepse Emi më tha se kishte zbuluar se Bibla ka disa të vërteta në të, por një pjesë e saj është vetëm histori. Ajo m’i ka turbulluar mendimet. Si mund ta dimë se kush ka të drejtë?”.

“Bibla është e vërtetë, e gjitha!” - tha xhaxhi Piteri. “E vërteta ka qëndruar për mijëra vjet, edhe pse shumë njerëz janë përpjekur ta quajnë të rreme. Bibla është Fjala e Perëndisë”.

“A mund ta dimë me siguri se Jezusi është Perëndi?” - pyeti Xhoni.

“Po, Xhon, mundemi” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Bibla na jep historinë e vërtetë të jetës së Tij: mrekullitë që bëri, gjërat që tha, faktin që nuk mëkatoi kurrë. Ajo na tregon që Ai i përmbushi saktësisht fjalët e shkruara për Të qindra vjet më parë nga profetët e Perëndisë”.

“Nuk ka asnjë tjetër si Jezusi, apo jo?” - pyeti Karola.

“Jo, Karola, nuk ka!” - tha xhaxhi Piteri. “Dikush mund të thotë se ka, por askush tjetër nuk mund të jetë i përsosur si Ai. Ai është me të vërtetë Perëndi!”.

“Emi ka vetëm një pjesë të së vërtetës, apo jo?” - tha Karola. “Pyes veten nëse dishepujt u pëshpëlluan ndonjëherë nga mësimet e farisenjve?”.

“Një ditë Jezusi u tregoi ‘anën hyjnore’ të Tij disa prej dishepujve” - tha xhaxhi Piteri. “Mendoj se duhet t’i tregojmë Emit atë që thotë me të vërtetë Fjala e Perëndisë. Le ta thërrasim dhe të shohim nëse do të na dëgjojë”.

Le të shohim në Bibël



Marku 9:7 - “Pastaj erdhi një re dhe i mbuloi me hijen e vet; dhe nga reja doli një zë që tha: ‘Ky është Biri im i dashur; dëgjojeni!’”.

Ky ishte Perëndia Atë që po u fliste tre dishepujve: Pjetrit, Jakobit dhe Gjonit kur u ngjitën në mal me

Jezusin. Perëndia donte që ata të mësonin se Jezusi ishte me të vërtetë Biri i Tij dhe se ata duhej ta dëgjonin dhe t’i bindeshin asaj që thoshte Ai.

Le të mendojmë

1. A është Jezusi thjesht një mësues i mirë? Po/**Jo**.
2. Kush i mashtron njerëzit për të besuar se ata do të kthehen nga vdekja si një person tjetër? a. Jezusi; b. Dishepujt; **c. Satani**.
3. Ç’pjesë e Biblës është e vërtetë? a. Asnjë pjesë; **b. E tëra**; c. Një pjesë.
4. Kush tjetër është njësoj si Jezusi? a. Satani; b. Fariseu; **c. Askush**.
5. Ku mund ta gjejmë historinë e plotë dhe të vërtetë të jetës së Jezusit? **a. Në Bibël**; b. Në asnjë vend; c. Në librat shkollorë.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Fakti i mahnitshëm historik i shpërftyrimin të Jezusit është e vërteta e Perëndisë.

Shfaqja e Moisiut dhe e Elisë me Krishtin në mal na jep një tablo të mrekullueshme për vërtetësinë e jetës së përjetshme. Këta burra kishin ndërruar jetë kohë më parë, por ata nuk kishin vdekur me të vërtetë, sepse ata kishin besuar që Perëndia do të siguronte një Shpëtimtar. Njerëzit janë gënjer nga Satani për të besuar se ata do të rishfaqen në forma të tjera: kafshë apo njerëz. Kjo ide e rimishërimit është një prej mashtrimeve mizore të Satanit për t’i gënjer njerëzit për të pasur një ndjenjë të rreme të shpresës për përjetësinë. Sigurisht, kjo nuk gjendet në Bibël. Bibla thotë se për jobesimtarin nuk ka asgjë pas vdekjes, përveç gjykimit dhe ferrit (Hebrenjve 9:27)⁶⁵.

1. Kush thoshin njerëzit se ishte Jezusi - Marku 8:27-28.

- Duke qenë se mbreti Herod kishte burgosur dhe vrrarë Gjon Pagëzorin, disa njerëz mendonin se Jezusi ishte Gjoni i kthyer në jetë.
- Të tjerë mendonin se Jezusi ishte Elia: i kthyer në tokë.
 - Elia ishte një profet që ishte marrë në qiell nga Perëndia rreth 850 vjet para se Jezusi të vinte në botë.
- Jezusi ua kishte treguar qartë njerëzve se kush ishte. (Gjoni 1:1, 14; 8:58).
 - Ai u tha njerëzve se Ai ishte Biri i Perëndisë, Çlirimtari, të Cilin Perëndia e kishte premtuar që nga fillimi i botës.
 - Ai u kishte treguar atyre fuqinë e Tij me anë të mrekullive të mëdha që kishte bërë.
 - Megjithatë, shumica e judenjve nuk besonin tek Ai⁶⁶.

2. Kush besonte Pjetri se ishte Jezusi - Marku 8:29-30.

- Jezusi e dinte se dishepujt e Tij nuk do të pranoheshin kurrë nga Perëndia, Ati i Tij, nëse nuk besonin se Ai ishte Çlirimtari.
- Pjetri e dinte dhe besoi se Jezusi ishte Krishti, Çlirimtari i premtuar.
- Njerëzit kishin shumë ide të gabuara se kush ishte Krishti (Mesia) dhe se çfarë do të bënte Ai për ta⁶⁷.
 - Jezusi e dinte se dishepujt kishin më shumë për të mësuar rreth Tij (si Krishti, Mesia). Ata nuk ishin gati t’u shpjegonin të tjerëve gjithçka që Jezusi erdhi të bënte.

⁶⁵Përjetësia është realitet, si për besimtarin, ashtu edhe për jobesimtarin. Danieli 12:2, Mateu 25:46 dhe Veprat e Apostujve 24:15 flasin për këtë në mënyrë të qartë.

Marku 6:14-29

2 Mbretërve 2:11; Malakia 4:5-6

⁶⁶Thuaju fëmijëve të klubit tënd: “Është shumë e rëndësishme ajo që besoni në lidhje me faktin se kush ishte Jezusi. A mendoni se Ai ishte thjesht një njeri tjetër i mirë? A ishte Ai thjesht një mësues i mirë që bënte disa mrekulli? A ishte Ai thjesht një profet tjetër, ashtu siç thoshin judenjët se ishte? A ishte Ai gënjeshtar apo tha të vërtetën? Nëse diçka nga ato që tha nuk ishte e vërtetë, atëherë Ai nuk mund të ishte Perëndia Bir, sepse Perëndia është i shenjtë dhe i përsosur. Nëse tha të vërtetën, atëherë ne duhet t’i besojmë Atij dhe asaj që tha”.

⁶⁷Perëndia nuk do që ju të besoni te Jezusi vetëm sepse një mësues apo dikush tjetër ju thotë atë që beson ai për Jezusin. Ju duhet të keni besimin tuaj te Perëndia dhe Fjala e Tij. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse shumë njerëz janë mashtruar nga gënjeshtar që thonë se Jezusi ishte thjesht një njeri apo një mësues i mirë. Për shkak të pohimeve që Ai bën për veten dhe pohimeve që të tjerët bëjnë për Të në Fjalën e Tij, Ai nuk mund të jetë veçse Perëndia.

→ Figura 57: Shpërftyrimi

⁶⁸Kujto: A e mban mend tabernakullin, të cilin Perëndia i tha Moisiut dhe izraelitëve ta ndërtonin për Të, kur ishin në malin Sinai në shkretëtirë? Ana e jashtme e asaj ndërtese mbulohej me lëkurë kafshësh. Kur njerëzit e shikonin, ata shikonin vetëm lëkurët e vjetra e të thara, por përbrenda dhomës së brendshme, poshtë lëkurëve, gjendej drita më e fortë, e cila tregonte se Perëndia ishte atje (Eksodi 36:14-19; 40:34-35). Kjo është një figurë e Jezusit. Ai dukej si një njeri i zakonshëm, por Ai ishte gjithashtu Perëndia Shumë i Lartë që krijoi qiejtë dhe tokën.

⁶⁹Elia dhe Moisiu kishin qenë me Perëndinë për qindra vjet. Kur ishin gjallë në tokë, ata i kishin besuar Fjalës së Perëndisë dhe kishin besuar te Perëndia dhe te Çlirimtari që do të vinte. Për shkak të kësaj, kur u larguan nga kjo tokë, ata nuk ishin të ndarë nga Perëndia në ferr. Perëndia i pranoi bashkë me Abelin, Sethin, Abrahamin, Sarën, Isakun, Jakobin, Jozefin, Moisiun, Jozueun, Davidin dhe këdo tjetër që ishte dakord me Perëndinë, që ata ishin mëkatarë të pashpresë dhe që i besonin Perëndisë për të dërguar një Shpëtimtar.

Përsëritje

Mesazh: Njerëzit që besuan te Jezusi, Shpëtimtari, do të jetojnë në qiell me Perëndinë kur të vdesin.

Pyetje dhe përgjigje

1. Kush tha Pjetri se ishte Jezusi? **Krishti, Çlirimtari të Cilin Perëndia e dërgoi në botë.**
2. Çfarë u tha Jezusi dishepujve të Tij se do t'i ndodhte? **Ai tha se do të refuzohej dhe vritej nga drejtuesit fetarë, por Ai do të ngjallej prej së vdekurish pas tri ditësh e tri netësh.**
3. A dukej Jezusi si njerëzit e tjerë? **Po.**
4. Çfarë kishte ndryshe Jezusi në krahasim me njerëzit e tjerë? **Ai ishte edhe Perëndi, edhe njeri.**
5. Çfarë tha Perëndia për Jezusin? **Ai tha se Jezusi ishte Biri i Tij i dashur dhe se duhej dëgjuar.**

3. Jezusi parashikoi vdekjen dhe ringjalljen e Tij - Marku 8:31.

- Jezusi e dinte se duhej të vdiste.
 - Jezusi e dinte se Satani do t'i përdorte drejtuesit judenj për ta vvarë, sepse ata nuk besonin se Ai ishte Biri i Perëndisë, Çlirimtari.
 - Jezusi e dinte gjithashtu se, edhe pse do të vdiste dhe do të varrosej, Ai do të ringjallej pas tri ditësh e tri netësh.
 - Ne nuk e njohim të ardhmen tonë, por Jezusi e njihnte krejt të ardhmen e Tij.
- Qindra vjet më parë, profetët kishin parathënë shumë hollësi të sakta rreth gjërave që do t'i ndodhnin Jezusit.
 - Ai do të vuante shumë gjëra.
 - Ai do të refuzohej nga drejtuesit fetarë.
 - Ai do të vritej.
 - Ai do të ngjallej prej së vdekurish.

4. Jezusi u shpërftyrua - Marku 9:2-3.

- Jezusi kishte një trup njerëzor ashtu si ne. Ai ishte njeri i vërtetë, por Ai ishte edhe Perëndi.
 - Kur njerëzit e shikonin, Ai dukej si çdo njeri tjerë.
 - Megjithatë, ajo që tha dhe bëri tregonte se Ai ishte ndryshe.
- Kjo është hera e vetme, ndërsa Jezusi ishte në tokë, që trupi i Tij në lavdi u shfaq përmes trupit të Tij njerëzor. Trupi i Tij njerëzor fshihte zakonisht "anën hyjnore" të Jezusit⁶⁸.
- Mateu, njëri prej dishepujve të Jezusit, thotë në librin që shkroi në Bibël se atje në mal fytyra e Jezusit shkëlqeu si dielli (Mateu 17:2).

5. Moisiu dhe Elia folën me Jezusin - Marku 9:4.

- Elia ishte një profet jude. Ai nuk vdiq si njerëzit e tjerë (2 Mbretërve 2:11).
- Bibla na thotë se Moisiu vdiq dhe u varros nga Perëndia (Ligji i Përtëritë 34:5-6).
 - Vdekja e Moisiut ndodhi rreth 1 400 vjet para se të vinte Jezusi në tokë.
 - Moisiu u largua nga trupi i tij kur vdiq dhe trupi i tij u varros⁶⁹.
- Perëndia lejoi tani Elinë dhe Moisiun të ktheheshin në tokë për të folur me Jezusin.
 - Parajsja është një vend real, por nuk është në këtë botë.
 - Parajsja është shtëpia e Perëndisë.
 - Cilido që beson te Jezusi, Shpëtimtari që dërgoi Perëndia, do të shkojë të jetojë me Perëndinë në qiell kur të vdesin trupat e tyre.
 - Luka, një dishepull që shkroi gjithashtu për jetën e Jezusit këtu në tokë, tha se atje në mal Moisiu dhe Elia folën me Jezusin për vdekjen e Tij, e cila do të ndodhte në Jerusalem (Luka 9:30-31).
 - Edhe pse këta burra e lanë këtë botë shumë, shumë vjet para se Jezusi të vinte në tokë, ata e dinin se premtimet e Perëndisë rreth Çlirimtarit do të ndodhnin saktësisht sipas mënyrës të premtuar nga Perëndia.

6. Çfarë tha Perëndia Atë për Jezusin - Marku 9:5-8.

- Ishte Perëndia Atë që po fliste.
- Ai u tha dishepujve që Jezusi ishte Ai i Cili thoshte se ishte, pra, Biri i dashur i Perëndisë.
 - Ngaqë Jezusi ishte Biri i Perëndisë, Perëndia u tha dishepujve që ata duhet ta dëgjojnë Jezusin dhe t'i binden.
 - Nuk ka pasur kurrë dhe nuk do të ketë kurrë një person tjetër si Jezusi, Biri i Perëndisë.

Tani Perëndia nuk na flet me anë të një zëri nga qielli. Gjithçka që dëshiron të na thotë është e shkruar në Bibël. Tërë fjalët e Jezusit, që Perëndia dëshiron që t'i njohim dhe t'u bindemi, janë shkruar gjithashtu në Bibël dhe Perëndia pret prej nesh që t'i dëgjojmë dhe ta vendosim besimin tonë në to.

Mësimi 56

Qëllimi


- Ky mësim paraqet Jezu Krishtin si Shpëtimtarin e vetëm, derën e vetme për të Perëndia dhe jeta e përjetshme.
- Jezusi, Shpëtimtari i vetëm, krahasohet me arkën dhe derën e saj të vetme. Noeu, familja e tij dhe tërë kafshët kaluan përmes kësaj dera, rruga e vetme që të mund të shpëtoheshin nga shkatërrimi i përmbytjes.
- Do të diskutohet për disa nga gënjeshttrat e Satanit dhe do të tregohet se janë të rreme.
- Fjala e Perëndisë paraqitet si burimi i së vërtetës.

Hyrje

Pyeti fëmijët e klubit tënd nëse kanë dëgjuar dikë që të thotë ndonjërin prej këtyre pohimeve: “Ka shumë rrugë për të Perëndia”; “Çdo person e ka vetë në dorë të zgjedhë rrugën e tij për të Perëndia”; “Secili duhet të varet nga një fuqi më e lartë. Çdo person e ka vetë në dorë se si e kërkon dhe e zgjedh një fuqi më të lartë”; “Ka kultura dhe fe të ndryshme në vende të ndryshme. Perëndia do të pranojë këdo që është i sinqertë në fenë e tij”. Nëse fëmijët pohojnë se kanë dëgjuar, bëju të ditur se tërë këto ide janë gënjeshtra të Satanit.

Figurat

Figura 55: Një vathë delesh judaike



- Grafiku 15: Dera
- Grafiku 27: Profecitë

Jezusi është dera për në jetën e përjetshme

Historia

“Përshëndetje Xhon, Karola e Tom” - tha xhaxhi Piteri. “A keni dëgjuar për parkun e ri? Dëgjova që z. Xhons ka punësuar dikë që të rregullojë një pjesë të tokës së tij për të ndërtuar disa rrugë natyrore, pajisje lojërash dhe një liqen të vogël për të peshkuar. Është një vend i bukur. Kuptoj që ai po i jep mundësinë për të hyrë falas kujtdo që po ia kërkon”.

“Po, edhe ne dëgjuam për të!” - tha Xhoni. “Shkuam, por nuk mund të futeshim”.

“Çfarë do të thuash me ‘nuk mundëm të futeshim?’ - pyeti xhaxhi Piteri.

“Unë u futa!” - tha Tomi. “Falas! Është shumë bukur!”.

“Tom, mos u mburr për këtë” - tha Xhoni i zemëruar.

“Nuk po mburrem” - tha Tomi i qetë.

“Prit!” - tha xhaxhi Piteri. “Xhon, pse nuk u futët ti dhe Karola?”.

“Është pak e sikletshme” - tha Xhoni. “Nuk kishim pse të shkonim të takonim z. Xhons, ndaj vendosëm të gjenim një mënyrë tjetër. Disa nga miqtë e mi jetojnë pas tokës së z. Xhons dhe ata thanë se mund të kalonim poshtë gardhit. Na kapën! Ai personi na tha se kishin vendosur një gardh të fortë, në mënyrë që njerëzit të mos kalonin vjedhurazi. Z. Xhons donte që të ishte një vend i sigurt, që njerëzit ta shijonin”.

“Xhon, ti duhet ta kishe ditur që kjo nuk ishte e drejtë!” - tha xhaxhi Piteri.

“Këtë i thashë atij” - tha Karola. “Shkova me shoqen e klubit. Drejtuesi ynë tha që ai personi do të na linte të futeshim, sepse klubi ynë bën shumë gjëra të mira për njerëzit përreth”.

“Çfarë atëherë?!” - tha Xhoni. “As ju nuk u futët”.

“Duket sikur asnjë prej jush nuk i ka besuar udhëzimet që ju dhanë se si të futeshit në park” - tha xhaxhi Piteri.

“Ke të drejtë, xhaxhi Piter” - tha Karola. “Në të vërtetë mendova se ai personi te dera do ta linte klubin tonë që të futej. Drejtuesi ynë i tha atij për tërë gjërat e mira që bëjmë për të ndihmuar njerëzit”.

“Çfarë tha ai?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Ai tha që ishte shumë i lumtur që kemi bërë aq shumë gjëra të mira,” - tha Karola, - “por z. Xhons kishte lënë udhëzime që askush të mos futej pa biletat falas që shpërndan ai. Nuk mendoj se kjo është e drejtë!”.

“Karola, kujt i përket parku?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“I përket z. Xhons” - tha Karola.

“Atëherë z. Xhons ka të drejtën të thotë se kush mund të futet atje” - tha xhaxhi Piteri. “Ai është treguar shumë i mirë dhe bujar që e rregulloi parkun, në mënyrë që njerëzit ta shijojnë dhe që bëri të mundur që gjithkush të mund të hyjë falas”.

“Tom, si u fute ti?” - pyeti Karola.

“E kam njohur z. Xhons prej një kohe të gjatë” - tha Tomi. “Ai është një njeri i mirë dhe e mban fjalën. Kur dëgjova që do të hapej parku dhe që ai do të jepte bileta falas, shkova dhe i kërkoja dhe ai më dha një. Pastaj shkova atje dhe personi te dera e pa biletën time dhe më la të futem brenda”.

“Atëherë shpresoj që të keni nxjerrë mësim nga kjo” - tha xhaxhi Piteri.

“Disa njerëzve nuk u pëlqen t’ua vënë veshin udhëzimeve. Ata mendojnë gjithmonë se mund të gjejnë një mënyrë më të mirë nga ajo që u thuhet për të marrë diçka. Duket sikur ne sot nuk jemi ndryshe nga njerëzit për të cilët kemi lexuar në kohën kur Jezusi ishte në tokë. Le të shohim se çfarë mund të mësojmë tjetër rreth këtyre njerëzve”.

Le të shohim në Bibël



Gjoni 14:6 - "Jezusi i tha: 'Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje'."

Perëndia e dinte se çfarë lloj gënjeshtresh do të sajonte Satani ndaj çdo brezi apo kulture. Në vargun e sotëm përmendsh Perëndia u jep një përgjigje shumë të qartë këtyre gënjeshtreve. Ka vetëm një rrugë për t'u shpëtuar, përmes Birit të Tij, Jezu Krishtit. Ai është Çlirimtari i vërtetë, rruga e vetme që ne mëkatarët t'i afrohemi Perëndisë së Shenjtë.

Le të mendojmë

1. Çfarë duhet të bënin njerëzit për t'u futur në parkun e z. Xhons?
a. Të blinin një biletë; b. Të punonin për një biletë; **c. Të kërkonin një biletë falas.**
2. Çfarë bëri Xhoni për t'u futur në park?
a. Bleu një biletë; **b. U fut fshehurazi;** c. Mori një biletë falas.
3. Me ç'mënyrë u përpoq Karola për t'u futur në park?
a. Me anë të veprave të mira; b. Me anë të biletës falas; c. Bleu një biletë.
4. Si u fut Tomi në park?
a. Me një biletë falas; b. Pagoi një biletë; c. Punoi për një biletë.
5. Në ç'mënyrë thotë vargu përmendsh se mund t'i afrohemi Perëndisë Atë?
a. Me një biletë falas; b. Me anë të veprave të mira; **c. Përmes Jezusit.**

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Nëse do të kishim jetuar në kohën kur Jezusi mësoi në Izrael, do të dinim shumë gjëra për delet. Të gjithë në Izrael kishin njohuri rreth deleve; delet përdoreshin për flijimet. Kështu që edhe njerëzit që jetonin në qytete kishin njohuri për delet dhe dinin të paktën diçka për barinjët. Jezusi foli për delet dhe barinjët, sepse njerëzit e kuptonin se për çfarë po fliste.

1. Dera e vathës - Gjoni 10:7.

Shumica e tokës së Izraelit është e thatë dhe ndonjëherë barinjët kishin vështirësi të gjenin bar për delet. Shpesh barinjët largoheshin nga shtëpitë e tyre dhe i çonin delet larg për të kërkuar ushqim. Shumë herë barinjët ishin aq larg shtëpive të tyre në mbrëmje, sa që ata flinin jashtë në fusha apo male me delet e tyre. Ishte e rrezikshme të flije jashtë në vend të hapur, sepse kishte hajdutë që përpiqeshin të vidhnin delet dhe kafshë të egra që do t'i vrisnin. Prandaj para se të binte nata, barinjët gjenin një shpellë ku delet të mund të ishin të sigurt ose përgatitnin vende ku mund t'i fusnin delet e tyre gjatë natës. Vendet që ndërtonin barinjët ishin zakonisht vatha me gardhe prej gjemborësh dhe gurësh.

Shpjego: Kjo është një figurë e një vathe judaike për dele. Vathë të ndërtuara në këtë mënyrë mund të gjenden akoma në Izrael.

Kur binte nata, barinjët i fusnin delet e tyre në këtë zonë të mbrojtur. Pastaj bariu shtrihej te hyrja. Atyre që u duhej të futeshin në vathë duhej të kalonin bariun. Ai ishte si dera apo porta për në vathën e deleve. Kishte vetëm një derë për në vathë dhe atje shtrihej bariu.

- Jezusi donte të thoshte se Ai ishte rruga për në vendin e sigurt.
 - Jashtë në këtë botë janë Satani, frymërat e tij të këqija, mëkati dhe vdekja.
 - Në një farë mënyre ata janë si plaçkitësit dhe kafshët e egra që vrisnin dhe hanin delet.
 - Te Gjoni 8:44 Jezusi e quajti Satanin gënjeshtar dhe vrasës.
 - Ai përpiqet t'i shtyjë njerëzit që të mendojnë se janë të sigurt me të.
 - Satani i ka mashtruar dhe shkatërruar njerëzit për mijëra vjet.

→ Figura 55: Një vathë delesh judaike

2 Korintasve 11:13-15

Fjalët e Urta 16:25


Romakëve 10:17

⁷⁰Disa njerëz mund të thonë se ajo që mëson Bibla është e mirë për tërë njerëzit, por që ka edhe fe të tjera që i çojnë njerëzit te Perëndia. Kjo është një gënjeshtër e Satanit. Jezusi erdhi që të jetë Shpëtimtari i tërë njerëzve, kudo, pavarësisht se çfarë gjuhe flasin apo se si jetojnë.

→ Trego grafikun 15: Një derë.

⁷¹Një prej gënjeshtërave të Satanit është se mënyra e tij e të jetuarit është më e mira, më interesantja dhe më argëtuesja. Ai u jep njerëzve aq kënaqësi sa të mendojnë që rruga e tij është më e mirë se rruga e ofruar nga Jezu Krishti. Sa gënjeshtër e tmerrshme! Bibla e thotë qartë se të gjithë ata që refuzojnë të besojnë te Jezusi do të ndahen nga Perëndia dhe do të ndëshkohen përgjithmonë në liqenin e zjarrit (Zbulesa 20:15).

Përsëritje



- Kush u ngjan vjedhësve dhe kafshëve të egra që përpiqen të vjedhin apo të hanë delet? Satani, frymërat e tij të ndyra, mëkati dhe vdekja.
- Sa dyer ka për te Perëndia dhe për në jetën e përjetshme? Një.
- Cila është dera e vetme për te Perëndia dhe jeta e përjetshme? Jezu Krishti.
- Kush është si bariu që i do aq shumë delet e tij, sa që do të vdiste për to? Jezu Krishti.

2. Shpëtimtarët e rremë - Gjoni 10:8.

- Para se të lindte Jezusi, njerëz të tjerë kishin ardhur te judenjtë, secili prej tyre duke thënë se ishte Çlirimtari i dërguar nga Perëndia.
 - Jezusi tha se këta njerëz ishin si plaçkitësit që vinin natën për të vjedhur dhe për të vrarë delet.
- Satani përdor shumë hile për të na shtyrë të mendojmë se rruga që ai mëson është rruga e drejtë për t'u ndjekur.
 - Rrugët e Satanit mund të duken të mira, por fundi i tërë rrugëve të tij është vdekja: ndarja e përjetshme nga Perëndia.
- Rruga e vetme për të mësuar të vërtetën është të dimë atë që na thotë Bibla.

3. Jezusi, dera e vetme - Gjoni 10:9-10.

- Ka vetëm një derë apo portë për në vathë, vendi i sigurt, i mbrojtur dhe i jetës.
 - Jezusi, si Perëndi dhe Shpëtimtar, është dera e vetme për në jetën e përjetshme; nuk ka rrugë tjetër.
 - Ashtu si bariu i donte dhe kujdesej për delet e tij, Zoti Jezus i do dhe kujdeset për tërë njerëzit. Ai dëshiron të jetë Çlirimtari ynë nga Satani, mëkati dhe vdekja⁷⁰.

Kujto: Perëndia i tha Noeut të ndërtonte arkën, sepse Perëndia do të ndëshkonte tërë botën. Vetëm ata që u futën në arkën që ndërtoi Noeu shpëtuan nga gjykimi i Perëndisë.

- Ngaqë Noeu dhe familja e tij i besuan Perëndisë dhe fjalëve të Tij, ata u futën nga dera dhe shpëtuan nga përmbytja.
- Kjo është një tablo e derës së vetme për te Perëndia dhe jeta e përjetshme: Jezu Krishti.
- Rruga për t'u futur te dera e jetës së përjetshme është të biem dakord me Perëndinë dhe Fjalën e Tij dhe të besojmë vetëm te Jezusi që është Shpëtimtari.
 - Jezusi është dera për te Perëndia. Nuk ka rrugë tjetër për te Perëndia.
- Jezusi tha se Ai nuk është si Satani, i cili dëshiron vetëm të shkatërrojë njerëzit⁷¹.
- Jezusi erdhi në botë për t'u dhënë jetë të përjetshme me Perëndinë të gjithë atyre që besojnë tek Ai.
- Jezusi e tha qartë në këtë pjesë që Ai na jep jetë dhe e jep me bollëk.
 - Në një nga mësimet e mëparshme ne lexuam që jeta e dhënë nga Jezusi është jeta që kënaq plotësisht.

4. Jezusi, Bariu i Mirë - Gjoni 10:11.

- Drejtuesit judenj donin ta vrisnin Atë.
 - Jezusi u kishte thënë tashmë dishepujve të Tij që drejtuesit e judenjve nuk do të besonin se Ai ishte Shpëtimtari i dërguar nga Perëndia.
- Jezusi tha se Ai ishte si bariu që i donte aq shumë delet e tij, sa që do të vdiste për to.
 - Profeti Isaia tha që Jezusi do të vuante dhe do të vdiste për të tjerët (Isaia 53:4-5).
 - Secili nga premtimet që Perëndia dha për hollësitë e jetës së Jezusit këtu në tokë u realizua.

→ Trego grafikun 27: Profecitë "Vuaj për të tjerët". Lexo Shkrimin e profecisë: Isaia 53:4-5, në të majtë dhe përmbushjen e Shkrimit, Gjoni 10:11, në të djathtë.

Ashtu si plaçkitësve nuk u interesonte nëse dëmtoheshin delet, po kështu mësuesve të rremë nuk u intereson se çfarë u ndodh njerëzve që i ndjekin. Këta mësues të rremë sajojnë një rrugë për të fituar jetën e përjetshme me Perëndinë, dhe ajo rrugë është e mirë në dukje, por të gjithë ata do të përfundojnë në vdekje të përjetshme: ndarje nga Perëndia. Neve nuk na duhen idetë e njerëzve të tjerë për të gjetur rrugën tonë për te Perëndia; Ai e ka bërë shumë të qartë në Fjalën e Tij se Jezusi është rruga E VETME për te Perëndia.

Mësimi 57

Qëllimi

Ky mësim paraqet Jezu Krishtin si ringjallja dhe jeta, Shpëtimtari që erdhi për t'u dhënë jetën e përjetshme të gjithë atyre që besojnë. Përmes historisë së ringjalljes së Llazarit nga të vdekurit, fëmijët do të shikojnë:

- Dhembshurinë dhe aftësinë e Jezusit për të kuptuar brengat e njerëzve.
- Qëndrimet e Marisë dhe Martës që besuan te Jezusi.
- Qëndrimet e drejtuesve judenj që urrenin Jezusin.
- Që Jezusi është Perëndia dhe ka fuqi për t'u dhënë njerëzve jetë.
- Që tërë njerëzit do ta kalojnë përjetësinë ose në qiell, ose në liqenin e zjarrit.

Hyrje

Ndihmoji fëmijët e klubit tënd të kuptojnë që Perëndia kujdeset me të vërtetë për secilin prej nesh. Ne e dimë që njerëzit vdesin për shkak të mëkatit që kanë trashëguar nga Adami, por ne nuk kuptojmë gjithmonë se përse vdesin njerëzit; vetëm Perëndia e di, sepse Ai ka kontroll mbi jetën dhe vdekjen. Megjithatë, ne mund të kemi besim se Ai e di se cila është më e mira për ne. Ai krijoi gjithçka dhe dëshiron që të gjithë të shpëtohen. Për këtë arsye Ai dërgoi Birin e Tij, Jezu Krishtin, për të na shpëtuar nga Satani, mëkati dhe vdekja (ndarja nga Perëndia).

Figurat

→ Figura 56: Ringjallja e Llazarit



Jezusi ngjalli Llazarin prej së vdekurish

Historia

“Karola!” - thirri Xhoni, ndërsa u fut me vrap në shtëpi. “Nuk ke për ta besuar se çfarë ka ndodhur. Ka vdekur znj. Xheksën!”.

“Oh, mos!” - tha Karola. “Mendova se ajo ishte vetëm me grip”.

“Kështu menduan në fillim,” - tha Xhoni, - “por doli që kishte diçka më serioze”.

“Është e vështirë ta besosh” - tha Karola. “Ajo ishte kaq e re”.

“Çfarë është e vështirë për ta besuar?” - tha xhaxhi Piteri, ndërsa hyri në shtëpinë e Xhonit dhe Karolës.

“Mësuesja që kisha vitin e kaluar ka vdekur sot” - u përgjigj Karola. “E pëlqej shumë atë. Nuk kishte vdekur më parë një njeri aq i afërt për mua”.

“Oh, Karola, më vjen keq” - tha xhaxhi Piteri. “Nuk e kisha dëgjuar këtë që ka ndodhur”.

“E pashë në shkollë të premten” - tha Karola. “Të hënën mësuam që ishte sëmurë dhe sot... ajo ka vdekur!”.

“Pse vdesin njerëzit?” - tha Xhoni. “Pse nuk vazhdoi të jetonte? Ajo ishte një person i mirë”.

“Nuk është e drejtë!” - tha Karola. “Ajo nuk duhej të vdiste. Pse nuk vdiq më mirë një njeri i keq?”.

“Njerëzit nuk flasin gjëra të mira për vdekjen, apo jo?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Mendoj se jo” - tha Xhoni. “Ç’të mirë ka ajo për të folur!”.

“Por në Bibël Perëndia flet shumë për vdekjen” - tha xhaxhi Piteri. “Kemi folur për këtë edhe më parë: të gjithë do të vdesin një ditë. Vdekja është rezultati i mëkatit; të gjithë njerëzit kanë lindur mëkatarë, sepse tërë njerëzit janë pasardhës të Adamit, që kanë mëkatar kundër Perëndisë”.

“E kujtoj,” - tha Karola, - “por prapë nuk më duket e drejtë. Znj. Xheksën ishte shumë e veçantë. Tani ajo ka vdekur dhe nuk kam për ta parë më kurrë”.

“Prit pak, le të mendojmë për atë që na thotë Perëndia në Bibël” - tha xhaxhi Piteri. “Është e vërtetë që trupat tanë do të vdesin për shkak të mëkatit, por Bibla na thotë se një ditë Perëndia do t’u japë jetë tërë të vdekurve dhe çdo person do të gjykohet nga Perëndia. Ata që i kanë besuar Jezu Krishtit do të jetojnë përgjithmonë me Perëndinë, por ata që nuk kanë besuar do ta kalojnë përjetësinë të ndarë nga Perëndia”.

“Do të thuash se disa njerëz do të jetojnë përgjithmonë në qiell dhe të tjerë do të jetojnë përgjithmonë në ferr?” - pyeti Xhoni. “Pikërisht” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Unë e di që znj. Xheksën është me Jezusin tani. Ajo ishte mëkatore, ashtu si ne të gjithë, por ajo i besoi Jezu Krishtit kur ishte në moshën tënde. E di që do ta shoh atë përsëri: do ta shoh në qiell!”.

“Dëgjova një burrë që thoshte se mbase ajo do të kthehet këtu si zog apo flutur!” - tha Xhoni. “Dhe e kishte seriozisht! Doja t’i thosha se kjo ishte një gënjeshtër e Satanit, por mendoj se do të do të zemërohej me mua”.

“Gëzohem që mendon se kjo është një gënjeshtër e Satanit, Xhon” - tha xhaxhi Piteri. “Ai dëshiron t’i mashtrojë njerëzit që të mendojnë se nuk ka ndëshkim për mëkatin: nuk ka ferr, nuk ka gjykim, vetëm një jetë e ndonjë lloji tjetër pas kësaj. Kur njerëzit mendojnë kështu, ata nuk ndiejnë nevojën e tyre për një Shpëtimtar. Do të të pëlqejë studimi ynë sot; do të shohim se si Perëndia ka fuqi mbi jetën dhe po ashtu edhe mbi vdekjen”.

Le të shohim në Bibël



Gjoni 11:25 - “Jezusi i tha: ‘Unë jam ringjallja dhe jeta; ai që beson në mua, edhe sikur të duhej të vdesë do të jetojë.’”

Shpjego që ringjallja i referohet fuqisë së Perëndisë për të ngjallur të vdekurit. Këtë gjë bëri Jezusi për Llazarin: Ai e ngjalli prej së vdekurish. Ky varg na

thotë se ata që besojnë te Jezusi nuk do të vdesin frymërisht, edhe pse trupi i tyre vdes.

Le të mendojmë

1. Pse vdesin trupat? a. Nuk kemi mjekësi aq të mirë; b. Për shkak të mëkatit; c. Jezusi është i zemëruar me ne.
2. Kush do të gjykohet nga Perëndia një ditë?
a. Vetëm jobesimtarët; b. Të gjithë; c. Vetëm Satani dhe demonët e tij.
3. Ku do të shkojnë njerëzit që besojnë te Perëndia kur të vdesin?
a. Në ferr; b. Do të kthehen në tokë si zogj; c. Në qiell.
4. Ku do të shkojnë njerëzit që nuk besojnë te Perëndia kur të vdesin?
a. Në ferr; b. Do të kthehen në tokë si zogj; c. Në qiell.
5. Kush ka fuqi mbi jetën dhe vdekjen? a. Satani; b. Farisenjtë; c. Perëndia.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Njerëzit nuk kanë dëshirë të flasin për vdekjen. Ndonjëherë fëmijët mund të frikësohen nga ajo; mbase ndonjë person i afërt i tyre ka vdekur kohët e fundit. Megjithatë Jezusi foli për këtë. Gjërat që tha duhet t'i ndryshojnë përgjithmonë mendimet tona rreth jetës dhe vdekjes.

1. Jezusi priti derisa të vdiste Llazari - Gjoni 11:1-6.

- Jezusi ishte në anën tjetër të lumit Jordan.
- Edhe pse ishte larg Betanisë, vendit ku ishte Llazari, Jezusi e dinte se çfarë do t'i ngjante Lllazarit.
 - Jezusi është Perëndi; nuk ka asgjë që Ai të mos e dijë.
 - Jezusi e dinte se Llazari do të vdiste.
- Jezusi kishte çdo fuqi në dispozicionin e Tij.
 - Jezusi mund ta kishte shëruar Lllazarin, madje pa shkuar në vendin ku ai ishte.
 - Ose mund të shkonte menjëherë te Lllazari për ta shëruar.
 - Por Jezusi priti dy ditë.
- Jezusi priti; Ai do të tregonte pushtetin e Tij të madh si Biri i Perëndisë.
 - Jezusi e donte Martën, Marinë dhe Lllazarin dhe interesohej për ta, por kishte një arsye të fortë që e la Lllazarin të vdiste.
 - Përmes vdekjes së Lllazarit Jezusi do të tregonte pushtetin e Tij për t'u dhënë jetë atyre që besojnë.

2. Jezusi shkoi për të ngjallur Lllazarin nga të vdekurit - Gjoni 11:7-16.

- Dishepujt nuk e kuptuan se çfarë donte të thoshte Jezusi.
- Edhe pse Jezusi nuk ishte i shqetësuar, dishepujt u merakosën që drejtuesit judenj do të përpiqeshin ta vrisnin përsëri Jezusin.

3. Jezusi është ringjallja dhe jeta - Gjoni 11:17-27.

- Marta besoi që Jezusi kishte fuqinë për ta shëruar vëllanë e saj.
- Ajo besoi se Perëndia, Ati i Tij, do të bënte atë që do t'i kërkonte Jezusi.
 - Ajo nuk e kuptonte se çfarë donte të thoshte Jezusi.
 - Lllazari nuk kishte pse të rrinte i vdekur deri në ditën kur Perëndia do të gjykojë njerëzit.
- Jezusi i tha asaj: “Unë jam ringjallja dhe jeta” (Gjoni 11:25a).
 - Ai është dhuruesi i jetës dhe ka kështu pushtetin për t'u dhënë përsëri jetë të vdekurve.

⁷³Nëse fëmijët e klubit tënd janë shumë të vegjël, nuk ke pse e trajton këtë, por gënjeshtria e rimishërimit besohet nga shumë vetë, ndaj nëse ke fëmijë të rritur, mund të përmendësh ato që vijnë: Disa njerëz sot besojnë të rimishërimit. Ata mendojnë se dikush që vdes kthehet të jetojë në tokë si një person tjetër, si një kafshë apo krijesë tjetër. Kjo është një gënjeshtër e Satanit. Ai do që njerëzit të mendojnë se ata nuk kanë nevojë të çlirohen nga mëkatet e tyre. Ai do që ata të besojnë se nuk ka ferr dhe gjykim. Nëse ai mund t'i bëjë njerëzit të besojnë se ka një jetë tjetër për ta këtu në tokë, atëherë ata do të mendojnë se nuk kanë nevojë për Jezu Krishtin për t'i shpëtuar nga ndëshkimi i drejtë i Perëndisë për mëkatet e tyre. Satani është mashtrues dhe gënjeshtria e rimishërimit është një prej përpjekjeve të tij për ta mbajtur njeriun larg Perëndisë dhe jetës së përjetshme.

⁷⁴Mendo: A do t'ia dijë Perëndia kur je i sëmurë apo kur dikush vdes? Po, Ai do t'ia dijë. Perëndia të do dhe Ai dëshiron që t'u besosh fjalëve të Tij dhe të besosh te Jezusi si Shpëtimtari yt. Ai dëshiron që ti të jesh me Të përgjithmonë. Prandaj Ai e dërgoi Jezusin në botë për të çliruar secilin prej nesh nga mëkatet tona, Satani dhe vdekja: ndarja nga Perëndia.

→ Figura 56: Ringjallja e Llazarit

Përsëritje

Shiko vargun përmendsh:
Jezusi i tha: "Unë jam ringjallja dhe jeta; ai që beson në mua, edhe sikur të duhej të vdesë do të jetojë".

Pyetje dhe përgjigje

1. Pse prit Jezusi për të shkuar të shihte Llazarin? **Ai do të tregonte forcën e Tij të madhe si Biri i Perëndisë.**
2. Kush e jep dhe kush e merr jetën? **Perëndia**
3. Çfarë po nënkuptonte Jezusi kur tha se ata që besojnë tek Ai nuk do të vdesin kurrë? **Jezusi nënkuptonte që ata nuk do të ndaheshin kurrë nga Perëndia dhe nuk do të ndëshkoheshin për mëkatet e tyre.**
4. Pse qau Jezusi? **Sepse Ai ishte i trishtuar duke parë problemet që mëkati dhe vdekja kishin shkaktuar ndaj tërë njerëzve dhe Ai ndjeu brengën e njerëzve.**
5. Kush përpiket që njerëzit të mbeten të mashtruar, në mënyrë që të mos besojnë te Jezusi si Shpëtimtari i tyre? **Satani.**

- Jezusi është i vetmi që mund t'u japë jetë të vdekurve.
 - Vetëm Perëndia mund të japë jetë, sepse Ai është Krijuesi i madh që u dha jetë secilit dhe çdo gjëje (Psalmi 24:1)⁷³.
- Jezusi tha se, edhe pse ata që i besojnë Atij si Shpëtimtari i tyre vdesin fizikisht, ata janë gjallë përherë me Perëndinë.
 - Ata nuk ndahen kurrë nga Perëndia dhe nuk ndëshkohen për mëkatet e tyre.
 - Ata vetëm sa largohen nga kjo botë për të shkuar e jetuar me Perëndinë në qiell (Gjoni 3:16; 5:24).
- Marta nuk ishte si pjesa më e madhe e njerëzve.
 - Ata e ndiqnin Jezusin, sepse donin shërim ose ushqim për trupat e tyre apo liri politike nga romakët. Marta besonte me të vërtetë te Jezusi si Çlirimtari i premtuar që kishte ardhur nga Perëndia.

4. Jezusi shkoi te varri i Llazarit - Gjoni 11:28-38.

Jezusi e dinte se do ta ngjallte Llazarin prej së vdekurish, por Ai qau, sepse ndjeu brengën e njerëzve që ishin të trishtuar për vdekjen e Llazarit. Perëndia është tmerrësisht i trishtuar për tërë njerëzit, sepse ka mëkat në botë.

- Ngaqë ka mëkat, ka sëmundje dhe vdekje.
- Mëkati dhe vdekja erdhën në botë për shkak të mosbindjes së Adamit ndaj Perëndisë.
- Tërë njerëzit janë mëkatarë; ne vdesim, sepse jemi të tërë pasardhës të Adamit⁷⁴.

5. Jezusi e ngjalli Llazarin prej së vdekurish - Gjoni 11:39-44.

- Në fillim Ai, me Perëndinë Atë dhe Perëndinë Frymë e Shenjtë, krijoi të gjitha gjërat (Kolozianëve 1:16).
 - Ata krijuan çdo gjë vetëm duke folur.
- Tani Jezusi po rrinte te hyrja e varrit dhe foli. Ai e urdhëroi Llazarin të kthehej në jetë. Ajo që thotë Jezusi, ndodh gjithmonë!

6. Disa besuan dhe të tjerë refuzuan të besojnë - Gjoni 11:45-48.

- Shumë judenj besuan te Zoti Jezus, kur panë që ringjalli Llazarin prej së vdekurish.
- Megjithatë, priftërinjtë dhe farisenjtë ishin të interesuar vetëm që të mbanin pozicionin e tyre të pushtetit dhe pasurisë.
 - Ata kishin frikë se mos njerëzit do ta bënin Jezusin mbretin e tyre.
 - Këta drejtues fetarë e dinin se romakët, që kontrollonin judenjtë dhe tokën e tyre, nuk do të binin kurrë dakord që të kishin Jezusin si mbretin e tyre.
 - Romakët do të zemëroheshin dhe do t'i fajësonin drejtuesit judenj që do t'i lejonin njerëzit ta bënin Jezusin mbretin e tyre dhe ata do t'i zëvendësonin drejtuesit judenj me drejtues romakë.
- Satani po i udhëhiqte këta burra.
 - Satani nuk do që dikush të besojë te Jezusi dhe të shpëtohet nga pushteti i tij.
 - Ai po përpiket akoma sot që njerëzit të mbeten të mashtruar, në mënyrë që ata të mos besojnë te Jezusi si Shpëtimtari i tyre.

Ne kemi Fjalën e Perëndisë për të na treguar të vërtetën. Nëse na kanë mësuar gjëra frymërore që nuk janë në përputhje me Fjalën e Perëndisë, ne duhet t'i refuzojmë; ato nuk janë e vërteta! Ne nuk duhet t'i dëgjojmë gënjeshttrat e Satanit dhe mësuesit e tij të rremë.

Mësimi 58

Qëllimi

Ky mësim na tregon që duhet të shkojmë te Zoti si një fëmijë, vetëm duke besuar tek Ai. Ne nuk kemi asgjë të mirë për t'ia ofruar Perëndisë. Gjithashtu tregon rrezikun e pasurisë së shumë: Perëndia na ka urdhëruar që të duam Atë mbi çdo gjë tjetër.

Hyrje

Ndihmohi fëmijët e klubit tënd që të kuptojnë se nuk është mëkat të jesh i pasur, por është mëkat t'i duash pasuritë më tepër sesa Perëndinë apo njerëzit e tjerë. Perëndia kërkon këdo me dashuri dhe mirëkuptim. Megjithatë ka vetëm një rrugë për t'u pranuar prej Tij dhe për të pasur jetën e përjetshme: përmes besimit te Jezu Krishti si Shpëtimtar. Këto nuk mund të blihen.

Figurat

→ Figura 58: Jezusi dhe fëmijët



→ Figura 59: I riu pasanik



I riu pasanik

Historia

“Faleminderit që po na çon në spital, xhaxhi Piter” – thanë Xhoni dhe Karola.

“S’ka përse!” - tha xhaxhi Piteri. “Si shkoi vizita e fëmijëve?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Më pëlqeu,” - tha Karola, - “por mendoj se ishte e trishtueshme në të njëjtën kohë”.

“Edhe për mua” - tha Xhoni. “U çuditë që kishte shumë fëmijë atje. Disa prej tyre janë shumë sëmurë!”.

“Mua më pëlqeu në mënyrë të veçantë ajo vajza e vogël që ishte e paralizuar” - tha Karola. “Ajo qeshte tërë kohën!”.

“Xhaxhi Piter, a e di se ishte edhe diçka tjetër që më çuditi?” - e pyeti Xhoni. “Ai burri që takuam atje: ai që fliste shumë për paratë e tij”.

“Pse të çuditi, Xhon?” - e pyeti xhaxhi Piteri.

“Shiko, ai dukej i shqetësuar për çdo gjë” - u përgjigj Xhoni. “Dhe fliste tërë kohën për gjërat që kishte bërë për fëmijët atje”.

“Ai ka bërë shumë gjëra për t'i ndihmuar ata fëmijë” - tha xhaxhi Piteri. “Ai është një person që ka qenë shumë bujar me paratë e tij, në shumë mënyra, por e njoh dhe e di që nuk i ka besuar Perëndisë. Paratë janë shumë të rëndësishme për të dhe, edhe pse dhuron shumë prej tyre, sërish mban shumë edhe për vete. Ai është gjithmonë i shqetësuar për atë që ndodh me paratë e tij. Mendoj se po përpiqet të blejë pranimin e Perëndisë me veprat e tij të mira”.

“Mbase të shkuarit në kishë do ta ndihmonte” - sugjeroi Karola.

“Po, nëse do të dëgjonte predikimin e Fjalës së Perëndisë” - tha xhaxhi Piteri. “Por ky njeri ka shkuar në kishë shumë herë dhe e konsideron vetëm si diçka që mund të bëjë për t'i pëlqyer Perëndisë. Ai duhet të kuptojë se është mëkatar dhe që nuk mund të bëjë asgjë për ta bërë veten të drejtë para Perëndisë. Tërë veprat e tij të mira dhe pjesëmarrja në takime fetare nuk do ta bëjnë kurrë të pranueshëm para Perëndisë”.

“Xhaxhi Piter, a ia ke thënë ndonjëherë atij atë që sapo na the ne?” - e pyeti Xhoni.

“Po, ia kam thënë” - iu përgjigj xhaxhi Piteri. “Ai nuk do të më dëgjojë mua apo t'i vërë veshin Biblës. Ai është njeri shumë krenar”.

“Nuk e kuptoj,” - tha Karola, - “por ajo vajza e vogël dukej më e lumtur sesa i pasuri”.

“Po, është, Karola,” - tha xhaxhi Piteri, - “por disa muaj më parë ajo ishte një person ndryshe. Ajo nuk qeshte kurrë dhe ishte e hidhëruar, sepse ishte e paralizuar”.

“E vështirë për t'u besuar!” - tha Karola. “Çfarë e ndryshoi atë?”.

“Është e vërtetë!” - tha xhaxhi Piteri. “Ajo ndryshoi pasi erdhën dy vajza për ta vizituar dhe i folën për Perëndinë. Me anë të Fjalës së Perëndisë ato i treguan se problemi i saj më i madh nuk ishte se nuk ecte, por mëkati i saj. Ndërsa vajzat po i lexonin Biblën dhe i treguan për Jezu Krishtin, vajza e vogël besoi! Ajo e di tani që ka jetë të përjetshme. Ajo më tha: ‘Jezusi ka bërë gjithçka për mua, edhe pse unë nuk mund të bëj asgjë për Të. Perëndia më ka pranuar për shkak të Jezusit!’”.

“E di çfarë, mua më ka ardhur keq për të,” - tha Karola, - “por tani ndihem edhe më e trishtuar për atë personin e pasur”.

“Është me të vërtetë e trishtueshme” - tha xhaxhi Piteri. “Ai është një njeri i mirë, por nuk është gati t'i besojë Fjalës së Perëndisë. Ai i do paratë e tij më tepër sesa Perëndinë, edhe pse bën gjithmonë vepra të mira. Ai më kujton një person në Bibël, për të cilin do t'ju flas më vonë në studimin tonë biblik. Shihemi pas një ore!”.

Le të shohim në Bibël



Gjoni 6:29 - “Jezusi u përgjigj dhe u tha atyre: ‘Kjo është vepra e Perëndisë: të besoni në atë që ai ka dërguar’.”

Shpjego që njerëzit donin të dinin se çfarë vepre kërkonte Perëndia prej tyre për të marrë jetën e përjetshme. Jezusi tha që ajo që Perëndia kërkonte është që ata të besojnë në atë që Ai ka dërguar dhe ky është vetë Jezu Krishti.

Le të mendojmë

1. A mund ta blejë dikush pranimin e Perëndisë? **Po/Jo.**
2. Çfarë na bën të pranueshëm para Perëndisë?
 - a. Veprat e mira; b. Të shkuarit në kishë; **c. Besimi te Jezu Krishti.**
3. Çfarë duhet të dëgjojnë njerëzit kur shkojnë në kishë?
 - a. Histori të bukura; **b. Fjalën e Perëndisë;** c. Si të jemi të mirë.
4. Cili ishte problemi më i madh i vajzës së vogël?
 - a. Ajo ishte e paralizuar; b. Ajo ishte në spital; **c. Mëkati i saj.**
5. Pasi vajza e paralizuar besoi te Jezusi, çfarë mësoi se do të kishte?
 - a. **Jetë të përjetshme;** b. Këmbë të reja; c. Pasuri.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Perëndia dëshiron që t'i besojmë Jezu Krishtit, Birit të Perëndisë, të Cilin Perëndia e dërgoi për të na çliruar nga ndëshkimi i mëkateve tona. Kur dikush përulet dhe i beson Fjalës së Perëndisë si një fëmijë i vogël, Perëndia e shpëton atë person nga kontrolli i Satanit, mëkatis dhe vdekjes. Megjithatë, ne do të shikojmë se të qenët shumë i pasur nuk e bën një person të lumtur apo të bëjë paqe me Perëndinë. Këta njerëz duan t'u besojnë pasurive që kanë, për të plotësuar nevojat e tyre, por kjo nuk u sjell atyre jetë të përjetshme me Perëndinë. Ne nuk mund ta blejmë atë!

1. Jezusi i donte fëmijët - Marku 10:13-16.

- Dishepujt menduan se Jezusi nuk kishte kohë që të fliste me fëmijët.
- Jezusi i do fëmijët! Ai dëshiron që ata të besojnë fjalën e Tij dhe të kenë besim tek Ai.
 - Të gjithë ne kemi lindur mëkatarë dhe jemi nën pushtetin e Satanit dhe vdekjes.
 - Rruga e vetme se si mund të shpëtohemi ne, të rinj apo të vjetër, është duke i besuar Jezusit si Shpëtimtarit tonë.
- Njerëzit që nuk duan t'i afrohen Perëndisë dhe t'i besojnë Atij si një fëmijë i vogël nuk do të hyjnë në qiell⁷⁵.
 - Ne do të kemi gjithmonë nevojë për Perëndinë!
 - Perëndia nuk na ka krijuar për të jetuar larg Tij. Ai na bëri njerëz sipas shëmbëlltysës së Tij, për ta njohur, dashur dhe për t'iu bindur Atij.
 - Si mëkatarë, ne nuk mund ta bëjmë këtë. Ne jemi të ndarë nga Perëndia për shkak të mëkateve tona. Nga natyra, ne jemi të pavarur (“duke bërë gjërat tona”) dhe egoistë.
 - Deri diku mendojmë se, nëse do të ndodhë ndonjë ndryshim në jetën tonë, na takon ne të bëjmë tërë punën.
 - Ky nuk është mesazhi i ungjillit.
 - Jezu Krishti erdhi të shpëtonte mëkatarët⁷⁶ (Gjoni 3:16).
 - Nëse një person është krenar dhe i pavarur, Perëndia nuk mund ta ndihmojë atë.

2. Pyetja e të riut pasanik - Marku 10:17.

- Ky i ri ishte krenar; ai mendoi se mund t'i pëlqente Perëndisë dhe të fitonte hyrjen në mbretërinë e Perëndisë përmes mirësisë së tij dhe bindjes ndaj ligjeve të Perëndisë.
 - Ai mendoi se duke bërë gjëra të mira, ai do të ishte aq i mirë sa të meritonte jetën e përjetshme⁷⁷.

→ Figura 76: Jezusi dhe fëmijët

⁷⁵Një foshnjë e vogël prehet në krahët e nënës së saj. Ai nuk ka frikë se mos bie. Ai i beson të ëmës për ta mbajtur dhe për t'u kujdesur për të. Kur ishe foshnjë, ti besojë atë që të thoshin prindërit. Ti nuk përpiqeshe t'i shpjegoje gjërat sipas arsyes tënde, se cili ishte shkaku që gjërat ndodhnin në atë mënyrë. Tani po mëson shumë gjëra dhe po mëson të kujdesesh për veten. Prindërit e tu nuk kanë pse të bëjnë më gjithçka për ty.

⁷⁶Jezusi tha që ne duhet të lindim sërish. Ashtu siç është e pamundur që dikush të shkaktojë lindjen e tij fizike, po kështu është e pamundur që ne të shkaktojmë lindjen tonë frymërore (Gjoni 1:12-13). Vetëm Perëndia është në gjendje të na japë jetë të re; vetëm Ai mund të na shpëtojë nga dënimi i mëkateve tona. Prandaj dërgoi Birin e Tij, Jezu Krishtin, në botë.

⁷⁷Kujto: Ky i ri ishte si Kaini. Kaini mendoi se duke i sjellë Perëndisë gjërat që kishte rritur, ai mund të siguronte favorin e Perëndisë. Por a e pranoi Perëndia Kainin për shkak të gjërave që i sollí? Jo!


→ Figura 59: I riu pasanik

Isaia 64:6

Hebrenjve 4:12-13

⁷⁸Kujto: Perëndia nuk ia dha ligjet e Tij izraelitëve, sepse mendonte se ata mund t'u bindeshin. Perëndia u dha atyre Dhjetë Urdhërimet për t'u treguar si atyre, ashtu edhe të gjithë në njerëzve që kemi mëkatuar dhe që jemi të privuar nga standardi i Perëndisë për mirësinë (Romakëve 3:19-23).

Përsëritje



Mesazhi: Beso në Atë që dërgoi Ai.

Pyetje dhe përgjigje

- Çfarë mendon Jezusi për fëmijët? **Ai i do ata!**
- A lindin fëmijët nën kontrollin e Satanit? **Po, të gjithë.**
- Si mund të shpëtojnë fëmijët nga Satani? **Duke besuar te Jezusi si Shpëtimtari i tyre, ashtu si gjithë të tjerët.**
- Si mendonte i riu pasanik se mund të shkonte në qiell? **Me anë të mirësisë dhe bindjes ndaj ligjeve të Perëndisë.**
- Përtej bindjes së jashtme ndaj ligjeve të Tij, për çfarë i gjykon Perëndia njerëzit? **Për mendimet e tyre të brendshme, ndjenjat dhe dëshirat (zemrat e tyre).**

3. Vetëm Perëndia është i mirë - Marku 10:18.

- Perëndia thotë se nuk ka asnjë person në tokë që të jetë i mirë dhe të bëjë atë që është e drejtë në sytë e Tij (Romakëve 3:10-20).
 - I riu pasanik nuk e kuptoi se Perëndia është i vetmi që është me të vërtetë i mirë.
 - Ai mendonte se ishte i mirë dhe mendonte se Jezusi ishte një njeri tjetër i mirë si vetja e tij.
 - Megjithatë, Jezusi donte që i riu të dinte se **asnjë njeri i zakonshëm nuk është i mirë.**

4. Rruga e Ligjit - Marku 10:19-20.

- Ky i ri nuk e dinte:
 - Se kishte lindur mëkatat nën kontrollin e Satanit.
 - Prandaj ai nuk mund t'u bindej në mënyrë të përsosur ligjeve të Perëndisë dhe kështu t'i pëlqente Atij.
- Ky i ri mendoi se i kishte zbatuar Dhjetë Urdhërimet në mënyrë të përsosur, sepse u ishte bindur atyre nga ana e jashtme, ku njerëzit mund të shikojnë.
- Megjithatë, edhe pse u ishte bindur Ligjeve të Perëndisë nga ana e jashtme, nuk u ishte bindur atyre në zemrën e tij (1 Samuelit 16:7).
 - Perëndia i gjykon njerëzit edhe në bazë të mendimeve të tyre të brendshme, ndjenjave dhe dëshirave.
 - Nëse një person planifikon të marrë diçka që i përket dikujt tjetër, ai ka vjedhur.
 - Nëse një person i bindet në dukje autoritetit të dikujt, por është i zemëruar apo ankohet në zemrën e tij, ka mëkatuar para Perëndisë⁷⁸.
- Sot dikush mund të mendojë se ai është një person i mirë dhe nuk meriton të shkojë në ferr.
- Megjithatë, është e pamundur që ne t'i pëlqejmë Perëndisë në bazë të përpjekjeve tona, sepse ne kemi lindur si pasardhës të Adamit dhe jemi të ndarë nga Perëndia.

5. Rreziku i pasurisë - Marku 10:21-24.

- Jezusi e donte këtë të ri të pasur, edhe pse ai ishte krenar dhe nuk e konsideronte veten mëkatat, siç e konsideronte Perëndia.
- Jezusi i tha të riut të shiste gjithçka që kishte dhe t'ua jepte paratë të varfërve.
 - Jezusi e dinte se ky i ri ishte lakmitar dhe i donte pasuritë, më tepër sesa Perëndinë apo fqinjët e tij të varfër.
 - Ai kishte shkelur ligjin e Perëndisë dhe nuk e kishte dashur fqinjin si veten.
 - Ai kishte shkelur Urdhërimin e Parë të Perëndisë që thotë që ne duhet ta duam Perëndinë me tërë zemrën tonë, me tërë shpirtin tonë dhe me tërë mendjen tonë (Mateu 22:37-39).
 - Ne nuk duhet të vendosim asgjë, askënd, në vend të Perëndisë.
 - Jezusi donte që ai të kuptonte se nuk mund të pranohej nga Perëndia për shkak të gjërave që bëri: sepse kishte shkelur ligjet e Perëndisë. Ai ishte tashmë i vdekur para Perëndisë dhe i refuzuar prej Tij.
 - Ky i ri i pasur kishte bërë zgjedhjen e tij; ai nuk donte të bënte atë që tha Jezusi.
 - Ai i zgjodhi pasuritë e tij, të cilat mund t'i shikonte vetëm në këtë jetë dhe i ktheu shpinën jetës së përjetshme me Perëndinë.
 - Ai ishte i trishtuar sepse, edhe pse e donte jetën e përjetshme, ai i donte paratë e tij më tepër nga Perëndia apo njerëzit.

Mbase je duke menduar si ky njeri. Mbase mendon se gjëja më e rëndësishme në jetë është të pasurohesh. Megjithatë kur të vdesësh nuk do ta marrësh pasurinë tënde me vete. Për Perëndinë nuk kanë rëndësi paratë apo gjërat tona, por se sa e dëgjojmë Fjalën e Perëndisë dhe i besojmë Atij.

Mësimi 59

Qëllimi

Ky mësim paraqet historinë e treguar nga Jezusi për një pasanik dhe një lypsar të quajtur L Lazar. Ky mësim paraqet ndëshkimin e përjetshëm dhe ndarjen nga Perëndia për jobesimtarin, ndërsa për besimtarin, lumturinë e përjetshme në praninë e Perëndisë.

Hyrje

Pyeti fëmijët e klubit tënd se çfarë i bën ata të lumtur. Nëse dikush thotë se do të dëshironte të kishte shumë para për të blerë çfarë të donte, pyete se për sa kohë do të zgjasin këto "gjëra" (nëse askush nuk e përmend, atëherë përmende ti). Askujt nuk i pëlqen të mendojë për vdekjen, por edhe fëmijët duhet të mendojnë për të ardhmen e tyre tani; pas vdekjes është shumë vonë! Është më mirë të sigurohemi për lumturinë e tyre të përjetshme se sa për fitimin e "gjërave" për të tashmen.

Figurat

→ Figura 60: I pasuri në ferr



→ Grafiku 35: Grafiku i kohës

Qielli apo ferri?

Historia

"Xhon dhe Karola, do të gëzoheni kur të dëgjoni se kush erdhi në studimin e Biblës sonte!" - tha me gëzim, xhaxhi Piteri.

"Kush, xhaxhi Piter?" - pyeti Karola.

"Babai i Tomit, z. Bond!" - u përgjigj xhaxhi Piteri.

"Vërtetë!?" - tha Xhoni. "Fantastike!"

"Shpresoj të mos jetë shumë vonë" - tha xhaxhi Piteri.

"Çfarë do të thuash?" - e pyeti Karola.

"Z. Bond sapo zbuloi se ka tumor" - tha xhaxhi Piteri. "Doktorët thonë se i kanë mbetur vetëm disa javë apo muaj".

"Oh, jo!" - tha Xhoni. "Tomi duhet të jetë shumë i mërzitur".

"Me siguri që po" - tha xhaxhi Piteri. "Meqë z. Bond nuk i ka mbetur shumë kohë për të jetuar, u thashë se jam gati t'u mësoj çdo javë, në javët e ardhshme. Ai po shikon se paratë e tij nuk mund t'i blejnë asnjë nga ato gjëra për të cilat ka nevojë".

"Çfarë do t'i ndodhë Tomit kur të vdesë z. Bond, xhaxhi Piter?" - pyeti Karola.

"Nuk e di" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Nëna e tij ka qenë e sëmurë për një kohë të gjatë. Ajo po qëndron në një qytet tjetër me të motrën, derisa të shërohet. E di që kjo do të jetë shumë e vështirë për Tomin".

"Xhaxhi Piter," - tha Xhoni, - "a nuk të duket edhe ty që po ndodhin shumë gjëra të vështira?"

"Po, ashtu është, Xhon" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Por Bibla na thotë se do të ishte kështu për shkak të mëkatit në botë".

"Është e vështirë të mendosh për vuajtjet e z. Bond," - tha Karola, - "por është edhe më e vështirë t'i shohësh të vegjlit të vuajnë: disa nga ata që pamë në spital".

"E di çfarë do të thuash, Karola" - tha xhaxhi Piteri i trishtuar. "Vizitoja një djalë në spital që kishte dhimbje të vazhdueshme. Edhe ai kishte një buzëqeshje të ëmbël kur shkoja ta takoja. Ai e donte Jezusin dhe i kishte besuar Atij që ta shpëtonte nga mëkatet dhe t'i jepte jetën e përjetshme. Ai e dinte se do të vdiste, por kishte besim te Perëndia që Ai ta merrte me vete, për të qenë gjithmonë me Të".

"A vazhdon të jetë i sëmurë?" - pyeti Xhoni.

"Jo, nuk është!" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Ai ka vdekur dhe është me Jezusin tani!"

"Xhaxhi Piter, nuk më pëlqen që e përsëris këtë," - tha Karola, - "por kjo nuk duket e drejtë. Ai ishte shumë i ri për të vdekur!"

"E kuptoj se çfarë do të thuash, Karola," - u përgjigj xhaxhi Piteri, - "por ai po vuante këtu dhe tani është në qiell me Perëndinë përgjithmonë. Është si ajo vajza e vogël në spital. Jeta është shumë e vështirë edhe për të, por kohët e vështira këtu në tokë janë shumë të shkurtra krahasuar me përjetësinë".

"Ke të drejtë, xhaxhi Piter" - tha Karola. "Po z. Bond? Pyes nëse mendon se çfarë do t'i ndodhë kur të vdesë?"

"Shpresoj të fillojë të mendojë për të" - tha xhaxhi Piteri. "Bibla na tregon për një të pasur që refuzoi të mendonte për atë që do t'i ndodhte kur të vdiste. Ai refuzoi t'i besonte Perëndisë. Dhe na tregon për një njeri, i cili, si djali i vogël, vuante shumë këtu, por i besoi Perëndisë. Z. Bond nuk ka shumë kohë për të vendosur se çfarë do të bëjë me të ardhmen e tij".

"Nëse tërë gjërat në Bibël janë të vërteta, pse njerëzit nuk i besojnë Perëndisë?" - pyeti Xhoni.

"Kjo është pyetje me vend, Xhon" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Perëndia na e ka thënë në mënyrë të qartë në Bibël atë që duhet të dimë, por njerëzit refuzojnë të besojnë".

Le të shohim në Bibël



Mateu 16:26 – “Ç’përfitim ka njeriu nëse fiton gjithë botën dhe pastaj e humb shpirtin e vet? Ose çfarë do të japë njeriu si shkëmbim të shpirtit të vet?”

Kujtoju fëmijëve të klubit tënd që shpirti është pjesë e jona që jeton përgjithmonë. Kur vdesim, shpirti ose shkon në qiell me Perëndinë, ose ndahet përgjithmonë nga Perëndia në liqenin e zjarrit.

Le të mendojmë

1. Për çfarë ka nevojë z. Bond, gjë të cilën nuk mund ta blejë?
 - a. Ilaçe; b. Ushqim; c. Jetë të përjetshme.
2. Pse në botë vazhdojnë të ndodhin “gjëra të vështira”?
 - a. Për shkak të mëkatit; b. Askush nuk e di pse; c. Sepse Perëndia është i zemëruar.
3. Cila zgjat më shumë, një jetë e vështirë apo përjetësia?
 - a. Një jetë e vështirë; b. Përjetësia; c. Ato zgjasin njësoj.
4. Ku e gjejmë rrugën e vërtetë për të pasur jetën e përjetshme?
 - a. Në gazetë; b. Te një person që ka vdekur; c. Në Bibël.
5. Pse ai djaloshi do të ishte me Jezusin kur vdiq?
 - a. Ai besoi te Jezusi; b. Sepse ishte i ri; c. Sepse kishte pasur një jetë të vështirë plot me vuajtje.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Jezusi i kishte mësuar judenjtë për rreth tre vjet deri në këtë pikë. Ai i njihte “zemrat” e njerëzve. Edhe përpara dy mijë vjetësh njerëzit jetonin për veten, duke menduar vetëm për kohën kur ishin gjallë. Ata nuk donin të mendonin për atë që do t’u ndodhte pasi të vdisnin. Historia e sotme është një paralajmërim nga Perëndia për ndëshkimin e përjetshëm dhe të pafund ndaj tërë atyre që refuzojnë shpëtimin që ka siguruar Perëndia përmes Jezu Krishtit. Na jep një rast për të menduar tani për të ardhmen tonë të përjetshme.

1. I pasuri dhe Llazari - Luka 16:19-22.

- Kur i krahasojmë këta dy burra, duket sikur i pasuri po ia kalonte më mirë se Llazari, lypsari⁷⁹.
 - I pasuri dukej se kishte gjithçka për të cilën kishte nevojë dhe mbase më tepër.
 - Por Llazari ishte shumë i sëmurë; ai nuk kishte shumë ushqim dhe qentë i lëpinin plagët.
- Lypsari vdiq dhe u çua nga engjëjt në “gjirin e Abrahamit”. I pasuri vdiq dhe u varros.

Mendo:

- A e penguan pasuritë të pasurin që të mos vdiste?
 - A i erdhën pasuritë në ndihmë pasi vdiq?
 - Ku shkoi Llazari pas vdiq?
 - Ai shkoi në vendin ku ishte Abrahami.
 - Çfarë i ndodhi të pasurit? Ku shkoi pasi u shkëput nga trupi i tij?
- Kur njerëzit vdesin, ata ose shkojnë drejt e te Perëndia ose drejt e në vendin e ndëshkimit (2 Korintasve 5:8).
 - Abrahami ishte varrosur para se të vdisnin këta njerëz, por ai po jetonte akoma me Perëndinë.
 - Ti, ose do të jetosh përgjithmonë me Perëndinë në qiell, ose do të jesh përgjithmonë në vendin e zjarrit dhe ndëshkimit për mëkatin⁸⁰.

2. Thirrja e të pasurit për ndihmë - Luka 16:23-24.

- Jezusi e dinte se ku kishin shkuar Llazari dhe i pasuri pasi vdiqën (Psalmi 139:7-8).
 - Ai është Perëndia, ndaj Ai e di se ku është personi, edhe pasi ka vdekur.
 - Llazari shkoi në vendin e paqes, lumturisë dhe pranimit, me Perëndinë.

Ky nuk është i njëjti Llazar që Jezusi ngjalli prej së vdekurish në mësimin e mëparshëm.


Ne nuk e kemi bërë më parë dhe nuk do të kalojmë kohë tani për të mësuar ndryshimin midis Hadesit dhe liqenit të zjarrit. Edhe pse Hadesi, në të cilin shkoi i pasuri, nuk është vendmbërritja përfundimtare e të pashpëtuarve; ata që janë atje kanë hyrë tashmë në vuajtjet e përjetshme. Pas Gjykimit të Fronit të Madh e të Bardhë, ata që janë në Hades do të hidhen në liqenin e zjarrit, që u përgatit për Satanin dhe engjëjt e tij (Zbulesa 20:10, 12-15).

→ Figura 60: I pasuri në ferr

⁸¹Mendo: A shkoi Llazari në vendin e paqes, lumturisë dhe pranimit me Perëndinë, sepse ishte i varfër në këtë tokë? A shkoi i pasuri në vendin e ndëshkimit, sepse ishte i pasur? A i refuzon Perëndia të pasurit dhe i pranon të varfrit? Jo! Nuk ishte ky ndryshimi midis këtyre dy burrave. I pasuri shkoi në ferr, sepse nuk u pajtua me Perëndinë që ai ishte mëkatar dhe nuk besoi në Perëndinë dhe premtimet e Tij. I pasuri nuk gjeti kohë të mendonte për Perëndinë apo t'i besonte Fjalës së Tij. Ai thjesht jetoi jetën e tij këtu në tokë për të shijuar pasuritë e tij. Ai jetoi për veten dhe nuk u kujtua për Perëndinë. Megjithatë, Llazari ishte ndryshe. Ngaqë ai shkoi te Abrahami, dimë që ai duhet të kishte rënë dakord me Perëndinë se ishte mëkatar. Ai i besoi Perëndisë dhe premtimeve të Tij.

⁸²Nëse dikush pyet për "purgatorin", thuajti që Bibla nuk e përmend purgatorin. (Purgatori është një ide e rreme njerëzore e një vendi ku një person mund të ketë një mundësi tjetër pasi vdes për t'i rregulluar gjërat me Perëndinë). Kur flet për një mësim të rremë si ky, mos e sulmo fenë që e mëson; thjesht poho faktin se ai mësim nuk përputhet me atë që thotë Bibla.

→ Grafiku 35: Grafiku i kohës



Pyetje dhe përgjigje

- Kur vdesin njerëzit, ku shkojnë ata?
 - Ose te Perëndia në qiell;
 - Ose në ndëshkim të përjetshëm.
- Kush vendos kur vdesin? **Perëndia.**
- A do të çlirohet dikush nga vendi i ndëshkimit? **Jo, ata nuk mund të shpëtojnë kurrë.**
- Kush i mashtron njerëzit për të ardhmen e tyre? **Satani, armiku ynë.**
- Sa zgjat përjetësia? **Përgjithmonë.**

- I pasuri shkoi në vendin e zjarrit dhe ndëshkimit të përjetshëm⁸¹.

- Ka vuajtje të mëdha në ferr.
 - Të gjithë ata që refuzojnë t'i besojnë asaj që thotë Perëndia në Fjalën e Tij do të shkojnë atje dhe do të vuajnë.
 - Perëndia e urren mëkatin.
 - Ndëshkimi ndaj mëkatiit për të cilin flet Perëndia, nuk është thjesht një kërcënim.
 - Çdo mëkat duhet të paguhet plotësisht.

3. Përgjigja e Abrahamit - Luka 16:25-26.

- Kur njerëzit vdesin dhe shkojnë në ferr, nuk kanë më mundësi shpëtimi apo çlirim⁸².
- Ata vdesin të ndarë nga Perëndia për shkak të mëkatiit të tyre dhe mbeten të ndarë nga Ai përgjithmonë.

4. I pasuri kujton vëllezërit e tij - Luka 16:27-28.

- Edhe pse po vuante tmerrësisht, i pasuri akoma kujton vëllezërit e tij.
- I pasuri donte që të afërmit e tij të paralajmëroheshin, në mënyrë që ata të mos përjetonin të njëjtin ndëshkim të tmerrshëm që po përjetonte ai.

5. Përgjigja e Abrahamit - Luka 16:29.

- Abrahami i tha të pasurit se vëllezërit e tij kishin shkrimet e Moisiut dhe të gjithë profetëve nga të cilat mund të mësonin.
 - Askush nuk ka pse të shkojë në ferr. Nëse dëgjojmë Fjalën e Perëndisë, Ai do të na mësojë rrugën për në jetën e përjetshme përmes Jezu Krishtit.

6. Argumenti i të pasurit dhe përgjigja e Abrahamit - Luka 16:30-31.

- Nëse njerëzit refuzojnë të besojnë fjalën e shkruar të Perëndisë, ata nuk do të besojnë edhe sikur Perëndia të dërgojë dikë prej së vdekurish për t'i paralajmëruar.
 - Edhe pse drejtuesit fetarë e panë Jezusin të ngjallë prej së vdekurish një Llazar tjetër, sërish ata nuk do të besojnë.

7. Satani, armiku ynë, i ka mashtruar me të vërtetë njerëzit!

- Për shumicën e njerëzve, paratë, gjërat dhe madje shëndeti duken më të rëndësishme sesa Perëndia.

Le të shikojmë këtë grafik kohe:



Vija në mes përfaqëson kohën.

- Mund të shikosh se shtrihet pafund në të dy drejtimet, përjetësia e largët dhe e ardhmja e përjetshme.
- Kanë kaluar rreth dy mijë vjet që kur Jezusi tregoi historinë e të pasurit dhe Llazarit.
- Të dy këta njerëz janë në të njëjtat kushte kur Jezusi tregoi historinë:
 - Llazari i besoi Perëndisë; ai është në paqe me Perëndinë.
 - I pasuri nuk i besoi Perëndisë kur ishte në tokë; ai po vuan në ferr.
- Vendet nuk mund të ndryshohen; e ardhmja e tyre u vendos, ndërsa ata ishin akoma në tokë.

Shikoni se ku jemi në tani në grafikun e kohës. Sa e gjatë mendon se do të jetë jeta jote: 50, 60, 70, 80 vjet! Sa e gjatë do të ishte në këtë grafik? Jo shumë. Mendo për atë, përjetësia është një kohë e gjatë – përgjithmonë. Satani dëshiron që të mendojmë që kemi shumë kohë për të menduar.

Zgjedhja për ta besuar apo për të mos e besuar Fjalën e Perëndisë dhe për t'i besuar sigurimit të tij për mëkatet e tua do të vendosë se ku do të kalosh përjetësinë. Mos u vono për të bërë zgjedhjen tënde!

Mësimi 60

Qëllimi

Në këtë mësim Jezusi shfaqet si Qengji i Pashkës, që vdiq për të shpëtuar tërë njerëzimin. Në Darkën e Zotit, buka përfaqëson trupin e Tij, të thyer për njerëzimin. Kupa përfaqëson gjakun e Tij, të derdhur për mëkatet e tërë njerëzimit. Tradhtia e Judës ndaj Jezusit tregohet si komplot i Satanit, i cili kishte synim që Jezusi të mos e çlironte njerëzimin. Hollësitë e jetës së Jezusit tregohen si përbushje e profecisë.

Hyrje

Qengjat dhe kafshët që flijuan izraelitët ishin një kujtesë që ndëshkimi për mëkatet është vdekja. Izraelitët ishin ata që mëkatuan, por qengjat vdiqën në vendin e tyre. Qengji ishte një zëvendësues apo një flijim, për personin që kishte mëkatuar. Në të njëjtën mënyrë Jezusi do të ishte Qengji i Pashkës për mëkatet. Ai do të vdiste, duke zënë vendin e mëkatarëve.

Figurat

→ Figura 61: Hyrja ngadhënjimtare



→ Figura 62: Darka e Zotit



→ Gafiku 27: Profecitë

Jezusi tradhthohet

Historia

“Përshëndetje, Tom” - tha Karola. “Çfarë po studioni tani me xhaxhi Piterin?”.

“Diçka që nuk më duket e drejtë” - u përgjigj Tomi. “Mendoj se ishte mizore kur izraelitët flijonin qengjat dhe kafshët e tjera”.

“Jam i kënaqur që na the, Tomi” - tha xhaxhi Piteri. “E kemi të vështirë ta kuptojmë, sidomos kur nuk flijojmë më kafshë. Ka disa gjëra që duhet të kujtojmë, në mënyrë që t'i kuptojmë”.

“Për shembull?” - pyeti Xhoni.

“Shiko,” - tha xhaxhi Piteri, – “së pari, vrasja e një qengji apo kafshe tjetër ishte një kujtesë se ndëshkimi për mëkatet është vdekja. Kjo ishte gjithashtu mënyra e Perëndisë se si izraelitët duhet t'i afroreshin Atij me anë të besimit”.

“Kujtoj që Abeli iu afrua Perëndisë sipas mënyrës së Tij” - tha Tomi.

“Po” - tha Xhoni. “Ai shkoi te Perëndia me një kafshë nga vatha e tij”.

“Dhe ai u pranua nga Perëndia” - tha xhaxhi Piteri. “Ai u afrua duke i besuar Perëndisë, duke rënë dakord me Perëndinë për mëkatet e tij. A e mbani mend Pashkën?”.

“Perëndia u tha izraelitëve që të vrisnin një qengj të përsosur për çdo familje” - tha Karola. “Dhe kur Perëndia pa gjakun në shtalkat e dyerve, Ai kaloi tutje pa i vrrarë ata”.

“Pikërisht” - tha xhaxhi Piteri. “Bibla thotë se pa derdhje të gjakut, mëkati nuk mund të shlyhet. Qengji na kujton gjithashtu ndarjen midis Perëndisë dhe njeriut. Në kohën e tabernakullit dhe tempullit, kryepriifti ishte i vetmi që mund të futej në Vendin Shumë të Shenjtë. Ai duhej të sillte gjakun e një qengji dhe ta spërkaste mbi pajtuesin”.

“Por kjo nuk i shlyente të gjitha mëkatet e tyre përgjithmonë, apo jo, xhaxhi Piteri?” - pyeti Xhoni.

“Jo,” - u përgjigj xhaxhi Piteri, - “por Perëndia kishte planifikuar diçka më të mirë. Për mijëra vjet njerëzit kishin sjellë qengja apo kafshë te Perëndia. Të gjithë ata që u afruan me anë të besimit do të përfshiheshin në atë që kishte planifikuar të bënte Perëndia. Ai bëri një premtim shumë të qartë në kopsht”.

“E di!” - e ndërpreu Karola. “Ai premtoi të dërgonte Çlirimtarin”.

“Po!” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Siç e dini, Perëndia kërkonte nga izraelitët që të vrisnin një qengj për mëkatet e çdo personi. Pastaj, në Pashkën e parë, Perëndia kërkoi një qengj për çdo familje”.

“Dhe më vonë një kryepriift sillte një qengj për tërë kombin!” - kujtoi Xhoni.

“Por, a e mbani mend se si e quajti Gjon Pagëzori Jezusin?” - pyeti xhaxhi Piteri.

“Qengji i Perëndisë që heq mëkatet e botës” - tha Xhoni.

“Ke të drejtë, Xhon” - tha xhaxhi Piteri. “Tani do t'ju tregoj për festimin përfundimtar të Pashkës. Megjithatë, këtë herë qengji që do të ofrohej ishte vetë Jezusi!”.

Le të shohim në Bibël



Gjoni 1:11-12 - “Ai erdhi në shtëpinë e vet dhe të vetët nuk e pranuan, por të gjithë atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e tij”.

Kujtoju fëmijëve që Jezusi erdhi të shpëtonte popullin e Tij, judenjtë, por shumica e tyre nuk e kuptonin me të vërtetë që ishin mëkatarë dhe që kishin nevojë për një Shpëtimtar. Ata donin vetëm shërimin fizik dhe “gjërat” që Ai mund t’u jepte.

Le të mendojmë

1. Cili është dënimi për mëkatet?
 - a. Pagesa e një gjobe; b. Të bërët vepra të mira; c. Vdekja.
2. Pse duhej të derdhej gjaku?
 - a. Për të paguar për mëkatin; b. Për të ngrënë kafshët; c. Kafsha ishte e keqe.
3. Kush do të hiqte mëkatin e botës sipas asaj që tha Gjon Pagëzori?
 - a. Qengji i përsosur; b. Jezusi; c. Kryepriifti.
4. Kush është i vetmi që mund t’i bëjë njerëzit të pranueshëm para Perëndisë?
 - a. Satani; b. Jezusi; c. Adami.
5. Cila është mënyra e Perëndisë që njerëzit t’i afrohen?
 - a. Të pagëzohen; b. Të bëjnë mjaft vepra të mira; c. Me anë të besimit: duke besuar te Perëndia.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Kemi parë se njerëzit ishin shumë të lumtur me mendimin se do të çliroheshin nga romakët. Ata i ishin kushtuar Jezusit për atë që Ai mund t’u jepte si një mbret tokësor. Megjithatë, vetëm disa e konsideruan Atë si Çlirimtarin e tyre nga Satani, mëkati dhe vdekja (ndarja nga Perëndia).

1. Jezusi dërgoi dishepujt e Tij për të marrë një kërraç që Ai t’i hipte - Marku 11:1-6.

- Ndërsa Jezusi dhe dishepujt e Tij ecnin drejt Jerusalemit, ata mbërritën në një qytet të vogël të quajtur Betani, fare pak jashtë qytetit të Jerusalemit.
 - Betania ishte shtëpia e Marisë, Martës dhe L Lazarit.
 - Vetëm pak kohë më parë, Jezusi kishte ngjallur L Lazarin prej së vdekurish.

2. Njerëzit e mirëpritën Jezusin si Çlirimtar - Marku 11:7-10.

- Jezusi i hipi kërraçit dhe u fut në Jerusalem ashtu siç kishte thënë Perëndia se do të ndodhte.
- Turmat e mirëpritën Jezusin si Çlirimtarin e premtuar nga Perëndia.
 - Ata e lavdëruan si personin për të cilin tërë profetët kishin premtuar që Perëndia do ta dërgonte për të qenë mbreti i tyre.
 - Fatkeqësisht, shumica e njerëzve nuk besuan te Jezusi për të shpëtuar nga mëkati, Satani dhe vdekja.
 - Ata donin që Jezusi të ishte vetëm mbreti i tyre, në mënyrë që t’i çlironte nga romakët që sundonin në vendin e tyre.

3. Plani i drejtuesve judenj - Marku 14:1-2.

- Drejtuesit judenj ishin të vendosur ta vrisnin Jezusin, por kishin frikë nga turmat.
 - Jezusi ishte shumë i njohur për shkak të tërë mrekullive të mëdha që kishte kryer.

4. Juda planifikoi të tradhtonte Jezusin - Marku 14:10-11.

- Juda ishte një prej dymbëdhjetë dishepujve.
- Atij nuk i interesonte natyra e tij mëkatore para Perëndisë.
 - Ai nuk i besoi Jezusit si Shpëtimtari i mëkatarëve.
 - Ai e ndoqi Jezusin për fitimet e tij personale⁸³.

→ Figura 61: Hyrja ngadhënjimtare



Lexo: Zakaria 9:9.

⁸³Gjoni 12:6 na thotë se Juda ishte hajdut. Si mbajtës i qeses së parave, ai fuste duart në të.

→ Trego grafikun 27: Profecitë.
Zbullo "Tradhtuar nga një mik". Lexo tekstin e profecisë, Psalmi 41:9, në të majtë, dhe tekstin e përmbushjes së profecisë Marku 14:10-11, në të djathtë.

→ Trego grafikun 27: Profecitë.
Zbullo "Shitur për tridhjetë monedha argjendi". Lexo tekstin e profecisë, Zakaria 11:12-13, në të majtë, dhe tekstin e përmbushjes së profecisë, Mateu 26:14-15, në të djathtë.

Eksodi 12:21-27

→ Figura 62: Darka e Zotit

⁸⁴Kur judenjtë hanin së bashku në këtë mënyrë, ata e thyenin bukën të vendosur në tryezë dhe pastaj ngjyenin kafshatat në një enë të madhe në qendër të tavolinës. Kjo enë zakonisht mbante fruta të shtypura.

Përsëritje

Përsërit lojën me këtë shprehje sekrete: Qengji i Perëndisë që heq mëkatën e botës.

Pyetje dhe përgjigje

1. Çfarë prisnin njerëzit që të bëhej Jezusi? **Mbreti i tyre tokësor.**
2. Çfarë planifikuan të bënin drejtuesit fetarë? **Të vrisnin Jezusin.**
3. Kush po e drejtonte Judën për t'i ndihmuar drejtuesit fetarë që të vrisnin Jezusin? **Satani.**
4. Pse e donte Satani Jezusin të vdekur? **Sepse Jezusi do t'i çlironte mëkatarët nga ai dhe do ta shkatërronte.**
5. Çfarë arsye dha Jezusi për vdekjen e Tij? **Ai do të jepte jetën në vend të mëkatarëve.**

- Vetëm për pak para Juda ishte gati ta shiste Jezusin në duart e armiqve të Tij.
 - Ajo që tha Perëndia në Fjalën e Tij u realizua.
 - Perëndia tha se një mik i Jezusit do ta shiste atë në duart e armiqve të Tij.
 - Juda kishte qenë një shok i ngushtë i Jezusit për tre vjet.
- Satani po e drejtonte Judën të tradhtonte Jezusin.
 - Satani e urren Jezusin, sepse Jezusi është Perëndi dhe flet të vërtetën.
 - Satani mendonte që nëse do t'i nxiste drejtuesit judenj për të vrarë Jezusin, ai do të prishte planin e Perëndisë për të çliruar mëkatarët dhe përfundimisht për të shkatërruar Satanin.
- Juda shkoi tek armiqtë e Jezusit dhe u tha atyre që ai ishte gati të tradhtonte Jezusin për para.
 - Mateu na thotë se drejtuesit judenj premtuan t'i paguajnë Judës tridhjetë monedha argjendi: çmimi për një skllav të zakonshëm.
 - Mbi pesëqind vjet më parë, Perëndia i kishte thënë profetit të Tij, Zakarisë, që pikërisht kjo gjë do t'i ndodhte Çlirimtarit.
 - Fjala e Perëndisë është e mahnitshme; asnjë hollësi e profecisë nuk mbetet pa u përmbushur.

5. Përgatitja për Pashkën - Marku 14:12-16.

- Kush e kujton se çfarë ndodhie të veçantë përkujtonin judenjtë kur hëngrën Festën e Pashkës?
- Jezusi e dinte se dishepujt do të takonin një njeri që mbate një enë me ujë.
 - Kjo ishte e pazakontë për t'u parë, sepse puna e transportimit të ujit ishte zakonisht punë e grave.
 - Zoti di gjithçka para se të ndodhë.

6. Jezusi e njihje tradhtarin e Tij - Marku 14:17-21.

- Jezusi e dinte, pa ia thënë dikush, se Juda do ta tradhtonte.
- E megjithatë Jezusi e donte akoma dhe ishte shumë i trishtuar që Juda do t'ia bënte këtë Atij.
- Jezusi tha se ai që do ta tradhtonte ishte një prej dymbëdhjetë shokëve të tij që po hante me Të⁸⁴.
 - Jezusi dhe ai që do ta tradhtonte po ngjyenin copa buke në të njëjtën gjellë.
 - Edhe pse po hanin të njëjtin ushqim bashkë, shumë shpejt shoku i Jezusit do ta shiste tek armiqtë e Tij.
- Jezusi e dinte se Ai do të vdiste, ashtu siç u kishte thënë Perëndia njerëzve përmes profetëve të Dhiatës së Vjetër.
 - Tradhtari i tij, Juda, do të ndëshkohej përgjithmonë për mëkatet e tij të egoizmit dhe për pjesëmarrjen në vrasjen e një të pafajshmi: Birit të Perëndisë, dhe, mbi të gjitha, sepse refuzoi Jezu Krishtin.

7. Domethënia e bukës dhe verës - Marku 14:22-26.

- Jezusi theu bukën dhe pastaj shpjegoi që ashtu siç kishte thyer bukën, po kështu trupi i Tij do të thyhej nga njerëzit e këqinj.
- Jezusi tha se pija që u dha për të pirë ishte një tablo apo ilustrim i gjakut të Tij, i cili kur Jezusi të vdiste, do të dilte nga trupi i Tij.
- Jezusi tha se kur vdiq, Ai do të jepte jetën e Tij në vend të mëkatarëve.

Shënim: Përmes këtyre fjalëve ti po shpall ungjillin. Ji i ndjeshëm për t'i treguar më tepër ndonjërit prej nxënësve që duket i përgatitur për ta dëgjuar ungjillin, të shpjeguar në mënyrë më të plotë.

Është e pamundur të mendosh se sa shumë na do Jezusi. Ai nuk kishte mëkatuar kurrë, megjithatë Ai do të vdiste për të gjithë ne mëkatarët. Gjithkush në botë, në të shkuarën, në të tashmen dhe në të ardhmen, ka nevojë për atë që bëri Ai në vendin tonë.

Mësimi 61

Qëllimi

Ky mësim paraqet arrestimin e Jezusit, një prej gjyqeve të rreme ndaj Tij dhe ndëshkimit mizor që vuajti para kryqëzimit. Në vuajtjet e Tij ai tregoi se ishte pa mëkat, i shenjtë dhe i duruar ndërsa mori me dashje ndëshkimin tonë.

Hyrje

Pyet fëmijët nëse janë akuzuar ndonjëherë për diçka që nuk e kanë bërë. Pyeti se si janë ndier për këtë. Pastaj pyeti nëse dikush ka marrë përsipër fajin për diçka ata që kanë bërë. Pyeti nëse dikush tjetër ka marrë dënimin për atë që kanë bërë gabim. Kërkoju të mendojnë për këtë, ndërsa lexon historinë e vërtetë të arrestimit të Jezusit.

Figurat

→ Figura 63: Jezusi lutet



→ Figura 64: Jezusi arrestohet



→ Figura 65: Jezusi para Pilatit



→ Figura 66: Ushtarët tallin Jezusin



→ Grafiku 27: Profecitë

Arrestimi i Jezusit

Historia

“Xhaxhi Piter,” - tha Tomi, - “nuk mund ta kuptoj se përse njerëzit nuk e pëlqenin Jezusin”.

“Karola bëri të njëjtën pyetje kur dëgjoji për herë të parë për planin e farisenjve për ta vrarë Jezusin” - tha xhaxhi Piteri. “Është e vështirë për ta kuptuar. Megjithatë ata nuk e dinin, por ishin nën ndikimin e Satanit; ata ishin kundër Perëndisë. Farisenjtë dhe drejtuesit fetarë e urrenin Jezusin dhe ishin xhelozë për të”.

“Por Jezusi bëri shumë gjëra të mira!” - tha Tomi. “Ata duhet ta kishin dashur! Ai asnjëherë nuk bëri ndonjë gjë të keqe!”.

“Ke të drejtë, Tom!” - tha xhaxhi Piteri. “Por kjo i bëri xhelozë. Shumë njerëz e ndiqnin Jezusin. Ata madje donin ta bënin mbret. Ai ishte mbreti i tyre i vërtetë. Ai ishte pasardhës i mbretit David dhe froni i takonte Atij me të drejtë, si nga rrënja e Davidit dhe si Mbreti i mbretërve: vetë Perëndia!”.

“Farisenjtë i njihnin Shkrimet” - tha Karola. “A nuk e dinin këtë ata?”.

“Po. Shumë nga hollësitë u shkruan nga profetët e Perëndisë qëndra vjet para se të ndodhnin” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Gjithashtu, ata panë mrekullitë e Tij dhe që Ai ishte shumë popullor me njerëzit. Megjithatë, ata ishin të shqetësuar se mos humbnin pozitën e tyre si drejtues. Gjithashtu, Jezusi tha të vërtetën për ta: që ishin mëkatarë. Ndaj ata ishin xhelozë për Të dhe e urrenin se tha të vërtetën”.

“Por meqë Jezusi ishte me të vërtetë Perëndi, a nuk mund t'i ndalonte Ai që të mos i bënin diçka të keqe?” - pyeti Tomi.

“Po, Tomi, mund t'i ndalonte” - tha xhaxhi Piteri. “Bibla na thotë që Jezusi mund të thërriste mijëra engjëj që ta ndihmonin”.

“E di se përse nuk e bëri” - tha Karola. “Kur pyeta xhaxhi Piterin për këtë, ai më tha që Perëndia kishte plane të tjera dhe Jezusi bëri ato gjëra që i pëlqenin Atit të Tij. Akoma po pres të dëgjoj se cilat ishin ato plane”.

“Mund t'ju tregoj” - tha xhaxhi Piteri. “Jezusi e dinte se Ai do të vdiste. Ky ishte plani i madh i Perëndisë për të çliruar popullin nga mëkatet, Satani dhe vdekja. Gjithashtu Ai e dinte saktësisht se çfarë do të hiqte”.

“Kështu Ai e dinte këtë, edhe para se të vinte në tokë si njeri?” - e pyeti Xhoni.

“Po, Xhon” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Ai e dinte dhe Ai donte ta bënte për ne”.

“A mund ta kishte bërë në mënyrë më të thjeshtë?” - pyeti Karola.

“Jo, vdekja e Tij ishte gjëja e vetme që do të paguante plotësisht për mëkatet tona” - tha xhaxhi Piteri. “Perëndia nuk do të pranonte asgjë tjetër. Jezusi vuajti me të vërtetë kur mendoi për gjërat që e dinte se do t'i ndodhnin. Jezusi do të merrte ndëshkimin e plotë për mëkatet e çdo personi që ka jetuar ndonjëherë. Kujtoni, mëkati na ndan nga Perëndia. Jezusi ishte gati të pranonte tërë këtë për ne”.

“Atëherë Jezusi kishte fuqinë ta ndalonte,” - tha Tomi, - “por pavarësisht nga kjo e mori ndëshkimin që na takonte neve? Nuk më duket e drejtë. Ai nuk e meritonte”.

“Ke të drejtë,” - tha xhaxhi Piteri, - “por ne e meritojmë dhe pavarësisht nga kjo Ai e bëri për ne.”

“A e dinte Jezusi se ne do të ishim gjallë tani?” - pyeti Karola.

“Po, e dinte” - tha xhaxhi Piteri. “Jezusi morë tërë ndëshkimin për secilin prej nesh dhe për tërë njerëzit në mbarë botën. Le të shohim në Bibël dhe të shohim se çfarë i ndodhi”.

Le të shohim në Bibël



Isaia 53:7 - “I keqtrajtuar dhe i përlur, nuk e hapi gojën. Si një qengj që e çojnë në thertore, si një dele e heshtur përpara atyre që i qethin nuk e hapi gojën.”

Isaia po e krahasonte Jezusin me një qengj që do të theret dhe me një dele që do t'i qethet leshi. Ato nuk bërtasin si kafshët e tjera.

Le të mendojmë

1. Pse e urrenin Jezusin udhëheqësit fetarë? a. Ata ishin xhelozë për të; b. Jezusi ishte zemërgushtë; c. Jezusi nuk u bindej ligjeve të Perëndisë.
2. Çfarë tha Jezusi për judenjtë, gjë e cila i zemëroi?
 - a. Ata nuk i njihnin Shkrimet; b. Ata ishin mëkatarë; c. Ata nuk luteshin sa duhet.
3. Kush ka të drejtën të jetë mbreti i të gjithëve? a. Satani; b. Një farise; c. Jezusi.
4. Cili ishte plani i madh i Perëndisë për të shpëtuar popullin nga mëkati i tyre?
 - a. Të vriste Satanin; b. Jezusi do të vdiste për ne; c. Do të na jepte rregulla më të lehta për t'u zbatuar.
5. Pse Jezusi nuk planifikoi t'i ndalonte judenjtë që të mos e vrisnin? a. Ai nuk mund t'i ndalonte; b. Ai donte të vdiste për ne; c. Perëndia nuk do të linte Jezusin që t'i ndalonte.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Ne duam që fëmijët e klubit tonë të kuptojnë në mënyrë të qartë që Jezusi është Perëndi dhe që Ai erdhi në tokë për të qenë Shpëtimtari i mëkatarëve. Ai e dinte se çfarë do t'i ndodhte; Ai kishte përmbushur profecitë që u shkruan rreth Tij qindra vjet më parë. Ai po e bënte këtë për shkak të dashurisë së Perëndisë ndaj nesh; është vullneti i Perëndisë. Jezusi erdhi për të qenë Çlirimtari ynë dhe Ai po vuante dënimin që meritojmë ne për mëkatet tona.

1. Jezusi në Gjetsemani - Marku 14:32-42.

- Edhe pse Jezusi ishte Perëndi, Ai ishte edhe njeri.
 - Ishte shumë e vështirë për Të të përballej me gjërat e tmerrshme, të cilat e dinte që do t'i vuante.
 - Ai e dinte që për të qenë Shpëtimtari ynë, do t'i duhej të kalonte përmes vuajtjeve akoma më të tmerrshme që ka kaluar ndonjëherë ndonjë person.

2. Jezusi u tradhtua dhe arrestua - Marku 14:43-49.

- Ata mbase nuk e dinin, por Juda dhe tërë njerëzit që erdhën për ta arrestuar Jezusin drejtoheshin nga Satani⁸⁵.
- Jezusi e dinte që gjithçka që ishte parashikuar për Të në Dhiatën e Vjetër do të ndodhte siç kishte thënë Perëndia.

3. Dishepujt u larguan të gjithë - Marku 14:50-52.

- Dishepujt u larguan të gjithë dhe e lanë Jezusin, ashtu siç kishte parashikuar Ai se do të ndodhte.
 - Ata kishin frikë, ishin të zhgënjyer dhe të pështjelluar.
 - Ata besuan se Jezusi ishte Shpëtimtari i dërguar nga Perëndia, por nuk mund të kuptonin se si mund të ishte Shpëtimtari nëse do të vritej nga armiqtë e Tij.
 - Ata nuk e kuptonin se si mund t'i çlironte kjo vdekje.

4. Jezusi u gjykua nga drejtuesit judenj - Marku 14:53-65.

- Pjetri e ndiqte nga larg. Ai kishte frikë që edhe ai mund të arrestohej.
- Jezusi qëndroi para Sinedrit, gjykatës së lartë judaike⁸⁶.
 - Jezusi nuk kishte bërë asgjë të keqe.
 - Prandaj ata nuk mund të gjenin asnjë arsye të ligjshme për ta dënuar.
 - Ata nuk kishin arsye për ta urreyer Jezusin përveçse donin rrugët e tyre mëkatore dhe nuk donin t'u bindeshin fjalëve të Perëndisë, të cilat ua kishte thënë Jezusi.
- Kur thanë gënjeshtër për Të, Jezusi ishte i qetë dhe nuk përgjigjej.
 - Jezusi po i besonte Perëndisë, Atit të Tij, që të bënte atë që kishte planifikuar për Të.

→ Figura 63: Jezusi lutet

→ Figura 64: Jezusi arrestohet

⁸⁵Njerëzit sot mund të mos e mendojnë akoma, por nëse kundërshtojnë apo injorojnë Fjalën e Perëndisë dhe refuzojnë t'i besojnë Jezusit si Shpëtimtari i dërguar nga Perëndia, edhe ata drejtohen nga Satani.

⁸⁶Ky është një prej gjashtë gjyqeve të rreme të pësuar nga Jezusi. Tre nga gjyqet u bënë para drejtuesve fetarë; tre të tjerët para zyrtarëve romakë. Tërë këto gjyqe ishin të paligjshme për shkak të mënyrës se si u zhvilluan dhe/ose përdorimit të dëshmitarëve të rremë.

⁸⁷A e mban mend emrin me të cilin Perëndia e quajti veten kur Moisiu e pyeti se çfarë do t'u thoshte njerëzve kur ta pyesnin se kush e kishte dërguar?

Drejtesit judenj e dinin emrin e Perëndisë: "UNË JAM". Gjithashtu ata e dinin se Jezusi po u thoshte atyre se Ai ishte Perëndia.

→ Trego grafikun 27: Profecitë.
Zbulo "I goditur dhe i pështyrë". Lexo tekstin e profecisë, Isaia 50:6, në të majtë dhe tekstin e përmbushjes së profecisë, Marku 14:65, në të djathtë.

→ Figura 65: Jezusi para Pilatit

→ Trego grafikun 27: Profecitë
Zbulo "I heshtur kur e akuzuan". Lexo tekstin e profecisë, Isaia 53:7, në të majtë dhe tekstin e përmbushjes së Shkrimit, Marku 15:3-5, në të djathtë.

Përsëritje

Vendos këto pjesë të vargut përmendsh në rendin e duhur duke i numëruar.

Isaia 53:7

5_ si një dele e heshtur përpara atyre që i qethin

1_ I keqtrajtuar

4_ Si një qengji që e çojnë në thertore,

6_ nuk e hapi gojën

2_ dhe i përulur,

3_ nuk e hapi gojën.

Pyetje dhe përgjigje

1. Kush po i drejtonte Judën dhe drejtuesit judenj që të arrestonin dhe vrisnin Jezusin? **Satani**.
2. Çfarë gabimi kishte bërë Jezusi? **Asgjë**.
3. Çfarë tha Jezusi kur dikush gënjeu rreth Tij?
Ai nuk u përgjigj.
4. Pse u zemërua kryepriifti dhe grisi rrobat?
Sepse Jezusi po thoshte se ishte i barabartë me Perëndinë.
5. Kur e përdornin romakët kryqëzimin për të vrarë dikë? **Ata e përdornin për kriminelët më të këqinj.**

- Megjithatë, kur e pyetën nëse ishte me të vërtetë Krishti (që do të thotë Çlirimtari i premtuar) dhe Biri i Perëndisë, Jezusi u përgjigj shumë qartë se ishte⁸⁷.
 - Kur Jezusi erdhi për herë të parë në tokë, Ai erdhi për të qenë Shpëtimtari.
- Herën tjetër kur Jezusi të vijë në këtë botë, do të jetë si Biri Shumë i Lartë i Perëndisë dhe do të gjykojë të gjithë njerëzit.
 - Kur të kthehet në këtë tokë, të gjithë do ta shohin të ulur bashkë me Atin e Tij.
 - Të gjithë do ta shohin se Ai është me të vërtetë Perëndia, sepse të gjithë do të shohin se Ai është i barabartë me Perëndinë, Atin e Tij.
- Kur judenjtë donin të tregonin se ishin të zemëruar apo mërziur, e kishin si zakon që të grisnin rrobat.
 - Kryepriifti ishte shumë i zemëruar, sepse, nga përgjigjja e Tij, Jezusi kishte thënë se ai ishte i barabartë me Perëndinë.
- Isaia shkroi gati shtatëqind vjet më përpara se Jezusi do të rrihej dhe pështyhej. Jezusi vuajti me dashje, ashtu siç kishte profetizuar Isaia.

5. Jezusi u gjykua nga Pilati - Marku 15:1-5.

- Judenjtë nuk mund ta vrisnin dikë nëse nuk merrnin urdhër nga sunduesit romakë.
- Cezari, perandori romak, kishte caktuar Pilatin si qeveritar të Samarisë dhe Judesë.
- Ndaj drejtuesit judenj e çuan Jezusin te Pilati, duke shpresuar se ai do ta dënonte Jezusin me vdekje, në bazë të padive të rreme që kishin përgatitur.
- Jezusi ishte pasardhës i mbretit David dhe duhet të ishte Mbret mbi tërë judenjtë.
- Profeti Isaia kishte thënë se Shpëtimtari do të heshte kur do ta padisnin në mënyrë të rreme.
 - Gjithçka që thotë Perëndia është përmbushur në çdo hollësi.

6. Baraba apo Jezusi? - Marku 15:6-11.

- Ishte zakon që për Pashkë Pilati, qeveritari, të lironte një të burgosur për judenjtë.
 - Pilati e dinte se Jezusi nuk kishte bërë asgjë të keqe.
 - Ai e dinte se drejtuesit fetarë donin ta vrisnin Jezusin, sepse ishin xhelozë për popullaritetin e Tij.
 - Pilati shpresonte që judenjtë do të zgjidhnin të lironin Jezusin në vend të Barabës, i cili ishte vrasës.

7. Drejtuesit fetarë donin që Jezusi të kryqëzohej - Marku 15:12-14.

- Kryqëzimi përdorej nga romakët për kriminelët më të këqinj.

→ Trego grafikun 27: Profecitë.

Zbulo "I refuzuar nga judenjtë". Lexo tekstin e profecisë, Isaia 53:3, në të majtë, dhe përmbushjen e profecisë, Marku 15:10, 14 në të djathtë.

8. Jezusi fshikullohet dhe tallet - Marku 15:15-19.

- Pas fshikullimit të tmerrshëm, ushtarët e tallën Jezusin.

→ Figura 66: Ushtarët tallin Jezusin

- Goditje të përsëritura me kamxhik binin mbi lëkurën e zhveshur të Jezusit, duke prerë mishin, muskujt dhe nervat e tij. (Diçka e tillë shpesh bënte që një personi t'i binte të fikët apo të vdiste.)
- Ata e veshën me një rrobë të purpurt (ngjyra që mbretërit vishnin gjatë asaj kohe).
- Ata bënë një kurorë të thurur që kishte gjemba të mëdhenj dhe të mprehtë, e vunë në kokën e Jezusit duke e tallur dhe duke i thënë: "Tungjatjeta, o Mbret i judenjve!".

Jezusi vuajti në mënyrë të tmerrshme për ty dhe për mua: për mëkatet e mia dhe për mëkatet e tua. Ai nuk u ankua. Mendo për këtë!

Mësimi 62

Qëllimi

Ky mësim paraqet vdekjen e Jezu Krishtit si pagesa e vetme për mëkatet. Gjithashtu jep përmbushjen e hollësisht të profecisë së Dhiatës së Vjetër. Fakti që Jezusi pagoi për mëkatet me anë të vdekjes, tregohet nga pikat e mëposhtme:

- Mëkati duhet të paguhet.
- Jezusi ishte pa mëkat.
- Jezusi u nda nga Perëndia për mëkatet tona.
- Jezusi bëri gjithçka që ishte e nevojshme për çlirim tonë nga Satani, mëkati dhe vdekja.

Hyrje

Ndihmoji fëmijët të kuptojnë se sa të vështirë e kishte Jezusi që të ndahej nga Ati i tij ndërsa ishte në kryq. Vdekja është ndëshkimi për mëkatet dhe duhet të paguhet dënimi i plotë. Mëkati duhet të shlyhet me ndarjen nga Perëndia. Këtë meritojmë ne. Jezusi duhet të ndahej nga Perëndia, në mënyrë që mëkatet tona të faleshin. Jezusi zuri vendin tonë!

Figurat

- Figura 16: Abrahami ofron Isaku



- Figura 34: Gjarpri mbi shtizë



- Figura 45: Gjon Pagëzori u thotë njerëzve që Jezusi është Qengji i Perëndisë



- Figura 67: Kryqëzimi



- Grafiku 27: Profecitë
- Grafiku 8: Perëndia dhe njeriu
- Grafiku 36: Perëndia dhe njeriu: Jezu Krishti

Kryqëzimi i Jezusit

Historia

“Xhaxhi Piter, a mund të na tregosh më tepër se çfarë i ndodhi Jezusit?” - pyeti Tomi. “Mendova se e kuptova, por më duket shumë më e tmerrshme tani që po e lexojmë nga Bibla. Ata u treguan të poshtër ndaj Tij!”.

“Ishte e tmerrshme, Tomi” - tha xhaxhi Piteri. “Jezusi po vuante ndëshkimin për tërë mëkatet e çdo personi që ka jetuar ndonjëherë”.

“Dhe Ai nuk bëri asgjë të gabuar!” - tha Karola.

“Jo, nuk bëri” - tha xhaxhi Piteri. “Dhe ishte plotësisht gati të vuante për këtë. Gjithçka në Bibël e tregonte këtë gjë: Jezusi do të vdiste për mëkatet”.

“A e dinin njerëzit se çfarë po ndodhte?” - pyeti Xhoni.

“Në të vërtetë jo” - tha xhaxhi Piteri. “Edhe dishepujt e Jezusit ishin të përshtjelluar. Ata mendonin se Jezusi do të bëhej Mbreti i tyre dhe do t'i çlironte nga sundimi romak. Por tani ata po e shikonin duke u kryqëzuar”.

“Çfarë do të thotë ‘kryqëzim’?” - pyeti Tomi.

“Do të thotë se ai u gozhdua në kryqin e drunjtë dhe u la atje derisa vdiq” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Vdekja në këtë formë ishte mbase mënyra më mizore. Një person mund të rrinte varur në kryq për ditë të tëra para se të vdiste. Ishte një vuajtje e tmerrshme”.

“Po mendoja që Ai mund të kishte shpëtuar paq nga tërë kjo!” - tha Xhoni.

“Por nuk e bëri! Ai donte ta bënte këtë me të vërtetë, për ne”.

“Po, ashtu është” - tha xhaxhi Piteri. “Ai nuk e mbrojti kurrë veten; Ai i duroi me qetësi. Ai u var atje në kryq midis dy njerëzve që meritonin të vdisnin. Është e vështirë të imagjinohet se sa shumë po vuante”.

“Duket shumë e tmerrshme” - tha Karola. “Do të doja që Perëndia të kishte gjetur një rrugë tjetër”.

“Mëkati na ndan nga Perëndia” - tha xhaxhi Piteri. “Ndëshkimi për mëkatet është vdekja. Perëndia nuk mund t'i falte kurrë mëkatet tona nëse ndëshkimi për mëkatet tona nuk paguhej plotësisht. Jezusi pagoi atë çmim për ne duke vdekur në vendin tonë”.

“Por Ai nuk kishte mëkatuar kurrë!” - tha Tomi. “Jo, dhe kjo është arsyeja se përse Perëndia do të pranonte vdekjen e Tij për ne” - tha xhaxhi Piteri. “A i mbani mend kafshët që silleshin për flijim? Ato duhet të ishin të përsosura. Asgjë tjetër veç flijimit të përsosur nuk do të ishte e pranueshme. Ne nuk do të mund ta paguanim kurrë çmimin për mëkatet tona”.

“A i mori Ai me të vërtetë mëkatet tona në kryq?” - pyeti Xhoni. “Edhe gjërat e tmerrshme që bëjnë njerëzit, si vrasja?”.

“Po” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Edhe gjërat e vogla që përpiqemi të harrojmë: ato gjëra që janë po ashtu mëkat dhe për të cilat duhet të paguhej plotësisht në kryq. Çdo gënjeshtër e vogël, çdo fjalë jo e këndshme, çdo akt mosbindjeje, çdo mendim i keq”.


“Oh, xhaxhi Piter,” - tha Karola, - “Jezusi e bëri këtë për mua! Ai e bëri këtë për mëkatet e mia!”.

“Po, Karola, për ty!” - tha xhaxhi Piteri. “Ai, për një farë kohe, u nda tërësisht nga Perëndia Atë. Kur Jezusi mori mëkatet tona mbi veten në kryq, Perëndia nuk mund të kishte përbashkësi me Të. Ashtu siç na ndalojnë mëkatet tona nga Perëndia, mëkatet tona e ndanë Jezusin nga Ati i Tij në atë çast të tmerrshëm”.

“Ua, Ai mori ndëshkimin tim!” - tha Karola. “Ai vdiq për mua! I jam shumë mirënjohëse!”.

“Jam shumë i lumtur që ti beson në atë që ka bërë Jezusi në kryq për ty, Karola!” - tha xhaxhi Piteri i gëzuar. “Do të doja që e tërë bota të besonte!”.

Le të shohim në Bibël



1 Timoteut 2:5 - “Në fakt një është Perëndia, dhe një i vetëm është ndërmjetësi midis Perëndisë dhe njerëzve: Krishti Jezus njeri.”

Shpjego që ndërmjetës është personi që bën paqe midis dy palëve, të cilat nuk mund të pajtohen pa ndihmë nga jashtë. Jezu Krishti është ndërmjetës.

Ai është Perëndia i shenjtë që u bë njeri dhe pagoi çmimin e plotë për mëkatarët. Tani njerëzit mund t'i afrohen Perëndisë me anë të besimit te Jezu Krishti.

Le të mendojmë

1. Për kë vuajti Jezusi?
a. Vetëm për dishepujt e Tij; b. Vetëm për miqtë e Tij; **c. Për të gjithë**
2. Si vdiq Jezusi?
a. E rrahën me kamxhik për vdekje; **b. U kryqëzua**; c. E rrahën për vdekje.
3. Çfarë na ndan nga Perëndia? a. Satani; b. Drejtuesit fetarë; **c. Mëkati**
4. Cili është ndëshkimi për mëkatin?
a. Vdekja; b. Pagesa e një gjobe; c. Një fshikullimë.
5. Kush pagoi çmimin për tërë mëkatet tona? a. Farisenjtë; **b. Jezusi**; c. Juda.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Midis të gjitha ndodhive të historisë, ajo që do të studiojmë sot është më e rëndësishmja. Asnjë tjetër nuk ka ndikuar apo do të ndikojë jetët e burrave dhe grave, djemve dhe vajzave, si kjo histori. Ne do të studiojmë tani se çfarë bëri Jezusi për ne, në mënyrë që të mund të pranohemi plotësisht nga Perëndia dhe të mos shkojmë kurrë në ndëshkimin e përgjeshëm.

1. Jezusi u kryqëzua - Marku 15:20-28.

- Golgota ishte jashtë mureve të Jerusalemit.
- Pija e përgatitur nga gratë e Jerusalemit jepet si akt mëshire për të ndihmuar në lehtësimin e dhimbjes të atyre që kryqëzoheshin.
- Gozhdët kishin depërtuar nëpër duart dhe këmbët e Jezusit në kryqin e drunjtë.
- Pastaj kryqi u vendos në pozicion vertikal.

Kujtoni:

A kujtoni që Jezusi i tha Nikodemit që, ashtu si Moisiu në shkretëtirë ngriti gjarprin mbi shtizë, po ashtu Jezusi, Çlirimtari, duhej të ngrihej, në mënyrë që mëkatarët të mund të shpëtoheshin nga ndëshkimi (Gjoni 3:14-15)? Jezusi u gozhdua në kryq dhe u ngrit ashtu siç tha që do të ndodhte.

- Afërsisht një mijë vjet më përpara Perëndia e kishte drejtuar mbretin David të shkruante që duart dhe këmbët e Çlirimtarit do të shpoheshin.
- Gjithashtu, Davidi tha se rrobat e Çlirimtarit do të bëheshin çmimi i një loje bixhozi.
- Zakonisht mbi kokën e kriminelit vihej një mbishkrim për të treguar se çfarë krimi kishte kryer.
 - Jezusi nuk kishte kryer asnjë krim, ndaj Pilati tha që sipër kokës së Jezusit duhej të vihej një mbishkrim që thoshte: “MBRETI I JUDENJVE” (Gjoni 19:6).

Mendo: Jezusi po vdiste për mëkatet: mëkatet e mia, mëkatet e tua dhe mëkatet e tërë botës. Ti dhe unë jemi ata që meritonim të ishim në kryq. Ai po merrte ndëshkimin tonë. Me qetësi, para Perëndisë, mendo se çfarë duhet të shkruhej te mbishkrimi mbi kokën tënde. Cilat janë mëkatet që ti i di se i ke kryer?⁸⁸

Jezusi po merrte mbi vete tërë turpin dhe ndëshkimin e plotë për secilin prej atyre mëkateve, po ashtu edhe për tërë mëkatet që nuk mund t'i kujtojmë se i kemi bërë. Ai po paguante çmimin e plotë për ne: ndëshkimin me vdekje, për mua dhe për ty.

→ Figura 67: Kryqëzimi

Shënim: Trego hollësitë e treguara në figurën 87: “Kryqëzimi”, ndërsa mëson pjesën e mbetur të mësimit.

→ Figura 34: Gjarpi mbi shtizë

→ Trego grafikun 27: Profecitë.

Zbulo “Këmbët dhe duart e Tij të shpuara”. Lexo tekstin e profecisë, Psalmi 22:16, në të majtë, dhe tekstin e përbushjes së profecisë, Marku 5:24, në të djathtë.

⁸⁸Ti nuk po u kërkon fëmijëve që të t'i rrëfejnë ty mëkatet e tyre. Ti po i këshillon që t'i konsiderojnë mëkatet e tyre para Perëndisë dhe të besojnë se Jezu Krishti vdiq për ato mëkate, për të mirën e tyre. Mos i detyro, vetëm jepu kohë dhe lejoje Frymën e Shenjtë të veprojë siç dëshiron.

→ Trego grafikun 27: Profecitë.
Zbulo "Vdiq me të pabesët". Lexo tekstin e profecisë, Isaia 53:12, në të majtë dhe tekstin e përmbushjes së Shkrimit, Marku 15:27, në të djathtë.

→ Trego grafikun 27: Profecitë.
Zbulo "I tallur dhe i sharë". Lexo tekstin e profecisë, Psalmi 22:6-8, në të majtë dhe tekstin e përmbushjes së Shkrimit, Marku 15:29-32, në të djathtë.

→ Figura 45: Gjon Pagëzori u thotë njerëzve që Jezusi është Qengji i Perëndisë (Mateu 3:17).

→ Figura 16: Abrahami ofron Isakun.

Të gjithë ne kemi lindur të ndarë nga Perëndia për shkak të mëkatit të Adamit. Në kryq Jezusi po merrte mbi veten ndëshkimin e plotë që meritonin tërë pasardhësit mëkatarë të Adamit.

- Përmes profetit Isaia Perëndia tha që Çlirimtari do të vdiste në shoqërinë e njerëzve të këqinj.

2. Jezusin e tallën ndërsa ishte në kryq - Marku 15:29-32.

- Edhe pse e kryqëzuan, ai planifikoi të ngjallej përsëri pas tri ditësh.
 - Judenjtë nuk e kuptonin që Jezusi e kishte fjalën për trupin e Tij (Gjoni 2:18-21).
 - Ata mendonin se Ai po fliste për tempullin në Jerusalem.
- Mbreti David kishte shkruar që armiqtë e Çlirimtarit do ta tallnin dhe do të qeshnin me vuajtjet e Tij.
 - Perëndia e dinte me saktësi se çfarë do t'i ndodhte Birit të Tij para se të vinte në botë.

3. Jezusi pagoi për mëkatin me anë të vdekjes - Marku 15:34-37.

- Kjo është ndodhia për të cilën profetët e Perëndisë folën dhe shkruan.
 - Jezusi, Çlirimtari, është Ai për të cilin folën.

Kujtoni: Kur filluam, thamë që bibla është letra e Perëndisë për ne.

- Ky është thelbi i letrës.
- Ky është mesazhi i Perëndisë për secilin prej nesh.
- Kjo është arsyeja se përse Perëndia Bir erdhi në këtë tokë.

4. Ja se çfarë ka bërë Perëndia, në mënyrë që ne të çliroheshim përherë nga Satani, mëkati dhe vdekja.

a. Mëkati duhet të shlyhet

- Perëndia nuk mund të na e falë kurrë mëkatin dhe të na pranojë nëse ndëshkimi për mëkatin nuk është shlyer plotësisht.
- Cili është ndëshkimi për mëkatin? Vdekja (Romakëve 6:23a).
- Kjo nuk do të thotë vetëm vdekje fizike, por edhe ndarje nga Perëndia në ferr.
- Prandaj rruga e vetme se si mund të na çlironte Jezusi ishte që të zinte vendin tonë para Perëndisë dhe të ndëshkohej për mëkatet tona.

b. Jezusi ishte pa mëkat.

- Jezusi nuk kishte asnjë mëkat të vetin për të cilin të vdiste.
 - Jezusi ishte i përsosur.
 - Kur Jezusi u pagëzua nga Gjoni, Perëndia Atë tha nga qielli se Jezusi ishte Biri i Tij i dashur me të Cilin ishte i kënaqur plotësisht.
- Ngaqë Jezusi ishte pa mëkat, Ai ishte në gjendje ta ofronte veten te Perëndia si ofertë për mëkatet tona (2 Korintasve 5:21).

Kujtoni: Që nga koha kur njeriu mëkatoi, Perëndia tha se sa herë që një person të ofronte një qengj apo kafshë të tjera para Perëndisë, kafsha duhet të ishte pa të meta. Nuk duhet të ishte e sëmurë apo e lënduar. A e kujtoni dashin që Perëndia siguroi për të vdekur në vend të Isakut? A kujtoni se cila pjesë e tij kishte ngecur në shkurre? Po, dashi ishte kapur prej brirësh. Nëse dashi do të ishte lënduar, nuk do të ishte i pranueshëm para Perëndisë (Zanafilla 22:13). Perëndia është i përsosur; prandaj çdo ofertë e bërë për Të duhet të jetë e përsosur (Eksodi 12:5).

- Ngaqë Jezusi ishte pa mëkat para Perëndisë, Ai ishte në gjendje të ofrohej në vendin tonë.
 - Ashtu si qengji zuri vendin e Isakut, po kështu Jezusi erdhi në këtë botë për të zënë vendin tonë para Perëndisë dhe për të vdekur në vendin tonë.

c. Jezusi u nda nga Perëndia për mëkatet tona - Marku 15:33-35.

- Merri parasysh vuajtjet e Krishtit:
 - Ai u tradhtua nga një prej dishepujve të Tij, u arrestua pa të drejtë, u padit në mënyrë të rreme, u gjykua pa një shkak të drejtë: i refuzuar nga ata njerëz të cilët duhet ta kishin pranuar si Mbretin dhe Zotin e tyre.

Mësimi 62

(vazhdim)

Habakuku 1:13a thotë: *Ti i ke sytë tepër të pastër për të parë të keqen dhe nuk e shikon dot paudhësinë.*

Isaia 53:5-6; 2 Korintasve 5:21; Gjoni 1:29

1 Pjetrit 2:24; 3:18

→ Grafiku 8: Perëndia dhe njeriu

Lexo - Gjoni 19:30 thotë:..."U krye!"...

Kryqëzimi i Jezusit

- Ai u rrah mizorisht, u fshikullua dhe u kryqëzua.
- Tani Ai varej atje në kryq, i raskapitur, i gjakosur dhe në agoni.
- Por **asnjë prej këtyre gjërave** nuk e turbullonin në krahasim me atë që do të përjetonte për të plotësuar ndëshkimin për shkak të mëkateve tona.
- Përse tha Jezusi: "Perëndia im, Perëndia, pse më ke braktisur?"
- Ngaqë **Perëndia i ktheu shpinën Jezusit**.
- Perëndia u largua prej Jezusit dhe e la Birin e Tij të dashur tërësisht vetëm. Pse e bëri Perëndia këtë gjë të tmerrshme ndaj Jezusit?
 - Jezusi i bindet gjithmonë Perëndisë dhe ligjeve të Tij.
 - Ai nuk kishte bërë asgjë të keqe.
 - Perëndia po e ndëshkonte Jezusin për mëkatet e mia, për mëkatet e tua dhe për mëkatet e tërë botës.
- Gjatë kësaj kohe në kryq **Jezus u nda nga Perëndia**, Ati i Tij, si ndëshkim për mëkatet tona.
- Jezusi vuajti ndëshkimin e plotë për mëkatet tona, në mënyrë që Perëndia të falte bujarisht (pa kosto për ne) dhe të pranonte si bijtë e Tij tërë ata që bien dakord me Perëndinë dhe i besojnë vetëm Jezusit.

Kujtoni:

Në fillim Perëndia i tha Adamit që nëse ai hante nga pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes, ai do të vdiste; Adami do të ndahej nga Perëndia, i Cili i kishte dhënë jetën. Kjo do të thoshte që trupi i Adamit do të vdiste dhe pas vdekjes ai do të ndahej nga Perëndia në vendin e ndëshkimit të tmerrshëm, të cilin Perëndia e përgatiti për Satanin dhe engjëjt e tij. Mëkati duhet të paguhet me anë të ndarjes nga Perëndia. Kjo është arsyeja se përse Jezusi duhet të ndahej nga Perëndia.



Ishte rruga e vetme që të mund të paguante për mëkatet tona.

- Njerëzit rreth kryqit e keqkuptuan atë që tha Jezusi (Marku 15:34).
- Jezusi vdiq dhe dha jetën e Tij për ne.


d. Jezusi bëri gjithçka që ishte e nevojshme për çlirimin tonë nga Satani, mëkati dhe vdekja.

- Marku na thotë se Jezusi thirri me të madhe dhe dha frymë, por Marku nuk na thotë se çfarë tha.
- Megjithatë Gjoni, një dishepull tjetër i Jezusit, shkroi atë që Ai tha.

Mendo:

Çfarë donte të thoshte Jezusi? A donte të thoshte që për Të mbaroi me kaq? Jo, Ai kishte thënë më parë se Ai do të ngjallej përsëri pas tri ditësh. Atëherë, çfarë ishte kryer?

- Vepra që Ai erdhi të bënte në këtë botë, ishte kryer.
 - Jezusi erdhi në botë për t'i çliruar mëkatarët nga Satani, mëkati dhe vdekja.
- **Ai e kreu këtë vepër duke u ndarë nga Perëndia dhe duke derdhur gjakun dhe jetën e Tij si pagesë të plotë për mëkatet tona.**
- Jezusi i pagoi Perëndisë gjithçka që ishte e domosdoshme për mëkatet tona.
- **Të gjithë ata që bien dakord me Perëndinë dhe që besojnë te Jezusi dhe te vdekja e Tij për ne, janë të falur nga Perëndia për tërë mëkatet e tyre.**
 - Perëndia u jep atyre dhuratën e jetës së përjetshme.
 - Nuk ka përse dikush të jetë i ndarë më nga Perëndia.
- Jezu Krishti bëri për ne atë që nuk mund ta bënim për veten tonë, pra, të na afronte me Perëndinë.



⁸⁹Kujtoni: Në kopshtin e Edenit Perëndia premtoi se do të dërgonte një Çlirimtar (Zanafilla 3:15) dhe Ai e mbajti premtimin. Jezusi kreu atë vepër që Ati i kishte dhënë të bënte për ne. Mëkati i Adami i ndau tërë njerëzit nga Perëndia. Por vdekja e Jezu Krishtit në kryq, i fut të gjithë ata që vendosin besimin e tyre te Krishti në përbashkësi të përhershme me Perëndinë (Romakëve 5:12-21).

Hebrenjve 9:1-28; 10:1-18

Thuaji fëmijëve të thonë Gjonin 3:16.

Përsëritje

Mesazhi i fshehtë: "Jezusi dha gjakun dhe jetën e Tij si pagesë të plotë për mëkatet tona."

Pyetje dhe përgjigje

1. Pse u kryqëzua Jezusi? **Për të vdekur për mëkatet tona dhe mëkatet e tërë botës.**
2. Pse u bë errësirë për tri orë ndërsa Jezusi ishte në kryq? **Ishte shenja e Perëndisë që Jezusi po merrte ndëshkimin për mëkatet, duke u ndarë nga Perëndia.**
3. Çfarë nënkuptoi Jezusi kur tha: "U krye"? Jezusi nënkuptoi se Ai e kishte përbushur veprën e dhënë nga Ati i Tij, duke marrë mbi vete ndëshkimin e plotë për mëkatet.
4. Pse nuk ishte më i nevojshëm flijimi i kafshëve? **Sepse Perëndia ishte plotësisht i kënaqur me pagesën që bëri Jezusi për mëkatet.**
5. Pse rruga për te Perëndia është përsëri e hapur për njerëzimin? **Sepse Jezusi dha gjakun e Tij si pagesë të plotë për mëkatet.**

- Vepra që bëri Jezusi për ne duke vdekur në kryq është vepra e vetme që Perëndia do të pranojë si pagesë për mëkatet tona.
- Kur vendosim besimin tonë në atë që bëri Jezusi për ne në kryq, futemi në përbashkësi me Perëndinë përmes Jezu Krishtit⁸⁹.

5. Veli në tempull u nda më dysh - Marku 15:38.

Kujtoni: Kjo perde e trashë apo veli, varej përballë dhomës së brendshme në tempull. Perëndia u kishte thënë judenjve që ta vendosnin këtë vel përballë Vendit më të Shenjtë, në mënyrë që ata të mos harronin kurrë që për shkak të mëkatit, atyre nuk u lejohej të futeshin në praninë e Perëndisë. Ky ishte vendi ku kryepriifti vinte çdo vit për të spërkatur gjakun e kafshëve (Levitiku 16:12-16).

- Kush mendoni se e grisi këtë vel nga maja deri në fund?
 - Vetë Perëndia!
- Perëndia e bëri këtë për të treguar se Ai ishte tërësisht i kënaqur me pagesën që bëri Jezusi për mëkatet.
 - Flijimet e kafshëve nuk ishin të nevojshme më.
 - Gjakun e kafshëve nuk mund të paguante kurrë për mëkatet.
- Kur Jezusi vdiq, Perëndia e prishi velin. Ai u kënaq plotësisht dhe nuk kishte më nevojë për të ofruar gjakun e kafshëve.
 - Rruga për te Perëndia ishte e hapur, sepse Jezusi dha gjakun e Tij si pagesë e plotë për mëkatet.

6. Njerëzit që e panë Jezusin të vdiste - Marku 15:39-41.

- Centurioni kishte në ngarkim njëqind ushtarë.
- Këto ishin gra që i besonin Fjalës së Perëndisë dhe kishin pranuar që Jezusi ishte Shpëtimtari i premtuar.

7. Jezusi varrosët - Marku 15:42-46.

- Edhe me varrosjen e Jezusit kemi përbushjen e profecisë.
 - Jozefi nga Arimatea ishte i pasur.
 - Jezusi u varros në zgavrën e varrit që i përkiste Jozefit.
- Trego grafikun 27: Profecitë.

Zbulo "I varrosur me të pasurin". Lexo tekstin e profecisë, Isaia 53:9, në të majtë dhe përbushjen e Shkrimit, Marku 15:43-46, në të djathtë.

Kujtoju fëmijëve të klubit tënd që Jezusi bëri gjithçka që ishte e domosdoshme për të paguar ndëshkimin e plotë që meritojmë për mëkatet tona. Thuaju atyre që mund të thonë: "Jezusi mori ndëshkimin tim; të tërin. Jezusi e mori në vendin tim. Perëndia më pranon, sepse unë besoj te Jezusi që vdiq në vendin tim dhe pagoi çmimin e plotë për të gjitha mëkatet e mia. Jezusi e pagoi të tërin. Për t'u pranuar nga Perëndia, nuk kam pse të bëj diçka, përveçse të besoj te Jezusi si personi që vdiq për mua".

Ji gati të flasësh me këdo nga fëmijët që do të donte më tepër shpjegim, që shpreh dëshirën për t'u shpëtuar, apo që do të dëshmojë besimin e tij për atë që ka bërë Jezusi për të. Mos u përpjek të sforcosh dëshminë e tyre; thjesht përgjigju pyetjeve të tyre dhe pyeti se çfarë besojnë.

Mësimi 63

Qëllimi

Ky mësim trajton këto ndodhi: varri bosh; shfaqja e Jezusit dishepujve të Tij; udhëzimet për ndjekësit e Tij; ngjitja e Tij në qiell dhe kthimi i Tij i premtuar. Gjithashtu, fëmijët do të mësojnë:

- Që Jezu Krishti vdiq për mëkatet e tyre dhe që ata mund të shpëtohen vetëm duke i besuar Atij.
- Që Jezusi do të kthehet, tashmë jo për të shpëtuar, por për t'i gjykuar jobesimtarët.

Hyrje

Ndihmoji fëmijët e klubit tënd të kenë parasysht se sa e rëndësishme është të tregojnë atë që kanë mësuar rreth këtij Jezusi të mrekullueshëm, i Cili vuajti, derdhi gjakun, vdiq, u varros dhe u ngjall përsëri për ne: ky Jezus që do të vijë përsëri! Thuaju fëmijëve të mendojnë se kujt mund t'ia tregojnë atë që kanë mësuar. Ata mund të sugjerojnë prindërit, tezet, hallat, dajat dhe xhaxhallarët; vëllezërit dhe motrat, gjyshërit, miqtë, komshinjët, mësuesit, shitësit e dyqaneve, etj.

Figurat

=> Figura 68: Ringjallja



=> Figura 69: Ngjitja në qiell



=> Grafiku 27: Profecitë

Ringjallja dhe ngjitja e Jezusit në qiell

Historia

“Xhon, ku është Tomi?” - pyeti Karola. “Mendova se do të vinte sonte”.

“Tomi me të atin do të shkojnë të takojnë të ëmën e Tomit” - tha Xhoni.

“Ajo po rri me motrën e saj. Ka kaluar shumë kohë që nuk ka qenë në shtëpi”.

“Po, e vërtetë?” - tha xhaxhi Piteri. “Për këtë arsye po kthehet në shtëpi. Ai dëshiron, gjithashtu, t'i thotë asaj se si e ka vendosur besimin e tij te Jezu Krishti si Shpëtimtari i tij”.

“A është shpëtuar z. Bond?!” - pyetën Xhoni dhe Karola njëzëri.

“Po!” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Do të doja që të ishte atje. Ai duket dhe flet si një njeri i ri. Tomi është shumë i lumtur për këtë gjë!”.

“A e kupton Tomi me të vërtetë se Jezusi vdiq për mëkatet e tij?” - pyeti Xhoni.

“Po” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Ai tha që i ka besuar Jezusit dy javë më parë”.

“Më vjen çudi!” - tha Karola. “Ai mësoi gjithçka shumë shpejt. Dukej se kuptoi dhe besoi menjëherë gjithçka që lexojmë në Bibël”.

“Tomi ka qenë shumë i trishtuar dhe i lënduar” - tha xhaxhi Piteri. “Ai ishte me të vërtetë i gëzuar që dëgjoi lajmin e mirë për Jezusin”.

“Po mamaja e Tomit?” - pyeti Xhoni.

“Çfarë do të mendojë ajo për tërë këto gjëra?”.

“Z. Bond po shpreson që kur ajo të shikojë ndryshimin në jetën e tij, edhe ajo do të do të dojë të mësojë për Perëndinë” - u përgjigj xhaxhi Piteri.

“Perëndia është i mrekullueshëm!” - tha Karola. “Nuk e di se përse nuk do të donte ta pranonte edhe ajo, kur të dëgjojë për Të. Dhe shiko të gjitha gjërat që po bën Perëndia në familjen e tyre! Jam shumë e gëzuar për z. Bond! Është e trishtueshme që ka tumor, por tani, edhe po të vdesë siç thonë doktorët, do ta shohim përsëri në qiell. Z. Bond është i falur, ashtu siç jemi dhe ne!”.

“Karola, kjo e bën Jezusin kaq të veçantë” - tha xhaxhi Piteri. “Shumë fe thonë se i ndihmojnë njerëzit, por vetëm Jezusi vdiq për mëkatet tona, u varros dhe u ringjall ditën e tretë! Nuk ka asnjë tjetër që ofron falje të plotë për mëkatet dhe jetë të përjetshme me Perëndinë e Gjallë”.

“Na trego përsëri, xhaxhi Piter, çfarë ndodhi pasi vdiq Jezusi?” - pyeti Xhoni.

“Kjo është një prej pjesëve më të bukura të historisë!” - tha xhaxhi Piteri.

“Jezusi u varros në varr. Por pas tri ditësh Perëndia e ngjalli prej së vdekurish”.

“A e panë njerëzit Jezusin të gjallë?” - pyeti Xhoni. “Sepse mendoj që drejtuesit fetarë do të sajnin ndonjë histori duke thënë se dikush vodhi trupin e Tij”.

“Oh, po!” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Këtë bënë, por nuk ishin vetëm dishepujt e Tij që e panë, pasi edhe në një rast tjetër, Jezusin e panë më tepër se 500 vetë!”.

“Do të doja të isha atje ta shikoja!” - tha Xhoni.

“Edhe unë” - tha xhaxhi Piteri. “Megjithatë, do ta shohim një ditë, sepse Ai është akoma i gjallë në qiell. Dhe Ai do të kthehet në tokë një ditë, por këtë herë jo për të sjellë shpëtim. Ai e ka kryer tashmë atë punë. Ai do të vijë përsëri për t'i gjykuar tërë ata që nuk i kanë besuar Atij”.

“Do të doja ta dija se kur do të vijë” - tha Karola – “por tani dua t'ju them të gjithëve që e njoh Jezusin!”.

“Shumë mirë, Karola!” - tha xhaxhi Piteri. “Bibla nuk e thotë se kur do të kthehet Jezusi, por na thotë që t'u tregojmë të gjithë njerëzve në botë rreth Tij”.

Le të shohim në Bibël



1 Korintasve 15:3-4 - “Sepse unë ju kam transmetuar para së gjithash ato që edhe unë vetë i kam marrë, se Krishti vdiq për mëkatet tona sipas Shkrimeve, se u varros dhe u ringjall të tretën ditë, sipas Shkrimeve.”

Ky është mesazhi i ungjillit. Kujtoji fëmijët e klubit tënd që këto vargje janë regjistruar si fakte historike. Jezu Krishti erdhi në tokë dhe vdiq për mëkatet tona, u varros dhe u ringjall!

Le të mendojmë!

1. Nëse z. Bond vdes, ku do të shkojë?
a. Në ferr; b. Në parajsë; c. Do të kthehet si një person tjetër.
2. Kush është i vetmi që mund të na i falë plotësisht mëkatet?
a. Prifti; b. Askush; c. Jezusi.
3. Çfarë ndodhi tri ditë pasi Jezusi u varros?
a. U ngjall përsëri; b. Asgjë; c. Dikush vodhi trupin e tij.
4. Ku është Jezusi tani?
a. Në tokë; b. Në qiell; c. Në ferr.
5. Çfarë do të bëjë Jezusi kur të kthehet përsëri?
a. Do të vdesë përsëri për mëkatet tona; b. Do të mësojë më tepër për Perëndinë; c. Do t'i gjykojë jobesimtarët.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Kur filluam të studiojmë Biblën, folëm për faktin që Bibla është një histori e vërtetë. Jezu Krishti është personi qendror gjatë gjithë historisë. Historia e tij është e vërtetë. Ne nuk po studiojmë për një person fetar; ne po studiojmë historinë e vërtetë të Perëndisë Bir, Perëndisë Shumë të Lartë që erdhi në tokë për të qenë Shpëtimtari ynë.

1. Gratë shkojnë te varri - Luka 24:1-2.

- Jezusi vdiq dhe u varros në varr për tri ditë dhe tri net⁹⁰.
- Në fund të kësaj kohe, mëngjesin e ditës së parë të javës, disa gra që kishin besuar te Jezusi dhe që ishin atje kur u varros Jezusi, u kthyen te varri.
- Judenjët e kishin zakon të vendosnin aroma erëkëndshme në trupat e të vdekurve para se ata të varroseshin.
- Megjithatë Jezusi ishte varrosur me nxitim.
 - Ato nuk kishin pasur kohë t'i vendosnin aromat në trupin e Tij⁹¹.
- Këto gra erdhën të dielën, herët në mëngjes për t'i vendosur aromat në trupin e Jezusit.
 - Ato prisnin ta gjenin trupin e Tij akoma në varr.
- Gratë nuk e dinin që Perëndia kishte dërguar engjëllin e Tij për të hequr gurin e rëndë nga hyrja e varrit, ku ishte varrosur trupi i Jezusit⁹².

2. Mesazhi i engjëllit - Luka 24:3-12.

- Trupi i Jezusit nuk ishte në varr.
- Dhe, për çudinë e tyre, u përshëndetën nga dy engjëj!
- Jezusi ishte ngjallur prej së vdekurish, ashtu siç kishte thënë!
- Jezusi është Perëndi.
 - Ai erdhi në tokë dhe u bë njeri për të na çliruar nga Satani, mëkati dhe vdekja.
 - Jezusi e dinte edhe para se të largohej nga qielli që duhej të jepte jetën e Tij për çlirimin tonë.
 - Ai e dinte, gjithashtu, se do të ngjallej përsëri dhe se nuk do të vdiste më.

⁹⁰Një fëmijë mund të pyesë se si funksionon koha e tri ditëve dhe tri netëve. Ti do t'i thuash se edhe pse nuk do të kalojmë kohë për ta studiuar, mënyra judaike për të treguar kohën e bën këtë pohim më të kuptueshëm. Një komentari i mirë biblik do të tregojë se si shpjegohet kjo çështje.

⁹¹Drejtimesit judenj nuk i lejonin njerëzit të punonin të shtunën, e cila ishte e nesërmja. Ndaj gratë pritën deri ditën e parë të javës për të ardhur dhe për ta mbuluar trupin e tij me erëza.

⁹²Ende sot mund të shohësh në zonën e Jerusalemit varre, të cilët janë që nga koha e Jezusit. Disa prej këtyre varreve, të prera në shkëmb, kanë një derë guri të madhe e të rrumbullakët në një ulluk, në mënyrë që guri të rrokullisej te hyrja, ashtu siç përshkruhet në këtë pjesë të Biblës.

=> Trego grafikun 27: Profecitë.

Zbulo "Do të ngjallet përsëri". Lexo tekstin e profecisë, Psalmi 16:10, në të majtë dhe përbushjen e profecisë, Luka 24:6, në të djathtë. Thuaju fëmijëve që kjo është përbushje e Fjalës së Perëndisë.

Romakëve 1:1-4; 10:9

⁹³Jezusi ishte pa mëkat, por Ai pranoi përgjegjësinë për të paguar çmimin e plotë për mëkatet tona. Ky çmim i plotë duhet të paguhej në mënyrë që të pranoheshim nga Perëndia. Jezusi zuri vendin tonë para Perëndisë, Gjykatësit, dhe Perëndia e ndëshkoi Jezusin në vendin tonë.

⁹⁴Nëse bie dakord me atë që ka shkruar Perëndia në Fjalën e Tij dhe beson vetëm te Jezusi dhe pagesa e Tij për mëkatet tona, atëherë Perëndia i fal tërë mëkatet e tua, të pranon dhe të jep dhuratën e jetës së përhjetshme.

Përsëritje

Pohimet e mëposhtme tregojnë se si do Perëndia dhe se si do Satani që t'i përgjigjemi pagesës së Jezusit për mëkatet tona.

Ndaji fjalët në dy pohimet e mëposhtme dhe shkruaji te vijat.

- dhe jetën e përhjetshme, faljen e Tij, Perëndia dëshiron, për mëkatet tona, që të pranojmë. Perëndia dëshiron që të pranojmë faljen e Tij për mëkatet tona dhe jetën e përhjetshme!
- pagesën e Jezusit për ne, Satani dëshiron, dhe të vazhdojmë të ndjekim atë, që të refuzojmë. Satani dëshiron që të refuzojmë pagesën e Jezusit për ne dhe të vazhdojmë të ndjekim atë.

Pyetje dhe përgjigje

- Çfarë gjetën gratë kur shkuan te varri ku ishte varrosur Jezusi? **Guri ishte rrokullisur dhe Jezusi s'ishte në varr.**
- Çfarë ndodhi me trupin e Jezusit? **Perëndia e kishte ngjallur prej së vdekurish.**
- Çfarë na tregon ringjallja e Jezusit? **Jezusi ishte Biri i Perëndisë dhe Çlirimtari.**
- Si mund të falemi nga Perëndia dhe të pranojmë dhuratën e jetës së përhjetshme? **Duke rënë dakord me Perëndinë që jemi mëkatarë të pashpresë dhe duke besuar vetëm te Jezusi, i Cili vdiq si pagesë për mëkatet tona dhe u ngjall prej së vdekurish për të na dhënë jetën e përhjetshme.**
- Pse u tha Jezusi dishepujve që të shkonin në tërë botën dhe të predikonin lajmin e mirë? **Në mënyrë që të gjithë njerëzit të dëgjonin dhe të besonin te Jezusi, te vdekja, varrosja dhe ringjallja e Tij për ta.**

- Të gjithë ndjekësit e Jezusit duhet të ishin duke e pritur dhe shpresonin që Ai të ngjallej prej së vdekurish.
- Ai u kishte thënë atyre shumë herë para se të vdiste që do të ngjallej të tretën ditë.

3. Perëndia është i kënaqur me pagesën e Jezusit për mëkatet tona.

- Ne jemi të sigurt që Jezusi është Biri i Perëndisë dhe Çlirimtari i premtuar, sepse Perëndia e ngjalli prej së vdekurish.
 - Drejtuesit fetarë e kryqëzuan Jezusin, për shkak se Ai pohonte se ishte Biri i Perëndisë dhe Çlirimtari.
 - Por Perëndia e ringjalli Jezusin, në mënyrë që të gjithë të dinin që Jezusi ishte pikërisht Ai që tha se ishte.
- Perëndia nuk do ta kishte ngjallur Jezusin nëse Ai nuk do të ishte kënaqur plotësisht me pagesën e Jezusit në kryq⁹³.
 - Perëndia na tregoi se nuk ngelet më asgjë për të paguar, duke e çliruar Jezusin nga vdekja dhe duke e ngjallur prej së vdekurish.
- Atëherë, tani që borxhi është paguar, si mund të çlirohemi nga Satani, mëkati dhe ndarja e përhjetshme nga Perëndia?
 - Ne duhet ta vendosim besimin tonë të plotë te Zoti Jezus, duke besuar që Ai dha gjakun e Tij si pagesë të plotë për mëkatet tona, si edhe që u ringjall prej së vdekurish, për të na dhënë jetën e përhjetshme⁹⁴.

4. Jezusi iu shfaq disa prej ndjekësve të Tij - Luka 24:13-44.

- Edhe pse Jezusi ishte me ta, ata nuk e njohën.
- Pastaj Jezusi i mësoi, ashtu siç po mësojmë ne, duke folur për profecitë e Dhiatës së Vjetër rreth vetes së Tij.
- Ndërsa Jezusi filloi të thyente bukën, ashtu siç kishte bërë me ta shumë herë më parë, ata menjëherë e kuptuan se Ai ishte Jezusi!
- Më vonë, kur dishepujt ishin mbledhur së bashku, Ai iu shfaq përsëri.

5. Fjalët e fundit të Jezusit ndaj dishepujve të Tij - Luka 24:45-48.

- Ky ishte urdhri i Jezusit, jo vetëm ndaj dishepujve të Tij të parë, por edhe ndaj atyre që besojnë tek Ai dhe pranojnë pagesën e Tij për ta.
- Kjo është arsyeja se përse e kemi studiuar Biblën së bashku: në mënyrë që ta dëgjojmë, kuptojmë dhe ta besojmë këtë lajm të mirë, të mrekullueshëm dhe të mund t'ua tregojmë të tjerëve.

6. Jezusi ngjitet në qiell - Veprat e Apostujve 1:9.

- Pasi Jezusi i urdhëroi dishepujt e Tij t'ia thoshin këtë lajm të mirë çdo njeriu, Ai u largua dhe u kthye tek Ati në qiell.

→ Figura 90: Ngjitja

→ Trego grafikun 27. Zbulo "Do të kthehet në qiell". Lexo tekstin e profecisë, Psalmi 68:18, në të majtë dhe tekstin e përbushjes së Shkrimit, Veprat e Apostujve 1:9, në të djathtë.

7. Jezusi do të kthehet përsëri - Veprat e Apostujve 1:10-11.

- Dy engjëj të Perëndisë thanë se Jezusi do të kthehet përsëri në këtë tokë!
 - Kur Jezusi të kthehet përsëri, Ai do të jetë Gjykatësi Shumë i Lartë. Të gjithë ata që nuk janë penduar dhe nuk kanë besuar te Jezusi dhe pagesa e Tij për ta, do të hidhen, bashkë me Satanin dhe tërë engjëjt e tij, në zjarrin e përhjetshëm (Veprat e Apostujve 17:30-31).

Dishepujt shkuan dhe u treguan të tjerëve për Jezusin dhe disa mijëra njerëz i besuan mesazhit të tyre. Shumë nga këta njerëz shkuan dhe u thanë njerëzve të tjerë! Ne nuk e kemi parë Jezusin me sytë tanë, por ne mund të besojmë se Jezusi erdhi në botë, se Ai vdiq për mëkatet tona dhe u ngjall përsëri ditën e tretë. Ne mund ta dimë dhe ta besojmë këtë, sepse Perëndia e ka shkruar në Bibël. Edhe ne duhet të vendosim: a besojmë dhe pranojmë atë që Perëndia ka shkruar apo vazhdojmë ta ndjekim Satanin në zjarrin e përhjetshëm?

Mësimi 64

Qëllimi

Ky mësim paraqet domethënien e vdekjes së Krishtit, të parë nën dritën e tri pjesëve të Dhiatës së Vjetër. Fëmijët e klubit do të mësojnë:

- Që njerëzimi është i paaftë të shpëtojë veten.
- Që shpëtimi është nëpërmjet besimit.
- Që kanë nevojë ta vendosin besimin e tyre personalisht te Zoti Jezu Krisht dhe vdekja e Tij, si pagesa e vetme e pranueshme për mëkatet e tyre.

Hyrje

Dhiata e Vjetër është si një tabelë rrugore prej Perëndisë, sepse shumë nga gjërat e regjistruara në Dhiatën e Vjetër tregojnë lindjen, vdekjen, varrosjen dhe ringjalljen e Zotit Jezus (ne do të diskutojmë më vonë për ringjalljen).

Në mësimin tonë të sotëm do të shikojmë disa nga ndodhitë e Dhiatës së Vjetër dhe do të shohim se si ato e drejtonin vëmendjen drejt Zotit Jezus dhe vdekjes së Tij në kryq.

Figurat

=> Figura 5: Mbulimi me gjethe fiku




=> Figura 6: Adami dhe Eva të dëbuar nga kopshti



=> Figura 7: Kaini dhe Abeli sjellin oferta para Perëndisë



=> Figura 9: Arka e Noeut



=> Grafiku 37: Të pranohesh nga Perëndia

=> Grafiku 15: Një derë

Domethënia e vdekjes së Krishtit - I

Historia

“Xhaxhi Piter, si mund të shpëtohet një person?” - pyeti Xhoni.

“Ka vetëm një rrugë, Xhon” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Kur një njeri bie dakord me Perëndinë se është mëkatar, i pazoti të shpëtojë vetveten, ai duhet të vendosë besimin e tij në atë që ka bërë Jezusi për të, kur vdiq në kryq”.

“Do të thuash se kaq mjafton?” - pyeti Xhoni.

“Kjo i kushtoi shumë Jezusit” - u përgjigj xhaxhi Piteri – “ndërsa ne duhet që thjesht të pranojmë atë që Ai bëri për ne, duke vdekur në vendin tonë”.

“Unë e kam pranuar këtë pagesë për vete!” - tha Karola.

“Karola, jam mirënjohës që e ke bërë!” - tha xhaxhi Piteri. “Perëndia dëshiron që të gjithë të besojnë tek Ai!”.

“A i do me të vërtetë Perëndia të gjithë njerëzit?” - pyeti Xhoni. “Disa njerëz janë me të vërtetë të këqinj!”.

“Bibla thotë se Perëndia aq shumë e deshi të gjithë botën, sa dërgoi Jezu Krishtin për të vdekur për mëkatet e çdo personi” - tha xhaxhi Piteri. “Bibla thotë, gjithashtu, se Perëndia nuk dëshiron që dikush të humbasë; Ai dëshiron që të gjithë të shpëtohen”.

“Është e vështirë ta mendosh se Perëndia i do me të vërtetë të gjithë” - tha Xhoni.

“Kjo tregon se sa e madhe është dashuria e Tij!” - tha xhaxhi Piteri.

“Kujtoni, ishte Perëndia Ai që i krijoi njerëzit. E kujtoni se si flet Bibla te Zanafilla për miqësinë që kishte Perëndia me Adamin dhe Evën në kopsht, para se ata të mëkatonin?”.

“Po” - tha Karola. “Perëndia ecte dhe fliste me ta”.

“Ke të drejtë” - tha xhaxhi Piteri. “Megjithatë, kur Adami dhe Eva mëkatuan, të gjithë njerëzit u ndanë nga Perëndia dhe nuk mund të bënin asgjë për të pasur një miqësi me Perëndinë. Në vend të jetës së përgjeshme me Perëndinë, njerëzit do të vdisnin dhe do të jetonin përgjithmonë në ferr”.

“A nuk e dinë njerëzit se do të shkojnë në ferr tani?” - pyeti Karola.

“Duhet ta dinë” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Perëndia e ka bërë shumë të qartë në Fjalën e Tij, por Ai e ka bërë, gjithashtu, shumë të qartë rrugën për tek Ai: Bibla tregon drejt Jezu Krishtit”.

“Do të thuash si një tabelë rrugore?” - pyeti Xhoni.

“Po, Xhon” - u përgjigj xhaxhi Piteri. “Përgjatë Dhiatës së Vjetër, Perëndia na dha udhëzime, përshkrime, ashtu si dhe shenja për të na treguar rrugën për tek Ai. Të gjitha këto e drejtonin vëmendjen drejt Çlirimtarit, Jezu Krishtit”.

“Si mund të mos e shikojnë këtë rrugë?” - pyeti Karola.

“Shumë njerëz nuk e kanë lexuar kurrë Biblën” - u përgjigj xhaxhi Piteri.

“Disa njerëz duket se nuk duan t’ia dinë për Perëndinë apo Biblën. Ata nuk mendojnë se kanë nevojë për Perëndinë. Të tjerë mendojnë se Perëndia ekziston, por mendojnë se duhet të bëjnë diçka për t’u bërë të pranueshëm para Tij”.

“Nëse do të lexonin ‘tabelat rrugore’, ata nuk do të mendonin ashtu!” - tha Karola.

“Ke të drejtë!” - tha xhaxhi Piteri. “Perëndia e ka bërë Fjalën e Tij shumë të qartë. Jezu Krishti është rruga e vetme për te Perëndia. Perëndia do të pranojë vetëm ata që do të shkojnë tek Ai duke besuar te Jezusi, për shkak të asaj që ka bërë në kryq për të paguar për mëkatin”.

“A do të thuash se Perëndia dëshiron prej meje thjesht të besoj te Jezusi, i Cili vdiq për mëkatet e mia?” - pyeti Xhoni. “A më pranon me të vërtetë Perëndia nëse besoj në veprën e Birit të Tij në kryq? Nuk më duhet të bëj gjë tjetër?”.

“Xhon, xhaxhi Piteri na e ka thënë këtë prej shumë kohësh!” - tha Karola.

“E di, por tani e kuptoj se çfarë do të thotë” - tha Xhoni. “Është kaq e thjeshtë: Jezusi vdiq për mua! Perëndia më pranon për shkak të asaj që bëri Jezusi për mua në kryq!”.

“Mirë se erdhe në familjen e Perëndisë, Xhon!” - tha xhaxhi Piteri. “Tani ne jemi vëlla dhe motër në familjen e Perëndisë!” - tha Karola.

Le të shohim në Bibël



Romakëve 5:8- “Por Perëndia e tregon dashurinë e tij ndaj nesh në atë që, kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne.

Shpjego që Perëndia na do aq shumë sa që edhe pse jemi mëkatarë, Ai dha jetën e Birit të tij për të na shpëtuar nga mëkati ynë”.

Le të mendojmë

1. A mund të shpëtohet dikush që nuk beson se është mëkatar? Po/Jo.
2. Si mund të shpëtohen njerëzit e këqinj?
 - a. Ata nuk mund të shpëtohen; b. Duke i besuar Jezu Krishtit; c. Duke iu bindur të gjitha ligjeve të Perëndisë.
3. Pas vdekjes, ku do të jetojnë njerëzit që nuk besojnë te Jezu Krishti?
 - a. Në qiell; b. Asgjëkund; c. Në ferr.
4. Si mund ta zbulojnë njerëzit të vërtetën rreth rrugës së kthimit te Perëndia?
 - a. Përmes Biblës; b. Përmes çdo predikuesi; c. Përmes të gjithë librave fetarë.
5. Pse vdiq Jezusi në kryq?
 - a. Ai u kap fajtor për një krim; b. Perëndia ishte i zemëruar me Të; c. Për të paguar për mëkatet tona

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Shumë njerëz që e kanë dëgjuar ungjillin nuk e kanë parë kurrë Krishtin nën dritën e të gjithë Fjalës së Perëndisë. Ata e kanë në dispozicion përgjigjen për nevojën e tyre, por nuk e kanë kuptuar plotësisht këtë nevojë, sepse nuk e kanë parë që Perëndia është i shenjtë edhe krejt i drejtë. Ata e shohin shpëtimin si dhuratë, por ata përqendrohen më shumë tek ajo që përfitojnë, sesa tek Ai që e dhuroi.

Ky mësim do të të japë mundësinë të paraqesësh vdekjen e Zotit tonë Jezu Krisht nën dritën e themeleve të Dhiatës së Vjetër, themele që u hodhën nga vetë Zoti ynë. Perëndia ynë gjen kënaqësi teksa na mëson ta njohim se kush është Ai, kush jemi ne, si edhe faktin që ne jemi mëkatarë të ndarë prej Tij, nevojtarë të mëdhenj për një Shpëtimtar, Jezus Krishtin, që ka paguar tashmë çmimin e plotë për të na vendosur në një marrëdhënie të drejtë me Perëndinë.

1. Perëndia vrau kafshë dhe me lëkurët e tyre bëri rroba për Adamin dhe Evën.

- A e kujtoni atë që bënë Adami dhe Eva kur mëkatuan dhe kuptuan se ishin lakuriq? - Ata bënë mbulesa prej gjethesh (Zanafilla 3:7).
- A i pranoi Perëndia veshjet që bënë ata? - Jo, Ai vetë vrau kafshë dhe bëri rroba për ta (Zanafilla 3:21).
- Ngaqë ishin të papranueshëm para Perëndisë, Ai i dëboi Adamin dhe Evën nga kopshti; ata nuk kishin më përbashkësi me Perëndinë.

→ Figura 7: Adami dhe Eva të dëbuar nga Kopshti

- Por ngaqë na do, Ai dërgoi Birin e Tij, Zotin Jezus, që të vdiste për ne, në mënyrë që ne të bëheshim të pranueshëm para tij.
- Si mund t'i përgjigjet atëherë një person Perëndisë, për t'u pranuar prej Tij?

PËR T'U PRANUAR NGA PERËNDIA, NJË PERSON DUHET:

Të pranohet se është mëkatar, të vendosë besimin e tij te Zoti Jezu Krisht si Shpëtimtari i tij, të besojë që kur Jezusi vdiq në kryq dhe derdhi gjakun e vet, Ai bëri pagesën e plotë me jetën e vet, për mëkatet e tij.

→ Figura 5: Mbulesat prej gjethesh fiku

→ Grafiku 37: Për t'u pranuar nga Perëndia

Shënim: Ti ke mësuar për shpëtimin me anë të hirit të Perëndisë, përmes besimit te Jezu Krishti. Mos e ndërliko duke u dhënë më shumë "hapa" apo "gjëra që duhet të bëjnë".

⁹⁵Mendo: Nuk mund të bëjmë asgjë për t'u bërë të pranueshëm para Perëndisë. Të shkuarit në kishë, të bërët e veprave të mira, dhënia ndaj të varfërve: të gjitha këto janë gjëra që duhet t'i bëjmë, por asnjë nga këto nuk do të na bëjë të pranueshëm para Perëndisë.

→ Figura 7: Kaini dhe Abeli i çojnë oferta Perëndisë

⁹⁶A e kujton se çfarë tha Gjon Pagëzori për Zotin, kur e pa të ecte drejt tij në bregun e lumit Jordan (Gjoni 1:29)?

Përsëritje

Përdori këto fjalë për të plotësuar vendet bosh në fjalitë e mëposhtme:

- | | |
|-------------|--------------------|
| 1. Qengji; | 2. e përjetshme; |
| 3. deshi; | 4. mëkatet; |
| 5. e vetme; | 6. flijuar; |
| 7. vdekur; | 8. rruga; |
| 9. jetën; | 10. të pranueshëm. |

Por ngaqë Ai na 3, dërgoi Birin e Tij, Zoti Jezus, për të 7 për ne, në mënyrë që ne të bëheshim 10 para Tij.

Jezusi ishte 1 i Perëndisë, 6 për 4 e kujtudo në tërë botën.

Zoti Jezus është 8 5 për në 9 2.

Pyetje dhe përgjigje

- Kur Adami dhe Eva mëkatuan, çfarë bënë për vetë? **Mbulesa me gjethe.**
- Çfarë mendoj Perëndia për mbulesat e tyre? Ai nuk i pranoi. **Ai u bëri rroba të reja.**
- Çfarë duhet të vdiste që Perëndia të bënte këto mbulesa? **Kafshët.**
- Kush duhet të vdiste për të mbuluar mëkatet tona për të na bërë të pranueshëm të Perëndia? **Jezusi.**
- Sa rrugë ka për të Perëndia dhe për të jeta e përjetshme? **Një: përmes besimit të Jezu Krishti.**
- Si duhet t'i përgjigjet Perëndisë një person për t'u pranuar nga Ai?
 - Të pranojë se është mëkatar;
 - T'i besojë Zotit Jezu Krisht si Shpëtimtarit të tij, duke besuar që kur Ai vdiq në kryq dhe derdhi gjakun e Tij, bëri pagesën e plotë me jetën e vet për mëkatet e tij.

- Nëse beson vetëm tek Ai (jo tek ajo që mund të bësh ti vetë), atëherë Ai do t'i falë mëkatet e tua dhe do të të pranojë si të drejtë para Tij⁹⁵.
- Perëndia do të të pranojë, jo ngaqë je pa mëkat, por ngaqë Zoti Jezus, i Cili vdiq në vendin tënd, është pa mëkat.
- Perëndia bëri rroba për Adamin dhe Evën dhe i veshi me to.
 - Në mënyrë të ngjashme, Perëndia i vesh apo i mbulon tërë besimtarët me drejtësinë e Zotit Jezus.

2. Perëndia e pranoi ofertën e Abelit, por refuzoi atë të Kainit - Zanafilla 4:1-5.

- Ofertën e kujt pranoi Perëndia? Të Abelit.
- Pse Perëndia e refuzoi Kainin dhe gjërat që solli ai?
 - Perëndia e refuzoi Kainin, sepse ai iu afrua Perëndisë sipas mënyrës së tij, sipas idesë së tij dhe jo sipas mënyrës që kishte urdhëruar Perëndia.
 - Perëndia e kishte bërë të qartë që nga fillimi se, sa herë që një person të vinte ta adhuronte, ai duhet të sillte një kafshë, ta therte dhe të linte që gjaku i saj të rridhte.
 - Perëndia tha që të bëhej kjo gjë, duke qenë se e dinte që një ditë Biri i Tij do të jepte gjakun e Tij për të paguar për mëkatet e botës.
 - Edhe Abeli ishte mëkatar, por ai u pranua nga Perëndia, sepse besoi që Ai mund ta shpëtonte, prandaj edhe solli një sakrificë gjaku të kërkuar nga Perëndia.
 - Qengji që vrau Abeli dhe që ia ofroi Perëndisë, na kujton për Zotin Jezus⁹⁶.
 - Abeli u pranua nga Perëndia, sepse i besoi Atij dhe i solli ofertën e duhur.
 - Jezusi ishte Qengji i Perëndisë, i flijuar për mëkatet e çdo personi në botë.
 - Perëndia i pranoi të gjithë ata që e vendosën besimin e tyre te Zoti Jezus dhe te gjakun që Ai derdhi për mëkatet e tyre.

3. Perëndia shpëtoi Noeun dhe ata që ishin në arkë.

- A ju kujtohet kur lexuam në Bibël rreth mënyrës se si jetonin njerëzit në kohën e Noeut, para përmytjes (Zanafilla 6:5)?
 - Më në fund, ngaqë njerëzit refuzuan t'i dëgjonin paralajmërimet e dhëna përmes Noeut, Perëndia tha se do ta shkatërronte botën me anë të përmytjes (Zanafilla 6:7).
 - A kishte si qëllim Perëndia ta shkatërronte Noeun, i cili, ashtu si Abeli, e dinte se ishte mëkatar dhe i besoi Perëndisë për të dërguar një Çlirimtar (Zanafilla 6:8-9, 13-14)?
 - Sa dyer i tha Perëndia Noeut që të bënte në arkë? Një (Zanafilla 6:16).
=> Grafiku 15: Një derë
 - Arka kishte vetëm një derë, përmes së cilës ata mund të hynin brenda dhe të shpëtoheshin nga gjykimi i Perëndisë.
 - Para se të vinte përmytja, kafshët, Noeu dhe familja e tij u futën të tërë nga njëra derë dhe Perëndia e mbylli derën pas tyre.
 - Brenda arkës ata ishin të sigurt, larg ndëshkimit të Perëndisë në botën mëkatore.
 - Të gjithë ata që ishin jashtë vdiqën nga përmytja, sepse refuzuan t'i besonin Perëndisë dhe të futeshin në arkë nga njëra derë.
- Figura 9: Arka e Noeut
- Ajo derë na kujton Zotin Jezus, i Cili është rruga e vetme për në jetën e përjetshme.
 - Kur dikush beson që Jezusi vdiq për mëkatet e tij dhe i beson vetëm Atij, Perëndia ia fal mëkatet dhe i jep jetën e përjetshme.
 - Mos ji i marrë si njerëzit në kohën e Noeut, të cilët refuzuan të futeshin në arkë dhe të shpëtoheshin.
Jezusi i tha: "Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje" (Gjoni 14:6).

Mësimi 65

Qëllimi

Ky mësim paraqet domethënien e vdekjes së Krishtit kur shihet nën dritën e dy pjesëve të Dhiatës së Vjetër. Ky mësim do të tregojë:

- Që njerëzimi është i paaftë të shpëtojë veten.
- Që shpëtimi është nëpërmjet besimit.
- Nevoja e tyre për t'i besuar personalisht Zotit Jezu Krisht dhe vdekjes së Tij, si pagesa e vetme e pranueshme për mëkatet e tyre.

Hyrje


Tregojë fëmijëve dëshminë tënde të shpëtimit. Mund të jetë diçka e tillë: "Kam pranuar para Perëndisë që jam mëkatar, i kam besuar Zotit Jezus dhe vdekjes së Tij për mua. E di që e kam jetën e përjetshme, sepse Jezusi pagoi për të gjitha mëkatet e mia". Thuaj atyre që nëse besojnë vetëm te Jezusi dhe e pranojnë vdekjen e Tij si pagesë për mëkatet e tyre, Perëndia do t'i falë dhe do t'u japë jetën e përjetshme.

Figurat


→ Figura 25: Gjaku i Pashkës i vënë në shtalkat e dyerve



→ Figura 31: Tabernakulli



→ Figura 32: Përbërësit e Tabernakullit



→ Grafiku 38: Jezusi: Një flijim për mëkatet

Domethënia e vdekjes së Krishtit - 2

Historia

"Ja ku po kthehet Xhoni me babanë nga qyteti" - tha Karola. "Xhoni u ndje keq kur u larguan".

"Pse" - pyeti xhaxhi Piteri. "Çfarë ndodhi?".

"Xhoni kishte marrë hua një libër shumë të bukur të botanikës nga mësuesi i tij" - tha Karola. "Ishte shumë i shtrenjtë. E zuri shiu dhe libri u prish. Ai duhet të paguajë për librin, por nuk ka mjaft para. Ai nuk di çfarë të bëjë".

"Ja ku erdhi," - tha xhaxhi Piteri, - "por ai është duke buzëqeshur!".

"Nuk e merr me mend se çfarë bëri babi!" - tha Xhoni.

"Më çoi te shtëpia e mësuesit dhe pagoi për librin në vendin tim: çmimin e plotë!".

"Po ti, si do t'ia kthesh paratë?" - pyeti Karola.

"Kjo është ajo që është e mahnitshme!" - tha Xhoni. "Ai tha që unë nuk mund ta paguaja. Ai donte që të paguante në vendin tim. Ai më përqafoi dhe më tha që më donte".

"Xhon, babai yt ka bërë një gjë të mrekullueshme për ty" - tha xhaxhi Piteri.

"Por nuk mbaron me kaq!" - tha Xhoni i gëzuar. "Më çoi në librari dhe ma bleu edhe mua një kopje të atij libri! E kam këtu në çantë. Shikoje!".

"Fantastike, Xhon!" - tha Karola. "Çfarë surprize e bukur!".

"Xhon, babi yt sapo të paraqiti një tablo shumë të bukur të diçkaje tjetër" - tha xhaxhi Piteri.

"Çfarë është kjo?" - pyeti Xhoni.

"Shpëtimi yt" - tha xhaxhi Piteri. "Ti, të gjithë ne, jemi mëkatarë të rrënuar. Ne vetë nuk mund të bëjmë diçka për të paguar borxhin për mëkatet tona. Ndëshkimi për mëkatet është vdekja dhe ndarja nga Perëndia përgjithmonë".

"Jetët tona i ngjajnë atij libri të prishur" - tha Karola.

"Po, por Jezusi zuri vendin tonë kur vdiq në kryq" - tha xhaxhi Piteri.

"Ai na desh, ndaj bëri që mëkatet tona të binin mbi Të, në mënyrë që të paguante ndëshkimin e plotë për ne".

"Ashtu si babi pagoi për librin që prisha" - tha Xhoni.

"Jo vetëm kaq," - tha xhaxhi Piteri, - "Jezusi u ngjall përsëri dhe është i gjallë përgjithmonë. Dhe Perëndia i premtonte jetë të përjetshme kujtdo që beson tek Ai!".

"Është njësoj si libri i ri që babai i dha Xhonit, apo jo?" - tha Karola.

"Po, Karola, ashtu është" - u përgjigj xhaxhi Piteri. "Por ajo që na jep Perëndia është shumë më e mirë!".

"Mbrëmë u ndjeva shumë keq për atë që ndodhi" - tha Xhoni. "Por tani jam mirënjohës. Jam i kënaqur për atë që më thatë, xhaxhi Piter. Të jesh i shpëtuar është me të vërtetë një dhuratë: ashtu siç është ky libër. Nuk meritoj asnjërin".

"Jo," - tha xhaxhi Piteri, - "dhe nëse do të varej nga ne, asnjë prej nesh nuk do të shpëtohej dhe asnjë nuk do të qëndronte i shpëtuar. Nëse do të varej prej nesh, ne do ta humbisnim shpëtimin çdo ditë. Por shpëtimi nuk varet prej nesh: varet nga ajo që bëri Jezusi për ne në kryq. Asgjë tjetër nuk mund ta shpëtojë një person".

"Libri im do të zgjasë për vite me radhë" - tha Xhoni. "Por shpëtimi im në Krishtin është më i mirë se kaq: shpëtimi është përgjithmonë! Nuk mendoj se do ta harroj ndonjëherë. Shpëtimi im nuk varet nga unë, por nga ajo që bëri Jezusi për mua! Ai pagoi gjithçka! Ai është i mrekullueshëm!".

Shpengim: PAGESA QË KRISHTI BËRI PËR MËKATET E MIA

Hir: Perëndia më jep një dhuratë që nuk e meritoj

Le të shohim në Bibël



Efesianëve 1:7 - “Në të cilin kemi shpengimin me anë të gjakut të tij, faljen e mëkateve sipas pasurivë së hirit të tij.”

Shpjego që në këtë varg shpengim do të thotë: pagesa që Krishti bëri për mëkatet tona, me gjakun e Tij, edhe pse ne nuk e meritojmë.

Le të mendojmë

1. Pse babai i Xhonit pagoi për librin e prishur?
 - a. Ai mendoi se e kishte për detyrë; b. Xhoni i tha atij ta paguante; **c. Sepse e donte Xhonin.**
2. Në ç’pikë ngjajmë ne me librin?
 - a. Ne jemi mëkatarë të rrënuar;** b. Ne jemi të mirë; c. Gjithkush mund të paguajë për të.
3. Çfarë duhet të bënte Jezusi për të paguar borxhin tonë te Perëndia?
 - a. Të paguante një gjobë; b. Të ishte pa mëkat; **c. Të vdiste në kryq.**
4. Pse vdiq Jezusi në kryq dhe pagoi ndëshkimin tonë?
 - a. Perëndia bëri që Ai të vdiste; **b. Ai na deshi;** c. Ushtarët bënë që Ai të vdiste.
5. Për sa kohë do të zgjasë shpëtimi?
 - a. Derisa të vdesë personi; **b. Përgjithmonë;** c. Derisa personi të mëkatojë përsëri.

Mësime nga Fjala e Perëndisë

Ky mësim do të vazhdojë të të japë mundësinë për të paraqitur vdekjen e Zotit tonë Jezu Krisht nën dritën e themeleve të Dhiatës së Vjetër, të cilat u hodhën nga vetë Zoti ynë. Mos u ngut me këto mësim. Është e rëndësishme që fëmijët ta kuptojnë mesazhin e ungjillit në mënyrë të plotë dhe të qartë.

1. Kur Perëndia pa gjakun, Ai kaloi tutje shtëpive të izraelitëve.

- Një histori tjetër që e drejton vëmendjen tonë te Zoti Jezus dhe te vdekja e Tij për mëkatarët, është Pashka.
- Tërë egjiptianët humbën të parëlindurit e tyre, të fëmijëve dhe kafshëve.
- Edhe izraelitët do të humbisnin të parëlindurit e tyre, por Perëndia u dha një rrugë shpëtimi.

a. Një qengj pa të metë - Eksodi 12:5

- Perëndia e urdhëroi çdo familje izraelite që të zgjidhte një qengj të përsosur.
- Këta qengja të përsosur të izraelitëve na kujtojnë Zotin Jezus:
 - Ai lindi pa mëkat; Ai bëri një jetë pa mëkat.
 - Ngaqë Jezusi ishte pa mëkat, Ai mund të pranohej nga Perëndia si pagesë për mëkatin tonë⁹⁷.

b. Qengjat duhet të thereshin - Eksodi 12:6.

- Familja izraelite duhet ta mbante qengjin e saj, derisa Perëndia ta urdhëronte të therej. **Krahaso:**
Nëse i parëlinduri duhet të shpëtohej nga të vdekurit, qengji duhet të vdiste dhe gjaku i tij duhet të derdhej.
Në të njëjtën mënyrë, ishte e nevojshme që Zoti Jezus të derdhte gjakun e Tij, si pagesë për mëkatet tona.
Nuk ka rrugë tjetër se si njeriu të mund të shpëtohet nga gjykimi i Perëndisë për mëkatet e tij.

c. Gjaku i qengjit duhet të vendosej në krye dhe në anët e kornizës së derës - Eksodi 12:7.

- Edhe pse izraelitët therën qengjin dhe mblodhën gjakun në një enë, ashtu siç i kishte urdhëruar Perëndia, fëmija i parëlindur sërish do të vdiste, nëse ata nuk do të bënin gjënë e radhës që u urdhëroi Perëndia.
- Kjo na mëson se vetëm të diturit se jemi mëkatarë dhe se Zoti Jezus vdiq për mëkatet tona, nuk do të na shpëtojë nga gjykimi i tmerrshëm i Perëndisë⁹⁸.

⁹⁷Për të përshpejtuar vdekjen e një të kryqëzuar, rojat i thyenin këmbët. Kjo gjë e bënte të pamundur që personi t’i përdorte këmbët për të shtyrë trupin lart, për ta ndihmuar që të merrte frymë. Megjithatë, Gjoni 19:32-33 thotë se kur ushtarët erdhën për t’u thyer këmbët Jezusit dhe dy njerëzve që ishin kryqëzuar me të, tashmë Jezusi kishte vdekur. Ata nuk ia thyen kockat. A e kujtoni që kjo ishte një prej kërkesave të qengjit të Pashkës? Izraelitët nuk duhet t’i thyenin kockat. Ndaj Jezusi përmbushi çdo kërkesë të flisë së përsosur për mëkatin.

=> Figura 25: Gjaku i Pashkës i vendosur te shtalkat e dyerve

⁹⁸Krahaso: Izraelitët duhet të vendosnin gjakun e qengjit te shtalkat e shtëpive të tyre për t’i treguar Perëndisë se po besonin që gjaku do t’i mbronte nga engjëlli i vdekjes. Në të njëjtën mënyrë, ne duhet të besojmë personalisht te Zoti Jezus dhe te vdekja e Tij si pagesë për mëkatet tona te Perëndia.

→ Figura 31: Tabernakulli

→ Figura 32: Përbërësit e tabernakullit

Shënim: Trego dhomën e brendshme, Vendin Shumë të Shenjtë. Ndërsa vazhdon të japësh mësimin, trego hollësitë e ndryshme të tabernakullit.



Lexo: Hebrejve 9:7; 10:1-10.

⁹⁹Jepu kohë fëmijëve për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje nëse mundën.

Përsëritje

J X C P E U R S H N D (K R Y Q)
I H I R X S H U P A R A J S F
D Y V Y (G J A K) È I U I Z X V
A Z D X Y I C T X Z Z B X D
(S H P E N G I M) I I X U J È I
U S H K È T O I M T A R I X Q
R X J X C D C T X J X I Y O
E N E (P A G E S È) L Y M C T
(J E T È E P È R J E T S H M E)
B N K H F O E T È S S T C T

Pyetje dhe përgjigje

- Çfarë lloj qengji u urdhëruan të përdornin izraelitët? **Një qengj të përsosur.**
- Cilin nga aspektet e Jezusit na kujtojnë këta qengja? **Jezusi ishte i përsosur.**
- Pse nuk mjafton që thjesht të dimë se Jezusi vdiq në kryq për mëkatet? **Ne duhet edhe të besojmë se Jezusi vdiq në kryq për secilin prej nesh, në mënyrë individuale.**
- Çfarë u treguan Dhjetë Urdhërimet izraelitëve? **Që ata ishin mëkatarë të pashpresë që meritonin të vdisnin.**
- Pse e ndau Perëndia velin më dysh kur vdiq Jezusi? **Jezusi kishte bërë pagesën e plotë për mëkatet tona; një herë e përgjithmonë. Nuk kishte më nevojë për të ofruar gjakun e kafshëve.**

- Ne duhet të besojmë se ajo që Zoti Jezus bëri në kryq ishte për secilin prej nesh. Jezusi vdiq për ty dhe për mua në mënyrë personale.
- Vetëm te Jezusi mund të gjejmë falje për mëkatet tona.

d. Asnjë prej të parëlindurve të izraelitëve nuk vdiq - Eksodi 12:27.

- A e vrau Engjëlli i Vdekjes fëmijën e parëlindur, i cili ishte brenda një shtëpie ku ishte vendosur gjaku? Jo!
- Perëndia bën gjithmonë atë që thotë.

Krahaso:

Perëndia tha që do të kalonte tutje çdo shtëpie ku do të shikonte gjakun, dhe ashtu bëri. Në të njëjtën mënyrë, ti mund të jesh plotësisht i sigurt që nëse beson te Zoti Jezus dhe vdekja e Tij për ty, ti nuk do të përballesh me ndëshkimin e përtjetshëm për mëkatet e tua (Gjoni 3:16).

2. Perëndia mbuloi mëkatet e Izraelit kur gjaku u vendos mbi pajtuesin.


Kujtoni:

Pasi Perëndia i çliroi izraelitët nga egjiptianët, Ai i drejtoi në malin Sinai. Atje në mal, Perëndia u dha atyre urdhërimet e Tij. Urdhërimet e Tij treguan se ata ishin mëkatarë pa shpresë dhe që meritonin të vdisnin. Megjithatë, ngaqë Perëndia është në të njëjtën kohë Perëndi i dashur, i mëshirshëm dhe plot hir, Ai udhëzoi Moisiun të ndërtonte një tabernakull ku mund të takohej me popullin e Tij dhe t'i falte mëkatet e tyre. Një herë në vit kryeprieti duhet të shkonte pas velit të trashë, të futej në dhomën e brendshme të tabernakullit dhe të spërkaste gjakun e qengjit mbi pajtuesin midis dy kerubinëve. Vit pas viti kafshët flijoheshin dhe gjaku i tyre spërkatej mbi pajtuesin. Por gjaku i kafshëve nuk mund të paguante kurrë për mëkatin. Këto oferta e drejtonin vëmendjen drejt Zotit Jezus, i Cili do të siguronte një flijim të plotë për mëkatin duke dhënë jetën e Tij të përsosur.

- A kujtoni atë që bëri Perëndia në tempull kur vdiq Jezusi (Marku 15:37-38)?
 - Kjo është perdisa që varej përballë Vëndit Shumë të Shenjtë.
 - Pse e grisi Perëndia perden më dysh?⁹⁹
 - Perëndia donte që të gjithë të dinin që Jezusi kishte paguar çmimin e plotë për mëkatin.
 - Nuk ishte më e nevojshme që të ofrohej gjaku i kafshëve.

Jezusi e bëri pagesën e plotë për mëkatet: një herë e përgjithmonë!

→ Grafiku 38: Jezusi: Një flijim për mëkatet



- Jezu Krishti bëri pagesën e plotë për çdokënd.

Gjithkush që besoi te Çlirimtari që do të vinte, njerëz si Abrahami, Moisiu dhe Davidi në kohën e Dhiatës së Vjetër, u falën plotësisht, sepse Jezusi vdiq për ta në kryq. Të gjithë ata që jetuan në kohën e Jezusit dhe besuan Atij, u falën si nga Perëndia, ashtu edhe nga Ai.

Që nga ajo kohë, miliona njerëz nga vende të ndryshme, nga mbarë bota, kanë hedhur vështrimin tek ajo që Zoti Jezus bëri kur vdiq për ta, dhe kanë besuar tek Ai si Shpëtimtari i tyre.

Mësimi 66

Qëllimi

Mësimi i sotëm do të jetë një përmbledhje e asaj që kemi mësuar gjatë këtyre 12 mësimëve të fundit. Mund të shtosh pyetje të tjera, apo t'i përshtatësh pyetjet sipas moshës së fëmijëve. Të lutem referoju faqeve 33-34 të Manuali i Mësuesit "Rrënjët e besimit", pjesa e parë, për ndihmë se si të zhvillosh mësimet dhe lojërat e përsëritjes. Ky është mësimi i fundit në këtë seri mësimesh rreth themelit biblik të mesazhit të ungjillit. Qëllimi yt duhet të jetë që secilin prej fëmijëve të klubit të ketë një kuptim të qartë se si të marrin shpëtimin përmes besimit të Jezu Krishti. Nëse kanë një kuptim të qartë të planit të Perëndisë për shpëtimin përmes Jezu Krishtit, atëherë ata nuk kanë zgjedhje tjetër, veçse të pranojnë apo të refuzojnë atë që ka bërë Krishti për ta. Jezu fëmijëve të klubit tënd rastin të bëjnë pyetje. Kjo është një kohë tepër e rëndësishme në jetët e tyre, e cila nuk mund të kalohet shkarazi për shkak të mungesës së kohës. Nëse të duhet ndihmë për të ditur se si t'i drejtosh këta fëmijë që kërkojnë ndihmën tënde, të lutem referoju paragrafit: "Si ta drejtosh një fëmijë të Krishti" në faqen 27 të Manualit të Mësuesit, pjesa e parë. Mund të duash të përsërisësh disa nga këto të vërteta kryesore me secilin prej fëmijëve që nuk e ka kuptuar qartë mesazhin e ungjillit.

Hyrje

Mund të përdorësh pyetjet për të bërë një Test Awana me fëmijët. Këto pyetje mbulojnë vetëm 12 mësimet e fundit.

Pyetje, pyetje, pyetje!

Historia

Ky mësim nuk ka histori. Kjo do të jetë një ditë përsëritjeje.

Le të shohim në Bibël



Le të shohim se sa vargje kanë mësuar fëmijët e klubit tënd dhe sa janë në gjendje të thonë përmendsh. Bëj një pyetje për secilin prej 12 vargjeve që kemi përdorur në 12 mësimet e fundit. Shembuj: Kush mund të thotë Efesianëve 2:8-9? Cili varg na thotë që shpëtimi është dhurata e

Perëndisë? Përgjigju pyetjes dhe cito përmendsh vargun që i përgjigjet kësaj pyetjeje. Fëmijët mund të fitojnë pikë shtesë për thënien e tërë vargjeve.

Marku 9:7; Efesianëve 2:8-9; Gjoni 14:6; Gjoni 11:25; Gjoni 6:29; Mateu 16:26; Isaia 53:7; Gjoni 1:11-12; 1 Timoteut 2:5; 1 Korintasve 15:3-4; Romakëve 5:8; Efesianëve 1:7.

Le të mendojmë

Gjatë 12 mësimëve të fundit kemi vazhduar të studiojmë nga pjesa e Dhiatës së Re në Bibël. Në këto mësimë mësuam për hipokrizinë e drejtuesve fetarë, sidomos farisenjve dhe skribëve, dhe se si feja pa pranuar mëkatin dhe pa pasur besim në Perëndinë, është e kotë; veprat e mira apo pasuritë e njeriut nuk mund ta shpëtojnë atë. Ne theksuam faktin që Jezusi është Perëndi dhe Shpëtimtar, dera e vetme për te Perëndia dhe te jeta e përjetshme. Ne mësuam se si Jezusi pati dhembshuri dhe mund të kuptojë brengën e njerëzve. Kemi mësuar, gjithashtu, për urrejtjen që drejtuesit fetarë kishin për Jezusin dhe se si e arrestuan, gjyqet e rreme dhe ndëshkimin mizor që hoqi para kryqëzimit. Në vuajtjet e Tij, Ai shfaqet i pamëkatë, i shenjtë dhe i duruar ndërsa mori me dëshirë ndëshkimin tonë. Ne pamë vdekjen e Jezusit në kryq si pagesa e vetme për mëkatin; Jezusi u nda nga Perëndia për mëkatet tona; Ai bëri gjithçka që ishte e nevojshme për çlirimin tonë nga Satani, mëkati dhe vdekja. Ngaqë Perëndia e pranoi pagesën e Tij për mëkatet tona, Perëndia e ngjalli prej së vdekurish. Jezusi shkoi në qiell dhe do të kthehet përsëri. Drejtuesit fetarë: skribët, farisenjtë dhe saducenjtë ishin drejtuesit judenj gjatë kohës së Jezu Krishtit.

1. Kush i sajoi ligjet e veta dhe i shtoi Fjalës së Perëndisë? **Farisenjtë.**
2. Çfarë mendon Perëndia për njerëzit që i shtojnë apo heqin nga Fjala e Tij? **Ata e kanë gabim; ata mëkatojnë. Ne nuk duhet t'i shtojmë apo heqim asaj që ka thënë Perëndia në Bibël.**
3. Ajo që hamë, veshim apo gjërat që bëjmë, a na bëjnë të pranueshëm apo të papranueshëm para Perëndisë? **Jo, asnjë nga këto gjëra nuk na bën të pranueshëm te Perëndia.**
4. Njerëzit na gjykojnë në bazë të asaj që na shikojnë të bëjmë (nga ana e jashtme), por ku shikon Perëndia? **Perëndia shikon brenda zemrave tona: mendimet, ndjenjat dhe dëshirat tona.**
5. Çfarë planifikuan t'i bënin Jezusit drejtuesit judenj? **Donin ta vrisnin.**
6. Pse donin ta vrisnin Jezusin drejtuesit fetarë? **Ata ishin të shqetësuar për faktin që njerëzit mund ta bënin Jezusin mbret dhe që romakët do të fajësonin drejtuesit judenj duke i hequr nga pozita e tyre e pushtetit dhe pasurisë.**

Jezusi: Jezu Krishti është Perëndi dhe Njeri. Ai është Biri i Perëndisë, Perëndia Bir.

1. Kur njerëzit e panë Jezusin, a dukej Ai si njeri i zakonshëm? **Jezusi nuk dukej ndryshe nga njerëzit e tjerë.**
2. Edhe pse Jezusi dukej si njerëzit e tjerë, çfarë kishte ndryshe? **Jezusi ishte edhe Perëndi, edhe njeri.**
3. Sipas Pjetrit, kush ishte Jezusi? **Pjetri besonte se Jezusi ishte Krishti, Çlirimtari, të Cilin Perëndia e dërgoi në botë.**

4. Çfarë u tha Jezusi dishepujve të Tij që do t'i ndodhte Atij? **Jezusi u tha se Ai do të refuzohej nga drejtuesit e judenjve dhe do të vritej, por se Ai do të ngjallej nga të vdekurit pas tri ditësh.**
5. A e kuptuan dishepujt atë që po thoshte Jezusi? **Jo.**
6. Në kohën e Jezusit, si bëheshin barinj të një derë për te delet? **Gjatë natës barinj të shtriheshin te hyrja e vathës, ku i fusnin delet për t'i mbrojtur.**
7. Pse Jezusi e quan veten "Dera e deleve"? **Sepse Ai është dera përmes të cilës ne duhet të hyjmë në jetën e përjetshme.**
8. Në ç'mënyrë na kujton për Jezusin dera në arkën e Noeut?
 - a. **Ashtu siç kishte vetëm një derë në arkë, po kështu Jezusi është e vetmja rrugë për në jetën e përjetshme.**
 - b. **Ashtu si vetëm ata që u futën në arkë nga një derë e vetme u shpëtuan nga gjykimi i Perëndisë, po kështu ata që e vendosin besimin e tyre te Jezusi do të shpëtohen nga zjarri i përjetshëm.**
9. Çfarë tha Jezusi se do të bënte për delet e Tij? **Ai tha se do të jepte jetën e Tij për to.**
10. **Cilat janë delet e Jezusit? Të gjithë ata që kanë rënë dakord me Perëndinë që janë mëkatarë të pashpresë dhe që i kanë besuar vetëm Jezusit si Shpëtimtarit të tyre.**
11. Çfarë premtoi Jezusi se do t'u jepte deleve të Tij? **Jetë të përjetshme.**
12. Kush e ka fuqinë për të dhënë dhe marrë jetën? **Perëndia.**
13. A do të ngjallen tërë njerëzit nga të vdekurit, dhe a do të gjykoen ata nga Perëndia? **Po, tërë njerëzit, u besojnë apo nuk u besojnë fjalëve të Perëndisë, një ditë do të ngjallen nga të vdekurit dhe do të gjykoen nga Perëndia.**
14. Kush po përpiqet t'i mbajë njerëzit të mashtruar, në mënyrë që ata të mos besojnë te Jezusi si Shpëtimtari i tyre? **Satani.**
15. Çfarë mendoi Jezusi për fëmijët? **Jezusi i do të gjithë fëmijët.**
16. A janë fëmijët nën kontrollin e Satanit? **Po, të gjithë.**
17. Si mund të çlirohen fëmijët nga Satani? **Duke besuar te Jezusi si Shpëtimtari i tyre, njësoj si të tjerët.**
18. Si mendonte se do të mund të shkonte në qiell i riu pasanik? **Me anë të mirësisë dhe bindjes ndaj ligjeve të Perëndisë.**
19. Kush është i vetmi që është i mirë? **Jezusi (ose Perëndia).**
20. A mund të shkonte në qiell i riu pasanik, për shkak të mirësisë së tij, apo për shkak të bindjes ndaj ligjeve të Perëndisë? **Jo. Të gjithë njerëzit i kanë shkelur ligjet e Perëndisë dhe vetëm Perëndia është i mirë.**
21. Pse i riu pasanik u largua i trishtuar? **Sepse donte paratë më tepër sesa donte Perëndinë.**
22. A tha Jezusi se është mëkat të jesh i pasur? **Jo, nuk është mëkat të jesh i pasur, por është mëkat të duash pasuritë më tepër se Perëndinë.**
23. Çfarë është më e rëndësishme sesa të punosh për pasuritë e kësaj bote? **Të sigurohesh që ke e vendosur besimin te Jezusi, Çlirimtari.**
24. Kush vendos se kur do të vdesim? **Perëndia.**
25. Ku shkojnë njerëzit kur vdesin?
 - a. **Në qiell me Perëndinë.**
 - b. **Ose në ndëshkim të përjetshëm.**
26. A do të mund të çlirohet dikush nga vendi i ndëshkimit? **Jo, kur një person shkon në vendin e ndëshkimit, ai nuk do të shpëtojë kurrë.**
27. Kush i mashtron njerëzit se ku do të shkojnë pasi të vdesin? **Satani.**
28. Pse nuk e pranoi Jezusi ofertën e njerëzve që të bëhej mbreti i tyre? **Sepse ata donin që Jezusi t'i çlironte nga romakët. Ata nuk donin që Jezusi t'i shpëtonte nga pushteti i Satanit, mëkatit dhe vdekjes.**
29. Cili dishepull e tradhtoi Jezusin për para, duke e dorëzuar Atë tek armiqët? **Judë Iskarioti.**
30. Sa para mori Juda nga drejtuesit fetarë për t'i ndihmuar që ta arrestonin Jezusin? **Tridhjetë monedha argjendi.**

Përsëritje

Përko referencat me vargun e saktë.

1. Marku 9:7;
2. Efesianëve 2:8-9;
3. Gjoni 14:6;
4. Gjoni 11:25;
5. Gjoni 6:29;
6. Mateu 16:26;
7. Isaia 53:7;
8. Gjoni 1:11-12;
9. 1 Timoteut 2:5;
10. 1 Korintasve 15:3-4;
11. Romakëve 5:8;
12. Efesianëve 1:7.

5. Jezusi u përgjigj dhe u tha atyre: “Kjo është vepra e Perëndisë: të besoni në atë që ai ka dërguar”.

8. Ai erdhi në shtëpinë e vet dhe të vetët nuk e pranuan, por të gjithë atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e tij.

1. Pastaj erdhi një re dhe i mbuloi me hijen e vet; dhe nga reja doli një zë që tha: “Ky është Biri im i dashur; dëgjojeni!”.

9. Në fakt një është Perëndia, dhe një i vetëm është ndërmjetësi midis Perëndisë dhe njerëzve: Krishti Jezus njeri.

10. Sepse unë ju kam transmetuar para së gjithash ato që edhe unë vetë i kam marrë, se Krishti vdiq për mëkatet tona sipas Shkrimeve, se u varros dhe u ringjall të tretën ditë, sipas Shkrimeve.

7. I keqtrajtuar dhe i përlulur, nuk e hapi gojën. Si një qengj që e çojnë në thertore, si një dele e heshtur përpara atyre që i qethin nuk e hapi gojën.

3. Jezusi i tha: “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje”.

12. Në të cilin kemi shpengimin me anë të gjakut të tij, faljen e mëkateve sipas pasurisë së hirit të tij.

11. Por Perëndia e tregon dashurinë e tij ndaj nesh në atë që, kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne.

2. Ju në fakt, jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit, dhe kjo nuk vjen nga ju, po është dhurata e Perëndisë, jo nga vepra, që të mos mburret askush.

4. Jezusi i tha: “Unë jam ringjallja dhe jeta; ai që beson në mua, edhe sikur të duhej të vdesë do të jetojë”.

6. Ç’përfitim ka njeriu nëse fiton gjithë botën dhe pastaj e humb shpirtin e vet? Ose çfarë do të japë njeriu si shkëmbim të shpirtit të vet?

31. Kush po e drejtonte Judën që t’i ndihmonte drejtuesit fetarë për të vrarë Jezusin? **Satani.**
32. Pse e donte Satanin Jezusin të vdekur? **Sepse ai e dinte se Jezusi do t’i çlironte mëkatarët nga ai dhe do ta shkatërronte.**
33. Nga e dinte Jezusi që Juda kishte planifikuar ta tradhtonte? **Sepse Jezusi di gjithçka.**
34. Çfarë arsyeje tha Jezusi për vdekjen e Tij? **Ai do të jepte jetën e Tij në vend të mëkatarëve.**
35. A kishte bërë Jezusi diçka të gabuar? A meritonte Ai të vdiste? **Jo, Jezusi ishte i përsosur dhe nuk meritonte të vdiste.**
36. Çfarë bëri Jezusi kur drejtuesit fetarë gënjyen për Të? **Ai nuk u përgjigj.**
37. Pse kryepriifti dhe drejtuesit fetarë i thanë Jezusit që duhet të vdiste? **Ata thanë që Ai kishte folur kundër Perëndisë, sepse kishte pohuar se ishte Perëndi.**
38. Për kë e përdornin romakët kryqëzimin si ndëshkim? **Ata e përdornin për kriminelët më të këqinj.**
39. Pse tha Jezusi: “Perëndia im, Perëndia im, përse më ke braktisur?” **Ngaqë Perëndia po e ndëshkonte Jezusin për mëkatet tona dhe mëkatet e tërë botës.**
41. Çfarë nënkuptoi Jezusi kur tha: “U krye”? **Jezusi nënkuptoi që Ai e kishte kryer veprën që i ishte dhënë nga Ati i Tij. Kjo vepër ishte marrja mbi vete e ndëshkimit të plotë për mëkatarët.**
42. Për çfarë qëllimi frymëror i përdornin izraelitët delet? **Ata i përdornin për flijime.**
43. Pse nuk ishte më e nevojshme që të bëhej flijimi i kafshëve? **Sepse Perëndia u kënaq plotësisht me pagesën që bëri Jezusi për mëkatarët.**
44. Pse mungonte trupi i Jezusit në varr? **Perëndia e ngjalli Jezusin nga të vdekurit.**
45. Çfarë na tregon ringjallja e Jezusit? **Jezusi ishte Biri i Perëndisë dhe Çlirimtari, ashtu siç kishte thënë vetë.**
46. Si mund të falemi nga Perëndia dhe të marrim dhuratën e jetës së përjetshme? **Duke pranuar para Perëndisë që ne jemi mëkatarë të pashpresë dhe duke besuar vetëm te Jezusi që vdiq si pagesë për mëkatet tona dhe u ngjall nga të vdekurit për të na dhënë jetën e përjetshme.**

Pyetje për diskutim

1. Çfarë nënkuptoi Jezusi kur tha se ata që besojnë tek Ai nuk do të vdesin kurrë? **Jezusi nënkuptoi se ata nuk do të ndahen kurrë nga Perëndia në zjarrin e ndëshkimit të përjetshëm.**
2. Pse Satani do që njerëzit të besojnë te rimishërimi? **Ai do që ata të mendojnë se ata nuk do të vuajnë gjykimin për mëkatet e tyre, as ndarjen e përjetshme nga Perëndia në liqenin e zjarrit.**
3. A ka ndonjë mënyrë tjetër për te Perëndia për njerëzit e vendeve të tjera? **Jo, Jezusi është Shpëtimtari i vetëm për të gjithë njerëzit në çdo vend.**
4. Jezusi ishte Perëndi. Pse nuk i ndali drejtuesit fetarë që të mos e kryqëzonin? **Ai donte të vdiste për mëkatet tona. Ai ishte i vetmi që mund ta bënte këtë për ne, sepse Ai ishte i përsosur. Vetëm një njeri i përsosur mund të vdesë në vendin tonë. Perëndia duhet të bëhej njeri për të marrë vendin tonë.**
5. Ku është Jezusi tani? **Në qiell.**
6. Çfarë do të bëjë Jezusi kur të kthehet përsëri në tokë? **Ai do të jetë Gjykatësi Shumë i Lartë. Të gjithë ata që nuk janë penduar dhe që nuk kanë besuar te Jezusi dhe te pagesa e tij për ta, do të hidhen bashkë me Satanin dhe engjëjt e Tij në zjarrin e përjetshëm.**
7. Pse Jezusi u tha dishepujve të Tij të shkonin në mbarë botën dhe të predikonin ungjillin? **Në mënyrë që të gjithë njerëzit të mund të dëgjonin e të besonin te Jezusi, si dhe ta pranonin Atë si Shpëtimtarin e tyre.**



1 East Bode Road
Streamwood, Illinois 60107-6658 U.S.A.
www.awanainternational.org